

**DHUNA SEKSUALE DHE DHUNA E BAZUAR NË PËRKATËSINË
GJINORE NDAJ REFUGJATËVE, TË KTHYERËVE DHE PERSONAVE TË
SHPËRNGULUR INTERN**

Direktivat për parandalim dhe reagim

Maj, 2003

**KOMESARIATI I LARTË I
KOMBEVE TË BASHKUARA
PËR REFUGJATË**

PËRMBAJTJA

Parathënie	1
Hyrje	3
Kapitulli 1: Vështrim i dhunës seksuale dhe dhunës në bazë të përkatësisë gjinore	7
Mbrojtja e refugjatëve nga dhuna seksuale dhe dhuna në bazë të përkatësisë gjinore	8
Çka është dhuna seksuale dhe dhuna në bazë të përkatësisë gjinore ?	10
Definicioni i nocioneve kyçe	11
Llojet e dhunës seksuale dhe dhunës në bazë të përkatësisë gjinore	15
Ku dhe kur ndodh dhuna seksuale dhe dhuna e bazuar në përkatësinë gjinore?	19
Shkaqet dhe pasojat e dhunës seksuale dhe dhunës në bazë të përkatësisë gjinore.....	21
Pikat kyçe.....	25
Kapitulli 2: Direktivat	27
Direktivat programore.....	28
Direktivat individuale	29
Qasja multisektorale	31
Pikat kyçe.....	32
Kapitulli 3: Parandalimi i dhunës seksuale dhe dhunës në bazë të përkatësisë gjinore	33
Transformimi i normave socio-kulturore.....	35
Rindërtimi i sistemit të përkrahjes në familje dhe bashkësi	40
Krijimi i kushteve për përmirësimin e sistemit të përgjegjësisë	41
Planifikimi i shërbimeve efikase dhe kapaciteteve të vendosjes	42
Ndikimi në suazat formale dhe joformale ligjore	47

Mbikqyrja dhe dokumentimi i rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës në bazë të përkatësisë gjinore	50
Pikat kyçe.....	51
Kapitulli 4: Reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës në bazë të përkatësisë gjinore	53
Edukimi dhe informimi i bashkësisë.....	55
Stërvitja e akterëve në reagimin e nevojave të viktimave/të mbijetuarëve.....	55
Vendosja e mekanizmave të rekomandimit, raportimit, mbikqyrjes dhe vlerësimit	56
Aftësimi i bashkësive të refugjatëve për të reaguar	58
Zhvillimi i sistemit të reagimit për nevojat shëndetësore/medicinale të viktimave/mbijetuarëve.....	59
Planifikimi lidhur me plotësimin e nevojave psiko-sociale të viktimave/ të mbijetuarëve	60
Zhvillimi i sistemit të reagimit, i bazuar në mbrojtje dhe siguri.....	61
Vendosja e sistemit juridik/ gjyqësor i reagimit	62
Identifikimi i rolit të akterëve tjerë potencialë.....	65
Zhvillimi i planit të punës me fillestarët	67
Pikat kyçe.....	68
Kapitulli 5: Shqyrtimet speciale lidhur me fëmijët refugjatë.....	69
Direktivat	70
Grupet e fëmijëve të ikur, të cilëve iu kanoset rreziku nga dhuna seksuale dhe dhuna e bazuar në përkatësinë gjinore	71
Format specifike të dhunës seksuale dhe dhunës në bazë të përkatësisë gjinore që ushtrohen tek fëmijët.....	75
Shqyrtimet speciale lidhur me parandalimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi përkatësinë gjinore, që ushtrohen ndaj fëmijëve	77
Shqyrtimet speciale gjatë reagimit ndaj dhunës seksuale dhe dhunës në bazë të përkatësisë gjinore që ushtrohen ndaj fëmijëve	80

Pikat kyçe	85
Kapitulli 6: Kornizat për veprim	87
Përpilimi i planit të veprimit	87
Pikat kyçe.....	96
Kapitulli 7: Mbikqyrja dhe vlerësimi	97
Definimi i mbikqyrjes dhe vlerësimit	97
Qëllimet e mekanizmave të mbikqyrjes dhe vlerësimit	98
Tipet e mekanizmave për mbikqyerje dhe vlerësim	99
Projektimi i sistemit të mbikqyerjes dhe vlerësimit, për programet që kanë në shenjestër dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar në gjini	99
Shembuj të formularëve për raportim	103
Pikat kyçe	107
Kapitulli 8: Persekutimi në bazë të përkatësisë gjinore	109
Përndndjekja në bazë të përkatësisë gjinore, në kontest të nenit 1A(2) Konventës së vitit 1951, respektivisht Protokolit të saj, të vitit 1967, që ka të bëjë me statusin e refugjatëve	110
Shtojca 1: Kodi i mirësjelljes së UNHCR-së.....	123
Shtojca 1.1: Parimet themelore të Kodit të mirësjelljes	129
Shtojca 2: Formulari për paraqitjen e rasteve të dhunës	131
Shtojca 3: Formulari për raportim mujor - programi lidhur me dhunën seksuale dhe dhunës në bazë të përkatësisë gjinore.....	143
Shtojca 4: Formulari për historinë e sëmundjes dhe kontrollin mjekësor	145
Literatura plotësuese	149

PARATHËNIE

Në çdo bashkësi të botës ekzistojnë njerëz që pësojnë nga veprat jonjerëzore. Egërsitë, të cilat i kryejnë grupet e armatosura në konfliktet e ndërsjella, shpesh janë të reklamuar mirë, ndërsa deliktet e kryera prapa dyerëve të mbyllura, në objektet e viktimave, rrallëherë dëgjohen. Refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda territorit, të cilët nuk e gëzojnë mbrojtjen nga qeveritë e tyre, janë ndër ata që më së shumti iu ekspozohen akteve të dhunës, përfshirë këtu edhe dhunën seksuale dhe dhunën në bazë të përkatësisë gjinore.

Eshtë e njohur se dhuna seksuale dhe dhuna e ushtruar në bazë të përkatësisë gjinore, më së tepërmi ndodhë në mjediset ku mungojnë të drejtat njerëzore. Dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, vetëvetiu është shkelje e të drejtave njerëzore. Femërat dhe fëmijët, të cilët më së tepërmi i ekspozohen keqpërdorimit të drejtave njerëzore, janë ata të cilët edhe më së shumti pësojnë nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore.

Këto Direktiva ofrojnë këshilla praktike se si të hartohen planet strategjike dhe të njëjtat të zbatohen në praktikë me veprime aktive, të orientuara drejt parandalimit dhe reagimit ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Këto Direktiva, poashtu, përmbajnë të dhënat mbi të drejtat themelore të njeriut të lidhura për shëndetin, ligjshmërinë, sigurinë dhe të drejtat njerëzore, e të cilat janë relative për këto strategji dhe veprime.

Direktivat janë zhvilluar në këshillimet me partnerët e UNHCR-it për mbrojtjen e refugjatëve: qeveritë, agjencitë ndërqeveritare dhe organizatat joqeveritare. Ju janë dedikuar personelit të UNHCR-it dhe anëtarëve të partnerëve operacional, të përfshirë në veprimtarinë e mbrojtjes dhe ndihmës së refugjatëve dhe personave të zhvendosur intern. Janë ekzaminuar në 32 vende të botës, dhe me pjesëmarrjen e më tepër se 60 partnerëve.

Dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, është një problem shumë serioz, i cili duhet të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdretë. Ne i kemi përsosur disa vegla, të cilat mund të shërbejnë për parandalimin e kësaj dhune, dhe t'iu ndihmojnë atyre viktimave, të cilat nuk janë në gjendje ta ndalojnë këtë. Zbatimi efikas i këtyre veglave varet nga të gjithë ne, që punojmë me refugjatë dhe persona të zhvendosur.

Ruud Lubbers

Komisar i Lartë i Kombevet të Bashkuara për Refugjatë

HYRJE

Sfondi

Në vitin 1995, UNHCR-i për herë të parë botoi librin *Dhuna seksuale ndaj refugjatëve: Direktivat për parandalim dhe reagim*. Deri atëherë u pa qartë se madhësia dhe rëndësia e problemit kërkon një qasje të drejtpërdrejt për shqyrtim dhe se, veprimtaritë e bashkuara, të cilat deri në atë kohë nuk kishin një domethënie adekuate, as që ishin të përmbledhura në ndonjë botim të mëparshëm të UNHCR-it. *Direktivat* e botuara në vitin 1995, ndihmuan gjatë krijimit të vetëdijës dhe arsyes, lidhur me shkeljen serioze të të drejtave të njeriut, duke vënë bazë për zhvillimin e plan-programeve, në mënyrë që të parandalohet shkelja e të drejtave të njeriut, respektivisht se si të reagohet ndaj tyre në mënyrë adekuate. Megjithatë, dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore vazhdoi së ndodhuri me një intenzitet të pazvogluar në mesin e popullatës refugjate, e sidomos tek fëmijët dhe femrat. Tek këto bashkësi, gjendja u keqësua edhe më tepër, nga shkaku i raporteve jo të barabarta ndërmjet gjinive; ajo u përdor edhe si mjet lufte dhe imponim i vullnetit personal; e cila u tregua edhe si shkaktare e shpërnguljes së detyrueshme dhe si pasojë e tmerrshme e prishjes së strukturës familjare dhe e bashkësisë, e që e përcolli edhe më tej procesin e shpërnguljes. Këtë lloj të dhunës e kryejnw, poashtu, edhe disa persona të atillë, të cilëve ju është besuar detyra e mbrojtjes së refugjatëve dhe e të zhvendosurëve.

Nga viti 1995 janë mësuar shumë leksione mbi përgjegjësitë individuale, shtetrorë dhe institucionale, lidhur me zbatimin e *Direktivave* dhe ofrimin e mbrojtjes së personave që ishin të detyruar që të shpërngulen. Gjatë këtyre viteve UNHCR, agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, refugjatët, të kthyerit si dhe të zhvendosurit intern, vlerësuan programet dhe veprimtaritë e propozuara në *Direktivat*, në kuadër të situatave të ndërlikuara të krizave. Si pasojë e kësaj procedure të vlerësimit ishte «Konferenca ndëragjencionale mbi leksionet e mësuara, lidhur me parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjininë e individit, në rrethin e refugjatëve», mbajtur në mars të vitit 2001 në Gjenevë.

Pjesëmarrësit e Konferencës identifikuan lëmitë se ku duhen bërë ndryshimet, duke theksuar rëndësinë e revidimit të *Direktivave* nga viti 1995 dhe duke kërkuar që këto të përmbajnë avancimin e realizuar brenda viteve të fundit, dhe që të përsoset qasja multisektoriale dhe ndëragjencionale ndaj dhunës dhe dhunës së bazuar në gjininë e të shpërngulurëve, të kthyerëve dhe të zhvendosurëve intern. Rekomandimet e kësaj Konference përfshijnë: shtimin e angazhimit të institucioneve për krijimi e Kodit të mirësjelljes, kushtuar punëtorëve humanitarë; përcaktimin e standardeve më të ulëta dhe të pranueshme, lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore; përkrahjen e ndarjes dhe qeverisjes me mjetet dhe personelin adekuat; dhe përkrahjen e perspektivës së barabarsisë ndërmjet gjinive në praktikën e përditshme institucionale. Pjesëmarrësit theksuan nevojën për angazhimin e bashkësisë së refugjatëve nëpër të gjitha etapat e realizimit të programit: në planifikim, në realizim, mbikqyerje dhe vlerësim.

Gjatë përcjelljes së mëtejme të rekomandimeve nga Konferenca, këto *Direktiva për pengimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës ndaj refugjatëve, të kthyerëve dhe personave të zhvendosur internë*, janë zhvilluar përmes konsultimeve të ndër-agjencive. Janë verifikuar në terren, në 32 vende të botës, me pjesëmarrjen e 60 partnerëve operativ kyç.

QËLLIMI I DIREKTIVAVE

Këto *Direktiva* iu janë kushtuar personelit të UNHCR-së, agjencioneve të Kombeve të Bashkuara, organizatave ndër-qeveritare dhe joqeveritare, si dhe organizatave qeveritare- vendeve mikpritëse, të cilat ju ofrojnë përkrahje dhe ndihmë refugjatëve dhe personave, për të cilët interesohet UNHCR-i. Ato, poashtu, ju janë përkushtuar orientimeve të veprimtarisë për parandalimin e dhunës, respektivisht reagimit ndaj dhunës, inicuar nga ana e vet bashkësive së refugjatëve. Ato i studjojnë shkaktarët dhe faktorët kryesorë që i kontribuojnë dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duke propozuar veprimtari praktike për parandalimin e dhunës, respektivisht reagime ndaj këtij lloji të dhunës. *Direktivat* ofrojnë qasje të freskët ndaj këtij problemi, me vetë faktin se e kuptojnë që dhuna seksuale dhe dhuna mbi përkatësinë gjinore, rrjedhë dhe zgjerohet edhe nga marrëdhëniet jo të barabarta të influencës ndërmjet femrave dhe meshkujve, andaj ato përpiqen për partneritet strategjik- duke përfshirë edhe atë në mes të femrave dhe meshkujve, në mes të organizatave joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat merren me të drejtat e njeriut, UNHCR-së, si dhe agjencitë e tjera pranë Kombeve të Bashkuara dhe shteteve – për promovimin e ndryshimeve. Ato, poashtu, theksojnë rëndësinë e kyçjes së bashkësive të refugjatëve, sidomos grave dhe fëmijve, në procesin e planifikimit, realizimit dhe vlerësimit të veprimtarive dedikuar pengimit, respektivisht reagimit ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi përkatësinë gjinore.

Duke iu përshtatur konteksteve dhe rrethanave të ndryshme, *Direktivat* ofrojnë kornizë për zhvillimin e strategjive efikase të pengimit dhe reagimit; ato nuk ofrojnë një tërësi themelore të veprimtarive, që do t'i përgjigjeshin çdo situatë të mundshme. Me që parandalimi dhe reagimi, ndaj problemit të ndërlikuar të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, kërkojnë bashkëpunim, interdisciplinar, multisektoral dhe ndër-agjencional, *Direktivat*, poashtu, nxisin shqyrtim dhe arsyetim në mes të organizatave dhe kolegëve të punës. Ato duhet ta plotësojnë, e jo ta zëvendësojnë ndonjë material tjetër për stërvitje.

PËRMBAJTJA E DIREKTIVAVE

- Kapitulli 1** Pasqyron të dhënat themelore mbi dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar mbi përkatësinë gjinore, mbi shkaqet kryesore të saj, faktorët dhe pasojat.
- Kapitulli 2** Ofron direktiva, që janë bazë për të gjitha përpjekjet për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, si dhe suazat për qasje multisektoriale dhe kolaborative ndaj këtij problemi.
- Kapitulli 3** Rekomandon strategjinë e parandalimit dhe zvoglimit, respektivisht menjanimin e shkaqeve dhe faktorëve, që i kontribuojnë ekzistimit të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.
- Kapitulli 4** Përshkruan mënyrën e rivendosjes së sistemit multisektorial të reagimit, në kontestin e dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në përkatësinë gjinore.
- Kapitulli 5** Përshkruan elementet e veçanta që duhet pasur parasysh gjatë ofrimit të ndihmës fëmijëve të mbijetuar, respektivisht atyre që iu kanoset rreziku i dhunës seksuale dhe i dhunës mbi baza të përkatësisë gjinore.
- Kapitulli 6** Ofron këshilla praktike se si duhet të zhvillohet plani i aksionit, i cili shtohet nga vetë fuqia ekzistuese, në situatën e dhënë.
- Kapitulli 7** Shqyrton mekanizmat e kontrollit dhe vlerësimit, duke ofruar tregues për matjen e veprimit, kushtuar mbrojtjes nga dhuna dhe dhuna mbi baza të përkatësisë gjinore.
- Kapitulli 8** Shpjegon nocionin e dëbimit i bazuar në përkatësinë gjinore dhe si duhet zbatuar në punë me personat që kërkojnë azil.

Lexuesit janë të orientuar kah burimet plotësuese, gjithkund ku janë relative, për të fituar informacione detale për tema specifike. Titujt e këtyre materijaleve doracake gjenden gjithkund nën hije, në tekstin me titull "**Shiko poashtu**". Shembujt e formularëve që mund t'i përshtatën përdorimit në situata specifike, janë pjesë e Shtojcës. Regjistri detal i literaturës plotësuese gjendet pas shtojcës. Verzionet elektronike të dokumenteve përkatëse gjenden në CD-ROM, që është pjesë përcjellëse e këtyre *Direktivave*.

TERMAT KYÇE

Këto *Direktiva* zbatohen në situata ku qëndrojnë refugjatët, të kthyerit, të zhvendosurit intern, respektivisht personat që kërkojnë azil. Edhe pse mandati dhe veprimtaritë e UNHCR-së mund të dallohen, kur është fjala për refugjatët dhe personat e zhvendosur intern, personat e tjerë juridikë, siç është qeveria e vendit nikoqir, organizatat joqeveritare apo agjencionet e tjera pranë Kombeve të Bashkuara, mund t'i mbrojnë dhe t'i ofrojnë ndihmë si refugjatëve, ashtu edhe personave të zhvendosur.

Për çështje praktike, termi **refugjat** ka të bëjë me personat që kërkojnë azil, si dhe personat e zhvendosur intern, të gjinisë mashkullore dhe feëmrore, fëmijve dhe të rriturëve. Ngjashëm me këtë, termi vendosja e refugjatëve ka të bëjë me objektet tranzitore, qendrat e strehimit, kampet e refugjatëve, institucionet për paraburgim të personave që kërkojnë azil, vendosja e përkohshme gjatë procesit të repatriacionit dhe qendrat që i tubojnë personat e zhvendosur intern. Edhe pse pjesa më e madhe e rekomandimeve, lidhur me vendosjen e refugjatëve, mund të zbatohen, si në mjediset e fshatrave ashtu edhe në atë të qyteteve, në situatat kur kjo është e domosdoshme, janë caktuar veprimtari specifike që kryhen në rrethanat specifike.

Termi **viktimë/personat që kanë mbijetuar (dhunën seksuale)** i takon individëve ose grupeve që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar mbi përkatësinë gjinore. Deri sa ndaj refugjatëve, në çdo rast, duhet sjellur me dhimbësuri dhe ndjenja, sjellja ndaj tyre sikur ndaj të mbijeturëve, do të thotë pranim i forcës dhe qëndrueshmërisën së tyre. Megjithatë, ndodhë që viktima e dhunës seksuale dhe e dhunës mbi baza gjinore mbetet viktimë, krahas përpjekjeve personale dhe përkrahjes nga jashtë. Në disa kontekste juridike të caktuara, termi viktimë është i përshtatshëm edhe/ose bile i obligueshëm, për shkak të ligjeve relevante, në rastet kur kërkohet dëshpërbim përmes drejtësisë. Ndërsa, në situata jojuridike, fjala viktimë, mundet të marrë kuptimin e personit të paaftë dhe të njollosur, por një përshkrim të tillë të vetive të karakterit, duhet flakur nga të gjithë ata që merren me këtë tematikë. Por, për ta kuptuar më mirë këtë gjëendje faktike, në këtë punim, do të përdorën që të dy termet.

Edhe pse burrat dhe djemt, shpeshëherë janë viktimë/ persona që e kanë mbijetuar dhunën seksuale, statistikat vërtetojnë se gratë dhe vajzat janë më shpesh viktima/ persona të mbijetuar. Për pranimin e këtij realiteti, **Direktivat shërbejnë me gjininë femrore gjatë përshkrimit të viktimave/personave që e kanë mbijetuar këtë lloj dhune.**

Termi **akterët** ka të bëjë me individët, grupet, organizatat dhe institucionet, që janë të angazhuara në parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Akterë mund të jenë refugjatët, popullata lokale, të punësuarit në ndonjë agjenci të Kombeve të Bashkuara ose vullnetarë në këto agjenci, organizatat joqeveritare, institucionet shtetore, donatorët, si dhe anëtarët e tjerë.

KAPITULLI 1

VËSHTRIM I DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS NË BAZË TË PËRKATËSISË GJINORE

Dhuna seksuale dhe dhuna në bazë të përkatësisë gjinore është shkelje e të drejtave njerëzore. Ky lloj i dhunës po e zgjatë jetën përmes roleve stereotipe të gjinive, e që nëpërkëmbin krenarinë njerëzore dhe e pamundësojnë zhvillimin njerëzor. Pjesa dërmuese e viktimave/individëve që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, janë gra dhe vajza.

Dhuna seksuale dhe dhuna e bazuar në përkatësinë gjinore, nënkupton shumë më tepër, se sa sulmi dhe çnderimi. Edhe pse mund të ndodhi në vende publike, më së tepërmi i është dhënë vërejtje qëndrimeve të disa individëve, të cilët heshtazi miratojnë dhunën në familje, bashkësi dhe shtet. Është më se e domosdoshme që të kuptohen shkaqet dhe pasojat e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, para se të planifikohen programet e përshtatshëm për parandalimin dhe reagimin e këtij lloji të dhunës.

Sikur agjencioni i Kombeve të Bashkuara, që merret me çështjen e refugjatëve, UNHCR-i iu ofron mbrojtje ndërkombëtare refugjatëve, siç i sygjeron mandati i tij. Në këtë mënyrë, UNHCR-i, së bashku me shtetet e ndanë përgjegjësinë për mbrojtjen e refugjatëve nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi përkatësinë gjinore.

Disa fakte të lidhura me dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar mbi përcaktueshmërinë gjinore

- Në tërë botë, përafërsisht 40 deri 70 për qind e vrasjeve të grave është kryer nga partenerët e tyre intim, shpesh në kontestin e marrëdhënieve, ku ka ekzistuar keqtrajtimi.
- Në tërë botën, të paktën njëra nga tri gratë ka përjetuar rrahje, seks të dhunshëm ose ka qenë e keqtrajtuar në ndonjë mënyrë tjetër.
- Pjesëmarrja në trafikimin e njerëzve është shtuar për afro 50 për qind, ndërmjet viteve 1995 dhe 2000. Organizata ndërkombëtare për migrim (IOM), vlerëson se gjatë një viti deri në 2 milionë gra bëhen viktimë e trafikimit me njerëz dhe, në këtë kontest, kalojnë kufij të ndryshëm.
- Më tepër se 90 milionë gra dhe vajza të Afrikës janë viktimë e gjymtimeve të organeve seksuale të femrave.
- Të paktën 60 milionë vajza, të cilat do të duhej të ishin gjallë, trajtohen si të zhdukura nga popullatat e ndryshme, kryesisht në Azi, si shkak i dështimeve-abortimeve, të bazuara në gjinën e fëmijës, fëmijëvrasjeve ose moskujdesit.
- Viteve të fundit, gjatë luftërave, dhunime masovike janë dokumentuar në Bosnje, Kamboxhë, Liberi, Peru, Somali dhe Ugandë. Ekipi nga Unioni Evropian, detyrë e të cilit ishte që të verifikojë të dhënat, vlerëson se, gjatë luftës në Bosnje, janë dhunuar më tepër se 20.000 femëra myslimane.
- 95 për qind e familjeve të shpërngulura dhe të anketuara në Siera Leone, i kanë paraqitur rastet e sulmeve seksuale, përfshirë këtu dhunimin,

torturimin dhe robërinë seksuale. Të paktën 250.000, e është e mundur edhe 500.000 femëra janë dhunuar gjatë gjenocidit në Ruandë, në vitin 1994.

Marrë nga: "Dhuna ndaj femërave: Barra shëndetësore e fshehur" (Banka Botërore 1994)

Raporti mbi dhunën i bazuar mbi përkatësinë gjonore: Raporti mbi të dhënat në dobi të ndërmarrjes së hapave vendimtare (L. Heise, IËTC, 1992) dhe

Përparimi i grave në tërë botën (UNIFEM, 2000)

MBROJTJA E REFUGJATËVE NGA DHUNA SEKSUALE DHE DHUNA E BAZUAR NË PËRKATËSINË GJINORE

Të gjitha krijesat njerëzore janë të lindura të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta

Deklarata univerzale e të drejtave të njeriut
Asambleja e Përgjithshme e KB
10 dhjetor 1948.

Pengimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar mbi baza gjinore direkt është e lidhur me mbojtjen e të drejtave të njeriut.

Të drejtat e njeriut janë univerzale, të patjetërsueshme, të pandara, të lidhura në mes vete dhe të varura në mënyrë reciproke. Çdo individ, pa marrë parasysh racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, besimin, mendimin politik apo mendimin tjetër, prejardhjen nacionale apo shoqërore, pasurinë, fisin apo prestigjin, ka të drejtë në respekt, mbrojtje, kryerjen dhe gëzuarjen e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shtetet janë të detyruara që të sigurojnë, në mënyrë të barabart, gëzuarjen e të gjitha të drejtave ekonomike, shoqërore, kulturore, qytetare dhe politike të grave, burrave, vajzave dhe djemve.

Veprat e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, shkelin një numër të madh të drejtave të njeriut, të cilat janë të garantuara përmes instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në mes tjerash, këto të drejta, janë:

- E drejta për jetë, liri dhe siguri personale.
- E drejta në standardin më të lartë të shëndetit fizik dhe shpirtëror.
- E drejta për përjashtim nga torturat, sjelljet e egra, jonjerëzore dhe të përlules ose dënimit.
- E drejta për lëvizje të lirë, mendim, shprehje dhe shoqërim të lirë.
- E drejta për martesë me pëlqim të lirë dhe të kompletuar, si dhe të drejtat e barabarta në vetë martesën, gjatë zgjatjes së kurorës dhe prishjes së saj.
- E drejta për shkollim, sigurim social dhe zhvillim personal.
- E drejta për pjesëmarrje në ngjarjet kulturore, politike dhe publike, me qasje të barabart në shërbimet publike, të drejtën për punë si dhe pagesë të njëjtë.

Disa instrumente ndërkombëtare merren në mënyrë specifike me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore tek gratë dhe vajzat. **Kongresi mbi eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimit ndaj grave**, të cilin e miratoi Asambleja e Përgjithshme më 1981, **Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi eliminimin e dhunës ndaj grave**, të cilën e miratoi Asambleja e Përgjithshme, më 1993, dhe **Deklarata e Pekinit dhe tribuna për aksion**, që u miratua në Pekin, më 1995, nënkuptojnë të gjitha llojet e diskriminimit si dhunë ndaj grave dhe vajzave, duke vërtetuar përgjegjësinë e shteteve që të punojnë në eliminimin e kësaj dhune. Kohëve të fundit, **Rregullorja e Romës e Gjykatës Ndërkombëtare Penale** e vitit 1998, dhunën, robërinë seksuale, prostitucionin e dhunshëm, shtatzaninë e detyruar, sterilizimin e detyruar dhe çdo formë tjetër të dhunës seksuale, e përshkruan si vepër penale, që për nga pesha e veprës, mund të krahasohet me krimin kundër njerëzimit. **Rezoluta 1325 e Këshillit**

të Sigurimit e Kombeve të Bashkuara (2000), thekson përgjegjësinë e shteteve që më të mos lejojnë që krimi kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, duke përfshirë edhe dhunën seksuale dhe llojet e tjera të dhunës ndaj grave e vajzave, të kalojnë pa u ndëshkuar.

(Këshilli Ekzekutiv i UNHCR-së)... E dënon dhunën e bazuar në përkatësinë gjinore dhe të gjitha llojet e diskriminimit, me arsyetim se në këtë mënyrë seksi orientohet kah refugjatet, gratë dhe vajzat e shpërngulura, duke i ftuar shtetet që të sigurojnë mbrojtje për të drejtat dhe integritetin e tyre fizik dhe psikologjik, si dhe që të vetëdijsohen për këto të drejta.

Konkluzë e Këshillit Ekzekutiv, nr. 85 (XLIX), 1998

Kombet e Bashkuara, agjencitë që merren me të drejtat e njeriut dhe agjencitë humanitare, së bashku me shtetet e ndajnë këtë përgjegjësi për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Si Agjenci e Kombeve të Bashkuara, e cila merret me çështjen e refugjatëve, UNHCR-i ka mandat që t'i sigurojë dhe t'iu ofrojë refugjatëve mbrojtje ndërkombëtare, duke kërkuar zgjidhje të përhershme për problemet e tyre. Në këtë mënyrë, UNHCR-i dhe shtetet, ndajnë përgjegjësitë për mbrojtjen e refugjatëve nga dhuna seksuale dhe dhuna e bazuar mbi përkatësinë gjinore.

Definicioni i UNHCR-së për mbrojtje

Të gjitha veprimtaritë e drejtuara kah sigurimi i qasjeve të barabarta për të drejtat e grave, burrave, vajzave dhe djemëve, që janë me rëndësi për UNHCR-in, si dhe mundësia e gëzimit të këtyre të drejtave, në pajtim me ligjet relevante (e drejta ndërkombëtare humanitare si dhe dispozitat që i takojnë të drejtave të njeriut dhe ligjeve që kanë lidhshmëri me refugjatët).

Në situatat, ku asgjë nuk është ndërmarrë për parandalimin, respektivisht reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza ligjore, UNHCR-i, si pjesë e veprimtarive të veta themelore, duhet të udhëheqi në vendosjen e mbrojtjes dhe të përshtatjes së ndihmës, që ka të bëjnë me këtë lloj të dhunës. Kjo nënkupton përpjekjet në dobi të refugjatëve, dhënien e këshillave shteteve se si duhet ta harmonizojnë legjislacionin e vet me standardet ndërkombëtare, duke marrë masa për zvoglimin e rrezikut të trafikut me njerëz, rrezik ky që po bëhet gjithnjë e më serioz, në rastet e shpërnguljes së individëve.

Trafikimi me qeniet e gjalla nënkupton rekrutimin, bartjen, transferin, fshehjen ose strehimin e individëve, përmes kërcnimeve ose përdorimit të forcës apo të ndonjë mënyre tjetër të detyrimit, si dhe nepërmjet kidnapimit, mashtrimit, gënjimit, keqpërdorimit të pozitës qeveritare, ose nepërmjet pagesës apo kompenzimit për blerjen e personit, i cili ka kontrollë mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit. Eksploatimi nënkupton, të paktën, shfrytëzimin e personave tjerë për prostitucion, ose forma tjera të eksploatimit seksual, shërbimeve ose punëve të detyrueshme, robërinë ose të një praktike ngjashëm me te, si dhe nënshkrimin dhe heqjen e organeve trupore.

Protokoli për pengimin, frenimin dhe dënimin e trafikimit me njerëz, sidomos me femëra dhe fëmijë, i cili i plotëson vendimet e Kongresit të Kombeve të Bashkuara, kundër kriminalitetit transnacional të organizuar, nëntor 2000

Shiko poashtu:

- **Kongresi i Kombeve të Bashkuara kundër kriminalitetit të organizuar transnacional (2000)**
- **Rregullorja e Romës e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (1998)**
- **Deklarata e Pekinit dhe tribuna për aksion (1995)**
- **Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi zhdukjen e dhunës ndaj grave (1994)**
- **Kongresi kundër mundimeve dhe llojeve tjera të torturave, sjelljeve poshtuese dhe jonjerëzore ose dënimeve (1984)**
- **Kongresi mbi eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimit ndaj femrave (1979)**
- **Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të drejtat qytetare dhe politike (1966)**
- **Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore (1966)**
- **Dekretligji i zyrës së UNHCR-it, Rezoluta 428(v) (1950)**
- **Deklarata Univerzale mbi të drejtat e njeriut (1948).**

ÇKA ËSHTË DHUNA SEKSUALE DHE DHUNA NË BAZË TË PËRKATËSISË SEKSUALE?

Dhuna seksuale, dhuna mbi përkatësinë gjinore dhe dhuna ndaj femrave janë termine, të cilët gjatë përdorimit, shpesh tregojnë të njëjtën çështje. Të gjitha këto shprehje i takojnë shkëlqes së të drejtave themelore të njeriut, duke i shtuar jetë roleve stereotipe, të bazuara në gjininë e individit dhe, në këtë mënyrë, individët i zhveshin nga dinjiteti njerëzor dhe vetëvendosja, duke penguar kështu zhvillimin njerëzor. Këto kanë të bëjnë me të padrejtat fizike, seksuale dhe psikologjike, që e mbështesin varësinë e femrës, duke ia shtuar periudhën kohore ndikimit dhe kontrollit të mashkullit mbi to.

Deri sa dhuna e bazuar në përkatësinë gjinore ka ndikim shkatrrues në jetën e grave dhe vajzave, që e përbëjnë shumicën e viktimave/ të mbijetuarëve, kjo e pengon edhe zhvillimin e burrave dhe djemëve. Eliminimi i dhunës dhe i pabarazisë, bazuar në përkatësinë gjinore, ndihmon që të forcohet e tërë bashkësia.

Termi **dhuna e bazuar mbi përcaktësinë gjinore** përdoret në mënyrë që të dallohet dhuna e përgjithshme nga dhuna e cila i godet individët apo grupet individësh, varsisht nga përkatësia e tyre gjinore. Dhuna e bazuar në përkatësinë gjinore është definuar nga ana e Këshillit CEDAW, si dhunë e drejtuar kah individit ose grupe individësh, në bazë të përkatësisë së tyre gjinore ose gjinisë së tyre gjenetike. Këtu përfshihen edhe veprat që shkaktojnë padrejtësi apo vuajtje fizike, shpirtërore ose seksuale, kërcnim, detyrime ose forma tjera të privimit nga liria.

Termi **dhuna ndaj femrës** ka të bëjë me çfardo veprë të dhunës, bazuar në përkatësinë gjinore, e që ka për pasojë ose sigurisht do ta ketë si pasojë të padrejtën

fizike, seksuale apo psikologjike, të ushtruar mbi gratë dhe vajzat, qoftë kjo dhunë të ketë ndodhur në situata private apo publike.

Dhuna seksuale, përfshirë këtu edhe **eksploatimi e keqtrajtimi**, ka të bëjë me çfardo veprë seksuale, tentim apo kërcnim, që ka për pasojë ose sigurisht që do ta ketë si pasojë të padrejtën fizike, psikologjike dhe emotive. Dhuna seksuale është formë e dhunës, që bazohet në përkatësinë gjinore .

UNHCR-i e shfrytëzon nocionin gjithëpërfshirës **dhuna seksuale dhe dhuna në bazë të përkatësisë gjinore**, duke marrë parasysh faktin se djemt, si dhe meshkujt e rritur, mund të jenë viktimë e dhunës seksuale dhe e dhunës mbi përkatësinë gjinore, edhe pse gratë dhe fëmijët përbëjnë numrin më të madh të viktimave/të mbijetuarëve. **Definicioni i zgjeruar i dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, me të cilin shërbehet UNHCR-i dhe partnerët e tij ekzekutivë** (bazuar në nenet 1 dhe 2 të Deklaratës së Asamblesë së Përgjithshme të KB mbi Eliminimin e dhunës ndaj femrave (1993) dhe Rekomandimin 19, paragrafi 6, nga mbledhja e 11 e Këshillit CEDAW)

... dhuna e bazuar mbi përkatësinë gjinore është dhunë e drejtuar kundër ndonjë individi, si rrjedhim i përkatësisë gjinore ose gjinisë gjenetike. Kjo nënkupton veprimet, të cilat shkaktojnë padrejtësi dhe vuajtje fizike, shpirtërore ose seksuale, klërcnim, detyrim dhe forma të tjera të privimit nga liria... Deri sa gratë, burrat, djemt dhe vajzat mund të jenë viktimë e dhunës seksuale, bazuar në përkatësinë gjinore, gratë dhe vajzat janë viktimë më e shpesht e kësaj dhune.

... do të përfshijë, por jo edhe të jetë e kufizuar si vijon:

- a) Dhuna fizike, seksuale dhe psikologjike **brenda familjes**, duke përfshirë këtu rrahjen, shfrytëzimin seksual, keqtrajtimin seksual të fëmijëve në familje, dhuna që lidhet me miraz, përdhunimin në martesë, lëndimin e organe gjenitale të femrës si dhe zakonet e tjera tradicionale që e dëmtojnë femrën, dhuna nga pala tjetër që nuk është bashkëshort dhe dhuna që lidhet me shfrytëzimin.
- b) Dhuna fizike, seksuale dhe psikologjike **në rrethin e gjerë të bashkësisë**, përfshirë këtu përdhunimin, keqtrajtimin seksual, sulmin seksual dhe frikën në vendin e punës, në institucionet arsimore dhe vendet e tjera, trafikun me femra dhe prostitucionin.
- c) Dhuna fizike, seksuale dhe psikologjike **e kryer apo e pranuar heshtazi nga ana e shtetit dhe institucionet e tij**, pa marrë parasysh se ku ka ngjarë ajo.

Dhuna seksuale dhe dhuna mbi bazë të përkatësisë gjinore më së tepërmi është rrënjosë në marrëdhëniet e pabarabarta të forcës ndërmjet gjinive. Këto marrëdhënie ia zgjatin jetën dhunës brenda familjes, bashkësisë dhe shtetit, duke e pranuar në heshtje. Dallimi ndërmjet sferave publike dhe private, nuk duhet të shërbejë si preteks për injorimin e problemit të dhunës në familje, si formë e dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në përkatësinë gjinore. Përrjashtimi i grave dhe i vajzave nga jeta publike, vetëm sa e shton nënshtrimin e tyre për dhunë brenda familjes. **Dhuna brenda familjes** e shton diskriminimin, bazuar në përkatësinë gjinore, duke i mbajtur femrat në një pozitë nënshtruese, në krahasim me meshkujt.

Shiko poashtu:

- **Raportet mbi popullsinë: Fund dhunës ndaj femrave (Universiteti Johns Hopkins, Shkolla e shëndetësisë 1999)**
- **Dhuna ndaj femrave: Barra e fshehur e shëndetësisë (Banka Botërore 1994).**

DEFINICIONI I NOCIONEVE KYÇE

Dhuna seksuale dhe dhuna e bazuar mbi përkatësinë gjinore përfshinë në vete shumë më tepër se sa të sulmuarit dhe përdhunimi. Për t'i kuptuar shkaqet dhe pasojat themelore të saj, është e nevojshme t'i definojmë nocionet *përcaktueshmëria gjinore dhe gjinia gjenetike*.

Shprehja **seksi gjenetik** ka të bëjë me *karakteristikat biologjike* të meshkujve dhe femrave. Këto karakteristika janë të lindura, ndërsa dallimet në mes tyre janë të përkufizuara në funksionet fiziologjike-reproduktive.

Përcaktimi gjinor është nocion, i cili shpreh *karakteristikat shoqërore*, të cilat iu caktohen meshkujve dhe femrave. Këto karakteristika shoqërore formohen në bazë të shumë faktorëve, siç është moshja, përkatësia fetare, kombëtare, etnike dhe shoqërore. Ato dallohen si brenda, ashtu edhe ndërmjet kulturave, duke definuar veçorinë individuale, pozitën në shoqëri, rolet, detyrat dhe raportet e aftësisë në mes të anëtarëve të asaj shoqërie apo kulture. Përcaktimi gjinor mësohet përmes socializimit. Ajo nuk është statike as edhe natyrale, por zhvillohet dhe reagon në ndryshimet e rrethanave shoqërore, politike e kulturore.

Përcaktimi gjinor mësohet, andaj mundet edhe të ndërrohet.

Njerëzit lindin si femra apo si meshkuj (gjinia gjenetike); mësohen se si të bëhen vajza e djem dhe atëherë bëhen gra dhe burra (përcaktimi gjinor). Përcaktimi gjinor ka të bëjë me domethënien e nocionit djalë apo vajzë, grua apo burrë, në shoqërinë apo kulturën e caktuar.

Shoqëria i mëson anëtarët e vet mbi qëndrimet që priten nga ata, si dhe cilat sjellje, role dhe veprimtari duhet t'i përvetsojnë. Përcaktimi gjinor definon rolet, detyrat, përkufizimet, mundësitë dhe privilegjet e meshkujve dhe të femrave, në çfardo kontesti qoft. Ky lloj i sjelljes së mësuar quhet **identiteti gjinor**.

Në tërë botën femrat, kryesisht, gjenden në pozitë të pavolitshme, në krahasim me meshkujt të një niveli shoqëror dhe ekonomik. Rolet dhe vetitë personale, të bazuara në përcaktimin gjinor, tërheqin pas vetes pabarazi dhe debalanc të ndikimit ndërmjet femrës dhe mashkullit. Dhuna ndaj femrës dhe miratimi i kësaj dhune brenda kulturave dhe shoqërive, është njëra nga mënyrat ku manifestohet pabarazia dhe debalanci ndërmjet gjinive.

Plani gjithëpërfshirës për pengimin dhe reagimin duhet drejtuar kah rolet dhe nevojat si të femrave ashtu edhe të meshkujve, duke zhvilluar mënyrat, të cilat do t'iu mundësonin që të jenë subjekt i ndryshimeve. **Përqëndrimi ekskluziv ndaj femrave, kur bëhet fjalë për dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, përgjegjësia për pengimin dhe reagimin ndaj kësaj dhune, i apostrofohet viktimave/ të mbijetuarëve.**

Dhuna është mjet, përmes së cilës bëhet kontrollimi dhe tiranizimi, që nënkupton dhunën, detyrimin dhe presionin emocional, shoqëror dhe ekonomik, si dhe keqtrajtimin fizik. Kjo mund të jetë e dukshme, në formë të sulmit fizik ose kërcnimit me armë; mund të jetë edhe e fshehtë, në formë të frikësimit, kërcnimit, mashtrimit, ndjekjes, ose të marri ndonjë formë tjetër psikologjike apo të presionit shoqëror. Personi, i cili shtë në nishan të këtij lloji të dhunës, detyrohet që të sillet ashtu, siç kërkohet nga ajo, respektivisht të veproi kundër dëshirës së vet, si pasojë e frikës.

Dhuna është veprim apo i shumë veprimeve të dëmshme, të kryera nga individi apo grupi, që e kryejnë veprën ndaj një personi apo grupi të individëve. Mund të nënkuptohen lloje të ndryshme të dhunës dhe të veprimeve të përsëritura të dhunës, gjatë një periudhe të caktuar, dhe të ketë kohëzgjatje të ndryshme. Mund të zgjasi disa minuta, disa orë, disa ditë ose gjatë gjithë jertës.

Keqtrajtimi është keqpërdorim i ndikimit, përmes të cilit kryesi veprës venë kontroll apo përparësi ndaj personit të keqtrajtuar, duke i shkaktuar dhembje fizike apo psikologjike, ose frikë nga këto dhembje. Keqtrajtimi i pengon individët që të marrin vendime të drejta, duke i detyruar që të veprojnë kundër dëshirave të veta.

Detyrimi është shtrëngim ose tentim i shtrëngimit të personit tjetër, që të veprojë kundër dëshirës së vet, përmes kërcnimit, insistimit verbal, manipulimit, mashtrimit ose influencës ekonomike e kulturore.

"[Dhuna ndaj femrave]... është shfaqje e pabarazisë historike e raportit të forcave ndërmjet femrave dhe meshkujve, që ka sjellë deri tek dominimi i mashkullit ndaj femrës dhe deri tek diskriminimi i saj nga ana e meshkujve, që si pasojë ka pengimin e plotë të përparimit të femrës, dhe faktin se dhuna ndaj femrave është njëri nga mekanizmat vendimtar, përmes të cilit femrat detyrohen që ta pranojnë pozitën e nënshtrimit, në krahasim me meshkujt. "

*Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi eliminimin e dhunës ndaj femrave
23 shkurt 1994*

Ndikimi do të thotë aftësia e marrjes së vendimit. Përdorimi i indikimit ka influencë në të gjitha marrëdhëniet ndërnjerëzore. Kur ndikimi përdoret në marrjen e vendimeve, lidhur me jetën personale, ai afirmohet në vetëlejim dhe vetërespektim, që pastaj nxitë shtimin e respektit dhe miratimin e të tjerëve njësoj si të vetin. Kur të përdoret për dominim, ndikimi i imponon obligimet, përkufizon, ndalon dhe bie vendime mbi jetën e të tjerëve. Që dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore të parandalohet në mënyrë efikase, është e domosdoshme të analizohen dhe kuptohen raportet e forcës ndërmjet femrave dhe meshkujve, ndërmjet gruas dhe grave të tjera, mashkullit dhe meshkujve të tjerë, të rriturëve dhe fëmijve dhe në mes të fëmijëve.

Në situatat e krizës humanitare, popullatat e goditura varen nga mbrojtja dhe ndihma e institucioneve. Punëtorët e ndihmës humanitare, funksionarët e qeverisë, shërbimet e sigurimit dhe policia gjenden në pozita privilegjuese, me që e kanë forcën e nxjerrjes së vendimeve, që ndikojnë në mirëqenien e personave, të cilëve ju ndihmojnë.

Ekspluatimi dhe keqtrajtimi ndodhin në rastet kur ky debalanc i forcave

keqpërdoret në dëm të atyre personave, të cilët nuk janë në gjendje të bisedojnë, as të marrin vendime në mënyrë të barabart.

Eksplotimi dhe keqtrajtimi mund të marrin formën e forcës fizike dhe psikologjike ose forma tjera të detyrimit (kërcnimit, bindjes, mashtrimit ose shantazhit) me qëllim të nënshtrimit seksual, në zëvendësim të shërbimeve.

Nga aspekti i vrojtimit të institucioneve , nocioni eksploatimi seksual dhe keqtrajtimi nga ana e personelit humanitar, paraqet mospushtet të institucioneve humanitare, roli i deklaruar i të cilave është ofrimi i kujdesit dhe i mbrojtjes.

Referati i Këshillit të përhershëm i ndërorgjencive mbi politikën e mbrojtjes nga keqtrajtimi dhe i eksploatimit seksual në situatat e krizës humanitare

Romë, 9 prill 2002

Pëlqimi është kur ndonjë person, që është i informuar më parë , zgjedh që në mënyrë të pavarur dhe vullnetarisht të kryejë ndonjë veprim. Shprehja *kundër dëshirës së (vet) saj* përdoret për të treguar mungesën e miratimit të informimit. Pëlqimi nuk ekziston në rastin kur merret nepërmjet kërcnimit, forcës ose me përdorimin e mjeteve tjera të detyrimit, siç është rasti i kidnapimit, mashtrimit, dinakrisë ose paraqitjes së rrejshme.

Kërcnimi përmes ndalimit të mjeteve monetare ose premtimit se ato të holla do të sigurohen me qëllim të marrjes së pëlqimit të ndonjë personi, poashtu është keqpërdorim i forcës; pëlqimi i fituar në këtë mënyrë, nuk trajtohet se është bërë me vullnet. Pëlqimi, poashtu, nuk ekziston nëse femra është më e re, se sa e parasheh ligji moshën madhore, ose që trajtohet akoma fëmij, spas ligjit në fuqi (shiko Kapitullin 5).

Kryesi veprës është personi, grupi ose institucioni që, drejtpërdrejt kryen, përkrah dhe heshtazi e miraton dhunën ose llojet e tjera të keqpërdorimit ndaj personit apo grup personash. Kryesit e veprës gjenden në pozita të ndikimit real, apo të paramenduara, në pozita ku merren vendime, respektivisht në pozita qeveritare, anadaj munden që të bëjnë kontroll mbi viktimat e tyre.

Besimi se dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore e kryejnë të panjohurit, është një përrallë e thjeshtë. Në të vërtetë, shumicën e prapësive të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, e kryen dikush që viktimës/ të mbijetuarës i është i njohur, ndërsa shumë raste të dhunës janë të planifikuara që më parë.

Dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar mbi përkatësinë gjinore, poashtu, mund ta kryejnë edhe anëtarët e familjes dhe të bashkësisë. Shtetet dhe institucionet heshtazi i miratojnë, duke kryer dhunë seksuale dhe dhunë mbi baza gjinore, në rastet kur veprimtaritë diskriminuese nuk ndalohen dhe ngadalsohen, as edhe përmes instrumenteve juridike e shtetore. Gjatë luftrave dhe konflikteve, dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, shpesh e kryejnë pjestarët e fraksioneve ose palët ndërluftuese.

Kryesit e dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në përkatësinë gjinore, nganjëherë janë të njëjtit njerëz, nga të cilët, të mbijetuarit, varen për ndihmë dhe mbrojtjen e tyre.

Në raste të shumta të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, kryesi i veprës është mashkull, ndërsa viktimat/ e mbijetuara është femër. Shumicën e veprave të liga, të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, që kryhen ndaj djelmoshave dhe meshkujve të rritur, i kryejnë meshkujt e tjerë.

Partnerët intim (burrat, djemt e ri): Në shumicën e shoqërive, roli i pranuar i partnerit intim mashkull, përfshinë marrjen e vendimeve si dhe influencën ndaj partnerit femër. Për fat të keq, ky ndikim dhe pushtet shpesh bëhet përmes diskriminimit, dhunës dhe keqtrajtimit.

Anëtarët e familjes, të afërmit dhe miqtë: Vajzat janë ato, të cilat brenda sferës familjare, më së tepërmi pësojnë nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore. Nga moskujdesi/ lënia pasdore e deri te mohimi, këto shkelje e të drejtave të njeriut, shpesh edhe nuk paraqiten, me që i kryejnë etrit, njerku, gjyshrit, vëllezërit, respektivisht xhaxhallarët ose dajallarët. Zakonet e prapambetura tradicionale vihen në jetë me dijeni, e nganjëherë edhe me pjesëmarrjen e anëtarëve të familjes, të afërmëve dhe miqëve.

Anëtarët me ndikim të bashkësisë (punëtorët arsimorë, udhëheqësit/prijësit, politikanët): Udhëheqësit/prijësit dhe anëtarët e tjerë të bashkësisë, të cilët gjenden në pozita qeveritare, mund ta keqpërdorin këtë ndikim, përmes keqbërjeve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Në këto situata, viktimat/ ajo që e ka mbijetuar dhunën, edhe më pak është e mendimit që ta paraqesi këtë përdhunim, nga shkak i pozitës dhe ndikimit që ky kryes i dhunës gëzon në masë.

Shërbimet e sigurimit dhe ushtarët, duke përfshirë edhe paqësjsit: Ushtarët shpesh janë personifikim i ndikimit absolut. Kryesisht janë të armatosur dhe kanë mandatin e sigurimit në popullatë. Në disa raste ushtarët mundën t'i ndalojnë dhe t'i arrestojnë njerëzit pa kurrëfarë frike nga pasojat- këtë edhe e bëjnë. Shpesh ndodhë që ushtarët dhe pjestarët e shërbimit të sigurimit janë në gjendje që refugjatëve t'iu ofrojnë dhe t'iu ndërprejnë disa të drejta, respektivisht disa privilegje. Kalimi i kufirit, kalimi nëpër punkte kontrolli, kërkimi i shërbimit nga forcat e armatosura, mund ta shtojnë rrezikun ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, sidomos në rastet e femrave refugjate.

Punëtorët humanitarë: Personeli i agjencioneve ndërkombëtare, shtetore dhe humanitare, që merren me refugjatët, duke përfshirë edhe organizatat joqeveritare dhe ministritë e qeverive mikpritëse, janë në pozita të ndikimeve të mëdha për gjendjen ku janë vendosur refugjatët. Bashkësia i sheh ata si persona që kanë të holla, ndikim dhe pushtet. Për fat të keq ka raste kur, pikërisht punëtorët humanitarë, e kanë keqpërdorë këtë ndikim, duke kryer vepra të shëmtuara të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Me rëndësi jetike është se të gjithë punëtorët humanitarë ushtrohen, duke ju **SHTUAR NDIESHMËRIA PËR** nocionin përkatësia gjinore si edhe për dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, dhe që të jenë përgjegjës për sjelljet (e veta) jonjerëzore dhe të papranueshme (Shih Shtojcën 1 të Kodit të mirësjelljes së UNHCR-së ,2002).

Institucionet: Sjelljet diskriminuuese, gjatë ofrimit të ndihmës sociale, e shtojnë pabarazinë ndërmjet gjinive. Mosofrimi i informacioneve, zvarritja ose ndërprerja e ndihmës mjekësore, rroga e pabarabart për të njëjtat punë dhe **opstruksioni i drejtësisë**, janë vetëm disa nga format e dhunës që kryhen përmes institucioneve të sistemit.

Shiko poashtu:

- **Referati i Këshillit të përhershëm ndëragjencional mbi politikën e parandalimit të keqtrajtimit seksual dhe eksploatimi në situatat e krizës humanitare (2002)**
- **Kodi i mirësjelljes së UNHCR-së (2002)**

LLOJET E DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS NË BAZË TË PËRKATËSISË GJINORE

Tabela e cila pason përshkruan disa nga format e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, të cilën e hasim më tepër. Ky regjistër nuk është as i mbaruar as i vetëm. Ai është një mjet praktik për ofrimin e ndihmës, gjatë identifikimit të llojeve të ndryshme të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, të cilat ekzistojnë.

Deliktet e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, janë të rradhitur në pesë kategori:

- Dhuna seksuale.
- Dhuna fizike.
- Dhuna emocionale dhe psikologjike.
- **Zakonet tradicionale të dëmshëm.**
- Dhuna shoqërore - ekonomike.

DHUNA SEKSUALE

Llojet e veprimit	Përshkrimi/Shembujt	Kryesit
Dhunimi dhe dhunimi në martesë	Depërtimi në çdo pjesë trupi të viktimës me organin seksual,ose në vrimën anale apo gjenitale të viktimës me çfardo mjete,ose në çfardo pjese tjetër të trupit me forcë,kërcnimit me forcë,detyrimin,shfrytëzimi i situatës së detyrimin ndaj individit që s'ka mundësi të ofrojë miratim vullnetarisht (Gjykata penale ndërkomb.).	Kushdo qoftë në pozitë ndikimi, autoritet, kontrollues, duke përfshirë burrin,partnerin intim ose kujdestarin
Keqtrajtimi seksual i fëmijve,marrja e virgjinitetit	Çfardo veprimi, ku fëmiju shfrytëzohet për knaqësi seksuale. Çfardo marrëdhënie seksuale/interaksione me fëmijun	Dikush,te i cili fëmiju ka besim, përfshirë prindin,vllaun,motrën anëtarin e rrethit të gjerë të familjes, mikun,arsimtarin,personin e vjetër, udhheqsin,kujdestarin personin me ndikim, me autoritet dhe kontrollin mbi fëmijun.
Sodomia e detyruar/dhunim anal	Kontakti anal i detyrueshëm, kryesisht në mes dy meshkujve ose në mes mashkullit dhe femrës	Kushdo që është në pozitë me ndikim, autoritet dhe kontroll.
Tentim dhunimi ose tentim i sodomisë detyruar/dhunim anal	Tentim i kontaktit gjenital me detyrim; pa penetrim.	Kushdo që është në pozitë me ndikim, autoritet dhe kontroll.
Keqtrajtimi seksual	Depërtim seksual, i vërtetë ose nën kërcnim, përfshirë kontaktet e papërshtatshëm, më forcë ose ën kushte jo të barabarta apo të detyrueshme.	Kushdo që është në pozitë me ndikim, autoritet dhe kontroll, anëtarët e familjes/bashkësisë,kolegët,mbikqyersit,personat nga jashtë.
Shfrytëzimi seksual	Secili keqpërdorim në pozitë lënduese,dallimet në raport me forcën ose të besuarit në qëllimet seksuale; kjo nënkupton shfrytëzim seksual momental shoqëror ose politik, duke eksploatuar individin tjetër (IASC); Eksploatimi seksual është njëri nga shkaqet për tregti me njerëz (sjellje e caktuar seksuale, zhveshja me forcë, martesa me detyrim; lindja e fëmisë nën forcë, angazhimi në pornografi dhe prostitucion, detyrimi me kërcnim për fitim mallrash, shërbime, ndihma plotësuse, robëri seksuale)	Kushdo që është në pozitë me ndikim, autoritet dhe kontroll, duke përfshirë punëtorët humanitar, ushtarët/zyrtarët në punktet kontrolluse, punëtorët arsimorë, shfercerët, rrjetat tregtare.
Prostitucioni me forcë (i njohur me emrin shfrytëzimi seksual)	Trafikimi seksual i detyruar me ndërrim të mjeteve materiale,shërbimeve dhe ndihmës, e orientuar kah gratë dhe vajzat, që janë shumë të varura nga kjo dhunë dhe të cilat nuk janë në gjendje t'i plotësojnë nevojat e tyre themelore, respektivisht nevojat e fëmijve të tyre.	Cilido që ka pozitë në pushtet, që ka të holla ose kontroll mbi mjetet materiale,ai që trajtohet me ndikim, punëtorët humanitar.
Shqetësimi seksual	Cilido i padëshiruar,kryesisht qasje seksuale e përsëritur kujdesje e padëshiruar, kërkesa për miratim të kontaktit aluzionet seksuale ose format e tjera të sjelljes verbale apo fizike të natyrës seksuale, pasqyrimi i materialit pornografik si kusht për punësim, ose kur krijohen rrethana të tmerrshme, armiqësore dhe poshtuese.	Punëdhënsit, mbikqyersit ose kolegët, kushdo që është në pozitë pushteti,autoriteti ose kontrolli.

Llojet e veprimit	Përshkrimi/Shembujt	Kryesit
Dhuna seksuale si mjet lufte për torturim	Krimet kundër njerëzimit të natyrës seksuale, duke përfshirë, në mes tjerash, dhunimin, skllavrinë seksuale, abortimin ose sterilizimin me forcë ose formë tjetër e pengimit të lindjes, mbarsimit me forcë, lindjes dhe rritjes fëmijve përmes forcës. Dhuna seksuale, si formë e mundimit, definohet si akt ose kërcnim i natyrës seksuale që shkakton dhembje serioze fizike, shpirtërore për marrjen e informacioneve, pranimit, dënimit nga ana e viktimës ose personit tretë, përmes frikësimit viktimës, apo përmes zhdukjes në tërësi ose pjesërisht të grupit nacional, etnik, racial apo fetar.	Shpesh herë të kryera, të lejuara ose të porositura nga ana e ushtrisë, policisë, grupeve të armatosura apo grupacioneve tjera në konfliktet reciproke.

DHUNA FIZIKE

Llojet e veprimit	Përshkrimi /Shembujt	Kryesit
Të sulmuarit fizik	Rrahje, mëshuarje me shuplakë, goditje, kafshim, djegie, lëndim ose vrasje me armë ose pa të; shpesh në kombinim me format e tjera të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.	Bashkëshorti, partneri intim, anëtar i familjes miku, i njohuri, i huaji kushdo që është në pozitë pushteti, anëtarët e fraksioneve që janë në konflikte reciproke
Trafiku, skllavëria	Shitja, respektivisht trafiku me njerëz për veprime seksuale të detyrueshme, punët dhe shërbimet e detyrueshme, skllavëria ose metodat e ngjashme me të, nënshtrimi ose heqja e organeve trupore	Kushdo qoftë në pozitë të pushtetit ose të kontrollit.

DHUNA EMOCIONALE DHE PSIKOLOGJIKE

Llojet e veprimit	Përshkrimi/Shembujt	Kryesit
Keqtrajtimi/poshtrimi	Keqtrajtimi gojor lidhur me seksin, që është fyese, poshtërimi, shkatërrimi; që e detyron viktimën/të mbijetuarën që të sillet në mënyrë nënshtruese, qoftë publikisht ose privatisht; që ia ndërprejnë nevojat themelore materiale për ekzistencën e familjes.	Kushdo qoftë në pozitë të pushtetit apo të kontrollit; kryesit më shpesh janë bashkëshortët, partnerët intim ose anëtarët e familjes që janë në pozita.
Arrestimi	Izolimi i individit nga miku/familja, kufizimi i lëvizjes, përkufizimi i lirisë ose opstruksioni/ restriksioni i të drejtave për lëvizje të lirë.	Kushdo në pozitë pushteti ose kontrolli, kryesit më shpesh janë bashkëshortët, partnerët intim ose antarët e familjes në pozita autoritative.

ZAKONET E DËMSHME TRADICIONALE

Lloji i veprimit	Përshkrimi/Shembujt	Kryesit
Gjymtimi i organeve gjenitale të femrave (FGM – Female genital mutilation)	Prerja e organeve gjenitale për qëllime jomedicinale, kryesisht në moshën e hershme; oscilon nga prerja parciale deri te ajo totale, heqja gjenitaleve, qepja për qëllime joterapiale; shpesh ka ngjarë gjatë jetës, respektivisht pas lindjes, tek gratë apo vajzat që kanë qenë viktimë e sulmeve seksuale.	Pseudomjekët, aktivitetin e të cilëve e mbështesin dhe e ndihmojnë heshtazi familjet, grupet fetare, disa bashkësi e shtete
Martesa e hershme	Martesë e negociuar me të miturën (marrëdhënia seksuale në këto raste trajtohet sikur me të miturën, me që vajzat nuk janë kompetente, për nga mosha, që ta miratojnë këtë lloj martese) .	Prindërit, bashkësia, shteti
Martesa me detyrim	Martesë e negociuar kundër dëshirës së viktimës/ të mbijetuarës; shpesh familjes i paguhet miraz; kur vajza nuk pajtohet, pasojat janë kërcnuese dhe fyese.	Prindërit, anëtarët e familjes
Vrasjet dhe gjymtimi për ruajtjen e nderit	Gjymtimi ose vrasja e gruas apo vajzës, si dënim për veprat që trajtohen si të shëmtuara për gjininë e saj e që mendohet se i sjellin turp familjes dhe rrethit (psh. hedhja e tharrtinës në fytyrën e vajzës si dënim për turpin e familjes, për shkak të tentimit të saj për martesë me njeriun e pazgjedhur nga familja) ose për ruajtjen e nderit të familjes (si hakmarrje për turpin e kryer nga ana e anëtarit të familjes së mashkullit).	Prindi, burri, anëtarët e tjerë të familjes ose pjesëtarët e bashkësisë.
Fëmijëvrasja, përkatësisht mospërfillja	Vrasja, ndërprerja e ushqimit, respektivisht mospërfillja e fëmijve të gjinisë femrore, nga shkak i vlerës më të ulët shoqërore se i fëmijve meshkuj	Prindërit, anëtarët e tjerë të familjes.
Ndërprerja e shkollimit të vajzave dhe grave	Heqja e vajzave nga shkolla, ndalimi ose pengimi i vajzave dhe grave në shkollimin fillor, teknik, profesional ose arsimin e lartë shkencor.	Prindët, anëtarët e tjerë të familjes, bashkësitë e disa shteteve.

DHUNA SOCIO-EKONOMIKE

Lloji veprimit	Përshkrimi/ shembujt	Kryesit
Diskriminimi, gjegjësisht ndalimi i mundësive të shërbimeve	Lënia pas dore, ndërprerja e arsimimit, ndihmës shëndetësore ose e pagesës së punës; ndalimi i të drejtës për pronësi.	Nëtarët e familjes, shoqërisë, institucionet dhe organizatat, funksionerët shtetror
Izolimi/lënia pasdore e shoqërisë, bazuar në përcaktueshmërinë gjinore	Ndalimi i qasjes në shërbime, ndihmës sociale ose shfrytëzimit të drejtave qytetare, ekonomike, kulturore dhe politike, imponimi i dënimit sikur për vepra penale, sjellja diskriminuese, cënimi fizik e psikologjik tolerimi i sjelljes diskriminuese, armiqësia publike dhe private ndaj homoseksualëve, transeksualëve ose transvestitëve.	Anëtarët e familjes, të shoqërisë, institucioneve dhe organizatave, funksionarët e pushtetit
Opstruksioni i praktikës së legjislacionit	Ndalimi i zbatimit dhe i shfrytëzimit të drejtave qytetare, shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike, kryesisht të femrave.	Familja, shoqëria, institucionet dhe shteti

KU DHE KUR NDODH DHUNA SEKSUALE DHE DHUNA E BAZUAR NË PËRKATËSINË GJINORE?

Dhuna seksuale dhe dhuna mbi përkatësinë gjinore, mund të ndodhi kudo dhe kurdoqoftë. Shfrytëzohet si armë luftarë; ndodhë kinse në sigurinë e shtëpisë. Në të vërtetë, sikur ligjet dhe strukturat që e drejtojnë shoqërinë, e që ndikojnë në sjelljet e individit, poashtu edhe qëndrimet e individëve mund të ndikojnë në mënyrën, në të cilën familjet, bashkësitë dhe shoqëria reagojnë në llojet përkatëse të mirësjelljes. Skema vijuese paraqet lidhjet e qarta në mes të individit dhe shoqërisë.

Shoqëria Bashkësia Relacioni Individi

Në nivel të *personit*, shkalla e njohurive, siguria personale, qasja dhe kontrollimi mbi resurset, shërbimet dhe ndihmën sociale, historia personale dhe qëndrimet ndaj përkatësisë gjinore, mund ta përcaktojnë nëse personi do të jetë viktimë/ i, e mbijetuar ose kryes i dhunës.

Shkalla e dytë, e *relacionit* ka të bëjë me kontekstin e drejtpërdrejt, ku mund të ndodhë keqtrajtimi; në mes të individëve apo brenda familjes. Në këtë nivel, debalanci ekzistues i forcës në mes të individëve, fillon t'i forcojë pozitat e varësisë, respektivisht të ndikimit.

Niveli i *bashkësisë* paraqet dinamikën ndërmjet njerëzve, tek të cilët ndikon socializimi, përmes strukturave lokale, siç janë shkollat, entet shëndetësore, grupet e një moshe dhe relacionet në vendin e punës. Në rastin e refugjatëve, kjo strukturë mund të gjendet në kampet e refugjatëve ose përreth, ku qasja në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe në vetë planin e kampit, mund të ketë ndikim të drejtpërdrejt në atë se, a do të ndodhin ose jo raste të dhunës seksuale dhe të dhunës mbi baza gjinore.

Shoqëria nënkupton normat shoqërore e kulturore, të lidhura me rolin e gjinive, qëndrimet ndaj fëmijëve, femrave e meshkujve, suazave ligjore e politike, që ndikojnë në mirësjellje, si dhe qëndrimet ndaj përdorimit të dhunës, si mjet për zgjidhjen e konfliktit.

Është e qartë se ndryshimet në sjellje dhe qëndrime, në cilëndo nga këto fusha, mund të ndikojnë tek të gjithë ata. Nga ky shkak, intervenimet për pengimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet të orientohen në të gjitha nivelet.

Dhuna seksuale dhe dhuna e bazuar në përkatësinë gjinore, ngjete në të gjitha shtresat shoqërore, në të gjitha kulturat, religjionet, racat, gjinitë dhe moshat.

DHUNA SEKSUALE DHE DHUNA NË BAZË TË ORIENTIMIT GJINOR, SI PJESË E CIKLIT TË REFUGJATËVE

Gjatë konflikteve të armatosura, çrregullohen strukturat e shoqërive. Gratë dhe fëmijët përballen me rrezik plotësues të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, deri sa të ikin nga vendi i konfliktit dhe të kërkojnë azil. Antëratët e familjes shpesh shpërndahen gjatë ikjes, duke lënë fëmijët të ndarë nga pjesa tjetër e familjes dhe gratë si persona më përgjegjese për sigurinë dhe mbajtjen e familjes. Tabela në vijim, e cila është përshtatur nga ana e S. Purdin-it, përshkruan llojet e dhunës, që mund të ngjasin gjatë etapave të ndryshme të ciklit të refugjatëve.

Etapa	Lloji i dhunës
Gjatë konfliktit, para ikjes	Keqtrajtimi nga personat e pushtetit; ndërrimi seksual i femrave; sulmi seksual; përdhunimi; kidnapimi nga pjestarët e armatosur të fraksioneve në konflikt, përfshirë edhe shërbime e sigurimit; dhunimet masovike dhe shtatzania me forcë.
Gjatë ikjes	Sulmet seksuale të banditëve, kufitarëve, piratëve; zënia rob për qëllime trafikimi me qeniet e gjalla.
Në vendin i cili ofron azil	Sulmi seksual; detyrimi, kërcnimi nga ana e personave në pushtet; keqtrajtimi seksual i fëmijëve për vendosje nëpër familje kujdestare; dhunimi në shtëpi; sulmi seksual në institucionet tranzitore, gjatë kohës grumbullimit të druve, mbushjes së ujit etj.; seksi për shkak të mbijetesës/prostitucion i dhunshëm; shfrytëzimi seksual i individit që kërkon status juridik në shtetin i cili ofron azil ose ndihmë në resurse, vazhdimi i zakoneve të dëmshme tradicionale.
Gjatë riatdhesimit	Keqtrajtimi i grave dhe i fëmijëve, që janë të ndarë nga familjet e tyre; torturimi seksual nga personat e pushtetit; sulmi seksual, dhunimi nga banditët, kufitarët, riatdhesimi me forcë/i detyruar.
Gjatë reintegrimit	Keqtrajtimi seksual i të kthyerëve si formë e hakmarrjes; kërcnimi seksual për rregullimin e statusit juridik, përjashtimi nga procesi marrjes së vendimeve; pengimi për qasje ndaj resurseve, të drejtës për dokumentacion personal dhe e drejta për kthimin e pasurisë vetiake.

DHUNA SEKSUALE DHE DHUNA MBI BAZA GJINORE GJATË CIKLIT JETËSOR

Tabela në vijim, e hartuar nga L. Heise, përshkruan format e dhunës, të cilat mund t'i kanosen femrave gjatë etapave të ndryshme jetësore.

Etapa	Lloji i dhunës që ekziston
Para lindjes	Abortimi i bazuar në gjininë e fëmijut; rrahja gjatë shtatzanisë; shtatzania me detyrim.
Fëmijëria e hershme	Fëmijëvraska e fëmijve femra; keqtrajtimi emocional dhe fizik; qasje jo e barabart ndaj ushqimit dhe kujdesit shëndetësor.
Vajzëria	Martesa me të miturën; gjymtimi organeve gjenitale; torturimi nga anëtarët e familjes dhe personave nga jashtë; qasje e pabarabart ndaj ushqimit, kujdesit shëndetësor dhe arsimimit.

Rinia	Dhuna gjatë vardisjes; seksi nën detyrimin ekonomik (p.sh. për fitimin e shkollimit); keqtrajtimi seksual në vendin e punës; përdhunimi; tronditja seksuale; martesë e kontraktuar; trafiku.
Mosha riprodiktive	Keqtrajtimi fizik, psikologjik dhe seksual nga partnerët intim meshkuj dhe të afërmit; shtatzania nën tryshinë e partnerit; keqtrajtimi seksual në vendin e punës, shqetësimi seksual; përdhunimi, keqtrajtimi i të vejave, përfshirë edhe grabitjen e pasurisë dhe praktika e pastrimit seksual.
Personat e moshuar	Keqtrajtim i vejesheve, përfshirë këtu edhe grabitjen e pasurisë; paditje për magji; sulmi fizik dhe psikik nga pjestarët e rinj të familjes; qasje jo e barabart ndaj ushqimit dhe kujdesit mjekësor.

SHKAQET DHE PASOJAT E DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS NË BAZË TË PËRKATËSISË GJINORE

Për planifikimin e programeve të veçanta, lidhur me pengimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, është me rëndësi të analizohen shkaqet dhe pasojat e këtij dhunimi në të gjitha rrethanat. Të kuptuarit e shkakut do t'iu ndihmojë që të zhvilloni veprimtari aktive për pengimin e dhunës; ndërsa kuptimi i pasojave ju mundëson që të zhvilloni ndërmarrjen e paket-masave përkatëse për ofrim të ndihmës viktimava/tw mbijetuarave.

SHKAQET → Veprimtaria e parandalimit
PASOJAT → Veprimtaria e të reaguarit

SHKAQET E DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS NË BAZË TË PËRKATËSISË GJINORE

Shkaqet themelore të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore mbështetën mbi qëndrimet e shoqërisë përkatëse dhe mirësjelljes së saj, ndaj diskriminimit gjinor, që femrat i vejnë në pozitë të varësisë, në krahasim me meshkujt. Mungesa e vlerësimit social dhe ekonomik e femrës dhe punës së saj, si dhe pranimi i përgjithshëm i rolit të gjinive, ia shton jetën dhe e forcon supozimin se meshkujt kanë dominim në marrjen e vendimeve dhe kontrollit mbi femrat. Keqbërësit tentojnë t'i mbajnë privilegjet, ndikimin dhe kontrollin mbi të tjerët, përmes dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, qoft mbi individët ose grupet.

Roli i femrës dhe i mashkullit, si dhe identiteti i tyre, përcaktohet përmes gjinisë, moshës, kushteve shoqëroro-ekonomike, prejardhjes etnike, kombësisë dhe përkatësisë fetare.

Relacionet ndërmjet meshkujve dhe femrave, si dhe në mes të vetë meshkujve, poashtu janë të niveleve të autoriteteve dhe influencave të ndryshme, që shprehin privilegje dhe varësi në mes të anëtarëve të shoqërisë përkatëse. Mungesa e vetëdijës mbi të drejtat e njeriut, barabarësisë në mes të gjinive, demokracisë dhe mënyrave joviolente të zgjidhjeve të problemeve, i ndihmon vazhdimin të ekzistencës së këtyre pabarazive.

FAKTORËT E RREZIKUT QË I KONTRIBUOJNË KËTIJ LLOJI TË DHUNËS

Deri sa pabarazia dhe diskriminimi i gjinive janë shkaktarët kryesorë të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, faktorët e tjerë të ndryshëm vendosin mbi llojin dhe shkallën e dhunës në çdo mjedis. Është me rëndësi të kuptohen këta faktorë për shkak të domethënies së strategjive efikase për pengimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.

Qasja e barabart dhe kontrolli mbi resurset materiale dhe ndihmës sociale, si dhe pjesëmarrja e barabartë e femrave në procesin e marrjes së vendimeve, duhet të jetë pjesë e të gjitha programeve, qofshin ata, të cilët, shprehimisht iu janë përkushtuar dhunës mbi baza gjinore, ose ata të cilët merren me reagimin

për nevojat e poullesisë në situatat e krizës, gjendjes së përmirësimit apo të zhvillimit.

Tabela në vijim përshkruan disa shkaqe ose faktorë të rrezikut, të cilët mund ta shtojnë josisurinë se peroni i caktuar mund të jetë viktimë ose kryesi i dhunës seksuale dhe i dhunës mbi baza gjinore.

SHKAQET OSE FAKTORËT E RREZIKUT TË DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS NË BAZË TË PËRKATËSISË GJINORE

Faktorët individual të rrezikut	<ul style="list-style-type: none"> • Humbja e sigurisë • Varësia • Paaftësia fizike dhe shpirtërore • Mungesa e opsioneve për pranimin e ndryshimeve në pozitën shoqëro-ekonomike • (Keq)përdorimi i alkoolit dhe drogës • Trauma psikologjike dhe acarimi nga konflikti, zhvendosja si pasojë e ikjes • Rolet e çrregulluara brenda familjes dhe bashkësisë • Mungesa e njohurive mbi të drejtat e individit, të garantuara me ligjet shtetërore dhe ndërkombëtare
Normat shoqërore dhe kultura	<ul style="list-style-type: none"> • Mendimi diskriminues kulturor e tradicional dhe zakonet • Religjioni
Korniza zakonore dhe praktika në shtetin-mikpritës, respektivisht në shtetin e prejardhjes	<ul style="list-style-type: none"> • Diskriminimi dhe miratimi në heshtje i dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore • Mungesa e mbrojtjes së të drejtave zakonore të grave e fëmijve • Mungesa e ligjit kundër dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në përkatësinë gjinore • Mungesa e besimit tek organet e punëve të brendshme • Zbatimi i ligjeve dhe i zakoneve tradicionale që e kryejnë diskriminimin mbi baza gjinore • Jodieshmëria e përgjithshme dhe mosdënimi i dhunës dhe i dhunës mbi baza gjinore • Traditat diskriminuese në administratën gjyqësore dhe në polici • Jokonsekuenca rreth paraqitjes së rasteve dhe mosbesimi ndaj zbatimit të drejtësisë • Mosdëshira që në mënyrë efektive të zbatohen procedurat penale, në të gjitha rastet, që iu kanë paraqitur pushtetit • Numri i vogël i procedurave të filluara penale, në krahasim me numrin e paraqitjes së rasteve • Mungesa e prezencës së policisë dhe gjykatave për shkak të largësisë së kampit • Mungesa e policeve femra • Mungesa e resurseve dhe pajisjes administrative për gjyqësinë vendore dhe shërbimet e sigurimit • Ligjet dhe praktika në zbatimin e drejtësisë që anojnë kah përkatësia specifike gjinore
Lufta dhe konfliktet e armatosura	<ul style="list-style-type: none"> • Shkatërrimi i strukturës shoqërore • Zbatimi i ndikimit politik dhe i kontrollit mbi bashkësitë e tjera • Dallimet etnike • Diskriminimi shoqëro-ekonomik
Situatat e lidhura me refugjatët, të kthyerit dhe personat e zhvendosur internë	<ul style="list-style-type: none"> • Shembja e strukturave shoqërore dhe familjare të mbështetjes • Lokacioni gjeografik dhe i qarkut lokal (lëmi i pjesëmarrjes së kriminelëve) • Plani dhe përbërja shoqërore e kampit (dendësi e tepërt, vendqëndrime me disa familje, strehimore të përbashkëta)

- **Planifikimi i shërbimeve dhe objekteve**
- **Udhëheqësia shumicë e meshkujve në kamp; vendimet e bazuara në përkatësinë gjinore**
- **Mungesa e ushqimit, lëndëve djegëse, mundësia e përfitimit, që shpie deri tek lëvizja në rrethanat e izoluara**
- **Mungesa e mbrojtjes policore**
- **Mungesa e prezencës së UNHCR-it/ organizatave joqeveritare nëpër kampe**
- **Mungesa e legjitimit individual**
- **Qëndrimi armiqësor i popullatës vendore (refugjatët trajtohen me beneficione materiale)**

PASOJAT E DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS NË BAZË TË PËRKATËSISË GJINORE

Për viktimat / personat që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, ekziston faktori i rrezikut nga problemet shëndetësore psiko-sociale, ndonjëherë edhe nga vdekja, edhe pse nuk ka pasë sulme fizike. Asnjëherë nuk duhet nënçmuar mundësitë e paraqitjes së pasojave afatgjate të **shkatërrimit**, të shkaktuara nga traumat emocionale dhe fizike.

Të kuptuarit e pasojave të mundshme nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, do t'iu ndihmojë akterëve që të zhvillojnë strategji të përshtatshme, dedikuar reagimit ndaj këtyre pasojave dhe pengimin e shkakut të një dhune dhe vuajtje plotësuese.

Në pasqyrën e shkurtë vijuese, është kryer përpunimi, sipas sektorëve.

Spektori shëndetësor

Kur është në pyetje çfarë lloji i dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, ekziston mundësia që të lindin pasoja serioze shëndetësore, që mund të jenë të rrezikshme për jetën.

Përfundimet fatale
<ul style="list-style-type: none">• Vrasja• Vetëvrasja• Vdekja e nënës• Vdekja e fëmijve• Vdekja si pasojë e sidës

Përfundimet jofatale		
Akute fizike	Kronike fizike	Reproduktive
<ul style="list-style-type: none">• Lëndimi• Shoku• Sëmundja• Infeksioni	<ul style="list-style-type: none">• Invaliditeti• Ankesat nga vështirësitë në stomak• Infeksionet kronike• Sëmundjet kronike• Problemet e lukthit dhe zorrëve• Çrregullimet në ushqim (bulimia, anoreksia)• Çrregullimet e gjumit• (Keq)pëdorimi i alkoolit/drogës	<ul style="list-style-type: none">• Dështimi natyror• Shtatzania e padëshiruar• Abortim i pasiguruar• Sëmundjet e bartura seksuale, përfshirë edhe HIV/sidën• Çrregullimet menstruale• Komplikimet në shtatzani• Çrregullimet gjinekologjike• Çrregullimet seksuale

Sektori psiko-social

Pasoja emocionale dhe psikologjike	Pasoja shoqërore
<ul style="list-style-type: none">• Stresi post-traumatik• Depresioni• Shqetësimi, frika• Tërbimi/zemrimi• Ndjenja e turpit, pasiguria, urrejtja ndaj vetes, padia ndaj vetëvetes• Sëmundja shpirtërore• Mendimet vdekjepruese, sjellja	<ul style="list-style-type: none">• Paditja e viktimave/personat e mbijetuar• Humbja e rolit/funksionit në shoqëri (psh.mundësia e fitimit, kujdesi për fëmijët)• Njolllosja shoqërore• Përrjashtimi dhe izolimi nga shoqëria• Feminizimi i varfërisë• Shtimi i pabarazisë ndërmjet gjinive

- Shumica e shoqërive i padisin viktimat/personat e mbijetuar. Ky lloj i përrjashtimit nga ana e shoqërisë ka si pasojë dëmet e shtuara emocionale, duke përfshirë këtu edhe ndjenjën e turpit, urrejtjen ndaj vetes dhe depresionin.
- Si rezultat i frikës nga njolllosja shoqërore, shumica e viktimave/ të mbijetuarëve, asnjëherë nuk i paraqesin rastet e dhunës. Në të vërtetë, shumica e rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore kurrë nuk paraqiten.

Sektori i drejtësisë/gjyqësor

- Në rastet kur ligjet shtetërore nuk ofrojnë kurrëfarë mbrojtje adekuate nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, ose kur praktika gjyqësore dhe ajo e organeve të punëve të brendshme është diskriminuese, ky lloj i dhunës mund të kryhet pa ndonjë rrezik nga pasojat.
- Qëndrimet e bashkësisë që e fajsojnë viktimën/personin e mbijetuar, shpesh reflektohen në gjykatë. Shumë vepra penale të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore nuk aprovohen, ose kryesive i shqiptohen dënime të vogla. Në disa shtete, dënimi i cili i shqiptohet kryesit është një shkelje plotësuese e të drejtave dhe lirive të viktimës / të mbijetuarës, si në rastet e martesës me forcë me kryesin e veprës. Dëmi emocional mbi viktimat/mbijetuarit, keqësohet me implikimin se kryesi nuk është fajtor.

Sektori i sigurimit/mbrojtjes

- Viktima/ e mbijetuara ndjehet e pambrojtur, e kërcnuar, e frikësuar, se i kanoset rreziku nga dhuna e shtuar.
- Në rastet e trafikimit me qeniet e gjalla, policisë dhe punëtorëve të shërbimit të sigurimit, iu kanoset rreziku nga hakmarrja.
- Nëse policët dhe punëtorët e shërbimit të sigurimit janë të pandjeshëm ndaj kërkesave të viktimës/të mbijetuarës, pasojat e dhembjeve dhe vuajtjeve mund të jenë edhe më të mëdha, si rezultat i mungesës së ofrimit të ndihmës ose të pandjeshmërisë.

PIKAT KYÇE

- Dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore është shkelje e të drejtave të njeriut. UNHCR –i dhe shtetet e ndajnë përgjegjësinë për ofrimin e ndihmës refugjatëve dhe të zhvendosurëve të tjerë. Pengimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, që kryhet ndaj refugjatëve, është pjesë e strategjisë gjithëpërfshirëse e mbrojtjes së refugjatëve.
- Gratë dhe vajzat e përbëjnë numrin më të madh të viktimave/personëve që e kanë mbijetuar dhunën dhe dhunën mbi baza gjinore, edhe pse edhe djemt e burrat mund të jenë viktimat/personat të mbijetuar.
- *Përkatësia gjinore* ka të bëjë me atë se çka do të thotë të jesh djalë ose vajzë, grua apo burrë, në shoqërinë dhe kulturën përkatëse.
- Plani gjithëpërfshirës i parandalimit dhe reagimit, duhet orientuar drejt roleve dhe nevojave të femrave dhe meshkujve, edhe pse të dy gjinitë mund të jenë mjet i ndërrimeve.
- Shumica e veprave të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore janë kryer nga dikush, që personi i mbijetuar i njeh.
- Kryesit e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, nganjëherë janë po ata njerëz, nga të cilët, të mbijetuarit varen për ndihma dhe mbrojtje.
- Dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, kryhet në të gjitha shtresat shoqërore, në të gjitha kulturat, religjionet, racat njerëzore, gjinitë dhe moshat. Intervenimet për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet të drejtohen kah individit, relacionet e afërta, bashkësia dhe shoqëria në përgjithësi.
- Të kuptuarit e shkakut të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, do të ju ndihmojë gjatë zhvillimit të veprimtarive efikase për parandalimin e këtij fenomeni; të kuptuarit e pasojave të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, ju mundëson që të merrni masa përkrahëse për reagim ndaj këtij lloji të dhunës, në mënyrë që t'i ndihmoni viktimat/ të mbijetuarit.
- Pabarazia dhe diskriminimi ndërmjet gjinive janë shkaqet kryesore të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.
- Qasja dhe kontrolli i barabart ndaj resurseve materiale dhe ndihmës sociale, si dhe pjesëmarrja e barabart e femrës në procesin e marrjes së vendimeve, duhet të jetë pjesë e të gjitha programeve, si në ata që për pikësynim e kanë dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, poashtu edhe në ata që merren me reagimin mbi nevojat e popullatës në situatat e krizës si dhe të përmirësimit e zhvillimit të gjendjes.
- Asnjëherë nuk duhet nënvlerësuar mundësinë e shfaqjes së pasojave afatgjate të **shkatërrimit**, të shkaktuara nga traumat emocionale dhe fizike.

KAPITULLI 2 DIREKTIVAT

Dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, është problem që i përket individit, bashkësisë dhe institucioneve. Duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e saj, dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet qasur më mirë, përmes bashkëpunimit ndërmjet shumë sektorëve, organizatave dhe dicitinave, sepse në atë mënyrë bëhet planifikimi i strategjisë së përbashkët, ndaj këtij lloji të shkeljes së të drejtave të njeriut. Të gjithë akterët e përfshirë në zhvillimin e këtyre strategjive, duhet që bashkarisht t'i përmbahen Direktivave, duke kuptuar se dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, është shkelje e të drejtave të njeriut. Direktivat, të cilat duhet t'i përkrahin veprimtaritë programore janë: angazhimi i plotë i bashkësisë së refugjatëve; mbështetja e barabart e pjesëmarrjes së grave dhe burrave, vajzave dhe djemëve në procesin e planifikimit, realizimit, mbikqyerjes dhe vlerësimit të programit; sigurimi i harmonizimit të veprimtarive multisektoriale nga të gjithë akterët; synimi drejt integritit dhe aprovimit të përgjithshëm të veprimtarive të mbarshtruara; dhe sigurimi i përgjegjësive në të gjitha nivelet. Direktivat, të cilat duhet të mbështesin të gjitha veprimtaritë, lidhur me individët janë: sigurimi i mbrojtjes fizike të viktimës/personit të mbijetuar; sigurimi i besueshmërisë; dhe respektimi i dëshirave, të drejtave dhe krenarisë së viktimës/mbijetuarës, si dhe marrja parasysh e interesave të fëmiut, me rastin e vendosjes në mënyrë më të përshtatshme në parandalimin ose reagimin ndaj ndonjë rasti të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.

Për t'iu qasur problemit të ndërlikuar të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, është i nevojshëm bashkëpunimi dhe përpjekjet e përbashkëta të sektorëve të ndryshëm, organizimi dhe dicitina. Duhet që të gjithë akterët e përfshirë në zhvillimin e strategjisë së parandalimit dhe reagimit ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, bashkarisht t'i përkrahin Direktivat, të cilat duhet ta mbështesin punën e tyre të tërësishme. Këto direktiva mund të ndahen në ato që janë të orientuara kah zhvillimi, realizimi dhe mbikqyerja e programit, dhe ato që ofrojnë mbrojtje dhe ndihmë për viktimat/ të mbijetuarit, qofshin ata meshkuj, gra apo fëmij. (Shiko Kapitullin 5, për informacione më të hollësishme mbi Direktivat lidhur me fëmijt).

Direktivat
Programore
<ul style="list-style-type: none"> • Angazhimi në tërësi i bashkësisë së refugjatëve. • Sigurimi i pjesëmarrjes së barabart të grave dhe burrave, vajzave dhe djemëve në procesin e planifikimit, realizimit, mbikqyrjes dhe vlerësimit të programit. • Sigurimi i harmonizimit të veprimtarive multisektoriale të të gjithë akterëve. • Tentimi drejt integritit dhe miratimi i përgjithshëm i veprimtarive të ofruara. • Sigurimi i përgjegjësisë në të gjitha nivelet.
Individuale
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i mbrojtjes fizike të viktimës/personit të mbijetuar. • Sigurimi i privatizimit. • Respektimi i dëshirave, të drejtave dhe dinjitetit të viktimave/ mbijetuarëve, marrja parasysh e interesave të fëmijut, me rastin e vendosjes së mënyrës më të përshtatshme për parandalimin ose reagimin ndaj ndonjë rasti të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. • Pengimi i diskriminimit.

Direktivat e garantuara me dokumentet e tjerë, siç është kodi i mirësjelljes, duhet poashtu, t'i zbatojnë të gjithë pjesëmarrësit në program.

DIREKTIVAT PROGRAMORE

Angazhimi në tërësi i bashkësisë së refugjatëve. Bashkësia e refugjatëve duhet të jetë në qendër nga të gjitha veprimtaritë programore, që i përkasin dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Angazhimi i bashkësisë në vendimarrje, është me rëndësi vendimtare. Kjo kërkon punë shkencore, në mënyrë që të kuptohen raportet e forcës ndërmjet gjinive dhe llojeve tjera të dinamikës së forcës brenda bashkësisë.

Sigurimi i pjesëmarrjes së barabart të grave dhe burrave, vajzave dhe djemëve në procesin e planifikimit, realizimit, mbikqyrjes dhe vlerësimit të programit. Është e nevojshme që distanca e madhe e grupeve dhe e individëve në bashkësi, të marrin pjesë në të gjitha etapat e programit për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.

Tentimi kah integrimi dhe miratimi i përgjithshëm i veprimtarive të ofruara. Është e nevojshme që veprimtaritë për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, të përfshihen në rrjedhat kryesore të shoqërisë, si dhe të integrohen në programet dhe sektorët ekzistues. Këta programe apo projekte nuk duhet të krijohen në mënyrë të veçantë, me që kështu humb fuqia e tyre afatgjate.

Sigurimi i harmonizimit të veprimtarive multisektoriale të të gjithë akterëve. Angazhimi i sektorëve kyç (shërbimi social, shëndetësia, mbrojtja, siguria) është me rëndësi vendimtare për sukseset e programeve, të cilët i dedikohen zgjidhjes së problemit të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza ligjore. Akterët (qeveritë, organizatat joqeveritare dhe UNHCR-i) duhet të jenë të gatshëm që t'i harmonizojnë veprimtaritë e veta, të bashkëpunojnë dhe të ndihmohen në mes vete.

Sigurimi i përgjegjësisë në të gjitha nivelet. Të gjithë ata që janë të angazhuar në punën e programit, i cili i është dedikuar zgjidhjes së problemit të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet të përgjigjen për veprat e veta dhe për suksesin e arritur në detyrat, sipas marrëveshjes.

DIREKTIVAT INDIVIDUALE

Sigurimi i mbrojtjes së viktimës/personit të mbijetuar dhe familjes së tij në çdo kohë. Mbajeni në mend se viktimat/ personi i mbijetuar, mund të jetë shumë e frikësuar dhe duhet të bindet në sigurinë e vet personale. Në të gjitha rastet, është e nevojshme që të bindet se më nuk ekziston rreziku i torturimit nga ana e sulmuesit ose personave tjerë të bashkësisë. Nëse është e nevojshme, duhet kërkuar ndihmë nga shërbimi i sigurimit të kampit, policia ose organet e tjera kompetente, oficerët e terrenit etj. Merreni parasysh sigurinë dhe mbrojtjen e njerëzve, të cilët i ndihmojnë viktimat/ të mbijetuarit, siç janë anëtarët e familjes, miqt, punëtorët e shërbimit social ose punëtorët e shërbimeve që kanë lidhshmëri me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, si dhe punëtorët shëndetësorë.

Gjithmonë respektoni të drejtën private të personit të lënduar dhe familjes së tij. Kjo do thotë: t'i jepen vetëm informacionet e domosdoshme, me të cilat viktimat/personi mbijetuar është i pajtimit që të vehen në pah, atyre akterëve që janë të përfshirë në procesin e dhënies së ndihmës. E drejta private e kryesit të veprës, poashtu duhet respektuar. Informacionet mbi viktimat/ të mbijetuarit, asnjëherë nuk duhet zbuluar, nëse e përfshinë emrin e individit. Informacionet mbi viktimën/personin e mbijetuar, mund t'i zbulohen personit të tretë, vetëm pas kërimit dhe marrjes së pëlqimit me shkrim nga vetë viktimat (ose nga prindërit e tij, në rast se është fjala për fëmijë).

I gjithë dokumentacioni i shkruar duhet të ruhet në kartoteka të sigurt dhe të mbyllura. Në rast se paraqitet nevoja që të botohet publikisht ndonjë raport apo të dhëna tjera, vetëm një nëpunës brenda organizatës duhet të jetë i autorizuar që informacionet e tilla t'i bëjë të njohura. Ky person ka të drejtë që të zbulojë vetëm të dhënat e përgjithshme mbi viktimën/ personin e mbijetuar. Shënimet e tjera personale (emri, adresa, etj.) nuk duhet të jepen.

Personi i cili drejtpërdrejt merret me problemin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet ta nënshkruaj betimin me shkrim për besueshmëri.

Ndonjëherë, gjatë intervistimit me viktimën/personin e mbijetuar, duhen përkthyes. Në këto raste, këshillohet që të angazhohet përkthyesi jashtë bashkësisë, duke vendosur kompetenca për punën e tij. Me që përkthyesit e ushtruar dhe të pavarur, nuk janë gjithmonë në dispozicion, duhet që organizatat të parashohin mjete financiare, për të siguruar përkthyes kualitativ.

Të gjitha procedurat duhet të kenë parasysh dëshirat, të drejtat dhe dinjitetin e viktimës/personit të mbijetuar.

- Sa të jetë e mundur intervista duhet bërë në rrethin privat, në prezencën e përkthyesit të së njëjtës gjini.
- Duhet tentuar gjithnjë që intervistat dhe bisedat me viktimën/të mbijetuarin të bëhen nga personat e të njëjtës gjini (psh. viktimat/e mbijetuara femër me pyetësin femër).
- Duhet dëgjuar me kujdes.
- Sjellja të jetë pa paragjykime.
- Duhet pasur durim; të mos detyrohet viktimat/personi i mbijetuar, të japi informacione plotësuese, nëse nuk është e gatshme të flasi për përvojën e vet.

- Viktimave/të mbijetuarëve duhet shtruar vetëm pyetje relevante.
- Përvuajtja e viktimave/të mbijetuarëve nuk është diskutabile, dhe për atë s' duhet diskutuar
- Duhet shmangur situatatve, ku viktimat/e mbijetuara duhet ta përsërisi rrëfimin e vet gjatë intervistave të ndryshme.
- Nuk duhet qeshur dhe nuk duhet treguar kurrëfarë mosrespekti ndaj personit ose kulturës së tij, familjes apo situatës.
- Viktimat/ e mbijetuara duhet t'i rekomandohet akterwve përkatës relevantë, nëse personi i kualifikuar nuk është i kuptueshëm që ta zhvilloi intervistën.
- Duhet pyetur viktimën/të mbijetuarën se a dëshiron që partneri i saj/i tij, i kurorзуar apo i pakurorзуar, që të jetë prezent gjatë intervistimit.

Nëse viktimat/personi i mbijetuar është fëmij, parimi qw e merrw parasysht **interesin e fëmijut**, duhet ndihmuar gjatë vendosjes për llojin e kujdesit dhe mbrojtjen që i ofrohet. Shih kapitullin 5 për informim më të hollsishtëm.

Pengimi i diskriminimit. Çdo personit të rritur apo fëmijut, pa marrë parasysht gjininë, duhet ofruar kujdes dhe mbrojtje të njëllajt. Ndaj viktimave/ personave që e kanë mbijetuar dhunën, duhet të sillemi njësoj dhe në mënyrë të drejtë, pa marrë parasysht racën e tyre, besimin fetar, kombësinë ose orientimin seksual.

Pesë parime të obligueshtëm të UNHCR-së ndaj grave refugjate


UNHCR-i është angazhuar që të zbatojë në vepër pesë parime kyçe, që janë të lidhur me avancimin e të drejtave të femrave refugjate, përfshirjen e barabarsisë së gjinive në rrjedhat kryesore të shoqërisë, si dhe në ndihmesën për parandalimin dhe reagimin me plotë dhimbësuri, në situatat ku bëhet fjalë mbi dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore. Edhe pse këto pesë parime obligative nuk e formojnë një regjistër të kompletuar të prioriteteve, lidhur me femrat refugjate, ato megjithatë, janë elemente me rëndësi në procesin e eliminimit të rreziqeve që iu kanosen refugjateve nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore. Këto parime janë:

1. Zhvillimi i strategjisë së integruar në nivel të vendit për shqyrtim të problemit të dhunës seksuale, përfshirë këtu edhe dhunën në familje, kundër refugjateve femra.
2. Paraqitja zyrtare e femrave refugjate individualisht dhe sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm për mbrojtjen e tyre, lirisë së lëvizjes dhe pjesëmarrjes në shërbimet themelore. Nga femrat dhe meshkujt refugjatë pritet që në mënyrë të barabartë të marrin pjesë në procesin e paraqitjes.
3. Duhet përkujdesur që në 50 për qind të përfaqësuesëve në këshillat mbikqyrës dhe forumet e tjerë, që i përbëjnë refugjatët pranë UNHCR-së , në mjediset e qyteteve, fshatrave dhe kampeve, të jenë femra.
4. Duhet përkujdesur që femrat, në mënyrë të drejpërdrejt apo indirekt të marrin pjesë në ndarjen e ushqimit dhe artikujve të tjerë, në mënyrë që këto mallra të jenë nën kontroll të drejpërdrejt të femrave madhore të familjes.
5. Furnizimi i të gjitha grave dhe vajzave me material të nevojshëm sanitar, duhet të bëhet praktikë standarde në programet e ndihmave të UNHCR-së.

QASJA MULTISEKTORIALE

Qasja multisektoriale është një kornizë, përmes së cilës krijohen veprimtaritë për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Skema në vijim pasqyron mënyrën, ku akterët e ndryshëm bashkëpunojnë për t'iu ardhur në ndihmë viktimave/personave të mbijetuar.

Korniza ndëragjencionale dhe multisektoriale për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar mbi përcaktueshmërinë gjinore



Mbrojtja	Mbrojtja ndërkombëtare nënkupton ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme, që refugjatët të jenë të mbrojtur në mënyrë adekuate dhe t'i gëzojnë e zbatojnë të drejtat e tyre. UNHCR-i duhet të qëndrojë në ballë të përpjekjeve për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.
Veprimtaria e bashkësisë së refugjatëve	Refugjatët duhet të jenë aktivisht të përfshirë në procesin e projektimit, planifikimit dhe realizimit të të gjitha veprimtarive, duke përfshirë edhe ata, qëllimi i të cilëve është parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Sidomos është me rëndësi të përfshihen meshkujt dhe adoleshentët, si dhe femrat nëpër veprimtari që janë të lidhura me parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës. Meshkujt dominojnë në shumicën e strukturave udhëheqëse, në situatat e refugjatëve. Udhëheqësit meshkuj kanë ndikim të madh tek popullata mashkullore, andaj kanë mundësi që ta përhapin porosinë për zhdukjen e këtij lloji të dhunës. Poashtu mund të kujdesen që, në gjykatat lokale dhe zakonore, ta iniciojnë çështjen e dhunës seksuale dhe dhunës mbi përkatësinë gjinore. Me angazhimin e adoleshentëve, mund të fillojë

	<p>ndryshimi i qëndrimeve dhe supozimeve, që ndoshta qëndrojnë në baza të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Kur angazhohen të gjithë pjestarët e bashkësisë në parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës, bashkësia fiton një ndjenjë më të fortë të përgjegjësisë, ndaj atyre që iu kanoset rreziku nga dhuna dhe ndaj viktimave/personave që e kanë mbijetuar këtë lloj të dhunës.</p>
<p>Funksioni i bashkëpunimit</p>	<p>Vendi në fillim të skemës paraqet parimet e normave operacionale, për të cilat janë pajtuar të gjithë pjesëmarrësit që i udhëheqin të gjitha aktivitetet. Këto janë metoda për bashkëpunim, direktivat dhe sistemet e rekomandimit ndërmjet akterëve të ndryshëm.</p>
<p>Angazhimi i të gjithë akterëve kyç</p>	<p>Vendi në fund të skemës tregon se ekzistojnë shumë akterë të tjerë, kontributi i të cilëve është më se i domosdoshëm, por që nuk janë të angazhuar në mënyrë specifike, qoftë në grupet e refugjatëve, qoftë pranë grupeve sektoriale. Roli dhe detyrat e tyre duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë.</p>

Pengimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, nënkupton veprimtarinë e aktërëve të ndryshëm, nga të cilët shumë prej tyre përfaqësojnë një, nga katër sektorët kyç: shëndetësor, psiko-social, të sigurisë/mbrojtjes dhe juridik/gjyqësor.

Akterët në **shëndetësi** i përbëjnë: personeli i objekteve shëndetësore, mjekët, motrat medicinale, mamitë, ndihmësit tradicionalë gjatë lindjes, punëtorët në shërbimin mjekësor të bashkësisë, shëruesit tradicionalë, udhëheqësit shëndetësorë, drejtorët dhe koordinatorët, si dhe nëpunësit dhe personeli i ministrisë së shëndetësisë të vendit nikoqir.

Akterët në sektorin **psiko-social** i përbëjnë: personeli dhe vullnetarët brenda bashkësisë, anëtarët e bashkësisë, organizatat joqeveritare, të cilat zbatojnë veprimtari programore, që janë të lidhura me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, personeli arsimor, grupet e refugjatëve, personeli për arsimin profesional, kuadri që merret me krijimin e të ardhurave dhe ofrimin e mikro-kredive, si dhe nëpunësit e personeli i shërbimeve sociale/ministrisë së ndihmës sociale të vendit nikoqir.

Akterët e **sigurisë dhe mbrojtjes** i përbëjnë: policia, shërbimet e sigurimit, oficerët e sigurimit dhe oficerët në terren pranë UNHCR-it dhe organizatat joqeveritare; punëtorët që i sigurojnë refugjatët dhe udhëheqësit e refugjatëve/anëtarët e bashkësisë.

Akterët e sektorit **juridik/gjyqësor** i përbëjnë: pjesëtarët e sigurimit të UNHCR-së dhe organizata e cila merret me të drejtat e njeriut, gjykatësit dhe zyrtarët e tjerë gjyqësor të vendit mikpritës, ligjdhënësit, udhëheqësit e bashkësive, duke përfshirë këtu edhe nënkomitetet e këshillave të refugjatëve, përgjegjës për funksionimin e mbikqyerjes dhe sanksioneve, të inicuar nga ana e bashkësisë, shërbimet kriminalistike, si dhe organizatat joqeveritare dhe grupet që i përfaqësojnë ligjet dhe politikën e shtetit, lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore.

PIKAT KYÇE

Të gjithë akterët duhet t'i përmbahen këtyre direktivave:

Programore

- Të angazhohet në tërësi bashkësia e refugjatëve.
- Të sigurohet pjesëmarrje e barabart e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në procesin e planifikimit, realizimit, mbikqyerjes dhe vlersimit të programeve.
- Të sigurohet harmonizimi i veprimtarive multisektoriale i të gjithë akterëve.
- Të tentohet kah integrimi dhe miratimi i përgjithshëm i veprimtarive.
- Të sigurohet përgjegjësia në të gjitha nivelet.

Individuale

- Të sigurohet mbrojtja fizike e viktimave/personave të mbijetuar.
- Të sigurohet prona private.
- Të respektohen dëshirat, të drejtat dhe dinjiteti i viktimave/të mbijetuarëve, duke marrë parasysh edhe interesin e fëmijve, gjatë vendosjes së mënyrës më të përshtatshme të parandalimit dhe reagimit të ndonjë rasti të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.
- Të pengohet diskriminimi.

Të përdoret qasja multisektoriale e të gjitha përpjekjeve për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.

KAPITULLI 3

PARANDALIMI I DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS NË BAZË TË PËRKATËSISË GJINORE

Zhvillimi i strategjive preventive të përshtatshme dhe efikase, është i mundur vetëm nëse identifikohen faktorët, të cilët kontribuojnë dhe ndikojnë në llojin dhe seriozitetin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Veprimtaritë preventive kanë për qëllim kryesisht potencialë të veprave, viktimat potenciale dhe ata që iu vijnë në ndihmë. Së këndejmi, veprimtaritë duhet orientuar kah popullata refugjate, punëtorët humanitarë, shtetasit e vendit nikoqir dhe zyrtarët e pushtetit. Siç është rasti me të gjitha programet për zhdukjen e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, strategjitë preventive janë më efikase kur janë në procesin e planifikimit, realizimit dhe vlerësimit, ku janë të përfshirë të gjithë sektorët si dhe vetë refugjatët.

Strategjitë efikase preventive përfshijnë veprimtaritë që janë të lidhura me pesë qëllime kyçe: transformimin e normave socio-kulturore, me theks në aftësimin e grave dhe vajzave; përtrirjen e strukturës familjare dhe të bashkësisë, si dhe sistemit të përkrahjes; planifikimin e shërbimeve efikase dhe kapaciteteve të vendosjes; punën me shtetet juridike formale dhe tradicionale, për përshtatjen e tyre standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; dhe mbikqyerjen dhe dokumentimin e rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.

Parandalimi i dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, nënkupton zbulimin dhe eliminimin e atyre faktorëveve, që disa anëtarë të caktuar të bashkësisë së refugjatëve i bawjnw qw t'iu nënshtrohen këtij lloji të dhunës, si dhe planifikimi i shumë strategjive që e përmirësojnë mbrojtjen e të gjithë refugjatëve. Këto strategji janë më fitimprurëse, kur i planifikojnë, realizojnë dhe i mbikqyrin të gjithë sektorët, që janë të përfshirë në procesin e mbrojtjes dhe ofrimit të ndihmave të bashkësive refugjate, si dhe vetë refugjatët.

Për PARANDALIMIN e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet të identifikohen, kuptohen dhe përpunohen SHKAKTARËT DHE KRYESIT QË I KONTRIBUOJNË këtij lloji të dhunës.

Në radhë të parë identifikoni kryesit e veprave dhe çështjet lidhur me rajonin tuaj, duke vlerësuar nevojat/analizimin e gjendjes (Shih Kapitullin 6 për informim më të hollësishëm). Vlerësimi i nevojave/analiza e gjendjes do të ju mundësojë që:

- Të informoheni mbi kulturën, format e mbrojtjes tradicionale, zakonet dhe raportet e influencës, respektivisht relacionet në mes të gjinive në bashkësinë e refugjatëve dhe vendit nikoqir.
- Të njoftoheni me situatat, në të cilat ekziston mundësia e ekspozimit të disa personave për dhunim seksual dhe dhunim mbi baza gjinore, si për shembull në punktet distribuive, në entet për parburgim, në vendkalimet kufitare, në kafentë ku shërbehet alkooli etj.
- * Të bashkëpunoni me organizatat, të cilat merren me shërbimet mjekësore, psiko-sociale, juridike dhe të mbrojtjes, në vendin nikoqir, si dhe me organizatat joqeveritare dhe agjencionet e Kombeve të Bashkuara, për zhvillimin e përbashkët të masave preventive.

Zhvillimi i strategjive të përshtatshme efikase dhe preventive, vetëm nëse identifikohen faktorët, të cilët ndikojnë dhe kontribuojnë në llojin dhe seriozitetin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Faktorët që mund të kenë ndikim tek individët, grupet dhe institucionet janë:

- Përbërja demografike e popullsisë (janë të dobishëm shënimet statistikore, të radhitura sipas moshës dhe gjinisë).
- Normat shoqërore dhe kulturore brenda bashkësisë së refugjatëve.
- Struktura e sistemit e përkrahjes së familjes dhe bashkësisë para dhe pas shpërnguljes.
- Dituria, qëndrimet, sjellja e njerëzve në pozitat e pushtetit ekzekutiv.
- Shërbimet dhe kapacitetet e vendosjes , përfshirë edhe rrethin fizik, konfiguracionin e terrenit dhe qasjen në shërbime.
- Suazat juridike, praktika gjyqësore dhe zakonet, si formale ashtu edhe joformale.

Siç është rasti me të gjitha programet për zhdokjen e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, nevojitet angazhim aktiv nga bashkësia e refugjatëve për zbulimin e këtyre faktorëve dhe për planifikimin e strategjisë, e cila do të merrej me ta.

Veprimtaritë preventive kanë për qëllim kryesisht potencialë, viktimat potenciale dhe ata që iu vijnë në ndihmë. Së këndejmi veprimtaritë duhet orientuar kah popullata refugjate, punëtorët humanitarë, shtetasit e vendit nikoqir dhe zyrtarët qeveritarë.

Parandalimi, poashtu, nënkupton mbikqyerje të pandërprerë dhe vlerësim të programit, si dhe analizën e të dhënave të grumbulluara, falë raporteve për rastet e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.

Strategjitë efikase preventive përfshijnë veprimtaritë që janë të lidhura me pesë qëllime kyçe:

- Transformimin e normave socio-kulturore, me theks në aftësimin e grave dhe vajzave.
- Përrirjen e strukturës së familjes dhe bashkësisë, si dhe sistemin e përkrahjes.
- Planifikimin e shërbimeve efikase dhe kapaciteteve të vendosjes.
- Punën me sistemet juridike formale dhe tradicionale, për përshtatjen e tyre standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
- Mbikqyerjen dhe dokumentimin e rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.

TRANSFORMIMI I NORMAVE SOCIO - KULTURORE

Siç është cekur në Kapitullin 1, rrënjët e shkaqeve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, gjenden tek normat socio-kulturore të diskriminimit dhe pabarazisë ndërmjet gjinive. Parandalimi i dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, kërkon ndryshime të raporteve në mes të gjinive brenda bashkësisë-respektivisht roleve përkatëse shoqërore, detyrave, shpresës, përkufizimeve, mundësive dhe privilegjeve, që iu caktohen personave në bashkësi.

Veprimtaritë preventive, dedikuar normave socio-kulturore, kanë për qëllim që të ndikojnë në ndryshimin e njohurive, në qëndrime dhe sjellje. Qëllimet për çdo njëren nga këto lëmi janë:

Dituria:	Të kuptuarit e të drejtave të njeriut; respektimi i detyrave riprodiktive dhe punëve shtëpiake; pranimi i roleve alternative të punëve; përdorimi i metodave joviolente për shprehjen e mllëfit dhe zhgënjimit; informimi se ekzistojnë shërbime dhe përkrahje për viktimat/të mbijetuarit, si dhe për kryesit e delikteve.
Qëndrimet e bashkësisë:	Besimi në barazinë e të drejtave të njeriut për të gjithë, si në nivelin e bashkësisë, ashtu edhe në nivelin e individit; vlerësimi i kontributit të çdo personi në bashkësi; përfshierja e të gjithëve në procesin e marrjes së vendimeve; përkrahja e viktimave/personave që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore; jotolerimi i personave që e keqpërdorin influencën dhe pushtetin.
Mirësjellja:	Zgjidhja e problemit pa forcë: respektimi i të gjithë individëve, pa marrë parasysh gjininë ose përkatësinë gjinore; paraqitja e të gjitha rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore; gjykimi i kryesit të veprës dhe i vetë aktit, dhe përkrahja e viktimës/mbijetuarit

Me që janë të shpërngulur dhe iu janë çrregulluar zakonet dhe shprehitë, shumica e refugjatëve tani më i ka ndërë ndryshimet e roleve tradicionale të gjinive. Programet për parandalimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, mund të përmbajnë transformime pozitive afatgjate të relacioneve në mes të gjinive brenda bashkësisë. Veprimtaritë preventive, poashtu, mund t'i kontribuojnë përfundimit të zakoneve të dëmshme tradicionale, siç është gjymtimi i organeve gjenitale të femrës.

STRATEGJIA

Dhënia e kuptimit të fushatës së informimit, arsimimit, komunikimit (IEC)¹

Të mendohet dhe zbatohet fushata për promovimin e ndryshimeve në qëndrime, informim dhe mirësjelljen e bashkësisë. Temat e mundshme:

- Përkatësia gjinore;
- Të drejtat e njeriut, sidomos të drejtat e femrave dhe fëmijve;
- Dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza të përkatësisë gjinore;
- Rolet dhe shpresat brenda bashkësisë, që janë të bazuara në përkatësisë gjinore ;
- Shërbimet e përkrahjes që janë në dispozicion për të mbijetuarit dhe si të arrihet te këto,

¹ Information, Education, Communication = IEC

- Zgjidhja e konflikteve dhe arritja e paqes.

Mesazhet e drejtuara kah bashkësitë specifike, duke përfshirë femrat, meshkujt, rininë, fëmijët, grupacionet fetare, shkollat, njerëzit afaristë, udhëheqësit/eprorët, praktikantët e mjekësisë tradicionale dhe të tjerë.

Metodat e IEC-së duhet planifikuar dhe zbatuar përmes angazhimit aktiv të bashkësisë së refugjatëve. Është i nevojshëm zbatimi i metodave të ndryshme, në mënyrë që bashkësia të nxitet për angazhim. Këto metoda duhet të krijojnë vetëbesim dhe pajtim të përgjithshëm ndërmjet anëtarëve të bashkësisë, në dobi të miratimit të këtyre temave. Anëtarët e bashkësisë së refugjatëve duhet aftësuar që me efikasitet t'i udhëheqin fushatat. Teknologjinë e re informative, siç është interneti, duhet zbatuar si pjesë të fushatës së IEC –së, gjithkund ku ka mundësi. Duhet përfshirë në planifikim dhe zgjerim të porosive të IEC-së të gjithë personat që kanë njohuri nga lëmi i informimit publik dhe masovik

Mënyra efikase e transformimit të mesazhit është:

- Shtypja e posterëve dhe broshurave;
- Konkursi shpërblyes për posterë;
- Pjesët teatrale, këngët dhe vallet;
- Diskutimet në radio;
- Shpalljet e shërbimeve publike;
- Video prezentimi;
- Parullat e shtypura në maica;
- Seminarët edukativë; dhe
- Diskutimet joformale.

Gjatë planifikimit të strategjisë së IEC-së, merrni parasysh gjuhët e mundshme që janë pengesë për të gjitha nivelet e arsimit të popullsisë.

STRATEGJIA:

Forcimi i strukturave të bashkësisë

Bashkësia e refugjatëve duhet të luaj rol të rëndësishëm në planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e strategjisë për parandalimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Akterët humanitarë duhet të bashkëpunojnë me të gjitha sektoret e bashkësisë së refugjatëve – me shoqatat e grave, shoqatat e të rinjëve, punëtorët shëndetësorë dhe arsimorë, udhëheqësit brenda bashkësisë së refugjatëve e të tjerë, në mënyrë që në bashkësi të gjenden vullnetarë, të cilët do të ndihmonin për zbatimin e këtyre veprimtarive. Duhet pasur kujdes në numrin e njëjtë të përfaqësuesve të dy gjinive, me rastin e angazhimit të vullnetarëve nga bashkësia. Këta individë mund t'i edukojnë anëtarët e bashkësisë dhe moshatarët e tyre, të ofrojnë shërbime gjatë këshillimeve dhe, në grupe, të ndihmojnë në situatat e krizës.

Organizatat joqeveritare, UNHCR-i dhe organet e pushtetit të vendit nikoqir, vullnetarëve duhet t'u mundësojnë stërvitje të rregullta, së bashkë me përkrahjen teknike.

Shiko poashtu:

- **Si udhëhiqet: Programi lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore në Guine (UNHCR, 2001)**
- **Si udhëhiqet: Programi lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore në Liberi (UNHCR, 2001)**
- **Si udhëhiqet: Rindërtimi i qasjes ekipore për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale, Kigoma, Tanzani (UNHCR, 1998)**

STRATEGJIA:

Caktimi i numrit të njëjtë të pjesëmarrësve në strukturat udhëheqëse dhe në procesin e marrjes së vendimeve.

Është me rëndësi që grave refugjate t'iu mundësohet pjesëmarrja në nxjerrjen e vendimeve si dhe në udhëheqësi. Barazia numerike e gjinive, në kuadrin udhëheqës të bashkësisë, do ta ngriti vetëdijen për nevojat e grave, burrave, vajzave dhe djemëve, si dhe pjesëmarrjen e barabart në resurse dhe privilegje, si të meshkujve ashtu edhe të femrave.

Në disa raste është e nevojshme që të sigurohen lokale të veçanta për biseda, në bazë të gjinive dhe moshës së personave. Kështu krijohet liri më e madhe e shprehjes, nga e cila mund të rrjedhin të dhëna me rëndësi për dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, brenda bashkësisë. Takimet e ndara janë më të përshtatshëm në situata të caktuara, por angazhimi aktiv i grave në procesin e shqyrtimeve dhe marrjes së vendimeve, ka rëndësi vendimtare. Nëse kultura ose bashkësia e refugjatëve, nuk e lejon pjesëmarrjen e grave dhe të fëmijve në tubimet e meshkujve, atëherë mendimet e grave dhe të fëmijve duhet të jenë pjesë përbërse e vendimeve që i marrin meshkujt. Njëkohsisht, tentoni që të formoni grupet e meshkujve, të cilët e përkrahin pjesëmarrjen e grave nëpër tubime, për ta ndryshuar gradualisht mendimin e anëtarëve meshkujt të bashkësisë.

STRATEGJIA:

Aftësimi i femrave

Edhe pse burrat e djemt mund të jenë viktimat të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, viktimat e këtij lloji të shkeljes së të drejtave elementare njerëzore, më së shpeshti janë gratë dhe vajzat. Në shumë kultura, gratë janë të nënshtuara dhe të varura nga burrat. Si pasojë e kësaj mosbarazie në raportin e forcave, femrat janë dyfish të hendikepuara: i nënshtohen rrezikut nga keqtrajtimi fizik dhe psikologjik, e nga ana tjetër nuk kanë shumë mundësi që ta përmirësojnë padrejtësinë, respektivisht të jenë ekonomikisht të pavarura.

- Sistemi juridik vendor, ndoshta nuk e trajton dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, si vepër penale.
- Paraqitjet e grave mbi dhunën, ndoshta injorohen dhe nënçmohen.
- Femra ndoshta nuk e paraqet rastin nga frika dhe hakmarrja, ose nga dhuna që pastaj do të kryhet ndaj saj ose anëtarëve të familjes së saj.
- Nëse kryesi veprës, njëkohsisht është edhe burri saj, ajo mund të ndjehet e dhunuar në jetën e mëtejme me te, si dhe në mundësinë e vuajtjeve të shtuara, nga se nuk është në gjendje që vetes dhe fëmijve të saj t'i sigurojë ekzistencë ta pavarur.

Për ta ndryshuar rolin e femrës dhe gjykimin e saj në shoqërinë ekzistuese, duhet t'i ofrohen veprimtari që i sjellin pavarësi personale dhe ekonomike. Këto veprimtari mund të jenë:

- Programet e diturisë së shkrim-leximit;
- Ushtrimet profesionale;
- Planet dhe programet e krijimit të ardhurave dhe ofrimit të mikro-kredive;
- Sigurimi i numrit të barabart të meshkujve dhe femrave në këshillat ekzekutive për udhëheqje dhe ndihmë refugjatëve;
- Zbatimi i barabarsisë ndërmjet gjinive, me rastin e punësimit të refugjatëve;
- Barazia në shkollimin e vajzave;
- Përkrahja e organizatave dhe asociacioneve të grave;
- Ushtrimet mbi metodat e udhëheqjes.

Krahas promovimit të rolit të femrave në udhëheqësi të bashkësisë dhe procesin e marrjes së vendimeve, femrat refugjate duhet inkurajuar që të lidhen në mes vete, në përpjekje të përbashkëta për të drejtat e barabarta, brenda bashkësisë.

Shiko poashtu:

- **Direktivat për mbrojtjen e femrave refugjate (UNHCR, 1991)**

STRATEGJIA:

Të angazhohen meshkujt

- Orientimi i strategjisë për parandalim dhe reagim vetëm për femrat, e injoron faktin se meshkujt më së shpeshti janë autorët e delikteve ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Prandaj, meshkujt duhet të marrin pjesë në zgjidhjen e këtij problemi. Meshkujve ju takon që energjikisht ta dënojnë dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, për t'u arritur përparim në këtë drejtim.
- Meshkujt në pozita shtetore kanë ndikim dhe autoritet që ta fillojnë procesin e ndryshimeve, dhe të jenë si shembull për të tjerët.
- Meshkujt duhet ta dinë se kryesit e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore i pret dënimi, dhe se kjo do të ndikojë shumë keq tek familjet e tyre dhe bashkësia.

Ndihmoni dhe përkrahni meshkujt, të cilët janë të angazhuar për zhdukjen e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, brenda bashkësive të tyre. Këto grupe mundën që në mënyrë aktive ta përkrahin idenë se dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, nuk është vetëm ajo «gjëja e femrave». Mund të mësohet shumë nga ata të cilët punojnë me meshkujt, në programet për planifikimin e familjes. Kur bashkësia sheh se meshkujt janë angazhuar në pengimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, atëherë problemit në fjalë i jepet krebilitet më i madh, duke i bindur edhe meshkujt e tjerë që t'iu bashkohen.

Merreni parasysh faktin se edhe burrat e djemt mund të jenë viktima/persona që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore. Krijoni kushte dhe hapsirë, që iu mundësojnë meshkujve të flasin

për këtë çështje dhe të marrin pjesë në zhdukjen e këtij lloji të dhunës. Besoni në faktin se, viktimat e gjinisë mashkullore, nuk dëshirojnë të flasin haptas për dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, për dallim nga femrat.

Filloni herët; ushtroni prindërit mbi përkatësinë gjinore, barazinë dhe rrezikun që vjen nga dhuna, në mënyrë që ata njohuritë t'i bartin tek fëmijët e tyre. Ligjëratat mbi shëndetin reprodaktiv dhe seksual, të drejtat e njeriut dhe vetëdijen seksuale, duhet ofruar adoleshentëve në shkolla, ose përmes programeve tjera në bashkësi.

Shiko poashtu:

- **Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore në rrethin e refugjatëve: procesverbali i Konferencës ndëragjencionale mbi leksionet e mësuara**
- **Raportet mbi popullsinë: Fund dhunës ndaj femrave (Universiteti Johns Hopkins, Shkolla e shëndetsisë, 1999).**

STRATEGJIA:

Të angazhohen fëmijët dhe të rinjtë

Njohuritë, botëkuptimet dhe sjelljet është më lehtë të ndryshohen tek moshat e hershme.

- T'i përkujtoni prindërit që të njihen me të drejtat e njeriut, vetëdijen seksuale dhe zgjidhjen pa dhunë të konflikteve, dhe këto porosi t'ia bartin fëmijëve të tyre.
- Të aftësohen punëtorët arsimorë, që këto tema t'i përfshijnë në planet dhe programet e veta.
- Të themelohen dhe përkrahen shoqatat e të rinjëve, që merren me edukimin e moshatarëve të tyre dhe ngritjen e vetëdijes për problemin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore
- Të inicohet themelimi i shoqatave të vajzave nëpër shkolla, për përkrahjen reciproke dhe këshillime për vajzat më të reja.
- Të përfshihet diskutimi mbi përkatësinë gjinore, marrëdhëniet seksuale, si dhe dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, në veprimtaritë që janë prezente në bashkësi, e që nënkuptojnë edhe programet dhe fushatat arsimore e profesionale kundër HIV/sidës.
- Të mendohen mënyrat për rrumbullaksim të botëkuptimeve të fëmiut, se çka do të thotë të jesh djalë apo vajzë, përmes mediave, siç janë pjesët teatrale, poezia dhe arti.
- T'iu krijohet mundësia fëmijëve dhe të rinjëve që t'i shprehin nevojat dhe interesimet e veta.

Shiko poashtu:

- **Veprimtaritë lidhur me të drejtat e fëmijëve (ARC)² – Çështjet me rëndësi vendimtare: Keqtrajtimi dhe eksploatimi (UNHCR, OHCHR, UNICEF, Shpëtoni fëmijët, 2002)**
- **Fëmijët refugjatë: Direktivat lidhur me mbrojtjen dhe kujdesin (UNHCR, 1994)**

² Action for the Rights of Children = ARC

RINDËRTIMI I SISTEMIT TË PËRKRAHJES NË FAMILJE DHE BASHKËSI

Kur popullata ikë nga konflikti, shpesh shkatërrohen sistemet e përmbajtjes së familjeve dhe bashkësive të tyre. Gjatë konflikteve dhe gjatë kohës së ikjes, familjet shpesh shpërndahen. Shumica refugjatëve janë fëmijë dhe gra, që jetojnë pa burrat e tyre dhe familja e gjerë. Shumë gra refugjate, nga nevoja e imponuar, e kanë marrë rolin tradicional të burrit, në mënyrë që familjes dhe vetes t'i sigurojë ekzistencë elementare. Meshkujt refugjatë mund të ndjehen të paaftë, të habitur dhe me inat. Në sytë e tyre, organizatat humanitare, që ndihmojnë në ushqim dhe vendosje, sikur ua kanë uzurpuar rolin tradicional të ushqyesit dhe mbrojtësit të familjes.

Strukturat e bashkësisë, të cilat i përcaktojnë standardet morale, shoqërore dhe të sjelljes, poashtu janë të dobësuara apo të humbura gjatë ikjes. Në këto rrethana lulëzon dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore. Andaj, me rëndësi vendimtare është përtrirja e atyre strukturave dhe sistemeve, që i respektojnë të drejtat e barabarta për të gjithë anëtarët e familjes.

STRATEGJIA:

Zhvillimi i programeve shoqërore dhe rekreative

Gjatë projektimit të vendosjes së refugjatëve, caktoni hapsirë të mjaftueshme për sport, rekreacion dhe veprimtari shoqërore, si dhe për objektet në të cilat do të vendosen këto aktivitete. Bashkëpunoni me refugjatët, e sidomos me gratë dhe vajzat, për të zhvilluar veprimtari shoqërore dhe rekreative. Shkollat nuk ofrojnë vetëm arsimim: ato mund t'i mbrojnë fëmijët nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore. Prandaj duhet siguruar tretman të njëjtë shkollimi, si për djemt ashtu edhe për vajzat.

STRATEGJIA:

Të nxitet vazhdimi i veprimtarive fetare dhe spirituale

Gjatë projektimit, caktoni truall për kisha, xhamia dhe institucionet e tjera fetare. Kërkoni nga anëtarët e bashkësisë që t'i ripërtrijnë veprimtaritë fetare dhe spirituale, Udhëheqësit fetarë duhet të angazhohen si partnerë për përhapjen e porosive mbi të drejtat e grave dhe fëmijëve, si dhe për parandalimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, brenda bashkësisë.

Shiko poashtu:

- **Doracak për rastet urgjente – botimi dytë (UNHCR, 2000).**

KRIJIMI I KUSHTEVE PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË PËRGJEGJËSISË

Gjatë analizës së situatës, identifikoni njerëzit me ndikim brenda bashkësisë së refugjatëve dhe në mesin e atyre që ju ofrojnë ndihmë refugjatëve. Personat e pushtetit janë në pozitë të atillë që mund të ndikojnë në normat shoqërore dhe kulturore, dhe të cilët kanë mundësi t'iu ofrojnë ndihmë personave që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore. Çështjet me rëndësi janë:

- Kush vendos në bashkësi?
- Me kënd organizatat humanitare këshillohen dhe me kënd bashkëpunojnë në planifikimin, realizimin, mbikqyrjen dhe vlerësimin e intervenimeve?
- Kush merrë ndihma?
- Kush i kontrollon resurset brenda bashkësisë dhe familjes?

STRATEGJIA:

Ngritja e vetëdijes

Personelin e të gjitha organizatave duhet edukuar rregullisht mbi të drejtat e njeriut, përkatësinë gjinore, ligjet dhe politikën relevante shtetërore e ndërkombëtare, si dhe për direktivat mbi parandalimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Duhet, poashtu, të planifikohen rregullisht kurse për perfeksionim. Në këto kurse duhet përfshirë personelin e Kombeve të Bashkuara, organizatat joqeveritare, organet e pushtetit të vendit nikoqir dhe partnerët e tjerë.

Mësimin mbi të drejtat e njeriut dhe vetëdijes seksuale duhet ofruar bashkësisë, policisë, gjyqësisë dhe akterëve humanitarë shtetërorë dhe ndërkombëtarë.

STRATEGJIA:

Të sigurohet niveli i standardeve të përgjegjësisë dhe kodi i mirësjelljes

Asnjërit nga punëtorët humanitarë nuk guxon t'i lejohet që ta keqpërdori pozitën e tij. Përgjegjësitë, normat dhe standardet që i dedikohen personelit, duhet të jenë pjesë e kodit të mirësjelljes dhe përshkrimit të vendit të punës dhe, në rastet, kur punëtorët humanitarë nuk i përmbahen këtyre standardeve dhe obligimeve, ndaj tyre duhet zbatuar masa dënimi.

Kodet e mirësjelljes janë mjete preventive. Ato tregojnë vendosshmëri në themelimin dhe përkrahjen e standardeve të drejta, si dhe në zhdukjen e sjelljes, e cila përsëri krijon viktima nga anëtarët e lënduar të popullatave relevante, që i shkelë të drejtat e njeriut, gropos mandatet dhe përbuzë këtë organizatë.

Ruud Lubbers, komesar i lartë i KB për refugjatë, 2002

Përmes veprimtarive informative dhe arsimore duhet njoftuar bashkësinë e refugjatëve mbi standardet për intervenime humanitare, si dhe mbi të gjitha kodet që zbatohen për mirësjellje. Të krijohet sistemi, përmes të cilit mund të paraqiten dhe shqyrtohen, nw besueshmëri, rastet e keqtrajtimit nga ana e personelit humanitarë.

Besueshmëria duhet të jetë e garantuar për personat që i paraqesin rastet e tilla si dhe për personat që e kanë mbijetuar këtë dhunë. Jeni të sigurtë se anëtarët e bashkësisë së refugjatëve e dinë se ku duhet t'i paraqesin rastet e tilla. Hetimet për rastet e keqtrajtimit nga punëtorët humanitarë, duhet të fillojnë menjëherë dhe duhet të shqyrtohen në mënyrë profesionale. (Shiko Shtojcën 1 për Kodin e mirësjelljes së UNHCR-it dhe Shtojcën 1.1 për Principet themelore të Kodit të mirësjelljes së IASC-së).

PLANIFIKIMI I SHËRBIMEVE EFIKASE DHE I KAPACITETEVE TË VENDOSJES

Plani i kampit, i projektuar me kujdes, dhe zgjidhja e nevojave themelore, mund të të ndihmojë në parandalimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Gjatë projektimit të vendosjes së kampit dhe planifikimit të shërbimeve të refugjatëve duhet:

- Ikur nga popullzimi i tepërt dhe vendbanimet me disa familje.
- Ofruar vendosje të ndarë për fëmijët pa kujdesje prindore, deri sa t'iu gjendet vendosje në familjet që i mbajnë dhe ushqejnë.
- Ofruar vendosje familjeve, që udhëhiqen nga gratë dhe ku nuk ka mashkull madhor, që është anëtar i familjes.
- Të bëhen përpjekje që familjet, të cilat nuk janë në farefisni, të mos vendosen në dhoma të përbashkëta të fjetjes dhe vende tjera për jetë.
- Mundësuar që artikujt e nevojshëm, siç është ushqimi, uji, lëndët djegëse për zierje, drejtpërdrejt t'iu ndahen grave, ose të ndahen me ndihmën e grave. Duhet siguruar qasje praktike ndaj këtyre mallrave, që femrat të mos jenë të detyruara të shkojnë për to në vende të izoluar.
- Që nevojtoret të vendosen në distancë të sigurt nga hapsira ku jetohej, duke i ndarë qartë në kthina për femra dhe meshkuj.
- Mundësuar ndriçim kualitativ, sidomos në stazat që shfrytëzohen nga femrat, për të shkuar në shërbime dhe objekte.
- Siguruar bravat e dyerëve të nevojtoreve dhe banjot e përbashkëta vetëm për gra dhe vajza.
- Nxitur femrat që në mënyrë të barabart të marrin pjesë në udhëheqësinë e kampit dhe strukturat e vendosjes.
- Organizuar mbrojtjen policore dhe patrullat e sigurisë brenda kampit, duke stërvitur rregullisht policia, për të qenë partner efikas në parandalimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.
- Siguruar prezencën e rregullt të UNHCR-së, gjegjësisht organizatave joqeveritare në kamp.
- Siguruar dokumentacionin e të gjithë refugjatëve.
- Të bëhen përpjekje për dhënien e dokumenteve personale refugjatëve, nga ana e qeverisë.
- Të vihet re sjellja e popullatës vendore ndaj refugjatëve. Ekziston mundësia që ndonjë anëtar i bashkësisë së vendit nikoqir, t'i shikojë refugjatët si persona materialisht të privilegjuar, me që marrin ndihma.

STRATEGJIA:

Të dokumentohen të gjithë refugjatët

Në rastet kur janë të paraqitur vetëm kryefamiljarët meshkuj, dhe kur atyre ju ndahen kuponat për ushqim, femrat mund të jenë të keqpërdorura nga frika se do ta humbin të drejtën për ushqim dhe llojet e tjera të ndihmave. Prandaj është shumë me rëndësi që të pajisen me dokumente personale veçmas, secili nga refugjatët. Në rastet kur nuk ka mundësi të sigurohen dokumentat për çdo anëtar të familjes, femrave madhore duhet dhënë përparësi në marrjen e dokumenteve të nevojshme, për t'i plotësuar kushtet në marrjen e ndihmave.

Shiko poashtu:

- **Konkluzioni i UNHCR EXCOM-it mbi Dokumentimin e refugjatëve që kërkojnë azil nr. 91 (LII) (UNHCR, 2001)**
- **Doracak për rastet urrgjente – botimi dytë (UNHCR, 2000)**
- **Direktivat lidhur me femrat refugjate (UNHCR, 1991).**

STRATEGJIA:

Të informohen refugjatët për të drejtat, autorizimet dhe beneficionet e tyre.

Refugjatët duhet të jenë të vetëdijshëm për të drejtat, beneficionet dhe detyrat e veta. Përmes mbledhjeve të antarëve të bashkësisë, respektivisht nepërmjet materialit të botuar, si dhe përmes përdorimit të fjalës dhe fotografisë, refugjatët duhet të njoftohen me:

- Shërbimet, të drejtat dhe beneficionet, në të cilat të gjithë personat e ikur kanë të drejtë.
- Mënyrën e pjesëmarrjes në ofrimin e ndihmave dhe shërbimeve, si dhe mbi rregullat e pjesëmarrjes.
- Mekanizmat e paraqitjes dhe pjesëmarrjes në këshillimore, ku pjesëmarrja është e lejuar për personat që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore.
- Ligjet shtetërore që i mbrojnë të drejtat e garantuara me të drejtat ndërkombëtarë të njeriut dhe kushtetutën e vendit në të cilin jetojnë.
- Procedurën juridike dhe mekanizmat administrative për paraqitjen e padive lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore.
- Akterët, që ofrojnë ndihmë dhe shërbime, rolin dhe detyrat që kanë ndaj bashkësisë dhe planet e programet e ardhshme.
- Përfaqësuesit e qeverisë, agjencitë humanitare, shoqatat e grave për të drejtat e njeriut, si dhe me shoqatat e qytetarëve që punojnë në këtë lëmi.
- Politikën ekzistuese dhe direktivat e UNHCR-së, që e përkrahin mbrojtjen e grave dhe fëmijve nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore.

Bindëni në informitet të gjithë refugjatët në bashkësi, përfshirë këtu: meshkujt, femrat, rininë dhe fëmijët, personat që dinë shkrim-lexim dhe ata që nuk dinë, në mënyrën që ata e kuptojnë. Porosinë duhet shpërndarë përmes kanaleve të sigurta, që janë më të përshtatshëm dhe më praktik për grupacionet e ndryshme brenda bashkësisë, siç janë mbledhjet e këshillave të grave, mbledhjet e këshillave të rinisë etj.

STRATEGJIA:

Të angazhohet bashkësia në veprimtaritë e planifikimit, projektimit dhe realizimit

Programet e parandalimit të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, mund të jenë të suksesshëm vetëm nëse bashkësia angazhohet në mënyrë aktive në të gjitha etapat e realizimit të tyre, duke filluar nga identifikimi dhe shqyrtimi i problemeve, deri në mbikqyrjen dhe vlerësimin e veprimtarive, kushtuar parandalimit të këtij lloji të dhunës. Bashkësia ka aftësi të zbulojë shkaqet e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, të japi këshilla se si është më mirë të përhapen informacionet mbi këtë problem, si dhe çfarë masa preventive duhet zbatuar.

- Të kërkohet pjesëmarrja e udhëheqsve refugjatë, meshkuj e femra, që janë anëtarë me ndikim në bashkësi, siç janë eprorët dhe udhëheqësit fetarë, si dhe të ikurit e tjerë të interesuar, gjatë mbledhjeve të para, pas ndonjë rasti urgjent.
- Të dëgjohet me vëmendje ajo që e thonë refugjatët. T'iu lejohet që ata lirisht të rrëfejnë për problemet dhe nevojat e tyre, edhe kur të jetë e nevojshme, të mbahen biseda të ndara, për grupacionet e ndryshme.
- Të merren pasrasysh dhe të zbatohen porositë e dhëna nga refugjatët:
 - Projektimi i planit të kampit.
 - Ndarja e vendeve për vendosje.
 - Ndarja e artikujve ushqimorë dhe artikujve të tjerë.
 - Përcaktimi i masave specifike për parandalimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.
 - Rregullimi i sistemit të raportimit dhe dërgimit.

Jeta në kampe shpesh krijon frustrim dhe bezdisje të madhe në mesin e refugjatëve. Përmes bashkëpunimit me refugjatët, zhvillonin aktivitete që iu mundësojnë ta kanalizojnë energjinë e tyre, siç është sporti dhe rekreacioni. Rregullat që kanë të bëjnë me përdorimin e alkoolit, kafenetë dhe aktivitetet e tjera në kamp, duhet ta zvoglojnë rrezikun e mbrojtjes. Në bashkëpunim me pushtetin vendor, shqyrtoni masat për parandalimin e keqpërdorimit të alkoolit. Organizoni fushata arsimore, ku do të shqyrtohet se keqpërdorimi i alkoolit shkakton dhunë seksuale dhe dhunë mbi baza gjinore.

Strategjitë preventive është e mundur që të përshtatën për një efikasitet më të madh, në punë me të kthyerit dhe rastet nga mjediset e qytetit. Për dallim nga popullata e kampit, të cilët e kanë të kufizuar hapsirën, të kthyerit shpesh janë të shpërndarë brenda bashkësisë. Për mbrojtjen e këtyre popullatave nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, është e nevojshme që :

- Të angazhohen femrat nga popullata e kthyer e qyteteve për formimin e shoqatave dhe rrjetit të përkrahjes që do të ketë rol udhëheqës në veprimtaritë preventive.
- Programet për parandalim të mos orientohen vetëm kah refugjatët e kthyer, por edhe kah udhëheqësi dhe përfaqësuesit e bashkësive, të locuara në rajonet ku kthehen refugjatët.
- Të organizohet edukimi, që iu jep njohuri për parandalimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore dhe ndërtimin e kapaciteteve të shoqatave në rajonet ku kthehen refugjatët.

STRATEGJIA:

Të caktohen sistemet e distribuimit, në bazë të përkatësisë gjinore

Sistemet e distribuimit të prodhimeve ushqimore dhe prodhimeve tjera, duhet planifikuar me kujdes dhe mbikqyrë për pengimin e korrupsionit, keqpërdorimit dhe eksploatimit. Përdorni të gjitha mjetet për t'i njoftuar refugjatët, sidomos femrat dhe fëmijët, për të drejtat e tyre. Qasja e barabart e kontrollimit të

resurseve nga të dy gjinitë në familje, ju sjellë dobi të gjithëve në familje, e zvoglon pabarazinë ndërmjet gjinive dhe i aftëson femrat, duke zbutur edhe rrezikun nga dhuna në familje. Keni parasysh furnizimin e grave me kupona ndamas për ushqim, nëse kjo mund të vehet në praktikë. Femrat duhet përkrahur që t'i pranojnë rolet qëndrore në udhëheqje, distribuim dhe mbikqyerje të porosive të ushqimit. Në këtë mënyrë mundësohet pjesëmarrja e të gjithë antëraëve të familjes në ushqim, ndërsa pengohet shfrytëzimi seksual i femrave, si kompenzim me ushqimin. Siguroni pjesëmarrjen e numrit proporcional me femra, gjatë procesit të ndarjes së ushqimit. Këshillat e grave refugjate duhet përfshirë në mbikqyerje, ndarje dhe aktivitete, pas ndarjes së ushqimit. Punëtorët humanitarë, që nuk janë anëtarë të bashkësisë së refugjatëve, duhet të jenë prezentë në vendet e distribuimit, që ta kontrollojnë tërë procesin.

STRATEGJIA:

Implementimi programit lidhur me shëndetin reprodutiv

Shumica e veprimtarive që janë të lidhura me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, që i realizon sektori i shëndetësisë, iu janë të dedikuara reagimit ndaj këtij lloji të dhunës dhe ofrimit të ndihmës viktimave/të mbijetuarëve. Mirëpo, sektori i shëndetësisë mundet, poashtu, t'i kontribuojë edhe parandalimit të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duke kryer:

Kontrollimin me kudes të pacientëve në shëndetësi, për t'i zbuluar ata, të cilëve më së tepërmi iu kanoset rreziku nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, për të penguar traumat dhe dhembjet e mëtejme të viktimës/mbijetuarit.

Implementimin e veprimtarive lidhur me shëndetin reprodutiv, duke përfshirë diskutimin mbi përkatësinë gjinore, marrëdhëniet, dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore. Këto veprimtari ju janë dedikuar jo vetëm femrave, por edhe meshkujve dhe adoleshentëve (informimi për parandalimin e HIV/sidës, poashtu, duhet të jetë pjesë e këtyre veprimtarive)

Angazhimin e ndihmësve tradicionalë gjatë lindjes, si partnerë në veprimtaritë lidhur me shëndetin reprodutiv. Ndhimësit tradicionalë gjatë lindjes, mund të ofrojnë informacione të çmueshme, duke ndihmuar edhe në përhapjen e porosive për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës seksuale.

Shiko poashtu:

- **Doracak ndër-agjencional i terrenit për shëndetin reprodutiv, në situatat e të ikurëve (Ndër-agjencionalë, 1999)**

STRATEGJIA:

Të zbatohen programet e mbrojtjes dhe sigurisë

Ndjenja e sigurisë ndikon në disa nivele të shoqërisë: në shtëpi, në rajonin e refugjatëve-zhvendosjeve, bashkësinë lokale dhe rrethin shtetror. Në princip, përgjegjësinë kryesore për sigurinë e refugjatëve e mbanë qeveria e vendit nikoqir. Por, në vendet ku shteti s' ka forcë, është i marginalizuar apo në shthurje, punëtorët humanitarë shpesh e marrin rolin e mbrojtësve të refugjatëve dhe të shpërngulurëve. Për të qenë refugjatët të mbrojtur, duhet:

- Të autorizohen udhëheqësit meshkuj e femra të bashkësisë, si dhe rrjeti i rojtarëve të refugjatëve në rrethinën e kampit.
- Të zhvillohet ndjeshmëria dhe të rritet kapaciteti i plocisë vendase, për plotësimin e detyrave të veta në mënyrë efikase.
- Të projektohet plani i kampit, që e zvoglon mundësinë e sulmimit të femrave.

- Të angazhohet një numër i caktuar i femrave në shërbimin e mbrojtjes dhe bashkëpunimit me policinë dhe organet e tjera të punëve të brendshme, i locuar brenda ose afër kampit.
- Të sigurohet lëvizje e lirë e femrave refugjate, gjatë grumbullimit të druve, mbushjes së ujit ose deri sa bëjnë tregti apo kryejnë ndonjë veprimtari tjetër, prej nga fitojnë të ardhura.
- Të caktohet njësi e rojtarëve të bashkësisë, që personelin e angazhojnë nga bashkësia e refugjatëve, si dhe përfaqësimin e një numri adekuat të femrave në këto njësi.
- Të analizohen të dhënat mbi rastet e dhunës, duke diskutuar për rrezikun dhe çështjet e tjera lidhur me sigurinë, me të gjithë akterët e bashkësisë.
- Të zgjidhen të gjitha problemet në vendbanim, si fjala vjen, ndërtimi rrethojës, përmirësimi i ndriçimit, shfrytëzimi i radios.
- Të bashkëpunohet me refugjatët, për parandalimin e rrezikut të shtuar ndaj viktimave/ të mbijetuarëve, planifikimit për mbrojtjen e të mbijetuarëve, menjëherë pas rastit të shëmtuar (për shembull: transferimin, caktimin e zonës së «mbrojtur» brenda kampit, themelimin e vendbanimeve të sigurta, etj.).
- Patrollim policor i shpesht në rajonet me rrezikshmëri të lartë.
- Vendosshmëri për atë se, a duhet kryesit e veprave të transferohen nga bashkësia, për t'u siguruar mbrojtja e viktimave/personave të mbijetuar dhe si të pengohet dhuna e sërishme.

Shiko poashtu:

- **Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore në rrethin e refugjatëve: procesverbal i Konferencës ndër-agjencionale mbi leksionet e mësuara**
- **Direktivat lidhur me mbrojtjen e grave refugjate (UNHCR, 1991)**

STRATEGJIA:

Keni ndishmëri ndaj popullatës së vendit nikoqir

Shumë popullata-të vendeve mikpritëse - jetojnë në kushte relativisht të varfëra, anadaj edhe ndoshta zemrohen që refugjatëve, të cilët jetojnë në mesin e tyre, apo afër tyre, ju ofrojnë shërbime dhe ndihma. Organizoni debate me popullatën vendase lidhur me refugjatët – se për çfarë arsye janë aty, sa do të qëndrojnë dhe pse ju nevojiten ndihma-që të zvoglohet tensioni ndërmjet këtyre dy grupacioneve. Kur kjo të jetë e mundur, veprimtaritë programore zbatoni në mesin e popullatës vendase. Shërbimet shëndetësore janë më të përshtatshmet dhe më të vlefshmet.

STRATEGJIA:

Të kyçen çështjet lidhur me përkatësinë gjinore në të gjitha etapat e planifikimit dhe realizimit të programit

Të gjithë akterët humanitarë, duke përfshirë edhe agjencionet e KB, organizatat joqeveritare, qeveritë e vendit nikoqir dhe partnerët e tjerë, duhet ta zbatojnë analizën e përkatësisë gjinore, gjatë planifikimit të programit. Këto programe duhet të jenë të ndieshëm ndaj përkatësisë gjinore, duke marrë parasysh nevojat specifike si të meshkujve ashtu edhe të femrave. Me ndihmën e personelit të UNHCR-it, planet

operative të vendeve duhet t'i shprehin prioritetet e zyreve përkatëse, që janë të ndieshme në përkatësinë gjinore dhe moshën.

Organizatrat ndërkombëtare dhe ato joqeveritare, duhet shpejt ta vejnë në jetë barazinë ndërmjet gjinive (në mënyrë që çdo gjini të përbëjë 50% të personelit të përgjithshëm) në nivel të udhëheqësisë, si dhe gjatë operacioneve në terren. Në këtë mënyrë, çështja e përkatësisë gjinore do të jetë aktuale, gjatë veprimit të programit të përgjithshëm.

Shiko poashtu:

- **Rezoluta UN GA mbi përshtatjen e përkatësisë gjinore në rrjedhat e gjera të shoqërisë (A/52/3, 1997)**

NDIKIMI NË SUAZAT FORMALE DHE JOFORMALE TË LIGJIT

Në përhapjen e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore në bashkësi, ndonjëherë ndikojnë ligjet qw e ndalojnë këtë lloj të dhunës, ose zbatimi i këtyre ligjeve në vendin nikoqir dhe në vendin e prejardhjes. Dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore mund të kryhet pa frikë nga dënimi, në rastet kur:

- Ligjet dhe politika e përkrahin diskriminimin gjinor dhe heshtazi e miratojnë dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore.
- Ekziston mbrojtje e kufizuar ligjore e të drejtave të grave.
- Nuk ekzistojnë ligjet kundër dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.
- Zbatimi i dobët i ligjit rezulton në mungesë të besueshmërisë ndaj legjislacionit.
- Zbatimi i ligjit dhe praktika gjyqësore i kontribuojnë sjelljes negative, bazuar në përkatësinë gjinore.

Në radhë të parë, **më përfaqësohet njoftohuni me sistemet juridike formale e tradicionale dhe sistemet juridike zakonore, të vendit mikpritës dhe vendit të prejardhjes.** Vërtetoni se a ekzistojnë zakone dhe politika që e mbrojnë nga diskriminimi, bazuar në përkatësinë gjinore si dhe nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, përfshirë këtu edhe rastet e dhunës në familje. Vërtetoni se si mund të përmirësohen këto ligje. Realizoni kontakte me organizatat që merren me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grave në atë vend.

STRATEGJIA:

Puna me sistemet juridike tradicionale

Sistemet tradicionale ose zakonore, me të cilët, kryesisht udhëheqin eprorët, janë aktiv në shumë bashkësi refugjatësh. Rregullat, procedurat dhe vendimet e grupacioneve të tilla përmbajnë norma, bindje dhe qëndrime të asaj bashkësie. Grupacionet e tilla kanë të drejtë të gjykojnë në rastet e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, përfshirë edhe rastet e dhunës në familje. Në situatat, kur aktgjykimet e gjykatave ose këshillave të tilla, i cënojnë standardet e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, lidhur me të drejtat e viktimave, duhet ndërmarrë masa për edukimin e anëtarëve të këtyre forumeve për standardet ekzistuese ndërkombëtare të drejtave të njeriut.

Orientoni fushatat dhe programet e stërvitjeve për të drejtat e njeriut dhe të përkatësisë gjinore, kah këto grupe. Shpreheni mendimin se respektimi i të drejtave të njeriut për të gjithë individët dhe jotoleranca ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, do t'i shërbejë tërë bashkësisë. Me që eprorët, të cilët e ndajnë drejtësinë, gëzojnë autoritet të madh brenda bashkësisë, qëndrimet e tyre, poashtu, ndikojnë edhe në qëndrimet e të tjerëve. Përkrahni pjesëmarrjen e grave dhe të rinjëve në këto struktura tradicionale. Këto këshilla duhet nxitur që t'i paraqesin rastet e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, sistemit juridik formal, në situatat ku kjo dhunë trajtohet si sjellje penale.

STRATEGJIA:

Puna me sistemet shtetore të jurisprudencës

Të vehen kontakte me gjykatësit vendorë për kundravajtje, gjykatat dhe gjykatësit. Ofroni programe edukative lidhur me ligjin mbi të drejtat ndërkombëtare të njeriut. Të ftohen organet gjyqësore të pushtetit dhe përfaqësuesit e të drejtave shoqërore që ta shqyrtojnë çështjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në ligjet shtetore, si dhe procedurat penale lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore. Në vendet ku organet gjyqësore janë të kufizuara në mungesë të resurseve, të krijohet rrjeti ku do të përfshiheshin gjykatësit, prokurorët dhe policia, për të pasur mbështetje ligjet shtetore.

Në situatat, ku gjykatat nuk janë prezente, sikurse në lokalitetet e largëta, merrni parasysh mundësinë e gjykatave lëvizëse, që financohen nga UNHCR-i dhe agjencionet e tjera. Në disa lokalitete, ekzistenca e gjykatave të tilla ka ndikuar në shtimin e paraqitjeve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, si dhe në informimin më të mirë të bashkësisë për sistemin e drejtësisë.

STRATEGJIA:

Të forcohen ligjet dhe politika shtetore që i mbrojnë të drejtat e njeriut

Të punohet me organizatat humanitare shtetore, siç janë shoqatat e grave juriste dhe organizatat e shoqatave qytetare, në dobi të përkryerjes së ligjeve dhe politikës së vendit nikoqir, e që kanë të bëjnë me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore. Korniza shtetore juridike, e cila e ndalon dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, është e domosdoshme për krijimin e strategjisë preventive, bazuar në sistemin juridik.

Të bashkëpunohet me organizatat që bëjnë përpjekje për reformat legjislative dhe merren me problemin e dhunës seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, si dhe me shkelje të tjera të të drejtave të refugjatëve.

Në bashkëpunim me agjencionet e KB dhe shoqatat qytetare, të ndikohet te shteti nikoqir që të bindet në ratifikimin e instrumenteve të të drejtave ndërkombëtare të njeriut. Në këtë mënyrë do të përfshihet statusi juridik i viktimave të refugjatëve/ personave që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore.

Shiko poashtu:

- **Mbrojtja e refugjatëve: Udhërrëfyes për punën në terren, dedikuar organizatave joqeveritare (UNHCR, 1999)**

STRATEGJIA:

Të caktohen dënime të përshtatshme për kryesit e veprave

Masat ndëshkuese serioze ndaj kryesve të dënuar për dhunë seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, mund të ndikojnë në mënyrë destimulative. Ndaj refugjatëve që kanë kryer këso vepra të liga, duhet vepruar njësoj, sikurse edhe ndaj shtetasëve, që kanë kryer vepra të ngjashme: sipas procedurës së rregullt ligjore

dhe masave ndëshkuese përcjellëse. Në thelb, ndëshkimet për kryesit e dënuar të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet ta respektojnë principin themelor të mosdetyrimit për kthim në vendin e prejardhjes.

Ku të jetë e mundur, dënimet duhet lidhur me përpjekjet për rehabilitimin e kryesit të veprës, përmes, fjala vjen, stërvitjeve, informimit mbi të drejtat e njeriut dhe përkatësisë gjinore, si dhe për dëmshpërblimin që i takon viktimës së dhunuar.

MBIKQYRJA DHE DOKUMENTIMI I RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS MBI BAZA GJINORE

Për t'u zhvilluar masat efikase preventive, duhet pasur pasqyrë të qartë për problemin në rrethin tuaj specifik. Mbikqyrja e rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet të jetë përgjegjësi e të gjithë aktërëve: shëndtësisë, psiko-sociale si dhe personelit të shërbimit të sigurimit dhe anëtarëve të bashkësisë së refugjatëve (Shih Kapitullin 7 për informacione plotësuese mbi mbikqyrjen dhe vlerësimin). Gjatë fazave fillestare të programimit, mos harroni t'i siguroni resurset financiare dhe njerëzore për mbikqyrje dhe vlerësime.

Të dhënat mbi dendësinë e rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet t'i shënojë dhe analizojë një agjenci qëndrore, nëherë në muaj. Nëpunësit e sigurimit duhet të parët të bëjnë përpjekje për mbajtjen e shënimeve mbi shkeljen e të drejtave të njeriut, të këtij lloji, sipas mënyrës se si shënohen të dhënat mbi shkeljen e të të drejtave të njeriut.

Për shkak të shfrytëzimit të informacioneve të grumbulluara, caktoeni mbledhjen me të gjithë akterët për definimin e nocioneve (në mënyrë që të gjithë akterët t'i japin të njëtin emër llojit të njëjtë të dhunës) dhe përcaktimit të mënyrës së numrimit të rasteve të dhunës. Informacionet e mbledhura duhet të përmbajnë fakte relevante, siç është lloji i rastit, vendi se ku ka ndodhur rasti, biografinë për kryesin e veprës dhe të viktimës/ të mbijetuarin, si dhe faktorët potencialë të rrezikut. Këto raporte mujore, duhet të përgjigjen në këto pyetje në vijim:

- Çka ka ndodhur në këtë muaj?
- Cila strategji preventive ka qenë e suksesshme? Çka nuk ka qenë e dobishme? Pse?
- Çka duhet bërë mëtej, në kuadrin e raportit të këtij muaji?

Merruni vesh me të gjithë partnerët mbi nevojat, mënyrën e raportimit dhe formatin e raportit, si dhe në çfarë mënyre dhe kujt t'i ndahen këta raporte (Shih Shtojcën 2 për kopjen e formularit për paraqitjen e rastit të dhunës).

Caktoni mbledhjet multisektoriale, ku duhet të kyçen refugjatët, për t'i shqyrtuar të dhënat. Gjatë këtyre mbledhjeve, përcaktoni faktorët që mund t'i kontribuojnë dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duke përpliluar planet për flakjen e këtyre faktorëve (Shih Kapitullin 6 për informacione plotësuese).

Përmes një shqyrtimi me kujdes të rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, do të keni mundësi që ta vlerësoni suksesin e strategjive tuaja preventive, t'i konsolidoni njohuritë dhe t'i grumbulloni shënimet e besueshme statistikore, që do t'iu ndihmojnë në përcjelljen e analizave krahasuese.

Shiko poashtu:

- **Si duhet udhëhequr: Mbikqyrja dhe vlerësimi i programit të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, bazuar në përcaktimin gjinor, Tanzani (UNHCR, 2000).**

PIKAT KYÇE

Gjatë tentimit të ndryshimeve të njohurive socio-kulturore, qëndrimeve dhe sjelljeve :

- Të zhvillohet fushata e informimit, edukimit dhe komunikimit.
- Të rekrutohen vullnetarë nga bashkësia.
- Të mbahet barazpesha në strukturat udhëheqëse dhe vlerësimin e marrjes së vendimeve.
- Të autorizohen femrat
- Të kyçen meshkujt.
- Të angazhohen fëmijët dhe rinia.

Kur sistemet e familjes, respektivisht të bashkësisë kolaborojnë:

- Të zhvillohen programet shoqërore dhe rekreative.
- Të bashkëpunohet me udhëheqsit fetarë e të tjerë të bashkësisë për përtrritjen e vlerave shoqërore, të cilat përmbajnë barazi dhe respekt ndaj të gjithë anëtarëve të bashkësisë.

Me rastin e planifikimit të shërbimeve dhe kapaciteteve të vendosje së refugjatëve:

- Të angazhohen të gjithë ofruesit kyç të shërbimeve, respektivisht në shërbimin e mbrojtjes, shërbimin social, shëndetësi, shërbimin e sigurimit, policinë dhe organet relevante të pushtetit, si dhe vetë refugjatët.
- T'iu mundësohen librezat e legjitimit të gjithë refugjatëve (meshkujve dhe femrave).
- Të informohen refugjatët mbi të drejtat, autorizimet dhe beneficionet e tyre.
- Të angazhohet bashkësia në procesin e projektimit, planifikimit dhe realizimit.
- Të formohen sistemet e barabarta gjinore të distribuimit.
- Të zbatohen programet e shëndetit reprodaktiv.
- Të zbatohen programet e mbrojtjes dhe sigurisë.
- Të kihet mirëkuptim ndaj popullatës së vendit nikoqir.
- Të përfshihen çështjet lidhur me përkatësinë gjinore, në të gjitha etapat e planifikimit dhe zbatimit të programit.

Me rastin e tentimit të ndikimit në sistemet formale juridike dhe tradicionale :

- Të njihemi me sistemet formale juridike dhe tradicionale të vendit nikoqir dhe vendit të prejardhjes.
- Të bashkëpunohet me udhëheqësit e sistemit juridik tradicional për përkrahjen e ndryshimeve.
- Të bashkëpunohet me personelin e sistemit shtetror të jurisprudencës, në mënyrë që refugjatët ta kthejnë besimin në sistemin juridik.
- Të forcohen ligjet dhe politika shtetore, që i mbrojnë të drejtat e njeriut.

Me rastin e mbikqyrjes së rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore:

- Gjatë muajit të grumbullohen dhe analizohen të dhënat mbi dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore.
- Të unifikohen definicionet e nocioneve dhe mënyrës së numrimit të rasteve ndërmjet të gjithë akterëve.
- Të bëhet harmonizimi me të gjithë partnerët rreth mënyrës së raportimit dhe formatit të vetë raportit, i cili do të përdoret gjatë punës.
- Të konvokohen mbledhjet multisektoriale, ku duhet të përfshihen edhe refugjatët, për shkak të revidimit.

KAPITULLI 4

REAGIMI NDAJ DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS NË BAZË TË PËRKATËSISË GJINORE

Është e domosdoshme që të kuptohen pasojat e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, për planifikimin e programeve efikase të përkrahjes në dobi të viktimave/personave që e kanë mbijetuar këtë lloj të dhunës. Këto pasoja dallohen, varsisht nga lloji i dhunës.

Të gjithë anëtarët e bashkësisë së refugjatëve duhet ta dijnë se si dhe ku duhet paraqitur rastet e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Nëse viktimat/personi mbijetuar nuk e paraqet rastin e dhunës, nuk ka mundësi që t'i ofrohet ndihma adekuate. I takon bashkësisë që të mendojë se si t'i ofrohet përkrahje viktimave/të mbijetuarëve. Veprimtaritë e reagimit përfshijnë: edukimin dhe informimin e bashkësisë; stërvitjen e akterëve për reagim ndaj nevojave të viktimave/të mbijetuarëve; rivendosjen e mekanizmave të porosive, raportimit, mbikqyrjes dhe vlerësimeve; aftësimin e bashkësive të refugjatëve që të reagojnë në këtë lloj të dhunës; reagimin ndaj nevojave të viktimave/mbijetuarëve; planifikimin për përmbushjen e nevojave psiko-sociale të viktimave/mbijetuarëve; ndërmarrjen e masave të mbrojtjes dhe sigurisë; rivendosjen e mekanizmave juridik/gjyqësor; përcaktimin e rolit të akterëve tjerë potencialë; dhe planifikimin e punës me autorët e veprave. Direktivat e lidhura me besueshmërinë e informacioneve, sigurinë fizike, si dhe respektimi i dëshirave, të drejtave dhe dinjitetit të personave të mbijetuar, duhet përkrahur përmes të gjitha veprimtarive.

Është më se e domosdoshme që të kuptohen pasojat e llojeve të ndryshme të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, për ndërmarrjen e masave më të përshtatshme të reagimit (Shih Kapitullin 1 për regjistrin e pasojave të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore). Këto pasoja mund të radhiten në katër fusha kryesore: shëndetësore, psiko-sociale, mbrojtjes-sigurisë dhe juridike, respektivisht gjyqësisë. Së këndejmi, reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet të përqëndrohet në këto katër lëmi vendimtare.

Për të REAGUAR ndaj nevojave të viktimave/personave që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, duhet t'i kuptoni PASOJAT e kësaj dhune.

VËSHTRIM I SHKURTË I PASOJAVE MË TË RËNDËSISHME TË DHUNES SEKSUALE DHE DHUNËS MBI BAZA GJINORE

SHËNDETËSORE	EMOCIONALE-PSIKOLOGJIKE-SHOQËRORE
<ul style="list-style-type: none"> • Lëndimi, invaliditeti, vdekja • Sëmundjet ngjitëse seksuale dhe sida • Sëmundjet e organeve reproduktive • Shtatzania problematike, lindje e vështirë • Dështimi spontan • Shtatzania e padëshiruar • Abortimi joprofesional • Depresioni dhe sëmundjet kronike • Shoku • Infeksionet, infeksionet kronike • Gjakderdhje e shumtë 	<ul style="list-style-type: none"> • Zemrimi, frika, mllëfi, urrejtja e vetëvetes • Ndjenja e turpfit, josigurua, humbja e aftësisë së funksionimit brenda familjes dhe shoqërisë • Depresioni • Çrregullimi i gjumit, gjegjësisht ushqimit • Sëmundja shpirtërore • Izolimi nga shoqëria • Vetëvrasja • Hedhja e fajit mbi viktimën • Izolimi/braktisja e viktimës • Presioni mbi resurset dhe përkrahja e bashkësisë

JURIDIKE/LIDHUR ME MBROJTJEN	TË SIGURISË/LIDHUR ME RAJONIN E BASHKËSISË
<ul style="list-style-type: none"> • Kryerja e presionit ndaj sistemeve të stërngarkuara të policisë dhe gjyqësisë • Ligjet joadekuate lidhur me format e ndryshme të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore mund të shndërrohen në mungesë të zgjidhjes gjyqësore për viktimën/mbijetuarin; pa masa ndëshkuese për kryesin e veprës • Vendimet e papërshtatshme gjyqësore, që i sjellin traumë të shtuar viktimës/të mbijetuarit, si psh. martesë e hershme dhe e detyrueshme me kryesin e veprës • Paraqitja e pakët e rasteve të dhunës seksuale, si pasojë e mungesës së besimit në mosfunksionimin e sistemit të gjyqësisë • Shtimi i numrit të rasteve të dhunës së sërishme ndaj të njëjtës viktimë, të mbijetuarës, ose ndaj grave dhe vajzave tjera të bashkësisë 	<ul style="list-style-type: none"> • Viktima/personi mbijetuar ndjehet jo i sigurtë, i rrezikuar, i frikësuar • Atmosfera e frikës dhe e josigurisë në tërë bashkësinë apo vetëm në mesin e femrave • Bashkësia mund të ndjehet joadekuate ose e pafuqishme kur s'mund ta pengojë dhunën përmes rojtarëve/shërbimit të mbrojtjes • Bashkësia e merrë drejtësinë në duart e veta, për t'u mbrojtur nga kryesit e dyshimtë • Punëtorët socialë dhe viktimat/të mbijetuarit shmangen

Veprimtaritë e nevojshme për reagim ndaj nevojave të viktimave/personave që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, shkurtazi janë të pasqyruara në faqen tjetër. Sikur në rastin e strategjive preventive, këto veprimtari janë më efikase nëse planifikohen përmes qasjes multisektoriale, duke përfshirë angazhimin e bashkësisë së refugjatëve. Kur refugjatët/ të kthyerit janë të shpërndarë nëpër mjediset e qytetit, mund të jetë i nevojshëm numër më imadh i akterëve, për reagim më të shpejt ndaj rasteve të dhunës seksuale.

Vështrim i shkurtë i veprimtarive të reagimit ndaj dhunës seksuale

- edukimi dhe informimi i bashkësisë
- stërvitja e akterëve për plotësimin e nevojave të viktimave/mbijetuarëve
- rivendosja e mekanizmave të porosisë, raportimit, mbikqyrjes, dhe vlerësimit
- aftësimi i bashkësisë së refugjatëve që të reagojnë në këtë lloj të dhunës
- reagimi ndaj nevojave shëndetësore/medicinale të viktimave/të mbijetuarëve
- planifikimi për plotësimin e nevojave psiko-sociale të viktimave/të mbijetuarëve
- ndërmarrja e masave të mbrojtjes dhe sigurisë
- rivendosja e mekanizmave juridiko-gjyqësore
- përcaktimi i rolit dhe i akterëve tjerë potencialë
- planifikimi i punës me kryesit e veprave

EDUKIMI DHE INFORMIMI I BASHKËSISË

Lansimi i fushatës së informimit publik mbi dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, që shprehin ndieshmëri kulturore, etike dhe rrethana specifike që mbizotërojnë në mjedisin tuaj.

Temat, të cilat këto fushata mund t'i inicojnë janë: si dhe ku duhet kërkuar ndihmë në rastet e dhunimit seksual; rëndësia e paraqitjes së rasteve dhe kërkimi i drejtpërdrejt i ndihmës; ligjet shtetore dhe ndërkombëtare që e dënojnë dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore. Këto porosi mund të përhapen përmes broshurave, buletineve dhe posterëve; përmes koncerteve të këngëve dhe pjesëve teatrale; përmes prezentimit gjatë mbledhjeve të bashkësisë, shërbimeve fetare ose formave tjera të shoqërizimit; përmes radios dhe mediave tjera masovike si dhe përmes videos.

STËRVITJA E AKTERËVE PËR REAGIM NDAJ NEVOJAVE TË VIKTIMAVE/PERSONAVE TË MBIJETUAR

Gjatë angazhimit të bashkësisë në diskutime mbi dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, si dhe nxitjes së anëtarëve të bashkësisë për paraqitjen e rasteve të dhunës seksuale, akterët e përfshirë për të reaguar në nevojat e viktimave/të mbijetuarëve, duhet të përgatiten që t'i ofrojnë shërbimet e veta.

Personeli përgjegjës për kujdesin ndaj viktimave/personave të mbijetuar, duhet të ketë ndjeshmëri ndaj përkatësisë gjinore dhe të vazhdojë ushtrimet për çështjet e lidhura me përkatësinë gjinore. Stërvitja e tillë, që ka të bëjë me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, duhet të përmbajë:

- **Personelin shëndetësor**, i cili duhet t'i kryejë vizitat e para mjekësore, duke përcjellur mëtej shërimin dhe gjendjen shëndetësore.
- **Këshilltarët, që merren me problemet psiko-sociale dhe problemet e bashkësisë**, duhet të ofrojnë ndihmë psiko-sociale dhe rekomandime përkatëse.

- **Shërbimin e mbrojtjes**, i cili duhet t'i mundësojë siguri viktimës/personit të mbijetuar i cili ndjehet i rrezikuar dhe i frikësuar.
- **Personelin e mbrojtjes juridike**, i cili viktimave/të mbijetuarëve duhet t'i ofrojë përkrahje gjatë inicimit të procedurës gjyqësore kundër kryesit të deliktit, nëse dëshiron viktimë.

Nëse pas paraqitjes së rastit të dhunës seksuale, viktimës/të mbijetuarit nuk i është ofruar shërbimi, apo nuk iu ka mundësuar ndihma me kohë dhe në mënyrë sekrete, viktimë e humb besimin tek këto shërbime, ndërsa palët e tjera nuk dëshirojnë t'i paraqesin rastet e ngjashme.

Nëse viktimë/ e mbijetuara nuk e informon dikë për rastin e dhunës seksuale, atëherë nuk do t'i ofrohet ndihma adekuate.

VENDOSJA E MEKANIZMAVE TË REKOMANDIMIT, RAPORTIMIT, MBIKQYRJES DHE VLERËSIMIT

Duhet të vendoset sistem i qartë i udhëzimeve në çdo rajon, në mënyrë që viktimë/personi mbijetuar të dijë se kujt t'i drejtohet, për t'iu ofruar ndihma me kohë.


Ky sistem, për të cilin janë përgjegjës si punëtorët humanitarë ashtu edhe anëtarët e bashkësisë, duhet t'i jetë i njohur të gjithë anëtarëve të bashkësisë dhe të gjithë akterëve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të tyre viktimë/të mbijetuarëve. Raportimet në mes të agjencive dhe procedurat e dërgimit, duhet shkruar dhe përkthyer në gjuhët e vendit.

Siç tregon diagrami në vijim, shumica e rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, nuk paraqiten:

Ilustrimi 6.1

Serioziteti i problemit të dhunës seksuale

Pasojat fatale të dhunës seksuale



Seksi padëshiruar, ku viktimë pranon pas lutjeve dhe kërcnimeve

Dhunimi që është paraqitur

përmes anketimit

Seksi detyruar në martesë dhe gjatë vardisjes, kërcnimit dhe mashtrimit

Dhunimi nga personi i panjohur

Dhunimi i cili nuk është paraqitur
shkak të ndjenjës së turpit,
lutjeve ose kërcnimeve

Seksi i padëshiruar,ku viktime pranon për
pas lutjeve dhe kërcnimeve

Seksi detyruar në martesë dhe gjatë vardisjes,
kërcnimit dhe mashtrimit

Dhunimi nga personi i panjohur

Shfrytëzimi seksual si pasojë e varësisë ekonomike

Burimi: Raporti botëror mbi dhunën dhe shëndetin: WHO, 2002

Të gjithë akterët duhet të pajtohen lidhur me sistemin e përbashkët të raportimit.

Një element i rëndësishëm i sistemit efikas të raportimit është përdorimi i një formulari të përbashkët për Paraqitjen e rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Sipas nevojës ky formular duhet të përkthehet, dhe të gjithë akterët duhet të jenë të ushtruar për pëdorimin e tij. Shih Kapitullin 7 se si duhet të zhvillohet një sistem i vetëm dhe i përbashkët i raportimit, dhe cilat informacione duhet përfshirë në formularin për Paraqitjen e rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Në Shtojcën 2 gjendet kopja e formularit për Paraqitjen e rasteve të dhunës seksuale.

Akterët duhet t'i zhvillojnë mekanizmat për vlerësim dhe mbikqyerje të veprimtarive të reagimit dhe efikasitetit të sistemit të raportimit dhe udhëzimeve.

Qëllimi i sistemit të raportimit është të sigurojë zhvillimin e intervenimeve, ashtu siç është planifikuar. Vlerësimi i ndihmon akterët në identifikimin e mënyrës së drejtë të punës, efikasitetit dhe reagimit se a ekzistojnë apo nuk ekzistojnë nevojat për viktime/të mbijetuarit, dhe pse nuk janë të kënaqura. Të gjithë akterët duhet të përfshihen në zhvillimin e këtyre mekanizmave të mbikqyrjes dhe vlerësimit. Shih Kapitullin 7 për mënyrën e zhvillimit të mekanizmave efikase të mbikqyrjes, raportimit dhe vlerësimit.

SHEMBULLI I SISTEMIT TË RAPORTIMIT/UDHËZIMIT

Personi mbijetuar i rrëfen dikujt për rastin e dhunimit

Të udhëzohet dhe përcillet viktimë/personi i mbijetuar deri në entin shëndetësor
OSE viktimë/personi i mbijetuar të drejtohet vetë

Qendra për femra

Enti shëndetësor

(Qendra e cila ofron kujdesje shëndetësore pa caktim orari, i ofron viktimës informacione për «linjën e nxehtë», që iu ndihmon viktimave të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore se si të kontaktojnë me organizatat joqeveritare, të cilat punojnë me viktimat në rajonin e qytetit, ose për ekzistencën e qendrës, e cila merret me rastet e dhunimit) .

Nëse viktimë/personi mbijetuar dëshiron që rastin t'ia paraqesi policisë
OSE

Nëse viktimë/personi mbijetuar është fëmij

OSE

Nëse ekziston rrezik i drejtpërdrejt për mbrojtje dhe siguri

- Anëtari i familjes, miku ose personeli e udhëzon dhe e përcjellë viktimën/personin e mbijetuar deri në stacionin policor. Policia e përpilon procesverbalin dhe e dërgon ekzemplar të zyrtar.
- Viktimë/personi mbijetuar e dërgon formularin në entin shëndetësor për ta plotësuar
- Viktimë/personi mbijetuar ia kthen formularin e plotësuar policisë
- Policia i kryen hetimet, i burgos sulmuesit përkatës dhe e fillon procedurën gjyqësore:

PËRCJELLJA E MËTEJME DHE OFRIMI I NDIHMËS MUND TË PËRFSHIJË: (varsisht nga zgjedhja e viktimës/personit të mbijetuar)

Kujdesjen shëndetsore Ndhmën psiko-social

Veprimtarinë lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë

Përkrahjen juridike/
gjyqësore

Mos harroni që gjithmonë t'i përkrahni direktivat që kanë të bëjnë me besueshmërinë

AFTËSIMI I BASHKËSIVE TË REFUGJATËVE PËR TË REAGUAR

Puna me bashkësinë është e domosdoshme në zhvillimin e programeve dhe veprimtarive të qëndrueshme

Këta programe, të zhvilluar në bashkëpunim të akterëve humanitarë me bashkësitë e refugjatëve, janë treguar shumë efikas. Për angazhimin e bashkësive duhet:

- Të thellohet dituria dhe të kuptuarit e relacioneve ndërmjet gjinive, dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, brenda bashkësisë së refugjatëve, përmes fushatës së informimit.

Këto fushata duhet t'i përfshijnë të gjithë anëtarët e popullatës përkatëse: meshkujt, femrat dhe fëmijët e të gjitha grupeve etnike dhe fetare. Meshkujt që janë të angazhuar në këshillime dhe veprimtari të informimit, mund të jenë të dobishëm gjatë ndikimit në qëndrimet e gjykatave tradicionale ndaj viktimave/të mbijetuarëve, gjatë zhvillimit të sistemit të mbrojtjes që reagon dhe parandalon dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, si dhe në bindjen e meshkujve të tjerë për faktin se dhunimet e tilla e dëmtojnë krejt bashkësinë.

- Të mbahet dhe forcohet rrjeti ekzistues i përkrahjes shoqërore.
- Të përkrahët roli femrës si e barabart në procesin e marrjes së vendimeve dhe si udhëheqëse e bashkësisë.

Gratë-udhëheqëse të bashkësisë- kanë pasur rol vendimtar në trimrimin e viktimave/personave të mbijetuar që të paraqiten dhe të kërkojnë ndihmë. Kur janë të veshura si organizatore të fushatës së informimit, apo si kshilltare, gratë-udhëheqëse të bashkësisë kujdesen për çështjet që janë të lidhura me përkatësinë gjinore dhe dhunën e bazuar në pëkatsinë gjinore, që t'i inicojnë dhe shqyrtojnë.

- Të caktohet strehim i sigurtë dhe ndihma e nevojshme momentale për viktimat/të mbijetuarit.
- Të përcillen viktimat/personat e mbijetuar për të marrë ndihmën sociale, mjekësore dhe juridike
- Të sigurohet mbrojtje për viktimat/personat e mbijetuar, familjet e tyre dhe bashkësinë.

Veprimtaritë e reagimit duhet të kenë për cak kryesit e delikteve. Viktimat/personat që e kanë mbijetuar dhunën në shtëpi, më së shpeshti do të dëshirojnë që të mbeten me kryesin e veprës, nga shkaqet ekonomike. Nëse autorit të veprës nuk i ndihmohet, ai me siguri do të vazhdojë me keqtrajttime.

- Të harmonizohen veprimtaritë me bashkësinë e refugjatëve dhe akterët e tjerë për promovimin e efikasitetit, në drejtim të parandalimit dhe reagimit.
- Të bëhen përpjekje për angazhimin e refugjatëve në vendimarrje për llojet e shërbimeve, të cilat do t'iu ofrohen, në cilat lokacione, kush do t'i ofrojë dhe në cilën/cilat gjuhë.

Në kampet e refugjatëve, shërbimet mund të ofrohen në qendra të tipit të ambulantave, qendrat për shëndetin e gruas, shtëpitë e kulturës dhe të rinisë, ose lokacione të tjera, ku viktimat/të mbijetuarit ndjehen mjaft mirë për t'i paraqitur rastet e dhunimit. Shërbimet duhet kryer në lokacione, ku mund të garantohet besueshmëria dhe dinjiteti i viktimës/personit të mbijetuar.

- Të bëhen përpjekje për shërbimet që janë të ndjeshme në pyetjet kulturologjike.
- * Të bëhen përpjekje për të drejtat e viktimave/të mbijeturëve dhe të drejtat e grave në përgjithësi.

Shumica e qeverive të vendeve nikoqire, nuk i lejojnë refugjatët që të marrin pjesë në veprimtaritë politike, si fjala vjen, në ndryshimin e ligjeve. Kjo e kufizon aftësinë e refugjatëve që t'i formojnë lëvizjet për të drejtat e grave, që do të bënin përpjekje për dobi të tyre. Vënia e lidhjes me organizatat joqeveritare, brenda shtetit mikpritës, të cilat janë të angazhuara për mirëqenien e refugjatëve, i mundëson popullatës refugjate që të ketë dobi nga avokatura e shtetit, pa i shkelur ligjet e vendit nikoqir.

REAGIMET NDAJ NEVOJAVE SHËNDETËSORE/MEDICINALE TË VIKTIMAVE/PERSONAVE TË MBIJETUAR

Lloji i dhunës dhe periudha kohore, nga momenti kur ka ndodhur rasti e deri te momenti kur viktima/personi mbijetuar arrinë në entin shëndetësor, e përcakton llojin e kujdesjes që do t'i ofrohet pacientit.

Me rëndësi vendimtare është që personi i mbijetuar ta vizitoj entin shëndetësor sa më parë, pas ndodhjes së rastit të dhunës, për ta marrë ndihmën asequate.

T'i ofrohet ndihmë e gjithanshme shëndetësore, e cila është më e përshtatshme.

- Vizitat mjekësore dhe shërimin duhet ta kryej personeli i ushtruar, sipas mundësisë i të njëjtës gjini, sikurse edhe personi i cili kërkon ndihmë mjekësore. Protokolet dhe pajisja adekuate, rezervat dhe ilaçet duhet të përdoren për:
 - parandalimin e sëmundjes ngjitëse (infeksionet seksuale ngjitëse etj.);
 - pengimin e shtatzanisë së padëshiruar;
 - shërimin e lëndimeve;
 - grumbullimin e fakteve fizike të dhunës;
 - ofrimin e shërbimeve për këshillime dhe shërime, në rastet e traumave psikike;
 - të kryer selekcionimin e pacientëve në shëndetësi, lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore;
- Të udhëzohet dhe sigurohet udhëtimi për shërim më të përshtatshëm, kur paraqitet nevoja.
- T'i ofrohet shërbimi për përcjelljen e gjendjes së mëtejme shëndetësore.

- Të sigurohen të dhëna mjekësore (dëshmi, ku është e nevojshme) gjatë procedurës gjyqësore, e inicuar në kërkesë të viktimës/personit të mbijetuar për dëmshpërblim nepërmjet drejtësisë.
- Të bashkëpunohet me mjekët e mjekësisë tradicionale për identifikim, paraqitje, dërgim dhe ofrim të përkrahjes adekuate viktimave/personave të mbijetuar.
- Të dokumentohen, grumbullohen dhe analizohen faktet.
- * Të mbikqyren shërbimet mjekësore, duke siguruar qasje të barabart për femrat, meshkujt dhe adoleshentët, si dhe kualitetin e njëjtë të shërbimeve.
- Të mbikqyren nevojat shëndetësore për viktimat/të mbijetuarëve.
- Të identifikohen dhe planifikohen strategjitë për shkaktarët që i kontribuojnë, siç është alkooli.
- Të përfaqësohen viktimat/personat e mbijetuar:
 - Për mbrojtje dhe siguri;
 - Për shkak të ndryshimeve në ligje dhe politikën e vendit nikoqir, që mund të jenë në papajtueshmëri me të drejtat apo nevojat e viktimave/personave të mbijetuar.
- Të bashkëpunohet me personelin e enteve shëndetësore, mjekët e mjekësisë tradicionale dhe bashkësinë, për stërvitje dhe zhvillimin e ndjeshmërisë.

Shiko poashtu:

- **Mbikqyrja klinike e personave që e kanë mbijetuar dhunën (UNHCR/WHO, 2002)**
- **Konferenca ndëragjencionale për leksionet e mësuara, lidhur me parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, në rajonin e refugjatëve (UNHCR, 2001)**
- **Qasje praktike ndaj dhunës seksuale, bazuar në përkatësinë gjinore: Udhërrëfyese programor për të punësuarit dhe drejtorët në shërbimet mjekësore (UNFPA, 2001)**
- **Doracak i terrenit ndëragjencional mbi shëndetësinë riprodiktive, në situata e refugjatëve (Ndëragjencional, 1999).**

PLANIFIKIMI LIDHUR ME PLOTËSIMIN E NEVOJAVE PSIKO-SOCIALE TË VIKTIMAVE/PERSONAVE TË MBIJETUAR

Pas kryerjes së dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, viktimat/personi i mbijetuar mund të përjetojë reaksione të ndryshme emocionale dhe psikologjike, duke përfshirë këtu frikën, turpin, fajsinë, depresionin dhe zemrimin. Mund të krijohen mekanizma të forta të mbrojtjes, siç është harresa, mohimi dhe ndrydhja e thellë e ngjarjes traumatike, të cilat i ka përjetuar. Anëtarët e familjes, poashtu, mund të përjetojnë situata të ndryshme emotive, andaj edhe atyre iu nevojitet përkrahje gjatë kësaj periode traumatike.

Ndaj viktimave/personave të mbijetuar duhet të sillemi me kujdes dhe ndjeshmëri..

Veprimtaritë e bazuara brenda bashkësisë, janë më efikase gjatë zbutjes së traumës. Këto veprimtari mund të përfshijnë:

- Identifikimin dhe stërvitjen e punëtorëve tradicionalë, të cilët ofrojnë përkrahje dhe kanë mbështetje nga bashkësia.
- Formimin e grupeve për ofrimin e përkrahjes së grave ose grupet që janë të dizajnuara në mënyrë specifike për ofrimin e ndihmës viktimave/personave që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe familjeve të tyre.
- Krijimi i «bujtinave», ku viktimat/personat e mbijetuar mund të kenë kujdesje, ngushllime, informacione dhe këshilla të besueshme.

* Krahas kësaj, punëtorët psiko-socialë duhet:

- Të mbajnë kshillime në situatat e krizës (të dëgjojnë, të ofrojnë mbështetje emocionale, t'i trimërojnë) me viktimat/të mbijetuarit dhe familjet e tyre, me mbështetje emocionale afatgjate;
- Ta vazhdojnë praktikën pozitive të përmirësimit apo pastrimit tradicional, e cila me sukses zhvillohet në vendet e prejardhjes së tyre, si përgjigje në ngjarjet e dhembshme dhe traumatike;
- Ta përfaqsojnë viktimën/personin e mbijetuar para shërbimeve shëndetësore, të policisë/sigurimit, para organeve të drejtësisë/gjyqësore dhe ofruesëve të tjerë të shërbimeve;
- T'i zhvillojnë veprimtaritë grupore për viktimat/të mbijetuarit dhe femrat e tjera që kanë lidhje me ndërtimin e rrjetit të përkrahjes, reintegrimit në bashkësi, fitimit të shkathtësive, vetëbesimit dhe aftësisë ekonomike. Të fillohet me programet e krijimit të të ardhurave dhe ofrimit të mikro-kredive, për t'iu mundësuar ndjenjën e sërishme të vetëknaqësisë.

Shiko poashtu:

- **Si udhëhiqet: Përgjigja e bashkësisë në dhunën seksuale ndaj femrave, Ngara, Tanzani (UNHCR, 1997)**
- **Shëndeti shpirtëror i refugjatëve (UNHCR/WHO, 1996)**

ZHVILLIMI I REAGIMIT, I BAZUAR NË MBROJTJE DHE SIGURI

Në disa raste viktimës/personit të mbijetuar, mund t'i nevojitet një vend i sigurtë, ku mund të fshihet pas ngjarjes së dhunimit. Viktima, ndoshta, nuk ka mundësi që të kthehet në shtëpi, nëse, fjala vjen, kryesi deliktit është njëkohsisht edhe anëtar i familjes, fqiu apo anëtar i bashkësisë së saj. ***Familja dhe bashkësia të parat duhet të ofrojnë shërbime për strehim të sigurtë dhe mbrojtje të viktimave/personave të mbijetuar.***

- Të planifikohen strategjitë dhe opsionet për mbrojtjen momentale të viktimave/mbijetuarëve, siç është relokacioni, krijimi i zonave të sigurta brenda kampit dhe lokaleve tjera të mbrojtura. Strehimoret e sigurta duhet organizuar vetëm për nevoja ekstreme, sepse nëse vendosen larg bashkësisë dhe udhëhiqen nga partnerët operativ, mund që edhe më tepër ta izolojnë viktimën/të mbijetuarën.
- Të përfshihen edhe personat e moshuar në bashkësinë e refugjatëve, gjatë ofrimit të ndihmës viktimave/të mbijetuarëve.

- Të analizohen të dhënat për rastet e dhunës seksuale dhe të komunikohet me të gjithë akterët, si dhe me bashkësinë mbi rreziqet dhe problemet e sigurisë.
- Të bëhen përpjekje për respektimin e ligjit, duke përmbajtur prezencën efikase të shërbimit të mbrojtjes, si dhe për procedurën e drejtë dhe të shpejt gjyqësore për kryesit e deliktit.
- Të angazhohet bashkësia në të gjitha aspektet e mbrojtjes së saj. Të bëhen përpjekje që refugjatet femra të jenë pjesë e forcave policore ose të rojeve të bashkësisë.
- Të merren parasysh zgjidhjet alternative, si forma të mbrojtjes së viktimës/personit të mbijetuar, duke përfshirë këtu edhe transferimin në ndonjë kamp tjetër, ose vend që është më i përshtatshëm.
- * Të sigurohen policet femra me uniformë, për të gjitha grupet e mbrojtjes brenda bashkësisë së refugjatëve.
- Të edukohet policia dhe punëtorët në shërbimin e mbrojtjes ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.

Shiko poashtu:

- **Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore në rajonin e refugjatëve: Procesverbali i Konferencës ndëragjencionale mbi leksionet e mësuara (UNHCR, 2001)**

VENDOSJA E SISTEMIT JURIDIK/GJYQËSOR I REAGIMIT

Së bashku me pushtetin vendor të vendoset sistemi, me ndihmën e të cilit, viktimat/të mbijetuarit, që dëshirojnë kompensimin e së drejtës për vepra penale të kryera ndaj tyre, mundën ta rifillojnë këtë proces në ndërkohë.

Kjo nënkupton krijimin dhe bashkëpunimin e ngushtë me gjyqësinë, policinë dhe prokurorinë vendore. Është i nevojshëm edhe bashkëpunimi me gjykatat tradicionale brenda bashkësisë, që viktimat/të mbijetuarit të fitojnë dëmshpërblim të meritueshëm.

Njohja e regjimit relevant juridik

- Oficeri i mbrojtjes duhet të jetë i njoftuar me ligjin relevant shtetror, lidhur me këto pyetje:
 - Cili ligj dhe cilat procedura janë relevante? Cilat janë definicionet juridike të formave të ndryshme të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore? A shkakton dhuna në familje dënim penal, ndryshe nga kundravajtjet që janë të lidhura me sulmin fizik?
 - Nëse kushtetuta e shtetit përmbanë në vete amendamente lidhur me të drejtat e njeriut, a është e mundur që të thirremi në dispozitat e këtyre amandamenteve, për ta inicuar çështjen e formave të caktuara të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore?
 - Cilat ligje merren me çështjen e dështimit? Nëse dështimi është i paligjshëm, a ekzistojnë rrethana speciale (përjashtime) – si për shembull, kur gruaja mbetet shtatzanë si pasojë e dhunimit, kur jeta e gruas është në rrezik, ose kur ekzistojnë shkaqe lidhur me mirqenien e gruas- nën të cilat abortimi është lejuar? Cili lloj i dëshmisë është i nevojshëm për t'i plotësuar kushtet për rrethanat speciale?

Si të veprohet në rastin e ankesës, lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore.

- Personeli i cili komunikon me viktimën/personin e mbijetuar, që ka vendosur të kërkojë dëmshpërblim, përmes rrugës gjyqësore, duhet të jetë me ndjenja dhimbësuri. Në të njëjtën kohë, duhet të ofrojë informacione komplecte për procedurën juridike të atij shtetit, i cili ofron azil.
- Viktima/e mbijetuara duhet të jetë e informuar se çka mund të presi nga procedura juridike. Personeli i shërbimit të sigurimit dhe shoqëria duhet të bashkëpunojnë, që të sigurojnë informim adekuat të paraqitësit të padisë, për të drejtat e tij, procedurën ligjore dhe periudhën kohore, e cila ka të bëjë me procedurën.
- Personeli i mbrojtjes, poashtu, duhet ta këshillojë viktimën/personin e mbijetuar, për shërbimet shëndetësore ekzistuese, duke përfshirë shërbimet e këshillimeve dhe procedurat që kanë të bëjnë me trajtimin e lëndimeve, parandalimin e sëmundjeve dhe përfundimin e shtatzanisë së padëshiruar, ashtu siç i parashohin ligjet shterore.
- Oficerët e mbrojtjes, poashtu duhet:
 - të kujdesën që personi i mbijetuar dhe kryesi veprës, t'i kenë dokumentet e regjistruar dhe letnjoftimet;
 - të bashkëpunojnë ngushtë me avokatët vendorë, të cilët janë të njoftuar me ligjet dhe procedurat shtetore, lidhur me dhunën seksuale;
 - të kujdesën që raporti mbi padinë, të jetë i regjistruar në policinë vendore;
 - të kujdesen që raporti mjekësor dhe raporti i viktimës/personit të mbijetuar, të regjistrohen dhe t'i dorëzohen organeve relevante të pushtetit (policisë ose prokurorit publik);
 - të kujdesohen që dëshmitarët kryesorë nga bashkësia e refugjatëve, t'iu përmbahen procedurës ligjore, përmes dhënies së deklaratave dhe prezencës në gjykatë, kur kjo të kërkohet nga ata ;
 - të jenë në bashkëpunim të ngushtë me oficerin e mbrojtjes dhe policinë, duke u kujdesur që palët në procedurën gjyqësore, lidhur me dhunë seksuale, të jenë të mbrojtura nga frikësimi dhe kërcnimet e tjera për sigurinë e tyre fizike;
 - të kujdesën që UNHCR-i apo personeli i tyre/agjencioni, t'i përcjelli të gjitha viktimat/të mbijetuarit për marrje në pyetjet gjyqësore.

Është e nevojshme që të jemi të njohur me rolin e UNHCR- së dhe shërbimet juridike shtetore

- Oficerët e mbrojtjes duhet t'i identifikojnë organizatat vendore për të drejtat e grave dhe shoqatat e juristëve, që merren me problemin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duke zhvilluar partneritet, për zgjidhjen e këtij problemi. Në fushat ku UNHCR-i ofron ndihmë juridike, duhet kujdesur që viktimat/të mbijetuarit t'i përfaqësojnë juristët me përvojë. Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, të cilët bashkëpunojnë me personelin e mbrojtjes së UNHCR-it, për ofrimin e shërbimeve juridike, duhet:

- t'ia ofrojnë paraqitësit të padisë të gjitha informacionet e nevojshme mbi procedurën ligjore dhe penale, me qëllim të përgatitjes së paraqitësit të padisë dhe familjes së tij/saj për procesin gjyqësor;
- t'i ofrojnë ndihmë dorëzuesit të padisë me rastin e paraqitjes për financim të procedurës juridike, nëse ky lloj i ndihmës është i mundësuar përmes ligjit shtetror (nëse një ndihmë e tillë nuk ekziston, UNHCR-i duhet të kujdesohet që në buxhetin e vet të gjendet alinea, që është e lidhur me shpenzimet gjyqësore të viktimave nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore);
- * ta përcjellin paraqitësin e padisë deri në stacionin policor, edhe në gjykatë, duke qenë prezent gjatë gjithë intervistave dhe paraqitjes para gjykatës;
- të paraqiten në gjykatë në funksionin e vëzhguesit, në të gjitha rastet, për të pasur mundësi t'i drejtohen gjykatës (kjo është me rëndësi vendimtare, sidomos në rastet që kanë lidhje me fëmijët):
- të shqyrtohen mundësitë e marrjes në pyetje në seancat gjyqësore me dyer të mbyllura, në mënyrë që viktimat/personat e mbijetuar dhe familjet e tyre të mbrohen nga traumat e shtuara;
- t'i ruajnë aktet sekrete për të gjitha rastet dhe, lidhur me këtë, rregullisht ta njoftojnë personelin e mbrojtjes së UNHCR-së.

Duhet ditur të drejtat e të paditurit

- I padituri ka të drejtë të kërkojë që ndaj tij të sillen në bazë të respektimit të së drejtës që i takon, faji i të cilit akoma nuk është dëshmuar. Detyrë e UNHCR-së, ndaj të paditurit, është që këtij personi t'i sigurohet gjykim i drejtë, dhe gjatë marrjes në pyetje dhe periudhës sa gjendet në burg, ndaj tij/saj të ketë sjellje njerëzore. Personeli mbrojtës i UNHCR-së do të kujdesohet për respektimin e të drejtave të paditurit, gjatë kohës së hetimeve dhe gjykimit. UNHCR-i, sidomos, duhet të kujdeset që:
 - vonesat, gjatë gjykimit, të jenë minimale;
 - i padituri të mos torturohet, deri sa është në paraburgim;
 - i padituri të mos trajtohet në mënyrë jonjerëzore, deri sa është në paraburgim;
 - në rastet kur i padituri është trajtuar jonjerëzisht, UNHCR-i do t'i përfaqësojë të drejtat e tij para organeve të pushtetit, që të ketë tretman konform ligjit.

Duhet njohur aktvendimet dhe dënimet e zbatuara.

Personeli i UNHCR-së, përgjegjës për mbrojtje, duhet të kujdesohet që ata refugjatë, që janë dënuar për shkak të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, të dënohen në të njëjtën mënyrë, sikur që do të dënoheshin edhe nënshtetasit e vendit nikoqir, respektivisht, në pajtim me direktivat relevante shtetrore lidhur me dënimet. UNHCR-i dhe partneri i tij joqeveritar, i cili ofron shërbime juridike në shtetin përkatës, duhet të kujdesen që kryesit e delikteve të dënohen në atë mënyrë, që nuk është diskriminuese

për shkak të statusit të refugjatit. Të dënuarit e të paditurëve që janë fëmijë, duhet pasur parasysh nevojën për rehabilitimin e tyre. Gjithkund, ku është e mundur, të paditurit e mitur, nuk duhet të paraburgosen në të njëjtët objekte sikur të paditurit madhor.

Duhet qenë të informuar për dëmshpërblim.

Nëse viktimave/personi mbijetuar kërkon dëmshpërblim nga kryesi veprës, përmes seancës gjyqësore, duhet t'i sigurohet përkrahje për këtë procedurë. Në rast se UNHCR-i nuk është në gjendje të ofrojë ndihmë të tillë, duhet që viktimës/personit të mbijetuar t'i bëhet e mundur dhënia e këshillave juridike pa pagesë, që i ofrojnë këshillimoret për ndihmë juridike ose organizatat për të drejtat e gruas, brenda shoqërisë qytetare.

Duhet qenë të informuar për mënyrën e zgjidhjes së konflikteve.

Në disa bashkësi, viktimave/personave të mbijetuar, ju është ndoshta më lehtë ta kërkojnë të drejtën për dotacion plotësues nga mekanizmat tradicional ose zakonor, për zgjidhjen e problemit. Në disa raste, viktimat dhe familjet e tyre, janë nën presion që t'i shfrytëzojnë këto mekanizma, nga frika se bashkësia do t'i mohojë, nëse kështu nuk veprojnë. Personeli i UNHCR-së, përgjegjës për ofrimin e ndihmave, duhet t'i mbikqyrë këto mekanizma, për t'u bindur se janë në pajtim me ligjet shtetërore dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në rastet, kur këto struktura alternative i çenojnë ligjet shtetërore, personeli mbrojtës duhet të mundësojë informim më të mirë brenda bashkësisë, duke i trimëruar anëtarët e bashkësisë që, praktikën e vet të zgjidhjes së konflikteve, t'ia përshtatin standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ky lloj i ndryshimit mund të zgjasi, por durimi dhe qëndrimi, pa paragjykim, është me rëndësi vendimtare.

Shiko poashtu:

- **Udhërrëfyes për oficerët e mbrojtjes: Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore (UNHCR, 1998)**
- **Fëmijët refugjatë: Direktivat lidhur me ofrimin e mbrojtjes dhe kujdesjes (UNHCR, 1994)**
- **Direktivat lidhur me mbrojtjen e femrave refugjate (UNHCR, 1991).**

IDENTIFIKIMI I ROLIT TE AKTERËVE TJERË POTENCIALË

Krahas akterëve të sektorit të shëndetësisë, shërbimeve shoqërore, të mbrojtjes dhe sigurisë, ekzistojnë edhe njerëz tjerë, roli i të cilëve është me rëndësi gjatë reagimit të nevojave të viktimave/personave të mbijetuar. ***Të gjithë ata që punojnë me refugjatët, duhet të jenë të njoftuar me detyrat e veta dhe detyrat e të tjerëve, që janë të kyçur në përkrahjen e viktimave/personave që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore.***

Shërbimi në terren

- Pranon dhe i shqyrton raportet për rastet e dhunës seksuale dhe të dhunës mbi baza gjinore.
- I siguron mbrojtje viktimës/personit të mbijetuar, duke iu rekomanduar të gjithë akterëve, që këtyre personave ju ofrojnë ndihmë, të sillen ndaj tyre me ndjeshmëri dhe brenga.

- Bën përpjekje që viktima/personi mbijetuar dhe familja e saj të marrin ndihma nga të gjithë akterët, sipas nevojës.
- I zhvillon mekanizmat administrative për nevojat e sigurisë së viktimave/të mbijetuarëve, siç është ndarja e kuponave për ushqim brenda familjeve dhe ndarja e vendeve veçmas, si dhe e prodhimeve joushqimore për viktimën/mbijetuarin.
- Mbanë evidencë për shkak të kontrollimit të trendeve ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, i analizon problemet, duke zhvilluar strategji për parandalim dhe reagim.
- I harmonizon veprimtaritë e veta me të gjithë sektorët dhe akterët e tjerë.

Shërbimi programor

- Ndihmon dhe përkrah të gjithë sektorët, gjatë zbatimi të planit multisektorial të parandalimit dhe reagimit.
- Ndanë resurset për shkak të përkrahjes së veprimtarive të përshtatshme.
- * Pranon dhe i shqyrton raportet e shkurta, që përbëhen nga të dhënat, si dhe veprimtaritë e nevojat lidhur me trendet, analizat e parandalimit dhe të reagimit.
- I mbështet partnerët, që njëkohsisht janë edhe organizata joqeveritare ndërkombëtare, me rastin e ndarjes së resurseve për programet e parandalimit dhe reagimit.
- I harmonizon veprimtaritë e veta me të gjithë sektorët dhe akterët.

Shefi zyrës

- Pranon dhe i shqyrton raportet dhe analizat e të dhënave lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, si dhe veprimtaritë programore dhe rezultatet përfundimtare.
- Përkrah personelin e UNHCR-së gjatë planifikimit, realizimit, mbikqyerjes dhe vlerësimit të strategjive të parandalimit dhe reagimit.
- Merrë pjesë në koordinimin ndërsektorial dhe ndër-agjencional.
- E angazhon tërë personelin e UNHCR-së, refugjatët, partnerët dhe qeverinë e vendit nikoqir, në zhvillimin e programeve.
- Mundëson shkallë të lartë të përfaqësimit dhe përkrahjes së veprimtarive për parandalim dhe reagim; ndihmon gjatë zgjidhjes së problemit, duke u përpjekur për resurse adekuate.
- Bashkëpunon me kolegët e zyreve tjera të UNHCR-së dhe agjencitë e tjera të KB, për përfitimin e dobive maksimale nga resurset ekzistuese si dhe përhapjen e informacioneve.

Policia

- Pranon ankesat dhe udhëheq hetimet, pas procedurës juridike dhe penale të parapara me ligj.

- Në pajtim me procedurën standarde policore, e burgos personin/personat e akuzuar, bënë hetimet, përgatit paditë, i dërgon thirrjet gjyqësore, duke u kujdesur që të gjithë dëshmitarët potencialë të jenë prezent në gjykim.
- Bën përpjekje që, kur të paraqitet nevoja, të kryejë në mënyrë ekspeditive hetimet dhe ndjekjen penale në rastet e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.
- I shpjegon viktimës/personit të mbijetuar procesin juridik dhe penal.
- Tregon mirkuptim për nevojat private, besueshmëri dhe respekt ndaj viktimës/mbijetuarit.
- Merrë pjesë në fushatat e edukimit dhe informimit të ligjeve dhe të drejtave, që i organizojnë shërbimet e mbrojtjes, në dobi të bashkësisë së refugjatëve.

Gjyqtaria

- Përgatit regjistrin javor të rasteve, me shënim se në cilin nga këto raste janë palët refugjate (paraqitësi i padisë apo i akuzuari).
- Në pajtim me procedurat standarde, udhëheq procedurën juridike për rastet e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duke respektuar rastet dhe duke udhëhequr marrjen në pyetje të dëshmitarëve, udhëheq gjykimin dhe cakton dënimin.
- Merrë pjesë në seminare dhe veprimtaritë e informimit të opinionit, që i organizon shërbimi mbrojtjes.

ZHVILLIMI I PLANIT TË PUNËS ME KRYESIT E VEPRAVE

Puna me kryesit e dhunës është i rëndë, por i domosdoshëm. Të drejtat e njeriut të kryesit dhe siguria e tij duhet respektuar. Nëse kryesi i veprës është njëkohsisht edhe refugjatë, ka të drejtë në mbrojtje ndërkombëtare. ***Ekipi multisektorial duhet të zhvillojë plane pune me kryesit e veprës.***

- Konsultohet me organet e pushtetit mbi veprimtaritë e punës që kanë të bëjnë me kryesit e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore.
- Angazhon shërbimin e mbrojtjes, policinë, përfshirë këtu edhe rojet e bashkësisë, për bashkëpunim dhe mbikqyerjen e veprimeve të kryesëve të njohur të delikteve.
 - Ku është e mundur, duhet t'i largoi kryesit e veprave nga anëtarët e tjerë të bashkësisë.

PIKAT KYÇE

Bashkësia duhet të udhëheqi me mënyrën e planifikimit për përkrahjen e viktimave/personave të mbijetuar..

Të zhvillojë veprimtaritë e edukimit dhe informimit të bashkësisë

- Të lansohen fushatat për informimin publik të dhunës seksuale, dedikuar të gjithë anëtarëve të bashkësisë.

Vendosja e mekanizmave të dërgimit dhe raportimit

- Të vendoset sistem i qartë i njoftimeve në të gjitha rrethet, në mënyrë që viktimat/të mbijetuarit të dinë se ku mund ta marrin ndihmën relevante me kohë.

Të aftësohet bashkësia për reagim

- Bashkëpunimi me bashkësinë është i domosdoshëm për zhvillimin efikas të reagimit.

Të reagohet ndaj nevojave shëndetsore/medicinale të viktimave/personave të mbijetuar

- T'i sigurohet viktimës/të mbijetuarit qasje e lehtë në kujdesjen shëndetësore, në shërbimet e nevojshme dhe përcjelljen e gjendjes shëndetësore.

Të reagohet ndaj problemeve psiko-sociale të viktimave/personave të mbijetuar

- Të sillemi ndaj viktimave/të mbijetuarëve me kujdes dhe ndjeshmëri.

Të zhvillohet sistemi i sigurisë dhe mbrojtjes së reagimit

- Viktimës/të mbijetuarit duhet t'i sigurohet mbrojtje pas rastit të dhunës, ndërsa bashkësia duhet të angazhohet për vendosje të sigurtë.

Të rivendoset reagimi juridik/gjyqësor

- Së bashku me organet e pushtetit, të vendoset sistemi, përmes të cilit, viktimat/personat e mbijetuar që dëshirojnë dëmshpërblim për veprat penale të kryera mbi ta, mund t'i realizojnë me kohë.

Të identifikohen rolet dhe obligimet e akterëve tjerë potencialë

- Personeli udhëheqës, programor dhe ai i terrenit mund të ketë rol vendimtar ndaj reagimit të nevojave të viktimave/personave të mbijetuar.

Të zhvillohet plani i punës me kryesit e delikteve

- Të drejtat e njeriut, të autorëve të veprave, përfshirë këtu edhe sigurinë personale, duhet të respektohen pa tjetër.

KAPITULLI 5 SHQYRTIMET SPECIALE LIDHUR ME FËMIJËT REFUGJATË

Deri sa principet dhe direktivat, për të cilat u bë fjalë në kapitujt e tjerë, mund të zbatohen edhe tek fëmijët refugjatë, ekzistojnë edhe disa çështje tjera specifike, që duhet të merren parasysh gjatë punës me fëmijët refugjatë. Fëmijët refugjatë përballen me forma specifike të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore: me zakone tradicionale shumë të dëmshëm, trafikim njerëzish, prostitucion fëmijor, dhunë seksuale brenda familjes dhe shfrytëzimin seksual, si dhe me keqtraktim dhe përdhunim nga personat, të cilët kanë hyrje të papeguar tek fëmijët.

Disa grupe të caktuara, sidomos, janë të rrezikuara nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore. Këto grupe janë: fëmijët pa kudestarë apo fëmijë të ndarë, fëmijë të paraburgosur, fëmijë ushtarë, adoleshentë, fëmijë të paaftë fizikisht dhe shpirtërisht, fëmijë punëtorë, nëna të mitura, fëmijë nënat e të cilëve janë viktimë e dhunimit, djem si viktima/të mbijetuar dhe fëmijë që kryejnë dhunë.

Gjatë punës me fëmijët refugjatë, është me rëndësi të njihet Konventa mbi të drejtat e fëmijut (1989), e cila i përcakton standardet gjithpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave të gjithë fëmijëve. Si shtesë për Direktivat e përshkruara në Kapitullin 2, edhe katër principe duhet ta mbështetin punën tuaj me fëmijët refugjatë: e drejta për jetë, ekzistenca dhe zhvillimi; interesi më i mirë për fëmijun; jodiskriminimi; dhe pjesëmarrja.

*Konventa mbi të drejtat e fëmijut (CRC)*³ e definon fëmijun si person më të ri se 18 vjet, përveç kur ligjet relevante shtetore e përcaktojnë moshën rinore njësoj si atë madhore. Kjo do të thotë që CRC është i zbatueshëm për të gjithë personat deri në moshën 18 vjeç, përveç nëse është treguar se ai-ajo është i/e moshës madhore, nga se kështu e kërkon ligji shtetror.

Fëmijët refugjatë, sidomos, mund të jenë të kanosur nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, kur kemi parasysh nivelin e tyre të varësisë, aftësitë e tyre të kufizuara që ta mbrojnë vetëveten dhe të marrin pjesë në marrjen e vendimeve. Nga shkakun se kanë relativisht pak përvojë jetësore, ata lehtë mund të shfrytëzohen dhe të detyrohen, se sa personat e rritur. Varsisht nga shkalla e zhvillimit tyre, ata edhe mundën që në tërësi të mos e kuptojnë natyrën seksuale të disa sjelljeve, andaj nuk janë të aftë të informohen sa duhet. Faktorët plotësues etnik, kulturor, ekonomik e shoqëror, poashtu, mund ta shtojnë rrezikun e fëmijëve refugjatë që të binë viktimë/persona që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore.

Dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore ka ndikim shkatërrues në zhvillimin fizik dhe shëndetin shpirtëror të fëmijëve.

Siç është shqyrtuar në Kapitullin 1, keqtrajtimi seksual mund të marrë forma të ndryshme, nga të cilat, shumë prej tyre mund t'i kenë pikësynim fëmijët. Veprat/deliktet e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore- si fjala vjen zakonet e dëmshme tradicionale- janë kryer pikërisht gjatë kohës së fëmijërisë. Kryesit e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore tek fëmijët refugjatë, mund të jenë persona që fëmiju i njih dhe të cilëve iu beson, persona që e kanë rolin e kujdestarit, ose fëmijë të tjerë. Të jeni koshientë në faktin se, nga këto arsye, perceptimi i fëmijut lidhur me ngjarjet, mund të jetë i shtrembëruar.

Convention on the Rights of the Child = CRC

Gjatë punës me fëmijët refugjatë, njoftohuni me CRC-in. Kjo Konventë, në mënyrë të përgjithësuar, i përshkruan të drejtat elementare të njeriut për fëmijët në tërë botën, përfshirë edhe fëmijët refugjatë. Këto të drejta nënkuptojnë edhe të drejtën e mbrojtjes nga keqtrajtimi dhe shfrytëzimi seksual. Së këndejmi CRC i ofron ndihmë fëmijëve refugjatë, bile edhe në shtetet, të cilat nuk i takojnë asnjë instrumenti refugjatësh. *Protokoli opcional i CRC-së mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionit të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve (2000)* merret me çështjen e trafikimit, shitjes dhe grabitjes së fëmijëve.

DIREKTIVAT

Pasojnë principet e miratuara univerzale, që detalisht janë shqyrtuar në CRC, dhe të cilët janë relevant, sidomos në punën me fëmijët refugjatë:

- **E drejta për jetë, ekzistencë dhe zhvillim:** Kjo e drejtë duhet te jetë e garantuar, përmes masave që e mbrojnë jetën. Principi i «ekzistencës dhe zhvillimit» zbatohet jo vetëm në ekzistencën fizike dhe zhvillimin e fëmiut, por edhe në zhvillimin e tij shpirtëror dhe emocional. Martesa e hershme, çënon të drejtat e nënës jomadhore dhe fëmiut të saj si dhe ekzistencës e zhvillimit në tërësi (neni 6, CRC).
- **Jodiskriminimi:** Çdo fëmij, brenda juridikcionit shtetror, pa marrë parasysh përkatësinë e tij gjinore dhe staturin e migrimit, mbanë të drejtën mbi të gjitha të drejtat e CRC-së. Së këndejmi, ky princip përfshinë edhe fëmijët refugjatë (neni 2, CRC).
- **Interesi më i mirë i fëmiut:** Ky princip i rëndësishëm duhet zbatuar si në vendimet që janë të lidhur me disa fëmijë, poashtu edhe me çështjet e gjera politike dhe vendimet që kanë të bëjnë me grupet e fëmijëve. Të gjitha zgjidhjet e mundshme duhet marrë parasysh me rastin e çdo vendimi që i përket fëmijëve, ndërsa kujdesi i obliguar duhet t'i kushtohet interesave më të mira të fëmiut (neni 3, CRC).
- Gjatë përcaktimit të politikës – si për shembull ndarja e buxhetit – duhet analizuar në mënyrë complete llojin e ndikimit, që ndonjë procedurë mund ta ketë tek fëmijët. Nuk është e detyrueshme që politika të mbështetet tek ajo që është më e mirë për fëmion, por nëse është identifikuar çfarido konflikti, ata që marrin vendime, duhet t'i kenë parasysh «interesat më të mira» të fëmiut si dhe «shqyrtimet me rëndësi primare».
- Me rastin e përcaktimit të interesave më të mira për çdo fëmijë, ata që marrin vendime, duhet të kenë parasysh jo vetëm standarde objektive, për të cilët mendohet se janë më të mirë në interes të fëmiut, por edhe mendimet subjektive, që kanë parasysh edhe qëndrimet e fëmijëve. Vendimi, se si të caktohen interesat më të mirë për fëmion, kryesisht është i rëndë dhe, shpesh, nuk ekziston vetëm një mënyrë e zgjidhjes së çështjes. Duhet të merren parasysh shumë faktorë, siç është mosha, gjinia gjenetike, prapavia kulturore, ambienti që e rrethon dhe përvoja nga e kaluara e fëmiut. Të gjitha shqyrtimet e principeve duhet zbatuar sipas CRC-së, duke pasur parasysh obligimin ndaj këshillave të profesionistëve, si nga aspekti juridik, ashtu edhe nga aspekti i fushveprimi, i cili merret me zhvillimin e fëmiut.

- **Pjesëmarrja:** Rëndësia e këtij neni qëndron në atë se fëmijët kanë të drejtë të ndikojnë në vendimet që janë primare për jetën e tyre, dhe se mendimeve të tyre duhet qasur me «seriozitet të detyruar». Ky princip duhet zbatuar në të gjitha procedurat e kërkimit të azilit, në planifikimin e çdo fëmiu dhe në planifikimin e përgjithshëm të programit (neni 12, CRC). Sa të jetë fëmiu i moshuar, mendimin e tij duhet të merret seriozisht gjatë prurjes së vendimeve, që do të ndikojnë tek ai.

Të gjitha këto direktiva janë relevante gjatë vendosjes, se cili është interesi më i mirë për fëmion në situatën e caktuar. Në disa situata, interesat më të mirë për fëmion ndoshta nuk janë të njëjta me dëshirat dhe pikëpamjet e shprehura të fëmion.

Shiko poashtu:

- **Fondacionet e aksioneve për të drejtat e fëmijëve (ARC): Standardet juridike ndërkombëtare (UNHCR, OHCHR, UNICEF, Shpëtoni fëmijët, 2002)**
- **Doracak i UNHCR-it mbi popullzimin e sërishëm (UNHCR, 2002)**
- **Fondacionet e aksioneve për të drejtat e fëmijve (ARC): Zhvillimi i fëmijve dhe adolishentëve (UNHCR, OHCHR, UNICEF, Shpëtoni fëmijët, 2001)**
- **Çështje kritike të aksionit për të drejtat e fëmijve (ARC): Keqtrajtimi dhe eksploatimi (UNHCR, OHCHR, UNICEF, Shpëtoni fëmijët, i përpunuar 2002)**
- **Fondacionet e aksioneve për të drejtat e fëmijve (ARC): Popullzimi i sërishëm (UNHCR, OHCHR, UNICEF, Shpëtoni fëmijët, 1999)**
- **Fëmijët refugjatë: Direktivat lidhur me mbrojtjen dhe kujdesin (UNHCR, 1994)**
- **Konventa mbi të drejtat e fëmijve (1989)**

GRUPET E FEMIJËVE TË IKUR, TË CILËVE IU KANOSËT RREZIU I DHUNËS SEKSUALE DHE I DHUNËS NË BAZË TË PËRKATËSISË GJINORE

- Fëmijët pa kujdestarë ose të ndarë.
- Fëmijët në paraburgim.
- Fëmijët ushtarë.
- Adoloshentët.
- Fëmijët e paaftësuar fizikisht dhe shpirtnisht.
- Fëmijët punëtorë.
- Nënmat jomadhorë.
- Fëmijët, nënat e të cilëve janë viktimat/personat që e kanë mbijetuar dhunën.
- Fëmijët si viktimat/ të mbijetuarë.
- Fëmijët, kryes të dhunës.

Fëmijët pa kujdestarë ose të ndarë

Termet «fëmiu pa kujdestar» ose « fëmiu i ndarë» duhet të përdoren në vend të shprehjes «jetim». Për UNHCR-in fëmiu është jetim vetëm në rastet kur të dy prindërit e tij vërtetohet se janë të vdekur. Emrimi i fëmijëve si jetima, kërkon verifikim të kujdesshëm, dhe ka tendencë që ta nxisi përvetësimin, në vend se të bëhet përqëndrimi në gjetjen e familjes së fëmiut dhe në përkrahjen e bashkësisë.

- Fëmijët pa kujdestarë dhe fëmijët e ndarë të refugjatëve, i shtrohen rrezikut më të madh nga eksploatimi seksual, keqtrajtimi, rekrutimi ushtarak, kidnapimi, trafikimi dhe arrestimi, ndoshta pde nuk kanë person madhor, tek i cili kanë besim dhe i cili do t'i mbronte ose ndihmonte. Në rast nevoje, fëmijët refugjatë jetojnë me anëtarin e familjes së gjerë, pra «me kujdestarin», por megjithatë mund të ju kanoset rreziku, njësoj sikur atyre fëmijë refugjatë pa kujdestar.
- Keni parasysh faktin se grupi i fëmijve pa kujdestar dhe i atyre të ndarë, munden të kyçen në familje, të cilën e udhëheqin fëmijët, ku vëllezrit apo motrat më të mëdha kujdesen për fëmijët më të vegjël.
- ***Merreni parasysh faktin se fëmijët që kanë mbetur jetima si pasojë e sidës, poashtu bëjnë pjesë në kategorinë e fëmijve pa kujdestar dhe të ndarë .*** Para se të mbesin jetima, fëmijët e prekur indirekt nga sida, ndoshta është dashur të kujdesën për prindin e vdekur. Kjo nënkupton se ata e kanë pasur përgjegjësinë e personit madhor, duke ndërprerë shkollimin dhe duke u kujdesur për vëllezrit apo motrat. Fëmijët që pastaj kanë mbetur jetima, si pasojë e sidës, e sidomos vajzat e reja, shpesh janë marginalizuar apo njollësuar dhe shpesh janë privuar nga qasja e barabart në shërbime, që i ofrohen refugjatëve të tjerë. Prandaj atyre më tepër ju kanoset rreziku nga eksploatimi dhe keqtrajtimi seksual. Me që numri i fëmijve, të cilët mbesin jetima, si pasojë e sidës është në shtim, mbetet të besohet se do të shtohet edhe numri i fëmijve, të cilët do të jenë të detyrur të përfshihen në prositucion apo punë të dhunshme «në rrugë», ose në punë brenda familjes.

Fëmijët në paraburgim

Fëmijët në paraburgim ose fëmijët, të cilët në ndonjë mënyrë tjetër janë privuar nga liria, lehtë mund të jenë pre e dhunës seksuale dhe e keqtrajtimit, andaj ndaj tyre duhet sjellur me kujdes, duke pasur parasysh nevojat konform moshës që kanë.

Keqtrajtimi seksual, gjoja ndodh në shumë burgje dhe ente për paraburgim, sidomos ku të burgosurit jetojnë në qelia të përbashkëta. Në këto situata, fëmijët mund të jenë pikësnyim i keqtrajtimit, për shkak të vetive të tyre specifike, si fjala vjen, për shkak të besimit se ata nuk janë të infektuar nga sida, ose si pasojë e vlerësimit në virgjinitetin e tyre, tek shumë kultura. Së këndejmi është vendimtare që fëmijët e paraburgosur të ndahen nga të rriturit e burgosur, përveç në rastet kur mendohet se kjo është në interes të fëmiut.

Fëmijët ushtarë

Fëmiu ushtar është çdo person më i ri se 18 vjet, i cili sajon një pjesë të ndonjë force të armatosur, në cilëndo cilësi qoftë, si dhe ata që i përcjellin grupet e tilla, përveç në rastet kur janë si pjestarë të familjes, si dhe vajzat e reja të rekrutuara për qëllime seksuale dhe martesë me detyrim.

Sekretari gjeneral i Kombeve të Bashkuara, Raporti i Këshillit të Sigurimit, 2000

Fëmijët refugjatë bëhen fëmijë ushtarë në shumë mënyra: disa janë të rekrutuar, disa janë rekrutuar me forcë, disa janë bashkangjitur për të mbijetuar ose që t'i ndihmojnë familjet e tyre, ndërsa të tjerët janë grabitur me forcë, duke përfshirë këtu edhe vajzat e reja që janë marrë për qëllime seksuale.

Rekrutimi shpesh herë merr formë të ndryshme për djemt dhe vajzat e reja: djemt shfrytëzohen për luftë dhe veprimtari të tjera ushtarake, ndërsa vajzat shpesh shfrytëzohen si skllave seksuale dhe për punë të dhunshme.

Fëmijët, në zonën e konfliktit ose afër saj, si dhe fëmijët pa kujdestarë dhe të ndarë, janë edhe më tepër në rrezik nga rekrutimi ushtarak, nga ana e entiteteve shtetërore ose joshtetërore. UNHCR-i është kundër praktikës së rekrutimit ushtarak. Keqtrajtimi seksual i djelmohave, e sidomos i vajzave të reja, gjatë rekrutimit ushtarak, mund të ketë implikime të dëmshme shoqërore e kulturologjike, të cilat mund të ndikojnë negativisht në mundësinë e bashkimit të sërishëm me familjen dhe reintegrimit shoqëror, pas demobilizimit. Fëmijët, e sidomos vajzat e reja, shpesh nuk vehen re në procedurat formale gjatë demobilizimit. E domosdoshme është, prandaj, të bëhen përpjekje që vajzat e reja të përfshihen në çfardo veprimtari të demobilizimit.

Adoleshentët

Definicioni "adoleshent" mund të ndryshojë nga njëra kulturë në tjetrën, duke ia përshtatur situatës specifike të refugjatëve. Çështja se a e ka marrë ose jo adoleshenti rolin e përgjegjesisë së personit madhor, poashtu është shprehje e kulturës prezente dhe e situatës së refugjatëve.

Nevojat e adoleshentëve për mbrojtje dhe ndihmë, ndoshta nuk janë aq evidente, sa edhe nevojat e fëmijëve, por janë me rëndësi vendimtare, me që ata i nënshtrohen rrezikut nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore, ndërsa nevojave të tyre shpesh nuk i kushtohet kujdes i duhur.

Adoleshentëve, e sidomos vajzave, iu kanoset rreziku nga keqtrajtimi seksual dhe eksploatimi, nga se kryesit e veprave i trajtojnë si të painfektuara nga sëmundjet bartëse seksuale. Nga kjo rrjedhë se vajzat dhe djemt edhe më tepër i nënshtrohen rreziqeve nga infektimi me sidë/HIV dhe sëmundjeve tjera seksuale që janë ngjitëse. Vajzat mund ta pësojnë shtatzaninë e rrezikshme potenciale, si pasojë të përdhunimit. Adoleshentët shpesh nuk kanë informacione mbi shëndetësinë reproduktive, në raport me personat madhor, me që për këto informacione nuk kanë njohuri.

Fëmijët e paaftësuar shpirtnish dhe fizikisht

Fëmijët me të meta fizike dhe shpirtërore shpesh janë të «fshehur» nga ana e familjes dhe kështu bëhen «të padukshëm», në pamundësi që t'i shfrytëzojnë strukturat ekzistuese të përkrahjes. Të eliminuar, e shpesh edhe në pamundësi që t'u ikin kryesve të veprave, atyre iu kanoset rrezik akoma më i madh se keqtrajtimi seksual. Këtyre fëmijëve duhet kushtuar kujdes të veçantë gjatë programimit të pengimit dhe reagimit ndaj dhunës seksuale dhe eksploatimit.

Fëmijët punëtorë

Fëmijët të cilët punojnë në shërbim tek familjet, kryesisht vajzat e reja ose fëmijët të cilët punojnë dhe jetojnë rrugëve («fëmijët e rrugës»), sidomos iu janë të nënshtruar rrezikut të keqtrajtimit seksual dhe eksploatimit. Fëmijët pa kujdestar dhe fëmijët e ndarë, si dhe fëmijët anëtarë të familjeve që i udhëheqin vetë fëmijët, janë të detyruar që të kërkojnë punë me pagesë. Punëdhënësit, të cilët i blejnë fëmijët për punë (punë e detyrueshme) shpesh kanë influencë të madhe tek fëmijët, duke i bërë ata të keqpërdoren dhe eksploatohen.

Nënat jomadhore

Gjatë punës me nënat jomadhore, është me rëndësi që gjithnjë të mbahet qëndrim pa paragjykime.

Nënat jomadhore shpesh iu janë të nënshtruara rrezikut nga shfrytëzimi seksual, nëse nuk janë në gjendje t'i plotësojnë nevojat e tyre elementare, si dhe nevojat e fëmijut të vet, si pasojë e varfërisë. Nënat jomadhore dhe vajzat e reja që kanë mbetur shtatzënë nga keqtrajtimi ose shfrytëzimi seksual, mund të përballen me diskriminim, izolim dhe damkosje, e ndoshta nuk kanë qasje as në shërbimet themelore. Të gjithë këta faktorë mund t'i sjellin në një situatë të nënshtrimit ndaj shfrytëzimit dhe keqtrajtimit seksual.

Me rëndësi është të kemi kujdes që nënat jomadhore ta vazhdojnë shkollimin e tyre ose veprimtaritë e tjera shoqërore-ekonomike, që i pengojnë format e tjera të dhunimit seksual dhe dhunimit mbi baza gjinore.

Fëmijët, nënat e të cilëve janë viktima të dhunimit

Fëmijët, nënat e të cilëve janë viktima të dhunimit, mund të maltreohen ose edhe të braktisen nga nënat e tyre dhe familja. Këtyre fëmijëve sidomos ju kanoset rreziku nga keqtrajtimi dhe shfrytëzimi, andaj duhet kujdesje e veçantë. Me rëndësi është të bëjmë përpjekje që familja dhe bashkësia të mos e njollosin fëmijun apo nënën. Kujdesja e përkohshme, e më vonë edhe përvetësimi, duhet të mbështeten në atë se a është fëmiju i braktisur, i lënë pas dore ose i maltretuar në çfardo mënyre.

Fëmijët si viktima/persona të mbijetuar

Keqtrajtimi seksual i djalit jomadhore nuk është pranuar dhe nuk është paraqitur sa duhet dhe nuk është trajtuar si duhet. Duke u bazuar në disa përkufizime kulturologjike, mitet dhe tabut e lidhura me homoseksualizëm ose turpin ekstrem, akoma më pak është për të besuar në paraqitjen e djemëve se kanë qenë të keqtrajtuar seksualisht, në krahasim me vajzat. Bashkësitë jo me dëshirë e pranojnë faktin se djemt mund të jenë viktima, ndërsa djemt mendojnë se të gjithë këto duhet t'i kalojnë në heshtje.

Fëmijët si kryes të dhunës

Edhe fëmijët mund të jenë kryes të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, me që, ashtu si të rriturit, edhe ata mund t'i shfrytëzojnë relacionet e pabarabarta të forcës ndërmjet tyre. Të detyrohet vajza e re apo djaloshi në aktin e padëshiruar seksual, është formë e keqtrajtimit seksual. Pa marrë parasysh përgatitjen e tyre, fëmijët e moshës jomadhore, nuk mund ta kuptojnë se çka po ngjet dhe as që është në gjendje të ofrojnë ndonjë pëlqim të sigurtë. Edhe kjo është formë e keqtrajtimit seksual.

Duhet të merremi si me traumën e viktimës, ashtu edhe me nevojat e kryesit për rehabilitim. Kryesi mund të jetë edhe vetë viktimë e keqtrajtimit dhe shfrytëzimit seksual, prandaj ka të drejtë në ndihmë dhe përkrahje. Deri sa është e vërtetë se shumica e kryesëve të veprës e ka historinë për keqtrajtim seksual, nuk është e vërtetë se shumica e viktimave më vonë do të fillojë me keqtrajtimin e fëmijëve. Shumica e atyre që keqtrajtojnë seksualisht, gjatë periudhës së adoleshencës, kryesisht nuk e bëjnë keqtrajtimin si personat e rritur, nëse në rini iu është ofruar ndihmë.

Me rëndësi është që t'i mbrojmë nga keqtrajtimi dhunuesit e mitur, deri sa janë në paraburgim. Kjo mund të arrihet përmes mbikqyerjes dhe marrjes në pyetje me shpejtësi nga ana e gjyqit. Fëmijëve të tillë, poashtu, duhet ofruar ndihmë psiko-sociale, gjatë rehabilitimit. Ligjet dhe procedurat, që mundësojnë mbrojtje juridike për kundërvajtësit jomadhore, duhet të promovohen atje ku nuk ekzistojnë, ndërsa atje ku ekzistojnë, të zbatohen në mënyrë të drejtë.

Shiko poashtu:

- Direktivat ndëragjencionale për fëmijët pa kujdestar dhe të ndarë (Ndëragjencionale, 2003)
- Çështje kritike të aksionit për të drejtat e fëmijve (ARC): Fëmijët e ndarë (UNHCR, OHCHR, UNICEF, Shpëtoni fëmij, përpunuar, 2002)
- Çështje kritike të aksionit për të drejtat e fëmijve (ARC): Invaliditeti (UNHCR, OHCHR, UNICEF, Shpëtoni fëmij, 2001)
- Çështje kritike të aksionit për të drejtat e fëmijve (ARC): Fëmijët ushtarë (UNHCR, OHCHR, UNICEF, Shpëtoni fëmij, 2000)
- Protokoli opcional i CRC-së mbi pjesëmarrjen e fëmijve në konfliktet e armatosura (2000)
- Direktivat e përpunuara mbi zbatimin e kriteriumeve dhe standardeve lidhur me arrestimin e personave që kërkojnë azil (UNHCR, 1999)
- Doracak i terrenit ndëragjencional mbi shëndetësinë reproduktive në situatat e ikjes (Ndëragjencionale, 1999)
- Regullorja e Romës e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (1998)
- Fëmijët refugjatë: Direktivat lidhur me mbrojtjen dhe kujdesin (UNHCR, 1994)
- Protokoli plotësues i Konventës së Zhenevës nga viti 1949, lidhur me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare (1977)

FORMAT SPECIFIKE TË DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS NË BAZË TË PËRKATËSISË GJINORE QË USHTROHEN NDAJ FËMIJVE

Fëmijët mund të jenë viktimat/personat që i kanë mbijetuar shumicën e formave të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, për të cilat u bë fjalë në Kapitullin 1. Megjithatë, fëmijët shpesh janë viktimat të formave tjera të dhunës:

- Zakoneve të dëmshme tradicionale.
- Trafikimit.
- Prostitucionit të fëmijve.
- Dhunës seksuale brenda familjes.
- Shfrytëzimit seksual, keqtrajtimit dhe dhunës nga personat që kanë qasje të lirë tek fëmijët.

Zakonet e dëmshme tradicionale

Në rastet ku zakonet tradicionale janë mirbërëse, bashkësitë e refugjatëve duhet t'i përmbahen atyre, si mënyrë për ruajtjen e identitetit dhe kulturës së tyre. Mirëpo, disa zakone tradicionale janë të dëmshëm për shëndetin, mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijve. Këto doke janë të gjykuara nga strukturat ndërkombëtare, si pasojë e rrezikut serioz për shëndetin, si dhe nga shkak se i cënojnë disa të drejta të njeriut. Zakonet e dëmshme tradicionale shpesh ndodhin gjatë periudhës së fëmijërisë, kur fëmiju nuk ka forcë që t'i kundërshtojë. Zakonet e dëmshme tradicionale, që ndikojnë tek fëmijët, e sidomos tek vajzat e reja, përfshijnë gjykimin e organeve seksuale të femrave, martesat e hershme, dhënien e përparësisë djemve, dhunën për shkak të mirazit, martesat e detyrueshme (pas aktit të përdhunimit) dhe besimi në magji (psh. besimi se seksi me fëmij do t'i sjellë dobi familjes).

Trafikimi

Fëmijët refugjatë, e sidomos fëmijët pa kujdestar dhe fëmijët e ndarë i nënshtrohen rrezikut të një trafikimi të detyruar ose mashtrues për qëllime komerciale. Trafikimi me fëmijë do të thotë rekrutim, transportim, fshehje ose pranim i fëmijve me qëllim të eksploatimit. Nuk është e nevojshme të theksohet se gjatë trafikimit është përdorur forca, mashtrimi ose shtrëngimi.

Protokoli për parandalimin, shuarjen dhe ndëshkimin e trafikimit me qenie të gjalla, sidomos të femrave dhe fëmijve, duke përbushur Konventën e Kombeve të Bashkuara, 2000, përjashton mundësinë e «miratimit» për trafikim nga secili person nën moshën 18 vjeçare. Në shumë raste trafikimi nënkupton pagesë ose ofrim të beneficioneve për marrjen e pëlqimit nga personi/personat që kanë kontrollë mbi fëmijun. Fëmijët e trafikuar ballafaqohen me pasoja serioze pas ikjes ose pas kthimit, përfshirë këtu edhe hakmarrjen nga organizatat apo individët që merren me trafikimin e fëmijve, pastaj mundësinë e tregtisë së pësëritur, dënimit fizik, privimit nga liria, braktisjen nga familja dhe bashkësia ose diskriminimi serioz.

Prostitucioni i fëmijëve

Prostitucion i fëmijve do të thotë shfrytëzimi i fëmijut në aktivitete seksuale për fitime personale. Oferta, të fituarit dhe furnizimi me fëmijë për qëllime të prostitucionit duhet të përfshihen në tërësi me ligjin penal ose ndëshkimor shtetror. Në bazë të definicionit, prostitucioni i fëmijve, është i barabart me shfrytëzimin seksual. Kur fëmijët refugjatë angazhohen njëherë në aktivitetet e prostitucionit, atëherë shtohet rreziku nga dhuna e shtuar seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore.

Varfëria dhe dallimet sociale bëjnë që fëmijët refugjatë të jenë edhe më shumë të rrezikuara nga shfrytëzimi seksual, e sidomos nga prostitucioni. Fëmijët, e në veçanti vajzat e reja, janë të rrezikuara më shumë, duke pasur parasysh faktin se dliresia, pafajësia dhe papjekuria e tyre, nganjëherë janë shumë të çmuara nga kryesit e veprave.

Dhuna seksuale brenda familjes

Keqtrajtimi dhe shfrytëzimi i fëmijve brenda familjes, paraqet provokim të ndërlikuar për ofrim të ndihmës, nga shkak se personi që është përgjegjës për mbrojtjen dhe kujdesjen e fëmijut- në shumë raste familjar i gjinisë mashkullore – nuk e bënë asnjëherë as tjetër. Dhuna seksuale brenda familjes, shpesh trajtohet si çështje private, që nuk iu intereson të tjerëve. Nga kjo rrjedhë se fëmiju i keqtrajtuar edhe fajsohet për rastin e dhunës, duke përjetuar dhunë edhe më të madhe. Edhe pse është e pamundur që të ofrohen këshilla të përgjithshme, që do të zbatoheshin në të gjitha rastet, është më se i nevojshëm identifikimi, paraqitje e vërtetuar e padisë- që nënkupton punëtorët shëndetësorë, punëtorët e arsimit dhe udhëheqësit e bashkësisë- si dhe hetimi i rasteve për planifikimin e mbrojtjes së fëmijëve. Bashkëpunimi më prindin, i cili nuk e keqtrajton fëmijun, mund të jetë më se i dobishëm, si dhe largimi i keqbërësve nga familja, deri sa vazhdon hetimi.

Edhe kur ata vetë nuk janë në nishan, fëmijët e familjeve, në të cilat njëri apo më shumë anëtarë e kanë mbijetuar apo e mbijetojnë dhunën seksuale ose dhunën mbi baza gjinore, ballafaqohen me vështirësi të tjera. Me që mirëqenia psikologjike dhe emocionale e fëmijut mund të gjendet në rrezik, nëse merr pjesë në ngjarjet ku përdoret dhuna, atëherë ai duhet të këshillohet. Aq më tepër, ngjarjet traumatike, ndonjëherë mund ta dëmtojnë aftësinë e të rriturëve që të kujdesën për fëmijët e tyre, andaj duhet një përkujdesje edhe për prindërit edhe për fëmijët në ato familje.

Shfrytëzimi seksual, keqtrajtimi dhe dhuna nga personat që kanë qasje të lirë tek fëmijët

Kur personave, jasht rrethit më të ngushtë familiar, i mundësohet qasje e lirë tek fëmijët në mjediset e izoluara, mund të vijë deri tek shfrytëzimi seksual, keqtrajtimi dhe përdhunimi. Personat e tillë mund të jenë punëtorët arsimorë, mësuesit fetar, kujdestarët, punëtorët humanitarë dhe të tjerët që nuk e kanë të ndaluar hyrjen tek fëmijët në shkolla, gjatë veprimtarive jashtshkollore dhe fetare, aktivitetet sportive, pushimet ditore etj. Në radhë të parë duhet identifikuar këto burime potenciale të rrezikut. Strategjitë që do të merreshin me këtë rrezik, mund të marrin forma të një kontrollimi të kujdesshëm të të punësuarëve dhe vullnetarëve, zvoglimit të mundësive që ta kalojnë kohën vetëm me fëmijët pa prezencën e personave tjerë të rritur, kontrollimi i pandërprerë, përdorimi i objekteve ku i gjithë lokali është kontrolluar si dhe aanazhimi më i madh i prindit në aktivitetet e fëmijut.

Shiko poashtu:

- Çështje kritike të aksionit për të drejtat e fëmijve (ARC): Keqtrajtimi dhe eksploatimi (UNHCR; OHCHR; UNICEF, Shpëtoni fëmijët, përpunuar 2002)
- Zgjedhni me kujdes (ECPAT Australi, 2001)
- Protokoli Opcional i CRC-së mbi trafikimin e fëmijve, prostitucionit dhe pornografisë së fëmijve (2000)
- Konventa lidhur me ndalimin dhe aksionin momental për eliminimin e formave më të këqia të punëve të fëmijve, C 182 (1999)
- Deklarata e KB mbi eliminimin e dhunës ndaj femrave (1994)

SHQYRTIME SPECIALE LIDHUR ME PARANDALIMIN E DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS MBI BAZA GJINORE QË USHTROHET NDAJ FËMIJËVE

Së bashku me strategjitë për pengimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, për të cilat u bë fjalë në Kapitullin 3, do të jetë si ndihmesë edhe analiza e situatës drejtuar kah fëmijë, për t'u identifikuar faktorët specifik të rrezikut dhe resurset, për të siguruar qasje multisektoriale problemit. Roli i bashkësisë së refugjatëve për mbrojtjen e fëmijëve refugjatë duhet të përkrahet.

Transformimi i normave shoqërore -kulturore

STRATEGJIA:

Të zhvillohet fushata e informitetit, edukimit dhe komunikimit (IEC)

- Fushata e përmirësimit të informimit për çështjen e dhunimit seksual dhe dhunës mbi baza gjinore, ku viktimat janë fëmijë, duhet të bazohet në principet CRC-së dhe protokolet e saj opcional, duke pasë si qëllim të gjithë partnerët, përfshirë këtu bashkësinë e refugjatëve, forcat ushtarake dhe të paqes.
- Përfaqësimi duhet bazuar në normat dhe vlerat tradicionale lidhur me mbrojtjen e fëmijve, nëse ato ekzistojnë, duke i kundërshtuar njëkohsisht paragjykimet, që bazohen në stereotipe mbi përkatësinë gjinore (psh. çështja e djemve si viktimat/persona të mbijetuar). Të gjitha iniciativat për reagim ndaj këtij problemi, duhet të jenë të bazuara mbi normat e arsyeshme vendore, zakonet dhe tabutë, lidhur me sjelljet seksuale.

- Fushata e mbrojtjes shëndetësore lidhur me "seksin e sigurtë" dhe bartja e HIV/AIDS, rrëzon mitet që qarkullojnë përmes popullatës refugjate se, fjala vjen, seksi me vajzën virgjëreshë mund ta shërojë HIV/sidën. Këto fushata duhet të orientohen kah burrat dhe djemt.
- Strategjitë për pengimin e zakoneve të dëmshme tradicionale ballafaqohen me rezistencën e normave të forta kulturore, andaj duhet që këto strategji të mbajnë shkallë të lartë senzitive ndaj tyre. Duhet kuptuar thellë natyrën dhe përdorimin e shpesht të disa zakoneve, rrënjët e tyre dhe pasojat shoqërore. Edukimi dhe informimi, që kanë për qëllim pasoja të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve, para se pasojat lidhur me aspektin juridik dhe të drejtat e njeriut të zakonit përkatës, të kenë gjasa për ndonjë sukses, duhet t'i kushtohen udhëheqësve fetarë, si meshkuj ashtu edhe femra, udhëheqsve tradicionalë, eprorëve të bashkësisë, liderëve politikë, ndihmësve tradicionalë gjatë lindjes, punëtorëve tjerë shëndetësorë, si dhe fëmijëve, femrave dhe meshkujve refugjatë. Grupet vendore, që i kundërshtojnë këto zakone të dëmshme tradicionale, duhet përkrahur, nga se janë në gjendje t'i aktivizojnë edhe udhëheqsit e veprimtarive brenda bashkësisë dhe kanë për qëllim t'i zhdukin këto zakone. Veprimtaritë alternative që krijojnë të ardhura, duhet t'i identifikojnë personat që merren me këto zakone prapanike, ndërsa anët pozitive duhet mbajtur dhe ruajtur. Rëndësia e arsimit të vajzave dhe grave nuk duhet nënçmuar, nga se prezenca e zakoneve të dëmshme tradicionale është e lidhur pikërisht për analfabetizmin.

STRATEGJIA:

Të angazhohen fëmijët dhe rinia

Duhet trimruar fëmijët refugjatë që të marrin pjesë në realizimin e programit kundër eksploatimit, keqtrajtimit dhe dhunës. Në situatat e përshtatshme dhe pas shqyrtimit detal të interesave më të dobishme të tyre, fëmijët viktima/të mbijetuarit duhet konsultuar dhe ftuar që të marrin pjesë në këto veprimtari.

STRATEGJIA:

Të bashkëpunohet me djemt

Bashkëpunimi me djemt është më se i domosdoshëm, që ata të bëhen të vetëdijshëm dhe ta kuptojnë termin e të drejtave të barabarta për vajzat. Kjo nënkupton përkrahjen e arsimit për motrat e tyre dhe promovimin e gjykimeve pozitive dhe respektimin e vajzave në klasat shkollore dhe në fushat e lojrave.

Ndërtimi i sërishëm i sistemit të përkrahjes së familjes dhe bashkësisë

STRATEGJIA:

Të sigurohet hyrja në shkollë

Kur fëmijëve refugjatë iu sigurohet shkollimi fillor- e ku është e mundur- edhe shkollimi i mesëm i përgjithshëm ose profesional, kanosja e rrezikut për shfrytëzimin e tyre është më e vogël. Programet speciale, të përshtatura për nevojat e vajzave, të cilat e kanë ndërprerë shkollimin, e zvoglojnë llojin e këtij rreziku. Informimi i fëmijëve mbi të drejtat e tyre, përmes formave të ndryshme të mësimi dhe stërvitjeve, lidhur me shkathtësitë jetësore, të rijëve ju ndihmon që të bëjnë zgjedhje më të mirë në jetë dhe vetë të mbrohen nga eksploatimi. Duhet përkrahur pjesëmarrja e barabart e vajzave në shkollë.

Bashkësia duhet të angazhohet gjatë rekrutimit dhe mbikqyerjes së personelit arsimor dhe pedagogëve, të cilëve iu beson, me që edhe arsimtarët mund të jenë kryes të dhunës seksuale. Duhet të përkrahen masat specifike, të cilat e miratojnë punësimin e personelit arsimorë të gjinisë femrore. Pedagogët e zgjedhur me kujdes, duhet të jenë të kyçur në mbikqyerjen e fëmijëve, për t'i vërejtur shenjat e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore. Vajzave duhet siguruar veshje të përshtatshme dhe material sanitar. Edhe

themelimi i klubeve jashtshkollore mund t'iu mundësojë vajzave këshillime dhe përkrahje të moshatarëve të tyre.

Krijimi i kushteve për përmirësimin e sistemit të përgjegjësisë

STRATEGJIA:

Të bëhet vlerësimi i personave që kanë hyrje të lirë te fëmijët refugjatë

Vlerësimi i njohurive, botkuptimeve dhe sjelljeve të gjithë personave që kanë hyrje të lirë tek fëmijët refugjatë, mund ta ndriçojë prezencën e eksploatimit, në situata të papritura, si për shembull në shkolla dhe qëndrime ditore. Njëri nga elementet kyç, në cilëndo strategji të pengimit, është edukimi i këtij personeli dhe mbikqyerja e punës së tyre.

Planifikimi i shërbimeve efikase dhe kapaciteteve të vendosjes

STRATEGJIA:

Të regjistrohet çdo fëmijë

Regjistrimi dhe dokumentacioni, përfshirë këtu edhe paraqitjen e fëmijve të posalindur, është me rëndësi vendimtare për çdo person të ikur në veçanti, e sidomos për fëmijët pa kujdestar dhe të ndarë, me që dokumentacioni në fjalë është parakusht për fitimin e të drejtave dhe qasjen në shërbime. Regjistrimi ndihmon në identifikimin dhe mbikqyerjen e grupeve, të cilëve ju kanoset rreziku nga dhuna seksuale, në përkrahjen e procedurës së sistemit gjyqësor për të miturit, në pengimin e rekrutimit ushtarak dhe në prapsimin e individëve/grupeve që merren me trafikimin e fëmijve.

STRATEGJIA:

T'i sigurohet qasje shërbimeve

Duhet kujdesur që fëmijët të marrin sasi të barabarta të ushqimit si edhe popullata tjetër, duke shqyrtuar mundësinë e përkrahjes edhe më të madhe, kur të shtrohet nevoja, si për shembull, përmes ndërtimit të objekteve speciale, ku do të vendoseshin familjet që udhëhiqen nga fëmijët.

STRATEGJIA:

Të gjenden familjet

Me rëndësi është kujdesja për fëmijët pa kujdestar dhe fëmijët e ndarë, përmes gjetjes së familjeve, sigurimit të formave të përshtatshme të kujdesjes së përkohshme, si dhe integrimi i sërishëm në familje, nëse kjo është në interes të fëmijut.

STRATEGJIA:

Të angazhohen fëmijët gjatë planifikimit, projektimit dhe implementimit të aktiviteteve

Fëmijët refugjatë, e sidomos adoleshentët, duhet të konsultohen gjatë planifikimit të kampit/vendbanimit, duke përfshirë lokalit shkollor dhe objektet për rekreacion, si dhe gjatë planifikimit të sistemit të vendosjes dhe programeve e veprimtarive tjera relevante.

Shiko poashtu:

- Çështje kritike të aksionit për të drejtat e fëmijve (ARC): Keqpërdorimi dhe eksploatimi (UNHCR; OHCHR; UNICEF, Shpëtoni fëmijët, përpunuar 2002)
- Fondacioni i aksionit për të drejtat e fëmijve (ARC): Mobilizimi i bashkësisë (UNHCR; OHCHR; UNICEF, Shpëtoni fëmijët, 2001)
- Çështje kritike të aksionit për të drejtat e fëmijve (ARC): Fëmijët e ndarë (UNHCR, OHCHR, UNICEF, Shpëtoni fëmijët, përpunuar 2002)
- Fondacioni i aksionit për të drejtat e fëmijve (ARC): Analiza e situatës (UNHCR; OHCHR; UNICEF, Shpëtoni fëmijët, 1999)
- Konkluzioni i UNHCR EXCOM-it mbi dokumentimin e refugjatëve dhe personave që kërkojnë azil, nr. 91 (LII) (UNHCR, 2001)

SHQYRTIMET SPECIALE GJATË REAGIMIT NDAJ DHUNËS SEKSUALE DHE DHUNËS MBI BAZA GJINORE QË KRYHET TEK FËMIJËT

Reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet të përfshijë veprimtaritë dhe shërbimet, të cilat janë të përkrahura në Kapitullin 4. Çështjet e tjera që duhet marrë parasysh, gjatë punës me fëmij, poashtu janë shqyrtuar në tekstin me titull: Çështje kritike të aksionit për të drejtat e fëmijve (ARC): Keqtrajtimi dhe eksploatimi (UNHCR; OHCHR; UNICEF, Shpëtoni fëmijët, 2001).

Merrni parasysh interesat më të dobishme të fëmiut.

Fëmijve, që janë viktime/persona që e kanë mbijetuar keqtrajtimin seksual, ju nevojitet kujdesje mjekësore dhe përkrahje psikologjike. Mund që këtyre fëmijve të ju nevojiten edhe shërbime juridike.

Të gjitha veprimtaritë duhet shqyrtuar nga këndi që është konsekuent me principin e interesave më të dobishme për fëmiun.

Rrëfimi i fëmiut për dëshirat dhe ndjenjat vetiake është me rëndësi vendimtare gjatë përcaktimit të rolit, gjë që është në interesin e tij/saj më të mirë.

Të përcaktohen mekanizmat e dërgimit, raportimit, mbikqyrjes dhe vlerësimit që anojnë kah fëmijët

Me rëndësi janë mekanizmat ekzistues dhe të njohur të raportimit, që janë të prirur për fëmijët dhe me të cilët udhëheq personeli me përvojë dhe i stërvitur ose refugjatët. Duhet harmonizuar raportimi mbi dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore me proceset e raportimit, që merren me llojet e tjera të cënimit të drejtave të fëmijve, para përpilimit të ndonjë procesi të veçantë, i cili do të merrej ekskluzivisht me raportet që kanë të bëjnë me dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar mbi përkatësinë gjinore, që kryhet ndaj fëmijve.

Mbikqyerja e fëmijve, të cilëve iu kanoset rreziku – siç janë fëmijët pa kujdestarë dhe të ndarë, me vendosje të përkohshme të kujdesit, fëmijët në përkujdesje të familjeve, fëmijët e rrugës, fëmijët në paraburgim, nënat e mitura dhe fëmijët invalidë, duhet vazhduar, duke ju ofruar mbrojtje nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore.

Zhvillimi i bisedës informative (intervistës) me fëmiun

Personi që e interviston fëmijën, duhet të jetë profesioniste dhe shumë mirë e stërvitur, e aftë që t'i përballojë emocioneve ekstreme dhe me përvojë, për të krijuar atmosferë, në të cilën fëmijë mund të shprehet për gjëra të vështira. Është më se e nevojshme që ky person të jetë i njoftuar me kulturën e fëmijës; andaj rekomandohet që ata të cilët punojnë me fëmijët refugjatë, të kenë pika kontakti me ta, me të njëjtën gjuhë dhe prejardhje kulturore.

Në kuptimin e përgjithshëm, rekomandohet që intervistuesi të jetë i të njëjtës gjini me fëmijën. Poashtu, është e nevojshme që të merren parasysh faktorët kulturorë e shoqërorë, me rastin e vendosjes së gjinisë të personit, i cili do ta zhvillojë bisedën informative. Në shumë shoqëri, fjala vjen, djemt nuk dëshirojnë të flasin për keqtrajtim homoseksual me meshkujt e tjerë, por ndoshta ndjehen më të lirë, kur për këtë çështje flasin me femrat.

Krijimi i rrethit të sigurtë

Caktojini kush duhet të jetë prezent gjatë intervistimit dhe vizitës. Ka mundësi që prindi të jetë njëkohsisht edhe kryesi i veprës, edhe pse fëmijë këtë e mohon. Ndoshta është më mirë që prindi apo kujdestari të gjendet jasht lokalit, gjatë intervistimit dhe vështrimit. Pyeteni fëmijën – kur nuk është askush prezent- për atë se a dëshiron që prindi apo kujdestari të jetë aty, gjatë intervistimit, duke respektuar dëshirën e tij/saj. Për njoftime plotësuese, shikoni kaptinën mbi Shkathtësinë e intervistimit, përgatitjes dhe zbatimit të bisedës informative, i cili gjendet në tekstin me titull: *Puna me fëmijët pa kujdestar: Qasje e bazuar në bashkësi.*

Jeni të vetëdijshëm në faktin se ekzistojnë edhe mënyra të tjera të grumbullimit të informacioneve, përmes lojrave, tregimeve, aktrimit dhe vizatimeve të fëmijëve. Këto metoda kërkojnë vëmendje dhe analizë të thellë dhe me përvojë, nga ana e profesionistëve ose personelit, i cili i ka kryer këto stërvitje përkatëse, në këtë lëmi.

TEKNIKAT PËR INTERVISTIM

- **Uluni në lartësinë e syve të fëmijës dhe mbajeni kontaktin me të përmes syve, nëse kjo është e përshtatshme,**
- **Bindeni fëmijën se nuk ka bërë asgjë të keqe, bëni çka është e mundur që ta fitoni integritetin fizik të fëmijës,**
- **Prezentojeni veten (edhe personin që do ta zhvillojë bisedën) dhe me kujdes shpjegoni se për çka është fjala, çfarë pyetjesh do të shtrohen dhe pse. Kjo bëhet që të minimizohet frika dhe ndonjë keqkuptim eventual, që mund të ndikojnë negativisht në brendin e përgjigjeve të fëmijës.**
- **Bindeni fëmijën se është e pranueshme, nëse në çfardo pyetje përgjigjet me «nuk e di» dhe se guxon edhe ai të bëjë pyetje**
- **Bëni disa pyetje për ndonjë temë neutrale, siç është shkolla, shokët, personat me të cilët jeton fëmijë, aktivitetet që i do fëmijë, duke i lejuar fëmijës që për një kohë të flasi për këto. Kjo kohë i mundëson fëmijës që të lirohet dhe t'iu bëjë të mundur që të dëgjoni dhe të mësoni mbi mënyrën me të cilën komunikon fëmijë.**
- **Nëse fëmijë nuk është në gjendje të flasi për ndonjë ngjarje të caktuar, ai ndoshta mundet të përgjigjet në pyetjet e tjera dhe, për një kohë, mos shtroji pyetje të tjera lidhur me këtë temë.**
- **Keni durim dhe përcilleni ritmin, të cilin e cakton fëmijë.**
- **Bëni pyetje, por përgjigja të mos jetë vetëm me «po» ose «jo», në mënyrë që të nxirren informacione mbi ngjarjen, të cilën e përshkruan me fjalët e veta. Pyetjet në të cilat merret përgjigja me "po" ose "jo" shtroni vetëm sa të sqaroni disa detale.**
- **Bëhuni gati që ta vëreni momentin se kur fëmijë e arrinë kufirin e qëndrueshmërisë.**
- **Intervista duhet të kryhet përmes diskutimit mbi ngjarjet normale ditore, për të krijuar ndjenjën e sigurisë.**

Zhvillimi i sistemit të reagimit ndaj nevojave shëndetësore/medicinale të viktimave/të mbijetuarëve

ASNJËHERË fëmijun e friksuar, i cili bënë rezistencë, mos e bindni, mos e ndaloni dhe detyroni që të flasi apo edhe ta vizitoni. Të ndaluarit, të detyruarit, të bindurit dhe manipulimi, shpesh janë pjesë e keqpërdorimit seksual, dhe në rast se shërbehen me këto, ata të cilët tentojnë të ndihmojnë, edhe më tepër do ta shtojnë frikën tek fëmiju, duke keqpërsuar ndikimin psikik të këtij keqtrajtimi.

Krahas krijimit të rrethit të sigurtë dhe të besueshëm, pregaditeni fëmijun për vizitë, duke trimruar që të bëjë pyetje për çfardo qoftë që e brengos apo që s'e kupton, kur ai dëshiron, gjatë intervistimit.

Krahas përgatitjes adekuate, shumica e fëmijve mund të lirohen dhe të marrin pjesë në vizitë.

Është e mundur që fëmiju të ketë dhembje, prandaj edhe nuk mund të lirohet. Shpjegoni fëmijut se çka do të ngjajë gjatë vizitës, përmes fjalëve të kuptueshme për fëmijun.

Shpesh është ndihmesë, nëse në dorë keni ndonjë kukull ose ndonjë lojë tjetër, për t'i treguar fëmijut pozitat dhe procedurat. Tregoni fëmijut pajisjen, si për shembull dorëzat, shufrat për marrjen e mostrës tek fëmijët dhe të tjera, duke i lejuar fëmijut që t'i përdori në kukull.

Vajzat e reja që janë keqpërdorur, mund të përballen me komplikime shëndetësore që kanë lidhje me abortimet e vetëkryera, shtatzëninë e padëshiruar dhe dështimet natyrore. Ao ndoshta edhe kanë fëmijë të vet, andaj ju është i nevojshëm kujdes i veçantë. Fëmijët-viktimat e demobilizuar mund të jenë, poashtu, të infektuar përmes ndonjë sëmundje seksuale ngjitëse, duke përfshirë edhe sidën.

Vajzave, të cilat iu janë nënshtruar gjymtimit të organeve gjenitale femrore, ju është e nevojshme përkujdesje e veçantë, sidomos gjatë shtatzanisë, lindjes dhe gjatë periudhës pas lindjes.

Përkrahja përkatëse mjekësore dhe psikologjike duhet t'iu mundësohet nënave të mitura, para dhe pas lindjes, duke përfshirë edhe këshillimoren për rritjen e fëmijut.

Planifikimi për plotësimin e nevojave psiko-sociale të viktimave/personave të mbijetuar

Profesionisti i stërvitur për punë me fëmijët, duhet të ofrojë ndihmë në rastet kur fëmijut i duhet përkrahje psiko-sociale. Ky profesionist duhet të jetë me prejardhje etnike të njëjtë sikur edhe fëmiju, ose ndonjëri që ka përvojë ndërkulturore. Roli i këtij profesionisti mund të jetë, ose të sigurojë drejtpërdrejt shërmin e fëmijut, ose të ofrojë këshilla për anëtarët e familjes ose bashkësisë, që do ta ushtrojnë këtë funksion.

Rehabilitimi i fëmijve-viktima/të mbijetuarëve, përfshirë edhe fëmijët që kanë qenë në rekrutim ushtarak, kërkon një përkujdesje të veçantë. Mësuarja e shpejtuar dhe programi i shkollimit të shpejt, janë elemente vendimtare për aftësimin e viktimave/të mbijetuarëve, për ta kapërcyer keqtrajtimin që e kanë përjetuar dhe për t'ii ndërtuar vetes një ardhmëri të re.

Zhvillimi i sistemeve të reagimit, të mbrojtjes dhe sigurisë

Fëmijun nuk duhet ndarë nga familja ose bashkësia me qëllim të shërimit, përveç kur është çështja e mbrojtjes nga keqtrajtimi dhe pakujdesia.

Reagimi i shpejt është me rëndësi vendimtare, kur paraqiten rastet që kanë lidhshmëri me zakonet e dëmshme tradicionale. Në këto situata, e drejta themelore e fëmijut- duke përfshirë edhe të drejtën për jetë,

liri dhe integritet fizik- mund të shkilet. Në rastet kur mbrojtja fizike e fëmiut është çënuar, duhet kërkuar zgjidhje në rajonin lokal, duke pasë parasysh vendosjen e tij në ndonjë strehimore, e cila gjendet aty afër bashkësisë. Nëse zgjidhja lokale nuk është e mundur, duhet marrë parasysh ndërrimin e vendbanimit, në mënyrë që siguria e fëmiut të jetë e garantuar.

Vendosja e sistemit juridik/gjyqësor të reagimit

Duhet patjetër të shqyrtohen të gjitha paraqitjet lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore, ku viktimat janë fëmijët. Punëtorët duhet pasur durim e sidomos kujdes, kur është në pyetje shqyrtimi i këtyre paraqitjeve. Fëmiu mund ta mohojë keqtrajtimin për arsye të ndryshme, duke pasë parasysh edhe frikën nga kryesi i veprës. Intervenimi i papërshtatshëm dhe i pandjeshëm, mund të shkaktojë dhembje dhe vuajtje plotësuese tek fëmiu. Gjithkund, ku është e mundur, personeli duhet të jetë i stërvitur për punë me fëmijët. Ndihma e kërkuar nga kolegët me përvojë më të gjatë në këtë drejtim, mund të jetë shumë e dobishme. Poashtu janë të nevojshëm edhe përkthyesit dhe interpretët. Binduni se personeli i policisë lokale është i ushtruar për punë me fëmijët viktimat/ personat që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore. Në situatat, ku rastet janë të lidhur me fëmijët viktimat, dhe paraqiten në gjykatë, jeni të bindur se në procedurën gjyqësore ekziston mirkuptim për nevojat e veçanta të fëmiut.

Angazhimi i familjes dhe bashkësisë

Shërbimet e dedikuara familjes: Në rastet e keqtrajtimit të fëmijëve, ndonjëherë këshillimi është i nevojshëm për gjithë familjen, në mënyrë që fëmiu ta ndjejë se i besohet atij dhe se ka mbështetje dhe ndihmë për kthim në rrjedhat normale të jetës. Anëtarëve të familjes, poashtu, ndoshta ju nevojitet ndihmë: mund që prindërit ndjehen fajtorë që nuk kanë arritur ta mbrojnë fëmiun e vet. Duhet pasur kujdes të veçantë në rastet kur në dukje, nderi i humbur të fëmiut, mund të ketë për pasojë injorimin e fëmiut nga familja. Në disa kultura, e drejta ligjore mund të kërkojë nga familja që ta detyrojë vajzën që të martohet me kryesin e veprës. Në këto raste duhet të ndërmerren masa të menjëhershme për pengimin e dëmeve fizike e psiko-sociale të viktimës/personit të mbijetuar. Nëse paraqitet nevoja, viktimës/personit të mbijetuar, duhet t'i ndërrohet vendbanimi.

Shërbimet e dedikuara bashkësisë: Nevojitet kujdes i posaçëm që viktimat/personi i mbijetuar të mos ndjehet i njollosur dhe i lënë pas dore. Strukturat ekzistuese të përkrahjes në bashkësi dhe sistemit të kujdesit social për fëmijët, duhet të sigurojnë mbështetje dhe mbrojtje kudo që ka mundësi.

Disa forma të zakoneve të dëmshme tradicionale, si për shembull martesat me detyrim dhe gjymtimi i organeve gjentile të femrës, ngjajnë shumë herët në jetën e vajzës. Me rëndësi është që t'i ndihmohet për mirkuptim, si ndërmjet familjeve, ashtu edhe brenda bashkësisë, lidhur me pasojat e dëmshme të këtyre zakoneve, si për personalitetin e fëmiut ashtu edhe për bashkësinë në tërësi.

Shiko poashtu:

- **Shërimi klinik i personave që e kanë mbijetuar dhunën (WHO/UNHCR, 2002)**
- **Doracak për popullzimin e sërishëm (UNHCR, 2002)**
- **Çështje kritike të aksionit për të drejtat e fëmijëve (ARC): Keqtrajtimi dhe eksploatimi (UNHCR; OHCHR; UNICEF, Shpëtoni fëmijët, përpunuar më 2002)**
- **Çështje kritike të aksionit për të drejtat e fëmijëve (ARC): Fëmijët ushtarë (UNHCR; OHCHR; UNICEF, Shpëtoni fëmijët, 2000)**
- **Fondacionet e aksionit për të drejtat e fëmijëve (ARC): Popullzimi i sërishëm (UNHCR; OHCHR; UNICEF, Shpëtoni fëmijët 1999)**

- Doracak për terren ndëragjencional mbi shëndetësinë reproduktive në situatat e refugjatëve (Ndëragjencional, 1999)
- Puna me fëmijët pa kujdestarë: Qasje e bazuar në bashkësi (UNHCR, 1996)

PIKAT KYÇE

Të gjitha intervenimet për pengimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, duhet të kenë për bazë këto katër principe:

- E drejta për jetë, ekzistencë dhe zhvillim.
- Jodiskriminimi.
- Interesat më të dobishme për fëmion.
- Pjesëmarrja.

Jeni të vetëdëshëm për faktin se grupet e fëmijve të përmendur më poshtë, sidomos iu janë të nënshtruara rrezikut nga dhuna seksuale dhe dhuna mbi baza gjinore:

- Fëmijët pa kujdestar dhe fëmijët e ndarë.
- Fëmijët në paraburgim.
- Adoleshentët
- Fëmijët e paaftë shpirtnisht dhe fizikisht (Fëmijët me invaliditet).
- Fëmijët punëtorë.
- Nënata e mitura.
- Fëmijët, nënat e të cilëve janë viktime/persona që e kanë mbijetuar dhunimin.
- Fëmijët si viktime/persona të mbijetuar.
- Fëmijët, kryes të dhunës.

Format specifike të dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, që kryhen ndaj fëmijve janë:

- Zakonet e dëmshme tradicionale.
- Trafikimi.
- Prostitucioni i fëmijve.
- Dhuna seksuale brenda familjes.
- Shfrytëzimi seksual, keqtrajtimi dhe dhuna e kryer nga personat që kanë hyrje të lirë tek fëmijët.

Gjatë zhvillimit të veprimtarive për pengimin e dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, që kryhen ndaj fëmijve, është e nevojshme:

- Të zhvillohet fushata e informimit, edukimit dhe komunikimit.
- * Të angazhohen fëmijët dhe rinia.
- Të sigurohet arsimimi.
- Të vlerësohen personat që kanë hyerje të lirë tek fëmijët.
- Të përcaktohen mekanizmat e mbikqyerjes.
- Të bëhet regjistrimi i çdo fëmiu.
- Të sigurohet qasja në shërbime.
- Të gjenden familjet.
- Të angazhohen fëmijët në veprimtarirë e planifikimit, projektimit dhe implementimit.

Gjatë reagimit ndaj dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, që kryhet tek fëmijët, është e nevojshme:

- Të përcaktohen mekanizmat e udhëzimit, raportimit, mbikqyerjes dhe vlerësimit që kanë kuptim për nevojat e fëmijve.
- T'i mundësohet fëmiut lëvizje e sigurtë në rrethinë për kryerjen e vizitave mjekësore dhe bisedave informative.
- Të përgaditet fëmiu mirë për vizitë mjekësorë.
- Të kihet kujdes që personat, të cilët bëjnë intervista, i vizitojnë dhe i këshillojnë fëmijët, të jenë profesionistë të ushtruar për punë me fëmijë.
- Të angazhohet familja dhe bashkësia.
- Të mobilizohen shërbimet që janë të dedikuara për nevojat e familjeve.
- Të përkrahen strukturat ekzistuese brenda bashkësisë, për t'i ofruar ndihmë fëmiut.

KAPITULLI 6 KORNIZA PËR VEPRIM

Programet për parandalim dhe veprim ndaj dhunës seksuale dhe asaj mbi baza gjinore, të cilët kanë më së shumti sukses janë ata që janë planifikuar përmes konsultimeve me bashkësinë/komunitetin e refugjatëve, dhe janë të bazuara në bashkëpunimin shumësektorësh/multisektoral dhe ate ndër-agjencional. Për të projektuar programe efikase, ekipi duhet të përpilojë plan të përbashkët për veprim.

PËRPILIMI I PLANIT PËR VEPRIM

Programet e suksesshme janë ata që janë planifikuar përmes konsultimeve me bashkësinë/komunitetin e refugjatëve, posaçrisht me gratë dhe adoleshentët, dhe ata të cilët bazohen në bashkëpunimin shumësektorësh/multisektoral dhe ate ndër-agjencional në një fushë të caktuar. Disa nga hapat e nevojshëm për përpilimin e planit për veprim, duhet të ndërmerren njëkohësisht; disa nga ta mund të bëhen pas shqyrtimit dhe vlerësimit të strategjive ekzistuese për parandalimin dhe reagimin në dhunën seksuale dhe ate të bazuar në gjini.

Për përpilimin e planit për veprim nevojitet:

- Identifikimi dhe angazhimi i akterëve.
- Definimi me kuptim të përbashkët i dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, dhe arritja e pajtueshmërisë për fushëveprim.
- Analiza e situatës: mbledhja e informatave për të kuptuar më mirë nevojat, problemet, shërbimet në dispozicion, si dhe përparësitë dhe mangësitë e bashkësisë/komunitetit të refugjatëve.
- Arritja e pajtueshmërisë për parimet udhëzuese.
- Definimi i rolit dhe përgjegjësi të të gjithë akterëve.
- Përpilimi i synimeve dhe qëllimeve; definimi i veprimeve, pikësnyimeve, përfundimeve dhe treguesve; identifikimi i resurseve të nevojshme.
- Arritja e pajtueshmërisë për sitemet e mbikqyrjes dhe vlerësimit, duke përfshirë edhe mekanizmat për raportim, referim dhe koordinim.
- Hartimi i planit për ruajtjen e mirëqenies së personelit dhe të vullnetarëve.

Identifikimi dhe angazhimi i akterëve

Filloni gjithë procesin me identifikimin e akterëve relevant dhe i ftoni ata për diskutim në një takim apo në një sërë takimesh. Varësisht nga numri i pjesëmarrësve, gjuhëve dhe kulturave që duhet të takohen, mund të përcaktoheni për mbajtjen e një sërë takimesh apo diskutimesh me fokus grupet e organizuara sipas përkatësisë gjinore, të moshës dhe asaj etnike, në vend se të keni vetëm një takim. Gjatë këtyre takimeve duhet të kërkohet pjesëmarrja aktive; prandaj preferohet takimi i grupit të përbërë nga 15 deri 20 persona, se sa një takim në përbërje të madhe. Gjatë zhvillimit të procesit, është e mundur që kontributi i grave, meshkujve, të rinjëve, udhëheqësve dhe përfaqësuesve të grupeve të posaçme të interesit, do të japi rezultate më të mira.

Është e mundshme që në mesin e akterëve kyç të jenë, së paku, përfaqësuesit si në vijim:

- Udhëheqësit e refugjatëve, femra dhe meshkuj.
- Grupet e grave dhe rinisë refugjate.
- Grupet apo individët refugjatë, që janë me ndikim në bashkësi (për shembull përfaqësuesit e organizatave fetare apo tradicionale, punëtorët e arsimit, apo profesionistët e tjerë).
- Përfaqësuesit e bashkësive nikoqire.
- Autoritetet qeveritare nikoqire nga këto fusha: lidhja me refugjatët dhe mbikqyrja e refugjatëve, forcat e policisë dhe sigurisë, sistemi gjyqësor dhe juridiko-penal, ministria e arsimit, shërbimet shoqërore për çështje të femrave, të familjes dhe të fëmijëve.
- Punëtorët e kudesit shëndetësor.
- Agjencionet e shërbimeve publike.
- Grupet këshillëdhënëse, personeli i qendrave të krizës.
- Organizatat joqeveritare, partnere kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë edhe personelin që udhëheq me kampet.
- Juristët kombëtarë, njohuritë e të cilëve janë specializuar në ligjshmëritë, që ndërlidhen me dhunën seksuale dhe ato të bazuar në gjini në atë vend.
- Shefi i zyrës së UNHCR-së dhe personeli i terrenit, shërbimi për mbrojtje, për bashkësi, për sigurim, dhe nëpunësit/bashkëpunëtorët e programit.
- Agjencionet e Kombeve të Bashkuara.

Do të ishte e dobishme që, pjesëmarrësit në takime, të kenë paraprakisht një kopje të këtyre *Direktivave*, që paraprakisht t'i lexojnë dhe mësojnë ato. Nëse kjo nuk është e mundur, mendoni për mundësinë e organizimit të një takimi – para takimit kryesor – për ata që nuk kanë mundësi që paraprakisht t'i lexojnë dhe mësojnë *Direktivat*. Kështu mundësohet që të gjithë pjesëmarrësit të vijnë në takim të përgatitur njësoj.

Gjatë takimit të parë me akterët, mund të përfshini:

- Stërvitje gjysëmditore dhe punëtorinë mbi të drejtat e njeriut, përkatësisë gjinore, dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, dhe mbi çështjet e mbrojtjes.
- Prezentimet lidhur me aspektet specifike të dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, të cilat dalin nga individët kyç. Kjo do t'i kontribuojë si informimit ashtu edhe nxitjes për bashkëpunim dhe koordinim. Shembuj:
 - Shefi i policisë përshkruan procedurat vepruese të policisë ndaj paraqitjeve dhe raportimeve të dhunimit, dhunës në familje, dhe formave tjera të dhunës seksuale dhe asaj mbi baza gjinore;

- përfaqësuesi i qendrës mjeksore paraqet dhe shpjegon në hollësi reagimet dhe veprimet e kujdesit mjeksor që janë në dispozicion, protokolet që shfrytëzohen, dhe/apo nevojat për procedurat lehtësuese të mbrojtjes shëndetësore dhe për stërvitjen e personelit;
 - nëpunësi për mrojtje jep informata mbi standardet relevante ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të dhëna për numrin e rasteve të paraqitura dhe të pranuar gjatë vitit, çerekvitit apo muajit të mëparshëm;
 - juristi shtetëror shkurtimisht informon grupin mbi ligjet dhe procedurat relevante kombëtare;
 - përfaqësuesi për refugjatë përshkruan qëndrimet e bashkësisë ndaj çështjeve mbi dhunën seksuale dhe atë mbi baza gjinore, si dhe rastet individuale që kanë mundur të trajtohen në vendin e origjinës.
- Diskutimi për këto Direktiva, posaçërisht mbi analizën e situatës (shiko më poshtë), dhe për atë se si ato mund të shfrytëzohen.
 - Caktimi i “agjencionit kryesor” për dhunën seksuale dhe atë të bazuar në gjini (agjencioni i tillë kryesor është përshkruar më poshtë, në tekstin e titulluar Koordinimi). Kjo organizatë do të jetë e ngarkuar të ftojë mbledhjet, të shpërndajë informatat, dhe të percjellë zhvillimet e planeve për veprim ndërorganizativ dhe ndërsektorial.
 - Diskutimi dhe pajtueshmëria mbi planin e bashkëpunimit për mbledhjen e informatave, analizën e situatës dhe takimin e sërishëm, me qëllim të shqyrtimit të të dhënave dhe fillimit të planifikimit strategjik për parandalim dhe përgjigje.

Definimi me kuptim të përbashkët i dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, dhe arritja e pajtueshmërisë për fushëveprim

Për të gjithë akterët, është e rëndësishme të arrihet kuptim i përbashkët i nocioneve të dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini dhe i terminologjisë së përshatshme, dhe të arrihet pajtueshmëri mbi mekanizmat standarde të raportimit. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e një qasjeje korrekte, këmbimin e informatave në mes të akterëve, në percjelljen dhe vlerësimin e përbashkët.

Terminologjia e qartë dhe konsistente do të ju ndihmojë që në mënyrë të drejt t'i grumbulloni informatat, analizoni situatën, përcillni zhvillimet, krahasoni të dhënat kohëpaskohe dhe të bëni percjelljen efikase. Aplikimi i terminologjisë së njejtë në tërë botën, e bën të mundshëm krahasimin në mese të ndryshme të refugjatëve, dhe mundëson mbledhjen e të dhënave të vlefshme për planifikim dhe përpilim të programeve, të cilët më parë nuk ishin në dispozicion.

Zbatimi i analizës së situatës

Analiza e situatës është bazë për definimin e problemit, nevojave dhe burimeve në dispozicion, dhe për përcaktimin e qëllimeve, detyrave, veprimeve dhe rezultateve të dëshiruara. Me qenë se asnjë organizatë nuk është e ngarkuar në veçanti për programet e dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, në përpilimin e analizës së situatës duhet përfshirë një sërë organizatash dhe individësh. Angazhimi i të gjithë akterëve, poashtu, do të ndihmojë në ndërtimin e përkrahjes që nga bashkësitë-bazë dhe nxitjen e interesimit për program që nga fazat fillestare.

Shiko poashtu:

- **Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës të bazuar në gjini: Pakoja për planifikimin e situatës dhe kartelat informative (UNHCR, 2000)**
- **Vlerësimi i shpejt i mjedisit rural dhe vlerësimi i pjesëmarrjes së mjedisit rural: Doracak për shërbimin e terrenit dhe partënerët e CRS (Shërbimi Katolik për Ndhim, 1999)**
- **Planifikimi i orientuar-njerëzor për punë në përmirësimin e programeve të UNHCR-së (UNHCR, 1994)**
- **Planifikimi i orientuar-njerëzor: Korniza për planifikimin e orientuar-njerëzor në situata të refugjatëve, duke marrë parasysh femrat, meshkujt dhe fëmijët (UNHCR, 1992)**

Grumbullimi i informatave përfshinë pasqyrimin e të dhënave në dispozicion, bisedat me njerëzit, shtruarjen e pyetjeve dhe ndëgjimi. Është me rëndësi të dini sa më shumë për problemet, nevojat e paplotësuara dhe përparësitë e bashkësisë, si dhe për karakteristikat dhe çështjet e posaçme, sikurse janë pengesat kulturore, institucionale dhe personale në dhënien e ndihmës, të cilat janë specifike për rrethin në të cilin punoni. Njohja e dinamikës së bashkësisë do t'iu ndihmojë në planifikimin e mirëfillt.

Programet efikase për parandalim dhe reagim ndaj dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, mbështeten në analizën detale të raporteve të forcave në mes të meshkujve dhe femrave, femrave dhe femrave tjera, meshkujve dhe meshkujve të tjerë, si dhe të rriturëve dhe fëmijëve, në mënyrë që intervenimet të arrijnë rezultatin e dëshiruar dhe që pabarazitë të mos qëndrojnë në fuqi përgjithmonë dhe të mos thellohen dhe ashpërsohen edhe më tepër.

Varësisht nga resurset dhe ekspertiza që dispononi, metodat për grumbullimin e informatave mund të përfshijnë:

- Intervistat individuale.
- Turnetë dhe vizitat lokacioneve.
- Mbledhjet me qëllim të diskutimit.
- Fokus grupet.
- Anketat.
- Shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave dhe shënimeve në dispozicion.

Informatat duhet të mblidhen nga një sërë burimesh të mirëinformuara, ndër të cilat përfshihen:

<p>Bashkësia e refugjatëve</p>	<p>Individualisht: femrat, meshkujt, adoleshentët Grupet dhe organizatat e grave, meshkujve, djemëve dhe vajzave adoleshente Udhëheqësit dhe grupet fetare Eprorët dhe udhëheqësit e bashkësisë Komisionet udhëheqëse të kampeve, drejtuesit dhe komisionet e njësiveve Shkollat Grupet e afaristëve meshkuj dhe femra, tregtarët e vegjël Punonjësit e sigurimit Mjekët e mjekësisë tradicionale</p>
<p>Agjencionet për ndihma humanitare</p>	<p>Personeli mjeksor, përfshirë këtu edhe personelin e qendrave mjekësore dhe shërbimeve lokale shëndetsore Personeli sanitar dhe për përkujdesjen e ujit Personeli për ndërtimtari dhe strehim Personeli për shpërndarjen e artikujve ushqimor dhe joushqimor Personeli i shërbimeve shoqërore Punonjësit e arsimit Personeli për udhëheqjen e kampeve Personeli për stërvitje dhe ai për krijimin e të ardhurave</p>
<p>UNHCR dhe agjencionet tjera të UN</p>	<p>Shefat e zyrave Nëpunësit dhe asistentët për program Nëpunësit dhe asistentët për mbrojtje Nëpunësit dhe asistentët për shërbime shoqërore Nëpunësit dhe asistentët për punë në terren Nëpunësit dhe asistentët për çështje gjinore, për femrat dhe për fëmijët Nëpunësit dhe asistentët për sigurim dhe sigurinë e personelit në terren Personeli shtetror në të gjitha sektoret</p>
<p>Institucionet qeveritare nikoqire</p>	<p>Nëpunësit e policisë Personeli i sitemit ligjor Personeli i ministrisë së shëndetsisë, mirëqenies sociale, për çështje të femrave, familjes dhe fëmijëve</p>
<p>OJQ-të vendore dhe praktikantët individualë</p>	<p>Shërbimi i krizve për rastet e dhunimit dhe/ose dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, si dhe grupet për përfaqësim juridik Grupet e grave juriste Grupet për përkrahje juridike dhe për të drejtat e njeriut Juristët</p>

Arritja e pajtueshmërisë për tërësinë e parimeve udhëzuese

Për më shumë detaje mbi parimet udhëzuese, duhet të shikohet Kapitulli 2 i këtij libri. Është me rëndësi për ekipin të bisedohet hapur për parimet, të cilat do të orientojnë punën e tij. Të gjithë akterët duhet të pajtohen këto parime dhe të kuptojnë se si ato ndikojnë në punën e tyre.

Parimet udhëzuese për të gjithë akterët

Për programet

- **Angazhimi i plotë i bashkësisë së refugjatëve.**
- **Sigurimi i pjesëmarrjes së barabart të femrave dhe meshkujve, vajzave dhe djemve në planifikimin, realizimin, përcjelljen dhe vlerësimin e programeve.**
- **Sigurimi i veprimit të koordinuar, shumësektorësh i të gjithë akterëve.**
- **Përpyjekja e fuqishme për të integruar dhe përforcuar veprimet në programimin e UNHCR-së, në të gjitha nivelet.**
- **Garantimi i përgjegjësive në të gjitha nivelet.**

Për individët

- **Garantimi i sigurisë fizike të viktimës(ave)/mbijetuar(ve).**
- **Garantimi i fshehtësisë.**
- **Respektimi i dëshirave, të drejtave dhe dinjitetit të viktimës(ave)/mbijetuar(ve), dhe përfillja e interesave më të mira për femiun, gjatë marrjes së çfarëdo vendimi për rrjedhën më të përshatshme për veprim në parandalimin dhe reagimin ndaj rasteve të dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini.**
- **Garantimi që të mos ndodhë diskriminimi.**

Definimi i rolit dhe i detyrave të gjithë akterëve

Meqenëse ekziston një numër i akterëve të ndryshëm, të cilët përfaqësojnë agjencione dhe sektore të ndryshme, është me rëndësi që të definohet qartë roli dhe detyrat e secilit prej tyre. Në disa raste, ndonjë detyrë apo funksion i caktuar, mund të kryhet jo vetëm nga një person. Megjithatë, ekipi duhet qartë të identifikojë personin, i cili në fund të fundit është ngarkuar për realizimin e detyrës së dhënë, raportimin për te, dhe do të jetë përgjegjës në rast se detyra e dhënë nuk është realizuar në tërësi.

Në situatat e refugjatëve UNHCR duhet të marrë udhëheqjen në koordinimin e qasjes multisektorale dhe përfshirjen e të gjithë akterëve relavantë.

Arritja e pajtueshmërisë për sistemet e mbikqyrjes dhe të vlerësimit, përfshirë këtu edhe mekanizmat koordinues të raportimit dhe përcjelljes

Është me rëndësi të zhvillohen mekanizma mbikqyrës dhe vlerësues të intervenimeve për parandalim dhe reagim. Ata duhet të jenë të koordinuar nga të gjithë akterët, me pjesëmarrje të bashkësisë, posaçërisht refugjatëve femra, meshkuj dhe të rinj. Mbikqyrja e vazhdueshme mundëson që intervenimet për parandalim dhe reagim të zhvillohen sipas planit. Vlerësimet ndihmojnë në identifikimin e ndikimit mbrojtës të strategjive për parandalim dhe reagim në refugjatët gra, burra, djem dhe vajza. Për më shumë detaje për mekanizmat mbikqyrës dhe vlerësues, duhet shikuar Kapitullin 7 të këtij libri. Është me rëndësi që të gjithë akterët të pajtohen me qëllimin e mekanizmave për mbikqyrje dhe vlerësim dhe të identifikojnë qëllimet, përfundimet dhe treguesit për secilin intervenim. Plani veprues, poashtu, duhet të nënkuptojë resurset njerëzore dhe financiare, të nevojshme në intervenimet për vlerësim.

Krijimi i mekanizmave për raportim, përcjellje dhe koordinim

Për akterët është me rëndësi vendimtare që ta koordinojnë sistemin e raportimit dhe përcjelljes. Duhet të zhvillohen sistemet e përbashkëta për përcjellje, në lëmin e nevojave për kujdesin shëndetësor, këshilldhënie, mbrojtje dhe atë juridik. Sistemi efikas i raportimit duhet të zhvillohet si pjesë përbërëse e mekanizmit të mbikqyrjes. Këtu bën pjesë përpilimi i një formulari të përbashkët për raportimin e rasteve të dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, dhe mekanizmat për këmbimin e informatave për incidentet e dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini. Kjo strategji e këmbimit të informatave do të përcaktojë mënyrën me të cilën problemet e veprimeve për parandalim dhe ragim do të diskutohen dhe zgjidhen në mes të akterëve.

Një sistem i përbashkët i raportimit do të ndihmojë në krijimin apo përmirësimin e të dhënave të sigurta statistikore, të cilat u mundësojnë akterëve, duke përfshirë edhe autoritetet e vendit nikoqir, të përcaktojnë përmasën e shtrirjes së problemit, të gjitha ndryshimet në rrethinë, të cilat mund të ndikojnë në uljen e dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, dhe të tregojnë për ndikimin e mbrojtës të intervenimeve. Formulari i përbashkët i raportimit do të lehtësojë përcjelljen dhe koordinimin dhe, çka është më e rëndësishme, do të mundësojë që viktima/mbijetuari/a të mos intervistohet disa herë. Për sistemin e raportimit/përcjelljes duhet shikuar Kapitulli 4 i këtij libri, ndërsa në Kapitullin 7 parqiten udhëzimet për mënyrën e zhvillimit të sistemit të përbashkët të raportimit.

Ruajtja e fshehtësisë në të gjitha stadet e këmbimit dhe analizës së informatave.

Koordinimi përfshinë, ndër të tjera, edhe këto aktivitete:

Krijimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të metodave të raportimit dhe përcjelljes në mes të akterëve të ndryshëm. Rrjetet për përcjellje duhet të përqëndrohen në dhënien e shërbimeve të shpejta dhe të përshtatshme viktimave/të mbijetuarëve.

Këmbimin e informatave të shkruara në mes të akterëve, por me respektimin e parimit të besueshmërisë.

Konvokimin e mbledhjeve të rregullta të akterëve kyç:

- Mbledhjeve mujore, në nivelin e kampeve, për të diskutuar mbi informatat që ndërlidhen konkretisht me atë kamp, për të dhënat dhe aktivitetet.
- Mbledhjeve mujore regjionale (p.sh. në nivel të zyrës fushore, nënzyrës dhe në nivelin e rrethit) për të diskutuar dhe rishqyrtuar informatat, të dhënat dhe aktivitetet në atë regjion.
- Mbledhjeve periodike (tremujore) në nivel të vendit, për të diskutuar dhe rishikuar informatat, të dhënat dhe aktivitetet në tërë territorin e vendit.

Pjesëmarrësit në mbledhjet koordinuese, duhet të:

- Këmbejnë informata përbrenda dhe në mes të sektoreve, organizatave dhe bashkësive të refugjatëve.
- Identifikojnë zbrazësitë në shërbimet dhe strategjitë për përparimin dhe përmirësimin e aktiviteteve në rrjedhë; vëzhgojnë zbatimin e strategjive të identifikuara.
- Kërkojnë këshilla dhe ndihmë nga kolegët; të ofrojnë në këmbim informata konstruktive, ide për zgjidhjen e problemit, si dhe diskutime e udhëzime të zgjeruara, pas rasteve posaçërisht të ndërlikuara apo të rënda.

- Arrijnë pajtueshmëri për rolin dhe detyrat e të gjithë atyre që janë të inkuadruar në planifikim, zbatim dhe mbikqyrje të aktiviteteve për parandalim dhe reagim.
- Planifikojnë dhe caktojnë programin e aktiviteteve për stërvitjen e personelit, edukimin e bashkësisë si dhe vetëdijësimin.
- Ndërtojnë zotërim të përbashkët të programit për dhunën seksuale dhe ato të bazuar në gjini dhe partneritetet efikase në mes të të gjithë akterëve të përfshirë.
- Pregatisin plane të përbashkëta të stërvitjes.

“Agjencioni kryesor” i emruar, ka për detyrë të nxisi pjesëmarrjen dhe koordinimin, si dhe të caktojë dhe mbajë mbledhjet.

Ruajtja e mirëqenies së personelit dhe vullnetarëve

Personeli dhe vullnetarët, të cilët punojnë në programe për dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar në gjini, posaçërisht ata të cilët punojnë si këshilltarë dhe përfaqësues të viktimave/të mbijetuarëve, duhet të jenë të vetdijshëm për dy rreziqe të mirëqenies së vet: njëri është mungesa e sigurisë, ndërsa tjetri – efektet potencialisht të dëmshëm të “traumës sekundare”, si dhe stërlodhja.

Mbrojtja dhe siguria

Pas marrjes së lajmit për dhunën seksuale dhe ato të bazuar në gjini, dhe tentimit për të ndihmuar viktimën/të mbijetuarën, secili i nënshtrohet rrezikut të hakmarrjes nga keqbërësit, e ndonjëherë edhe hakmarrjes nga ana e bashkësisë. Dhuna seksuale dhe ajo e bazuar në gjini është potencialisht vdekjepruese për viktimën/të mbijetuarën. Secili që ndien dhe konsideron se e ndihmon viktimën/të mbijetuarën mundet, poashtu, të bëhet edhe vetë cak i dhunës.

Përvoja e shënuar në tërë botën tregon se disa nga keqbërësit vertetë i sulmojnë ata që i ndihmojnë viktimat/të mbijetuarit dhe u bëjnë dëm atyre. Kjo posaçërisht vlen për rastet e dhunës në familje, kur këshilltari apo ndonjë anëtar tjetër i personelit, apo vullnetar e përfaqëson pranë policisë në emër të viktimës/të mbijetuarës. Është treguar se në të shumën e rasteve keqbërës është bashkëshorti apo partneri intim i viktimës/të mbijetuarës. Në shumë vende janë shënuar raste kur pjesëtarët e armatosur të policisë janë lënduar apo vrarë, kur kanë reaguar pas raportimit të dhunës në familje.

Udhëheqësit dhe mbikqyrësit duhet të vëzhgojnë dhe përcjellin sigurinë e personelit dhe menjëherë të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e tyre në rastet e kërcënimit, rrezikut, apo aktit të dhunës. Të gjitha rastet e tilla të kërcënimit, ndaj personelit, duhet menjëherë raportuar në UNHCR për mbrojtje, dhe të aplikohen menjëherë masat e përshtatëshme mbrojtëse. Organizatat duhet të vendosin politika dhe praktika me qëllim të zvogëlimin të rrezikut ndaj personelit/vullnetarëve dhe ngrisin në maksimum mbrojtjen dhe sigurinë.

- Vendosni politikën ku vetëm personeli vendas apo ai ndërkomëtar (të cilët nuk jetojnë në kamp), por jo personeli refugjatë, duhet të vendosen pranë/me policinë dhe forcat e tjera mbrojtëse, në emër të secilës viktimë/të mbijetuar individualisht.
- Angazhoni në aktivitetet tuaja udhëheqësit e refugjatëve dhe ata me ndikim në bashkësi. Nëse e tërë bashkësia është e inkuadruar në program, do t’i kuptojnë më mirë shërbimet, brengat dhe rreziqet, dhe do të jetë në gjendje që më mirë të ndihmojë në krijimin e strategjive për parandalim dhe për mbrojtje.
- Angazhoni trupat për zbatimin e ligjit dhe organet gjyqësore në projektimin dhe implementimin e planit për mbrojtje dhe siguri.

Trauma sekundare dhe rraskapitja

Trauma sekundare nënkupton stresin emocional që e përjetojnë ata që vazhdimisht i ekspozohen përshkrimeve të keqtrajtimit të rënda fizike dhe psikike. *Rraskapitja* është stërlodhje emocionale. Edhe trauma sekundare edhe rraskapitja janë shfaqje të shpeshta dhe të zakonshme në mesin a atyre që punojnë në programet për dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar në gjini.

Në mesin e simptomave të traumës sekundare dhe rraskapitjes, bëjnë pjesë:

- Problemet me gjumë dhe oreks.
- Plogështi fizike të pashpjegueshme dhe probleme shëndetësore.
- Reagime emocionale përplot ngarkesë ndaj situatave dhe frustracioneve, apo reagimi joemotiv dhe i “zbrazët” ndaj situatave dhe frustracioneve.
- Problemet me funksionimin praktik në vendin e punës.
- Tërheqja nga kolegët, familja, shoqëria, aktivitetet e ndryshme shoqërore.
- Komentet dhe sjelljet që tregojnë se personi e konsideron veten si të domosdoshëm/e dhe të pazëvendësueshëm/e në punë me viktimat/të mbijetuarat; identifikim me viktimat/të mbijetuarat, ndonjëherë i quajtur “kompleksi i heroizmit”.
- Vendosja e vetëvetes në rrezik fizik, për të ndihmuar viktimën/të mbijetuarën, në vend se të kërkohet ndihma dhe përkrahja.

Parandalimi është mënyra më e mirë e zgjidhjes së problemit të rraskapitjes së personelit. Në mesin e strategjive që duhet aplikuar në të gjitha programet, bëjnë pjesë:

- Diskutimet dhe sqarimet, posaçërisht pas rasteve serioze dhe tepër shqetësuese.
- Mundësitë e shkarkimit nga tendosja, sikurse janë ushtrimet fizike, aktivitetet për ndërtimin e ekipit, këmbimi joformal i përvojave dhe përshtypjeve për gëzimet dhe frustrimet që i sjellë puna e tillë.
- "Punëtoritë" e stërvitjes për përmirësimin e aftësive, krijimin e besueshmërisë dhe zgjerimin e kufinjëve profesionistë.
- Mbikqyrja dhe përcjellja e rregullt e punës së punëtorit/res, sigurimi i përkrahjes, vlerësimi i gjendjes emocionale të tij/saj.
- Marrja e pushimit/prehjes nga puna.
- Këshillimi me qëllim të shkarkimit nga stresi nga kolegu i nivelit të njejt.

PIKAT KYÇE

Për përpilimin e planit veprues:

- Identifikoni dhe angazhoni akterët.
- Zhvilloni një nocion me kuptim të përbashkët të dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini dhe pajtohuni për fushëveprim.
- Bëni analizën e situatës: mblidhni informatat në mënyrë që të kuptoni nevojat, problemet, shërbimet në dispozicion, si dhe përparësitë dhe mangësitë e bashkësisë së refugjatëve.
- Pajtohuni për tërësinë e parimeve udhëzuese.
- Definoni rolin dhe detyrat e të gjithë akterëve.
- Përcaktoni synimet dhe qëllimet; definoni rezultatet dhe treguesit; identifikoni resurset e domosdoshme.
- Pajtohuni për sistemin e mbikqyrjes dhe vlerësimit, të cilët përfshijnë bashkesinë.
- Ndërtoni mekanizmat për përcjellje dhe koordinim.
- Projektoni planin për ruajtjen e mirëqenies së personelit dhe të vullnetarëve.

KAPITULLI 7 MBIKQYRJA DHE VLERËSIMI

Mekanizmat për mbikqyrje dhe vlerësim janë të rëndësishë thelbësore për zhvillimin e programeve efikase për parandalimin e dhunës dhe reagimin ndaj dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini. Ata ngrisin përgjegjësinë, një nga udhëzimet parimore i përshkruar në Kapitullin 2, dhe janë pjesë e kornizës për veprim të përshkruar në Kapitullin 6. Këta mekanizma janë më të dobishëm kur i zhvillojnë të gjithë sektorët, përfshirë edhe bashkësinë e refugjatëve, me angazhim të përbashkët.

Gjatë zhvillimit të sistemit për mbikqyrje dhe vlerësim anëtarët e ekipit multisektoral duhet të ndërmarrin këto gjashtë veprime: përcaktimi i qëllimit të mekanizmave për mbikqyrje dhe vlerësim, dhe caktimi i informatave të nevojshme; sigurimi se intervenimet për parandalim dhe reagim i kanë të definuara qartë qëllimet, rezultatet dhe treguesit; krijimi i mënyrave të koordinuara dhe të përbashkëta të raportimit; përcaktimi i metodave të mbledhjes së informatave për treguesit; ndarja e përgjegjësisë dhe detyrave për mbledhjen e informatave, caktimi i afatit dhe shpeshësisë së mbledhjes së informatave, dhe vendosja e resurseve; formimi i mekanizmave për këmbim të informatave dhe përfshirja e rezultateve në planifikimin e parandalimit dhe reagimit.

DEFINIMI I MBIKQYRJES DHE VLERËESIMIT

Mbikqyrja dhe vlerësimi janë dy veprime qartë të ndara, por të lidhura mes vete.

Mbikqyrja është veprim, që e zbaton ekipi multisektoral, i shqyrtimit të vazhdueshëm të intervenimeve për parandalim dhe reagim për të përcaktuar, nëse ato zbatohen në përputhje me planin dhe kërkesat financiare, si dhe mos ndoshta paraqitet nevoja për ndonjë përshtatje për të arritur qëllimet e përcaktuara. Mbikqyrja efektive nëkupton një sistem të koordinuar të raportimit.

Vlerësimi është analizë e relevancës/lidhjes, efektshmërisë dhe efikasitetit të strategjive të ekipit multisektoral në parandalim dhe reagim. Vlerësimi, në mënyrë sistematike, përcakton ndikimin mbrojtës të politikave, programeve, praktikave, partneriteteve dhe procedurave, që kanë tek refugjatët femra, meshkuj, djem dhe vajza. Kriteret e vlerësimit mund të përfshijnë edhe qëndrueshmërinë e aktiviteteve të parandalimit dhe reagimit, koordinimin dhe konsistencën, si dhe efektshmërinë e sistemit të kontrollit dhe raportimit.

QËLLIMET E MEKANIZMAVE TË MBIKQYRJES DHE TË VLERËSIMIT

Mekanizmat gjithpërfshirëse të mbikqyrjes dhe vlerësimit:

- Ndhimjnë akterët të caktojnë ndikimin mbrojtës të aktiviteteve për parandalim dhe reagim.
- Përcaktojnë kualitetin e intervenimeve për parandalim dhe reagim dhe tregojnë nëse ata janë duke i aritur qëllimet e përcaktuara.
- Mund të nxjerrin në pah ndryshimet në mjedisin rajonal, të cilat ndikojnë në shkallën e dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini.
- Identifikojnë praktikrat e mira, nxjerrin mësim nga përvojat operative dhe mund të ndihmojnë në përmirësimin dhe përparimin e funksionimit dhe punës efikase.
- Mund të nxisin ndërtimin e ekipit, t'i kontribuojnë transparencës dhe të ngrisin përgjegjësinë ndaj refugjatëve femra, meshkuj dhe të rinj, dhe ndaj donatorëve.

Mbikqyrja efikase iu përgjigjet pyetjeve:

- A jemi duke arritur atë për çka jemi përcaktuar? Si? Për çfarë arsye, apo përse jo?
- Cilat janë barrierat që e pengojnë zbatimin?
- A kemi koordinim të mirëfillt dhe efikas?
- Cilat janë zbrazësitë për zbatim? Si do t'iu qasemi?

Vlerësimi efikas iu jep përgjigje këtyre pyetjeve:

- Çfarë kemi bërë?
- Çka kemi realizuar?
- A e kemi arritë atë që e kemi menduar?
- Çka kemi mësuar, cilat mësim i kemi nxjerrë?
- A i kemi nxjerrë në pah plotësisht pasojat e dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini? Nëse jo, cilat janë zbrastirat?
- Për çfarë tjetër kemi pasë nevojë?

TIPET E MEKANIZMAVE PËR MBIKQYRJE DHE VLERËSIM

Mbikqyrja dhe vlerësimi mund të dallojnë për nga përfshirja, intenziteti dhe fokusi. Ato mund të aplikohen në politikë, ndonjë funksion, ndonjë program, në praktika (sikurse janë raportimi, përcjellja, planifikimi apo praktikatat buxhetore) apo në ndonjë intervenim tjetër specifik.

Mekanizmat për mbikqyrje dhe vlerësim, vlejné për të gjitha nivelet e intervenimeve për parandalim dhe reagim, përfshirë edhe ato që i qasen individit, bashkësisë apo strukturave shoqërore/juridike/politike. Mbikqyrja dhe vlerësimi mundën, poashtu, të aplikohen në sektore, gjegjësisht në tërësinë e mekanizmave të aktiviteteve për parandalim dhe reagim, në lëmin e shëndetsisë, nevojave psiko-sociale, sigurisë/mbrojtjes dhe ligjësisë/jurisprudencës.

Mbikqyrja dhe vlerësimi mund të aplikohen në çdo stad të operimit. Mbikqyrja është më efikase, atëherë kur zbatohet në afat të gjatë, të pandërprerë; vlerësimet e programeve është më mirë të bëhen në baza vjetore. Vlerësimet e bëra në periudhën e herëshëm të një operacioni, mund të ofrojnë informata për analizën e situatës. Mbikqyrja, e cila zbatohet gjatë tërë rrjedhës së operacionit, mundëson që udhëheqësit dhe drejtuesit të kujdesen dhe të sigurojnë se, veprimet për të cilat ekziston pajtueshmëri, të përsosen dhe të zbatohen sipas planit. Vlerësimet e bëra në fund të operacionit, ndihmojnë në përcaktimin se çfarë është realizuar dhe të identifikohen praktikatat e mira.

Shiko poashtu:

Evaluimet humanitare në kohën reale: disa pyetje dhe përgjigje (UNHCR, 2002)

PROJEKTIMI I SISTEMIT TË MBIKQYRJES DHE VLERËSIMIT PËR PROGRAMET QË KANË NË SHENJESTËR DHUNËN SEKSUALE DHUNËN E BAZUAR NE GJINI

Sikurse sygjeronjë Direktivat parimore të paraqitura në Kapitullin 2, është me rëndësi të inkurajohet pjesëmarrja dhe kontributi i gjerë në projektimin e sistemeve për mbikqyrje dhe vlerësim. Një qasje multisektorale, përfshirë këtu edhe kontributi nga ana e bashkësisë së refugjatëve, e nxitë dhe e përmirëson mësimin, ndërton ndjenjën e pronësisë dhe promovon transparencën në mes akterëve pjesëmarrës. Kjo është posaçërisht me rëndësi, kur diskutohet për qëllimin e mbikqyrjes dhe vlerësimit dhe për atë se si do të shfrytëzohen informacionet, analizohen, dhe si do të ndikojnë në planifikimin e mëtejshëm.

Akterët duhet të kuptojnë dhe pranojnë faktin se disa grupe ballafaqohen me pengesa për pjesëmarrje në këtë proces. Për shembull, femrave dhe fëmijëve refugjatë, shpesh herë iu mungon autoriteti që t'i shprehin mendimet e veta në rrethin ku jetojnë. Mund të ndërmerren disa masa të posaçme për të siguruar që të rinjtë, në mesin e refugjatëve, e posaçërisht grupet e rrezikuara (shih Kapitullin 5), të jenë të përfshirë në projektimin e këtyre sistemeve. Analiza e situatës, e cila rekomandohet në Kapitullin 2, do t'i vejë në pah dhe do t'i qartësojë disa nga këto çështje. Pasi që të gjithë akterët të jenë të njoftuar me këto pengesa dhe vështirësi, ata të mund të punojnë bashkarisht për t'i tejkaluar ato.

Janë gjithsejt gjashtë veprimtari, të cilat do ta përcaktonin mënyrën e zhvillimit të sistemit të mbikqyrjes dhe vlerësimit:

1. Përcaktimi i qëllimeve të mekanizmave të mbikqyrjes dhe vlerësimit dhe vlerësimi i nevojave informative.
2. Përkujdesja dhe sigurimi se, intervenimet për parandalim dhe reagim, i kanë qartë të definuara detyrat, qëllimet, rezultatet dhe treguesit.
3. Krijimi i mjeteve të përbashkëta dhe të koordinuara të raportimit.
4. Përcaktimi i metodave për grumbullimin e informacioneve për treguesit.
5. Caktimi i detyrave dhe përgjegjësive për grumbullimin e informacioneve, caktimi i afatit dhe grumbullimin e shpeshtuar të dhënave dhe shpërndarjen e resurseve.
6. Krijimi i mekanizmave për këmbimin e informatave dhe përfshirjen e rezultateve në planifikimin për parandalim dhe reagim.

Shiko poashtu:

Planifikimi dhe organizimi i vlerësimeve të dobishme (UNHCR 1998)

VEPRIMI nr. 1:

Përcaktimi i qëllimeve të mekanizmave të mbikqyrjes dhe vlerësimit, si dhe vlerësimi i nevojave informative

Ekipi shumësektorial duhet të diskutojë për qëllimet e sistemit të mbikqyrjes dhe vlerësimit, duke arritur pajtueshmëri për to. Me këtë do të përcaktohet se çfarë sisteme të raportimit janë të nevojshëm, sa shpesh shfrytëzohen këta mekanizma, dhe si do të ndikojnë ata në planifikimin e përhershëm për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale.

Për t'i kontribuar zhvillimit të konsensusit për qëllimet e mekanizmave për mbikqyrje dhe vlerësim, mund të ishte e dobishme të përcaktohen nevojat informative për secilin akter/sector. Ky vlerësim i nevojave informative mund të bëhet në formë të matrisit dhe të organizohet në pajtueshmëri me sektorët apo me akterët e përfshirë.

Shembull:

Akterët e ekipit shumësektorial	<ul style="list-style-type: none"> • Nevojat informative
Grupi përfitues/Popullata në shënjestër	<ul style="list-style-type: none"> • Ndikimi në mirëqenie • Problemet në qasjen/shfrytëzimin e shërbimeve • Zotësia për pjesëmarrje dhe ndikim në vendimarrje
Personeli në terren	<ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e aktiviteteve • Problemet që ndikojnë në aktivitete apo në funksionimin e mirë të grupit • Përparimet sipas planit për veprim • Vlerësimi i faktorëve të rrezikut për paraqitjen e shunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini
Koordinatorët / Supervizorët	<ul style="list-style-type: none"> • Çfarë janë rezultatet? • Cilët janë problemet, me të cilat është ballafaquar personeli në terren? • Cilat janë përparimet, krahasuar me planin e punës? • Funksionimi i mirëfillt i personelit në terren
Udhëheqja me projektin	<ul style="list-style-type: none"> • Efektshmëria dhe efikasiteti i strategjive • A janë realizuar rezultatet e pritura? • Efektet pozitive dhe negative tek meshkujt dhe femrat • Përparimet dhe rezultatet e implementimit • Faktorët e jashtëm që ndikojnë në funksionimin e mirëfillt • Dobësitë e brendshme që ndikojnë në rezultate • Shfrytëzimi efikas dhe frytdhënës i resurseve
Agjencionet për financim/organizatat partnere	<ul style="list-style-type: none"> • Masa deri te e cila janë arritë qëllimet/synimet e përcaktuara • Strategjitë e projektit • Faktorët e jashtëm që ndikojnë në mbarëvajtjen e projektit • Qëndrueshmëria e rezultateve të projektit në nivelin e grupit në shënjestër dhe në nivelin institucional

VEPRIMI nr. 2:

Përkujdesja dhe sigurimi se intervenimet për parandalim dhe reagim i kanë qartë të definuara detyrat, qëllimet, rezultatet dhe treguesit

Secili intervenim duhet t'i ketë qartë të definuara qëllimet, të cilat duhet të jenë të operacionalizuara përmes treguesve të rezultateve, ndikimit dhe funksionimit të mirë. Këto qëllime, rezultate dhe tregues ofrojnë një mënyrë sistematike për përshkrimin e dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini. Treguesit poashtu sugjerojnë se cilat të dhëna duhet të mblidhen, si dhe cilët mekanizma raportues janë të nevojshëm.

Pët të përcaktuar qëllimet:

Qëllimet duhet t'i refrohen rezultatit të dëshiruar si dhe ndikimit mbrojtës të secilit intervenim të programit, që i kontribuon realizimit të qëllimit të programit.

Shembull: Një analizë e situatës tregon se ushqimi nuk po shpërndahet drejt dhe barabart. Disa grupe nuk pranojnë resurse të përshatëshme dhe kjo ka shtuar rrezikun nga dhuna seksuale dhe dhuna e bazuar në gjini, dhe nga shfrytëzimi/eksploatimi seksual.

Qëllimi i përcaktuar do të ishte që të bëhet rishikimi i proceseve aktuale të shpërndarjes së ushqimit, me qëllim që të zvogëlohet rreziku nga dhuna seksuale dhe ajo e bazuar në gjini, dhe të sigurohet barazi më e madhe në mes të gjinive.

Vërejtje: Qëllimet duhet të përpilohen në kuptim të ndërrimeve pozitive, që do të arrihen në kushtet e popullatës refugjate. Detyrat mund të përcaktohen drejt koordinimit më të mirë, mekanizmat për reagim të përmirësuar, infomimi më i mirë për bashkësinë në fjalë, apo raporte më të mira të bashkëpunimit për barazinë gjinore me meshkujt.

Për të përcaktuar rezultatet përfundimtare:

Rezultatet janë të arriturat specifike dhe konkrete. Për të ndihmuar identifikimin e rezultateve të dëshirueshme, duhet përshkruar se çka duhet bërë patjetër, për të realizuar qëllimet e përcaktuara.

Shembull: Nëse qëllimi i përcaktuar është shtimi i numrit të përfaqësimit të femrave në këshillat për shpërndarjen e ushqimit, njëri nga rezultatet ndoshta do të ishte rishikimi dhe ndërrimi i kushtev dhe mënyrës së përbërjes së këshillave për shpërndarjen e ushqimit, në mënyrë që të sigurohet përfaqësimi i femrave.

Për të përcaktuar treguesit e funksionimit praktik dhe të ndikimit:

Treguesit janë mjete matëse që ndihmojnë gjatë definimit të asaj që do të vlerësohet apo mbikqyret, si dhe gjatë shënimit të të arriturave. Për vlerësimin e ndikimit mbrojtës të intervenimeve për parandalim dhe reagim, janë të nevojshëm edhe treguesit **kuantitativë** dhe ata **kualitativë**. Treguesit kuantitativë janë ata të cilët mbikqyren lehtë gjatë kohës dhe përmes raportimit. Treguesit kualitativë ndihmojnë për nxjerrjen në pah të praktikave të mira, të përshkrimit të vështirësive që i hasim, dhe të identifikimit të zbrastirave në masat e parandalimit dhe reagimit.

UNHCR punon me dy tipe të treguesve. Fjala është për treguesit e ndikimit dhe ata të funksionimit praktik.

Treguesit e ndikimit shfrytëzohen për të ndihmuar në matjen e ndryshimeve në mirëqenie dhe në mënyrën e sjelljes, si dhe ndryshimeve në sisteme dhe në institucione. Treguesit e ndikimit më shpesh janë kualitativë, sepse masin ndryshimet e menduara në gjykimet/opinionet e njerëzve dhe perceptimeve të tyre, në lidhje me ndonjë çështje. Treguesit e ndikimit janë të lidhur me qëllimet e përcaktuara.

Shembull: Nëse qëllimi i përcaktuar është shtimi pjesëmarrjes së femrave në këshillat për shpërndarjen e ushqimit, njëri nga treguesit e ndikimit do të ishte se femrat në ata këshilla kanë ndjenjën se ofrojnë kontribut kuptimplotë drejt procesit të vendimarrjes.

Treguesit e funksionimit praktik zakonisht janë tregues kuantitativë. Treguesit e funksionimit praktik ndërliken me rezultatet përfundimtare.

Shembull: Nëse rezultati përfundimtar është rishikimi dhe ndërrimi i mënyrës së përbërjes së këshillit për shpërndarjen e ushqimit, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e femrave, treguesi i funksionimit praktik do të ishte , për shembull, që pjesëmarrja e femrave në këta këshilla të ngritet nga 30 në 50 për qind.

Të gjithë treguesit duhet të përpunohen sipas moshës dhe gjinisë. Kurdo që është e mundëshme, treguesit duhet të specifikojnë edhe aspektet e tjera të popullatës në shënjestër, duke përfshirë grupin etnik, lokacionin (zonat urbane apo rurale, kampet), apo sipas grupeve të rrezikuara.

Shiko poashtu:

Planifikimi i projekteve në UNHCR: Udhërrëfyes praktik për përdorimin e qëllimeve, rezultateve dhe treguesve (UNHCR, 2002)

VEPRIMI nr. 3:

Krijimi i mjeteve të përbashkëta dhe të koordinuara të raportimit

Mjetet për raportim ofrojnë mënyra sistematike dhe të vazhdueshme për mbledhjen e informatave mbi treguesit e lartpërmendur. Është me rëndësi të zhvillohen mjetet e raportimit, që janë të përbashkëta për të gjitha organizatat përbrenda sektorit (për shembull, të gjithë ofruesit e mbrojtjes shëndetsore do të duhej të mblidhin të njëjtin tog të informatave minimale).

Ekipi multisektorial duhet të fillojë nga identifikimi i të gjitha sistemeve aktuale të raportimit, ruajtjes së të dhënave/inçizimeve, listave përmbledhëse të të dhënave, dhe sistemeve për mbikqyrje dhe vlerësim, të cilët i shfrytëzojnë akterët e ndryshëm dhe të cilët përdoren në secilin sektor.

Gjatë shqyrtimit të mjeteve ekzistuese të raportimit, sikurse janë raportet mujore për mbrojtjen shëndetësore, nga ana e organizatave joqeveritare/shërbimeve adekuate në bshkësinë përkatëse të/UNHCR-së, raportet nga terreni, raportet vjetore për mbrojtjen dhe planet për veprim të vendit të dhënë, ekipi duhet ta vlerësojë situatën fillestare të raportimit, si dhe cilat ndryshime janë të nevojshme për të përfshirë informatat mbi aktivitetet e parandalimit dhe reagimit ndaj dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini. Është me rëndësi që këto raporte të ndryshme të flasin për përparimet që janë bërë, sfidat dhe problemet që mbesin ende, dhe mekanizmat e mbikqyrjes dhe vlerësimit që aktualisht aplikohen.

Të gjitha mjetet e raportimit që shqyrtojnë ndikimin mbrojtës të mekanizmave për parandalim dhe reagim, duhet të jenë të ndieshëm ndaj çështjeve të gjinive dhe moshës. Kjo do të thotë identifikimi i ndikimeve të ndryshme në intervenimet tek refugjatët, që janë gra, vajza, burra dhe djem.

SHEMBUJ TË FORMULARËVE PËR RAPORTIM

Formulari për Raportim të rastit të dhunës seksuale dhe formulari i raportimit Mujor për dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar në gjini

Formulari për Raportim të rastit të dhunës seksuale është mjet i rëndësishëm i raportimit, të cilin duhet ta shfrytëzojnë të gjithë akterët. Kur cilido akter/bartës i këtyre aktiviteteve hasë në një rast të dhunës seksuale, apo një rast të dhunës së bazuar në gjini, duhet të ketë një formular standard, të cilin e shfrytëzojnë për shënimin e rasteve të tilla. Mjet tjetër i raportimit është edhe **formulari i raportimit Mujor për dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar në gjini**. Ky mekanizëm i raportimit është i rëndësishëm për zbulimin dhe përcjelljen e ndryshimeve në atë rajon që ndikojnë në ndodhjen e rasteve të dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini. Raporti i tillë poashtu ofron një pasqyrë për faktorët, të cilët mund t'ia zgjasin jetën rasteve të këtilla të dhunës, në nivel të bashkësisë. Kur është fjala për formularin e raportimit mujor, duhet marrë parasysh se të dhënat duhet të mbidhen për secilin kamp veç e veç, përkatësisht për secilin vendbanim. Poashtu, janë të dobishme edhe të dhënat e mbledhura nga zyra fushore, regjionale apo ajo qendrore, për tërë vendbanimin. Shembuj të formularëve të tillë gjinden në Shtojcën 2 dhe Shtojcën 3.

Elementet e të dhënave të raporteve për dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar në gjini
Eshtë e rëndësishë thelbësorë që për raportim të mbidhen informatat e caktuara. Për të arritë mbarëvajtjen, të gjithë akterët duet të pajtohen për terminologjinë që shfrytëzohet, në mënyrë që formularët e raportimit të mund të kahashohen. Të gjithë mekanizmat e raportimit duhet të sigurojnë besueshmëri në relacion me viktimën/të mbijetuarën dhe në raport me keqbërësin.
Elementet e të dhënave për formularët e raportimit Mujor:
<ul style="list-style-type: none"> • Numri i përgjithshëm i rasteve të paraqitura • Llojet e dhunës së shkaktuar seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore • Numri, moshë dhe gjinia e viktimave/të mbijetuarave • Numri i rasteve sipas lokacionit (psh. shtëpi, treg, jashtë kampit – me shënim se ku saktësisht jashtë kampit) • Numri i rasteve të dhunimit që kanë marrë ndihmë mjeksore, gjatë periudhës kohore prej dy ditësh, pasi që ka ndodhë rasti
Elementet e të dhënave për formularin Juridik:
<ul style="list-style-type: none"> • Numri i rasteve për të cilat është informuar nëpunësi për mbrojtje • Numri i rasteve të paraqitura në polici • Numri i rasteve që kanë dalë para gjyqit • Numri i rasteve që nuk janë marrë në shqyrtim • Numri i të liruarëve/të dënuarëve • Llojet e dhunës së shkaktuar seksuale dhe asaj të bazuar në gjini • Numri i rasteve të dhunimeve, të cilat në afat prej dy ditësh, nga momenti i ndodhjes së aktit, janë gjendur nën përkujdesin shëndetsor • Numri i rasteve ku janë përgatitur dëshmitë mjeksore-ligjore • Përqindja mujore e ngritjes/rënies së numrit të rasteve të dhunimit • Përqindja mujore e ngritjes/rënies së numrit të rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini • Vrojtme të tjera
Elementet e të dhënave për raportet e situatës:
<ul style="list-style-type: none"> • Problemet, çështjet dhe incidentet që ndërliqhen me dhunën seksuale dhe dhunën mbi baza gjinore • Gjendja e koordinimit dhe planifikimit • Intervenimet për parandalim, nëpër sektore • Intervenimet për reagim, nëpër sektore • Aftësimi dhe formimi i kapaciteteve të personelit/përfituesve • Ndikimi i mbrojtjes: aktivitetet për mbikqyrje dhe vlerësim
Në Shtojcën nr. 4 të shikohet shembulli i formularit të Historikut mjeksor dhe Pyetsori për hulumtimin e rastit

Shkalla e raportimit të dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini
Shkalla e raportimit të dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini, paraqet numrin e të gjitha raporteve mbi ndodhjet e dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, që janë përgatitë në çfarëdo periudhe të dhënë, në krahasim me popullsinë e përgjithshme. Për ta llogaritur shkallën e raportimit për 10,000 persona gjatë një muaji, viti apo ndonjë periudhe tjetër të dhënë, aplikohet formula në vijim:
Numri i rasteve të paraqitura gjatë periudhës së dhënë <hr style="width: 50%; margin: auto;"/>

Popullata e përgjithshme gjatë periudhës së përcaktuar

X 10.000 = raportet e rasteve për 10,000 persona gjatë periudhës kohore

Krahasimi i shkallës së raportimit gjatë një periudhe kohore i mundëson ekipit t'i identifikojë trendet. Për shumicën e lokacioneve pritet që shkalla e raportimit të rritet me kalimin e kohës. Rritja e shkallës së raportimit mund të jetë tregues se viktimat/të mbijetuarat janë të vetëdijshme për mundësinë e shfrytëzimit të ndihmës dhe se ato kanë besim në shërbimet, prandaj edhe janë të gatshme ta bëjnë paraqitjen e rasteve. Me rëndësi është të mbahet në mend se rastet e dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini, në masë të madhe mbeten të pa paraqitura. Për këtë arsye, rritja e numrit të paraqitjeve, në të vërtetë të shkallës së raportimit, mund të konsiderohet si sukses i programit.

VEPRIMI nr. 4:

Përcaktimi i metodave për mbledhjen e informatave për treguesit.

Pas krijimit të mekanizmave për raportim, mund të fillohet me identifikimin e metodave të cilat do të shfrytëzohen për mbledhjen e informatave mbi treguesit që janë paraparë në formularin për raportim. Gjatë përcaktimit të këtyre metodave, është me rëndësi të shikohet nëse treguesi i dhënë është i natyrës kualitative apo kuantitative.

Të dhënat kuantitative mund të merren përmes anketave dhe të dhënave të qeverisë/ partnerëve implementues. Informatat, poashtu, mund të nxirren përmes krahasimit të shifrave statistikore në lidhje me popullatën në shënjestër. Është me rëndësi të vlerësohet se cilat burime të informatave të akterëve të ndryshëm janë në dispozicion të ekipit multisektorial.

Të dhënat kualitative mund të mblidhen përmes intervistave, fokus grupeve, si dhe përmes shfrytëzimit të metodave të pjesëmarrjes gjatë vlerësimit të situatës dhe hulumtimit në terren.

Pikëpamjet dhe qëndrimet e grave, djemve dhe vajzave refugjate, duhet të shqyrtohen me mekanizma për mbikqyrje dhe vlerësim. Këto informata kualitative janë të rëndësishme për identifikimin e zbrastirave në mbrojtje dhe për përmirësimin e mekanizmave për parandalim dhe reagim.

VEPRIMI nr. 5:

Caktimi i detyrave dhe përgjegjësive për mbledhjen e informatave, caktimi i afatit dhe i grumbullimit të shpeshtuar të dhënave dhe shpërndarja e resurseve.

Ndarja e detyrave:

Është me rëndësi të bëhet ndarja e detyrave për pjesët e ndryshme të sistemit të mbikqyrjes dhe të vlerësimit.

Afatet kohore:

Duhet të caktohet afati kohor për të gjitha mjetet e raportimit. Afatet kohore duhet të zhvillohen edhe për mekanizmat e tjerë për mbikqyrje dhe vlerësim. Ekipi duhet të caktojë afate kohore që i përshtaten intervenimit dhe programit. Mbikqyrja mund të bëhet çdo muaj, duke përdorur formularin për raportim Mujor mbi dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar në gjini; raportet gjithëpërfshirës mund të përpilohen mbi baza vjetore.

Përcaktimi i resurseve dhe buxhetit:

Ndodhë që planet operationale dhe burimet financiare të mos ndajnë resurse të mjaftueshme për zhvillimin dhe implementimin e mekanizmave për mbikqyrje dhe vlerësim. Prandaj, është me rëndësi të dihet se sa kohë iu nevojitet personave që e bëjnë raportin për të mbajtur azhuritetin e raportimit dhe për t'i bërë analizat e nevojshme. Poashtu, duhet marrë parasysh kapacitetet njerëzore në atë lëmi dhe shqyrtimin e nevojave për stërvitje plotësuese për zhvillimin e aftësive të mbikqyrjes dhe vlerësimit (për shembull – aftësitë për mbledhjen dhe analizën e të dhënave, implementimin e procesit për mbikqyrje dhe vlerësim në terren, dhe zbatimin e evaluimit të kontributeve).

Për vlerësimin e pjesëmarrjeve, të bazuara në nivel të bashkësisë, mund të tregohet nevoja për huazimin e personelit shtesë më profesional, dhe shqyrtimin e kërkesave të bashkësisë që bashkësisë t'i mundësohet qasje në sesionet, gjatë të cilave bëhet vlerësimi. Në kërkesa të tilla, mund të përfshihen përkthyesit, transporti dhe shërbimi për ruajtjen e fëmijëve. Udhëzimet për vlerësimet e bazuara në nivel të bashkësisë, mund të mirren në Njësitin për vlerësim dhe politikë të UNHCR-së.

VEPRIMI nr. 6:

Krijimi i mekanizmave për këmbimin e informatave dhe përfshirjen e rezultateve në planifikimin për parandalim dhe reagim.

Një nga qëllimet e mekanizmit për mbikqyrje dhe vlerësim është përmirësimi i funksionimit praktik. Për të realizuar këtë qëllim, është e nevojshme të arrihet pajtueshmëria se si do të këmben dhe përcillen informatat në mes të akterëve. Poashtu, është me rëndësi të dihet dhe të vendoset se cilët akterë janë të ngarkuar për mbikqyrje, dhe në çfarë mënyre rezultatet e cilit do mekanizëm për mbikqyrje apo vlerësim, do të ndikojnë në planifikimin e programit.

Strategjitë për këmbimin e informacioneve përfshijnë:

- Mbledhjet e rregullta (mujore apo dymujore) në nivel të kampit apo bashkësisë për t'i shqyrtuar rezultatet e mbikqyrjes/vlerësimit/raportimit, duhet ta vlerësoi ndikimin e mbrojtjes, të pasqyroi të dhënat për paraqitjen e rasteve, analizoi rezultatet e grumbullimit të informatave dhe shikoi rezultatet e marrura nga bashkësia, koordinoi veprimet, planifikoi sesionet e ardhëshme të mbikqyrjes, t'i identifikoi pengesat dhe zgjidhjet.
- Mbledhjet mujore në nivel të zyrës fushore/nënzyrës/rrethit, për ta shqyrtuar raportin mujor lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar në gjini, ndikimin e mbrojtës së intervenimeve, të dhënat e mbledhura gjatë intervenimit, për të rishikuar përparimet në drejtim të treguesve që i ofrojnë veprimet për mbikqyrje, në nivel të kampit apo bashkësisë, dhe përparimin në drejtim të përmbushjes së qëllimeve të përcaktuara.
- Mbledhjet e rregullta (ndoshta tremujore) në nivel të vendit për t'i shqyrtuar raportet nga mbledhjet në nivel të kampeve apo bashkësisë, mbledhjet e zyreve fushore, të dhënat e mbledhura lidhur me

intervenimet, për të shqyrtuar vlerësimet dhe për t'i diskutuar çështjet financiare që ndikojnë në implementim.

Secila mbledhje do të përmbledhet në një raport të shkurtë me shkrim, i cili thekson dhe i ven në pah çështjet kryesore të identifikuara, veprimet që janë ndërmarrë dhe detyrat që janë përcaktuar.

PIKAT KYÇE

Mekanizmat gjithëpërfshirës për mbikqyrje dhe vlerësim:

- Nxisin dhe shtojnë përgjegjësinë – një nga parimet orientuese të intervenimit për parandalim dhe reagim ndaj dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini.
- Janë pjesë e Kornizës për Veprim.
- Janë më efikase kur zhvillohen nga të gjithë sektorët, përfshirë edhe bashkësinë e refugjatëve, me punë dhe angazhim të përbashkët.

Anëtarët e ekipit shumësektorial duhet që në punën e tyre të përcjellin gjashtë veprime (aktivitete) gjatë zhvillimit të sistemit për mbikqyrje dhe vlerësim:

- Përcaktimi i qëllimeve të mekanizmave të mbikqyrjes dhe vlerësimit dhe vlerësimi i nevojave informative.
- Përkujdesja dhe sigurimi se intervenimet për parandalim dhe reagim i kanë qartë të definuara detyrat, qëllimet, rezultatet dhe treguesit.
- Krijimi i mjeteve të përbashkëta dhe të koordinuara të raportimit.
- Përcaktimi i metodave për mbledhjen e informatave për treguesit.
- Caktimi i detyrave dhe përgjegjësiave për mbledhjen e informatave, caktimi i afatit dhe grumbullimit më të shpeshtuar të dhënave dhe shpërndarja e resurseve.
- Krijimi i mekanizmave për këmbimin e informatave dhe përfshirjen e rezultateve në planifikimin për parandalim dhe reagim.

KAPITULLI 8 PERSEKUTIMI NË BAZË TE PËRKATËSISË GJINORE

Qasja ndaj dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini, gjatë procesit të përcaktimit të statusit refugjat

Ky Kapitull jep udhëzime për atë se si ankesat dhe kërkesat e refugjatëve, lidhur me përkatësinë gjinore, duhet gjykuar gjatë përcaktimit të statusit refugjat. Ato mbështeten në Direktivat e UNHCR-së mbi persekutimin në bazë të përkatësisë gjinore, botuar në vitin 2002, duke ofruar këshilla praktike se si Konventa për refugjatë, e vitit 1951, kujdeset për të gjithë personat që ikin nga ndjekja, pa asnjë kusht të parashtruar paraprakisht lidhur me rolin e tyre të definuar në shoqëri, bazuar në përkatësinë gjinore.

UNHCR dhe të gjitha vendet kyçe duhet të përkujdesen që qeveritë e vendeve, këshilltarët ligjorë dhe nëpunësit e ngarkuar për mbrojtje, të cilët janë të përfshirë në procesin e përcaktimit të statusit refugjat, sipas Konventës të vitit 1951, që ndërlidhet me Statusin Refugjat, apo sipas Urdhëresës së vitit 1950, me të cilin themelohet Zyra e Komesariatit të Lart për Refugjatë e Kombeve të Bashkuara, duhet të jenë të njoftuara me Direktivat që kanë të bëjnë me përndjekjen, në bazë të përkatësisë gjinore të dhëna në këtë Kapitull.

Fuqimisht dënon përndjekjen përmes dhunës seksuale, e cila jo vetëm që paraqet shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut si dhe, kur bëhet në kontekst të konfliktit të armatosur, dëmtim të rëndë të së drejtës humanitare, e poashtu është edhe sulm i rëndë ndaj dinjitetit njerëzor.

Përkrash pranimin e statusit refugjat të personave, kërkesat e të cilëve për statusin e refugjatit janë të bazuara në frikën e dëshmuar nga persekutimi përmes dhunës seksuale, për shkak të dallimeve racore, fetare, kombëtare, përkatësisë së ndonjë grupi të caktuar shoqëror, apo mendimit politik.

Këshillon që, gjatë procedurave për përcaktimin e statusit refugjat, personat që kërkojnë azil, e që ndoshta kanë përjetuar dhunë seksuale, të trajtohen me kujdes dhe ndjeshmëri të posaçme.

Fragmente nga Konkluzat e ExCom-it nr. 73 (XLIV) (1993)

Dhuna seksuale dhe ajo e bazuar në gjini mund të ndikojnë në procesin e përcaktimit të statusit refugjat, si te parashtruesit e kërkesës që është viktimë/e mbijetuar, poashtu edhe te personi apo parashtruesi i kërkesës që posedon statusin refugjat, por që është keqbërës. Këto udhëzime përqëndrohen në interpretimin e definimit të termit refugjat nga perspektiva e përcaktimit gjinor, me sygjerime për disa veprime në praktikë, që duhet përkushtuar kujdesin e duhur femrave që kanë ankesa në procedurat gjyqësore për përcaktimin e statusit refugjat. Poashtu ofrojnë informacione relevante, të cilat sigurojnë se intervistuesi apo personi që vendos, posedon njohuri të duhura, në bazë të të cilave do t'i kuptojë dhe do t'i njohi kërkesat për azil, që ndërlidhen me përcaktimin gjinor.

Kur dhunimet, apo format e tjera të dhunës seksuale, bëhen nga shkak i racës, fesë, kombësisë, mendimit politik, apo përkatësisë së ndonjë grupi të caktuar shoqëror, mund të konsiderohen ndjekje, sipas definicionit të termit refugjat të përshkruar në Konventën e vitit 1951, e cila ndërlidhet me statusin refugjat dhe sipas Statutit të Zyrës së UNHCR-së. Ndjeshmëri e posaçme kërkohet në rastet kur personi që kërkon azil ndoshta ka përjetuar dhunë seksuale apo dhunë të bazuar në gjini. Nëpunësit për mbrojtje, intervistuesit apo vendimarrësit duhet të jenë të vetëdijshëm për faktin se asnjë dëshmi e dokumentuar, vetvetiu nuk kërkon për të treguar se personi i caktuar ndoshta ka përjetuar ndjekje të bazuar në përkatësinë gjinore. Intervistuesit apo vendimarrësit duhet të jenë plotësisht pa paragjykime në qasjen e

tyre, kur dihet se ka mungesë të përgjithëshme të të dhënave statistikore dhe paraqitje jo të mjaftueshme të shkeljeve të tilla të të drejtave të njeriut në shumicën e shoqërive.

Shërbime juridike duhet të ofrojnë vetëm personat e kualifikuar. Ata do të sigurojnë informata, këshilla dhe përfaqësim ligjor. Për hirë të vazhdimsisë dhe efikasitetit, personeli i njëjt duhet të merret me të njëjtin rast deri te mbyllja e tij. Por, pa marrë parasysh këtë, i gjithë personeli i UNHCR-së, posaçërisht ata të cilët intervistojnë viktimat/të mbijetuarat, duhet t'i njohin direktivat e UNHCR-së, ligjet ndërkombëtare që ndërlidhen me këtë lëmi, dhe ligjet e vendit nikoqir. Agjencionet humanitare që punojnë me popullatën e përndjekur dhe të zhvendosur, duhet poshtu të dijnë se cilët janë instrumentet që lidhen me ligjin e rrefugjatëve dhe aplikimin e tij pjesëmarrës, për t'iu siguruar femrave dhe meshkujve qasje të barabartë dhe që ta gëzojnë njësoj mbrojtjen ndërkombëtare.

Përndjekja për shkak të përcaktimit gjinor: Udhëzimet plotësuese për veprimet dhe kriteret për përcaktimin e statusit refugjat të vitit 2000

UNHCR i boton këto Direktiva, në përputhje me mandatin e vet, ashtu si është e paraparë në *Statutin e Zyrës së Komisarit të Lart për Refugjatët të Kombeve të Bashkuara*, në pajtim me nenin 35 të *Konventës për statusin e refugjatëve të vitit 1951* dhe *nenin II të Protokolit të saj të vitit 1967*. Këto Direktiva janë plotësim i *Doracakut për veprim dhe përcaktimin e statusit refugjat të UNHCR-së sipas Konevntës së 1951. dhe Protokolit të 1967. që bëjnë fjalë për statusin e refugjatëve (Ribotim, Gjenevë, janar 1992)*. Ato mëtutje zëvendësojnë Dokumentin e qëndrimit të UNHCR-së ndaj përndjekjes së bazuar në përcaktimin gjinor (Gjenevë, janar 2000), dhe rrjedhin nga hapi i Dytë i konsultimeve Globale për procesin e mbrojtjes ndërkombëtare, të cilat janë marrë me shqyrtimin e tij në mbledhjen e vet të ekspertëve në San Remo, në shator të vitit 2001.

Këto Direktiva kanë për qëllim të ndihmojnë, gjatë interpretimit ligjor, qeveritë, juristët, vendim-arrësit dhe gjyqet, si dhe personelin e UNHCR-së, të cilët e zbatojnë përcaktimin e statusit refugjat në terren.

PERNDJEKJA NË BAZË TË PÛRKATËSISË GJINORE NË KONTEKSTIN E NENIT 1A(2) TË KONVENTËS SË VITIT 1951, PÛRKATËSISHT PROTOKOLIT TË SAJ, TË VITIT 1967, QË BËN FJALË PÛR STATUSIN E REFUGJATËVE

I. Hyrje

1. "Persekutimi në bazë të përkatësisë gjinore" është term, i cili në vetëvete nuk ka kuptim juridik. Ai më parë shfrytëzohet për përfshirjen e një numër ankesash të ndryshme, në të cilat përkatësia gjinore është arsye relevante për shqyrtim gjatë përcaktimit të statusit refugjat. Këto Udhëzime posaçërisht përqëndrohen në interpretimin e definicionit të refugjatit që përfshihet në nenin 1A(2) të Konventës për statusin e refugjatëve të 1951 (në tekstin e mëtejshëm: "Konventa 1951") nga perspektiva e përkatësisë gjinore, e pashtu ofrojnë edhe disa veprime praktike se si femrave aplikuese për statusin refugjat, t'i kushtohet kujdes i mirëfillt në procesin gjatë përcaktimit të statusit refugjat dhe se si tërësia e ankesave e bazuar në përkatësinë gjinore të njihet dhe të pranohet.
2. Është parim i përcaktuar se definicionin refugjat, në përgjithësi duhet interpretuar me vetëdije për dimensionet e mundëshme gjinore, me qëllim që të përcaktohet sa më saktësisht statusi refugjat. Qasja e tillë ka pëlqimin e Kuvendit të Përgjithshëm, si dhe të Këshillit Ekzekutiv të Programit të UNHCR-së.⁵

⁵ Në Konkluzat e veta të tetorit 1999, Nr. 87(n), Këshilli ekzekutiv "thekson me vlerësim angazhimet e posaçme të vendeve për të përfshirë perspektivat gjinore në politikat, rregullativat dhe praktikat e tyre për azil; nxitë vendet, UNHCR-në dhe akterët e tjerë prezent në këtë lëmi, të promovojnë pranimin dhe përfshirjen e gjerë në kriteret e tyre mbrojtëse nocionin se persekutimi mund të jetë i bazuar në përkatësinë gjinore apo të ushtrohet përmes dhunës seksuale; mëtutje nxitë UNHCR-në dhe akterët

3. Në përpjekje për të kuptuar natyrën e persekutimit të bazuar në gjini, është e rëndësishë thelbësore definimi dhe dallimi i termave "përkatësia gjinore" dhe "seksi gjenetiv". Përkatësia gjinore i referohet marrëdhënies në mes të meshkujve dhe femrave në bazë të identiteteve, të ndërtuara dhe definuara në baza shoqërore ose kulturore, statusi, roli dhe detyrat që i ndahen njerës apo gjinisë tjetër, ndërsa seksi gjenetiv është përcaktim biologjik. Gjinia nuk është statike dhe e lindur, por me kohën merr ndërtim shoqëror dhe kulturor. Ankesat për përkatësinë gjinore mund të rrjedhin edhe nga femrat edhe nga meshkujt, edhe pse, gjatë persekutimeve të ndryshme, më shpesh dhe zakonisht i paraqesin femrat. Në disa raste seksi gjenetiv i paraqitësit mund të jetë i rëndësishë thelbësore në mënyra të ndryshme, në lidhje me të cilat vendimarrësi duhet t'i kushtojë kujdes dhe vëmendje të posaçme. Në rastet tjera, megjithatë, paraqitja për statusin refugjat, të cilën e bën femra gjatë kërkesës për azil, nuk do të ketë kurrëfarë rëndësie siksi/pjella e saj biologjike. Paraqitjet e bazuara në gjini në mënytë tipike përfshijnë, edhe pse asesi nuk janë të kufizuara me kaq rastet e dhunës seksuale, dhunës në familje, planifikimit të detyruar të familjes, gjymtimit të organeve gjinitale të femrave, dënimeve, shkeljes së zakoneve shoqërore dhe diskriminimit të homoseksualëve.
4. Fakti se është miratuar interpretimi i Konventës 1951, e cila kujdeset për çështjet gjinore, nuk do të thotë se femrat automatikisht e gëzojnë të drejtën në statusin refugjat. Paraqitësi i kërkesës për statusin refugjat duhet qartë të dëshmojë se ekziston frikë e dëshmuar nga persekutimi për shkak të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë së ndonjë grupi të posaçëm shoqëror, apo mendimit politik.

tjerë pjesëmarrës të zhvillojnë, promovojnë dhe aplikojnë udhëzimet, kodet e miresjëlles dhe programet për stërvitje të çështjes gjinore të refugjatëve, me qëllim që të përkrahet vendosja në plan të parë të perspektivës gjinore dhe të ngritet niveli i përgjegjësisë për aplikimin e politikës lidhur qasjen e çështjeve gjinore". Poashtu duhet shikuar: Konkluzat e Këshillit Ekzekutiv: Nr. 39, Femrat refugjate dhe mbrojtja ndërkombëtare, 1985; Nr. 73, Mbrojtja e refugjatëve dhe dhuna seksuale, 1993; Nr. 77(g), Konkluzat e Përgjithëshme mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare, 1995; Nr. 79(o), Konkluzat e Përgjithëshme mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare, 1996; dhe Nr. 81(t), Nr. 77, Konkluzat e Përgjithëshme mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare, 1997.

II. ANALIZA E PËRMBAJTJES SË MATERIES

A. SFONDI/HISTORIKU

5. Historikisht, definicioni refugjat interpretohet përmes një përvoje të meshkujve, çka do të thotë se shumë ankesa të paraqitura nga femrat dhe homoseksualët kalojnë pa u vërejtë dhe mbeten të panjohura. Në decenien e fundit, megjithatë, analiza dhe kuptimi i seksit gjenetik dhe gjinisë në kontekstin e refugjatëve përbëjnë një përparim, përgjithësisht, të rëndësishëm në të drejtën e praktikës së mëparëshme, në praktikën e Shtetit përgjithësisht, dhe në punimet shkencore dhe profesionale. Përparimi i tillë ndodh paralelisht me përparimin dhe me ndihmën e zhvillimi të së drejtës ndërkombëtare dhe standardet që ndërliidhen me të drejtat e njeriut⁶, si dhe në fushat e ndërliidhura të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë edhe të arriturat përmes jurisprudencës së gjyqeve penale ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën, dhe statutit të Romës të Gjykatës penale ndërkombëtare. Në këtë kuptim, për shembull, duhet marrë parasysh praktikën e dëmshme në shkeljen e ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ku nuk mund të arsyetohet në bazë të themeleve historike, tradicionale, fetare apo kulturore.
6. Edhe pse përkatësia gjinore nuk përfshihet posaçërisht në definicionin refugjat, është pranuar gjerësisht se ajo mund të ndikojë, apo edhe të diktojë, llojin e persekutimit apo dhunës së përjetuar dhe arsyet e trajtimit të tillë. Prandaj, definicioni refugjat, kur interpretohet saktë, përfshinë ankesat dhe kërkesat lidhur me përkatësinë gjinore. Si i tillë, nuk ka nevojë për të shtuar ndonjë bazë shtesë definicionit tani më të dhënë nga Konventa 1951.⁷
7. Në përpjekje që gjatë procesit të përcaktimit të statusit refugjat të aplikohen kriteret e këtij definicioni të refugjatit, është me rëndësi që vlerësimi të tillë t'i qasemi në mënyrë holistike dhe të merren parasysh të gjitha rrethanat relative të rastit në fjalë. Me rëndësi të thelbësore është të kemi një pasqyrë të plotë të personit që kërkon azil, si dhe pasqyrën e prapavijës dhe përvojave të ngjashme, e poashtu të bëhet analiza mbi njohuritë për rrethanat historike, gjeografike dhe kulturore të vendit të origjinës. Nuk ndihmojnë shumë gjeneralizimet për femrat apo meshkujt, dhe duke bërë gjeneralizimet, dallimet vendimtare, të cilat ndoshta janë vendimtare për rastin në fjalë, mund të mos vërehen.
8. Elementet e definicionit që mëtej shqyrtohen, kërkojnë interpretime të ndjeshme ndaj përkatësive gjinore. Kriteret tjera (p.sh. të qenit jasht vendit të prejardhjes) mbesin, sigurisht, poashtu relevante për vlerësim holistik të secilës kërkesë. Përgjatë tërë këtij dokumenti, përdorimi i termit femër përfshinë poashtu edhe fëmijët-vajza.

⁶ Në mesin e teksteve të dobishme bëjnë pjesë: Deklarata univerzale për të drejtat e njeriut 1948; Marrëveshja ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike, 1966; Marrëveshja ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, 1966; Konventa për të drejtat politike të grave, 1953; Konventa kundër torturës dhe trajtimeve apo dënimeve tjera mizore, jonjerëzore dhe nënçmuese, 1984; Konventa për të drejtat e femijës, 1989; dhe posaçërisht: Konventa për eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimit ndaj femrave, 1979, dhe Deklarata për eliminimin e dhunës ndaj femrave 1993. Në mesin e instrumenteve relevante regjionale bëjnë pjesë: Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut 1950; Konventa Amerikane për të drejtat e njeriut 1969, dhe Karta Afrikane për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e popujve 1981.

⁷ Të shikohet: Përmbledhja e konkluzave – Persekutimi në bazë të përkatësisë gjinore, konsultimet Globale për mbrojtjen ndërkombëtare, Tryeza e rumbullakët e Ekspertëve në San Remo, 6-8 shtator 2001, nr. 1 dhe nr. 3.

B. FRIKA E BAZUAR THELLË NGA PERSEKUTIMI

9. Kuptimi i termit "frikë e bazuar nga persekutimi" do të varet nga rrethanat konkrete të secilit rast veç e veç. Është e vërtetë se si meshkujt ashtu edhe femrat, që e aparqesin kërkesën, mund t'i nënshtrohen llojit të njëjt të dëmtimeve, por ata, poashtu, mund të ballafaqohen me forma të persekutimit që janë karakteristike për seksin gjenetik të tyre. Legjislacioni ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe ligji penal ndërkombëtar, i identifikojnë qartë veprimet e caktuara si shkelje të këtyre ligjeve, sikurse është dhuna seksuale, dhe përkrahin karakterizimin e tyre si keqpërdorime serioze të cilat, në përgjithësi, konsiderohen si persekutim.⁸ Në këtë kuptim, e drejta ndërkombëtare mund t'i ndihmojë vendimarrësit gjatë përcaktimit të natyrës së persekutimit të ndonjë veprimi specifik. Nuk ka kurrëfarë dyshimi se dhunimi dhe format e tjera të persekutimit, bazuar në përkatësinë gjinore, sikurse është dhuna e motivuar nga paja, gjymtimi i organeve gjinitale të femrave, dhuna në familje dhe trafikimi,⁹ veprime këto të cilat shkaktojnë dhimbje dhe vuajtje të mëdha – shpirtërore dhe fizike – të cilat aplikohen si forma të persekutimit, pa marrë parasysh atë se a është keqbërës shteti apo është fjala për akterë individualë.
10. Vlerësimi i ndonjë **ligji si persekutues në përmbajtje të vet** është treguar si material për përcaktimin e disa ankesave/kërkesave, të bazuara në përkatësinë gjinore. Kjo posaçërisht vlenë kur mirret parasysh fakti se ligjet relevante mund të rrjedhin nga normat dhe praktikat tradicionale apo kulturore, të cilat nuk janë gjithmonë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Mirëpo, si në të gjitha rastet e tjera, paraqitësi i kërkesës megjithatë duhet të tregojë se ai/ajo ndien thellë frikë të bazuar nga persekutimi, si pasojë e ligjit të tillë. Kjo nuk do të ishte si kërkesë, për shembull, atje ku ndonjë ligj persekutues vazhdon të ekzistojë, por që nuk aplikohet më.
11. Edhe atëherë kur një vend ndoshta e **ka ndaluar ndonjë praktikë persekutuese** (për shembull gjymtimi i organeve gjinitale të femrave), ai vend megjithatë mund të vazhdojë "të falë" (të mos dënojë) apo tolerojë atë praktikë, apo ndoshta nuk është në gjendje që në mënyrë efikase të ndalë taktikën në fjalë. Në raste të tilla, praktika në fjalë do të kishte domethënien e persekutimit. Fakti se është nxjerrë ligji, me të cilin ndalohet apo shpallet e dënueshme një praktikë persekutuese, si e tillë nuk do të mjaftojë të përcaktojë se kërkesa e një individi për status të refugjatit nuk është e vlefshme.
12. Atje ku ka **dënim ligjor** për mospranim apo shkelje të ndonjë politike, apo ligji është joproportionalisht i ashpër dhe poashtu ka dimension të përcaktimit gjinor, përsëri bëhet fjalë për persekutim.¹⁰ Edhe nëse ligji është përgjithësisht i zbatueshëm, rrethanat e dënimit apo trajtimit nuk mund të jenë aq të ashpra, sa të jenë në disproporcion me qëllimin e ligjit. Prandaj, dënimi i ashpër për femrat, të cilat me shkeljen e ndonjë ligji, i thyejnë zakonet shoqërore të asaj shoqërie, mund të konsiderohet persekutim.
13. Edhe atje ku **ligji apo politika kanë qëllime të arsyeshme**, metodat e zbatimit që çojnë në pasoja të natyrës kryesisht të dëmshme për personat në fjalë, si rrjedhojë do të ishin persekutim. Për shembull, është gjerësisht e pranueshme se planifikimi i familjes krijon përgjigje të përshtatshme ndaj presioneve të popullatës. Megjithatë, zbatimi i një politike të tillë, përmes shfrytëzimit të abortit dhe sterilizimit të dhunshëm, do të cënonte ligjin fundamental të së drejtave të njeriut. Praktika e tillë, përkundër faktit se ndoshta zbatohet në kontekst të ligjit legjitim, njihet si keqpërdorim serioz dhe konsiderohet persekutim.

⁸ Të shikohet doracaku i UNHCR-së, paragrafi 51

⁹ Të shikohet mëtej në paragrafin 18

¹⁰ Personat që ikin nga ndjekja apo dënimet gjyqësore për kundërvajtje ndaj ligjit zakonor, kryesisht nuk janë refugjatë, megjithatë ky dallim mund të fshihet, posaçërisht në rrethanat e dënimit shumë të rrept për shkelje të ndonjë ligji legjitim. Të shikohet: Doracaku i UNHCR-së, paragrafi 56 dhe 57.

Diskriminimi që shndërrohet në persekutim

14. Ndonëse ekziston pajtueshmëri e përgjithëshme se diskriminimi i 'thjesht', në rrjedha normale, ndoshta edhe nuk rezulton si persekutim në vehte dhe në përgjithësi, një formular i diskriminimit apo ndonjë trajtimi më pak i favorshëm mundet, marrë në përgjithësi, të rezultojë si persekutim dhe ta meritojë dhe arsyejojë mbrojtjen ndërkombëtare. Diskriminimi, për shembull, do të rezultonte në persekutim, nëse masat e diskriminimit do të çonin te pasojat e natyrës thellësisht të dëmshme për personin në fjalë – për shembull kur bëhet fjalë për ndalesa serioze të së drejtës së dikujt për të fituar për jetesë, të drejtën për të ushtruar fenë dhe besimin, apo qasja në entet edukativo-arsimore ekzistuese.¹¹
15. Për ankesa/kërkesa lidhur me përkatësinë gjinore, është e rëndësishme edhe analiza e formës së diskriminimit nga ana e shtetit, kur ai dështon në mbrojtjen e individit nga lloje të caktuara të dëmit dhe dhunës. Nëse shteti me politikën apo praktikën e vet nuk i harmonizon dhe nuk i pranon të drejtat e caktuara apo mbrojtjen nga keqpërdorimet serioze, diskriminimi apo në garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes, mund të konsiderohet persekutim. Në këtë kontekst, për shembull, do të mund të analizohen rastet konkrete të dhunës në familje apo keqpërdorimet dhe keqtrajtimet për shkak se dikush ndryshon orientimet seksuale.

Persekutimi për shkak të orientimeve seksuale të individit

16. Kërkesat për statusin refugjat për shkak të orientimeve seksuale të individit përmbajnë elemente të përkatësisë gjinore. Seksualiteti dhe praktika seksuale e paraqitësit të kërkesës, mund të jetë relevante për kërkesën e statusit refugjat kur ai person mashkull apo femër është mjet i persekutimit (përfshirë edhe diskriminimin) për shkak të seksualitetit apo praktikës seksuale të tij/saj. Në shumicën e rasteve të tilla bëhet fjalë për individin, i cili refuzon t'iu nënshtrohet roleve apo pritjeve të definuara nga shoqëria apo kultura për mënyrën e sjelljes, që ndërlidhet me seksin gjenetik të tij/saj. Kërkesat/ankesat më të zakonshme, në këtë kuptim, nënkuptojnë homoseksualët, transseksualët dhe travestitët, të cilët ballafaqohen me armiqësi publike të ashpër, dhunë, keqtrajtim, apo përgjithësisht diskriminim të rëndë.
17. Kur homoseksualiteti është joligjor në një shoqëri të caktuar, imponimi i dënimeve të rënda penale për shkak të sjelljeve homoseksuale mund të konsiderohet persekutim, poashtu sikurse është rasti me femrat në disa shoqëri, të cilat refuzojnë të mbajnë vëllon. Poashtu, edhe në vendet ku homoseksualiteti nuk është i karakterizuar si vepër penale, paraqitësi i ankesës mund të krijojë kërkesë valide nëse shteti në heshtje pranon apo toleron praktikën diskriminuese apo dhunën përmes dëmit të shkaktuar atij/asaj, apo kur shteti nuk është në gjendje që në mënyrë efikase paraqitësin e ankesës ta mbrojë nga kjo dhunë apo dëm.

Trafikimi me qëllim të prostitucionit të detyruar apo shfrytëzimit seksual, si formë e persekutimit¹²

¹¹ Shiko: Doracak i UNHCR-së, paragrafi 54.

¹² Për nevojat e këtyre Direktivave, 'trafikimi' definohet sipas nenit 3 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shuarjen dhe dënimin e tregtisë me njerëz, posaçërisht me femra dhe fëmijë, me çka plotësohet Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, 2000. Neni 3(1) thotë se tregtia me njerëz do të thotë 'rekrutimi, transporti, bartja, mshefja apo pranimi i personave, duke përdorur kërcënimin apo dhunën apo forma tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, tradhëtisë, keqpërdorimit të forcës ose pozitës së dobësisë apo dhënja apo pranimi i pagesave apo fitimeve për të arritur pajtimin e ndonjë personi që ka ndikim ndaj ndonjë personi tjetër, me qëllim të eksploatimit. Eksploatimi

18. Disa femra apo adoleshentë të trafikuar, mund të kenë kërkesa valide për ndarjen e statusit refugjat sipas Konventës 1951. Rekrutimi i detyruar apo mashtrimi i femrave apo të miturëve me qëllim të prostitucionit të detyruar apo eksploatimit seksual, është një nga format e dhunës apo keqpërdorimit të bazuar në përkatësinë gjinore, e cila mund të përfundojë edhe me vdekje. Veprimi i tillë mund të konsiderohet formë e torturës dhe trajtim mizor, jonjerëzor apo nënçmues. Poashtu mund të imponojë përkufizime serioze të lirisë së lëvizjes për femrat, të shkaktuara me rrëmbim, burgim, dhe/apo konfiskim të pasaportës ose dokumenteve tjera personale. Përveç kësaj, femrat dhe të miturit e trafikuar, mund të ballafaqohen me reperkusione të rënda pas ikjes së tyre dhe/apo pas kthimit, sikurse janë reprezalja apo shpagimi nga ana e grupeve apo individëve që merren me trafikimin e njerëzve, mundësia reale që përsëri të jenë të trafikuar, injorimet e rënda nga ana e familjes apo shoqërisë, apo diskriminimi i rëndë. Në raste individuale, fakti se personi ka qenë i/e trafikuar për qëllime të prostitucionit të detyruar apo eksploatimit seksual, si pasojë mund të paraqesë bazë për kërkesë të statusit refugjat atëherë kur shteti nuk është në gjendje apo nuk është i gatshëm t'i ofrojë mbrojtje ndaj kësaj të keqe të tillë apo kërcënimeve me dëmtim.¹³

Kryesit e veprës së persekutimit

19. Përbrenda definicionit të refugjatit është një hapësirë për të njohur dhe përcaktuar akterët shtetrorë dhe joshetrorë të persekutimit. Persekutimi, të shumtën bëhet nga autoritetet e një shteti, por rastet e rënda të diskriminimit apo aktet e tjera ofenduese që i bën shoqëria, apo individët, poashtu mund të konsiderohen persekutim, nëse aktet e tilla tolerohen me vetëdije nga ana e shtetit ose nëse shteti refuzon, apo nuk është në gjendje të ofrojë mbrojtje efikase.¹⁴

C. LIDHJA E SHKAKTUAR ("për arsye/shkak të")

20. Frika e madhe e shkaktuar nga persekutimi, duhet të jetë në lidhje me një apo më shumë baza themelore të Konventës. Me fjalë tjera, ajo duhet të jetë 'për arsye/shkak të' racës, fesë, kombësisë, përkatësisë ndonjë grupi shoqëror, apo mendimit politik. Baza që është në Konventë duhet të jetë faktor relevant kontribues, edhe pse nuk është e nevojshme që ai të jetë shkaku i vetëm, apo dominant. Në shumë sisteme të juridiksionit, kjo lidhje e shkaktuar (kjo për arsye/shak të') duhet të përcaktohet shumë qartë (për shembull në disa vende ku respektohet ligji zakonor) derisa në vendet tjera përcaktimi i lidhjes së shkaktuar nuk trajtohet si pyetje e posaçme për analizë, por është e përfshirë në analizën holistike të definicionit të refugjatit. Në shumicën e kërkesave, që kanë të bëjnë me përcaktimin gjinor, çështje e vështirë për vendim-arrësin ndoshta nuk është vendimi sipas bazave të aplikueshme, aq sa është i vështirë vendimi sipas lidhjes shkajkore: përkatësisht fakti se frika e dëshmuar nga persekutimi ka qenë shkak për atë bazë. Dhënia apo atribrimi i bazës konvencionale paraqitësit të kërkesës nga ana e shtetit apo ndonjë akteri tjetër të persekutimit, mjafton të krijohet kjo lidhje e kërkuar shkajkore.

21. Në rastet kur ekziston rreziku se një person do të persekutohet nga ndonjë akter jo-shteti (për shembull nga burri, partneri, apo ndonjë akteri tjetër që nuk është shteti) nga shkaqet që lidhen me ndonjë nga bazat e Konventës, përcaktohet lidhja shkajkore edhe nëse mungesa e mbrojtjes nga shteti është e lidhur ose jo me Konventën. Në të kundërtën, kur rreziku nga persekutimi nga ana e ndonjë akteri jo-shteti nuk është në lidhje me ndonjë bazë të Konventës, mirëpo paaftësia apo jogadishmëria

së paku do të përfshijë shfrytëzimin e prostituimit të personit tjetër apo formave tjera të shfrytëzimit seksual, punën dhe shërbimin e detyruar, skllavërinë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë, shërbim i detyruar apo heqje të organeve."

¹³ "Tregtia/trafikimi" me njerëz për qëllime tjera, poashtu mund të rezultojë në persekutim në ndonjë rast tjetër konkret, varësisht nga rrethanat.

¹⁴ Të shikohet: Doracaku i UNHCR-së, paragrafi 65.

e shtetit për të ofruar mbrojtje ekziston si e tillë në bazat e Konventës, poashtu mund të përcaktohet lidhja shkajkore.¹⁵

D. BAZAT E KONVENTËS

22. Duke u kujdesur që secilës bazë të Konventës t'i jepet interpretimi i ndjeshmërisë gjinore, ka rëndësi gjatë përcaktimit nëse ndonjë person i plotëson kriteret për definimin refugjat. Në shumicën e rasteve, paraqitësit e kërkesave mund të ballafaqohen me persekutim për shkak të ndonjë baze të Konventës që iu është përcaktuar apo mveshur. Në shumë shoqëri, mendimi politik i femrës, raca e saj, kombësia, feja apo lidhjet shoqërore, shpesh shikohen si diçka që radhitet dhe ndërlidhet me elementet përkatëse që vlejné për të afërmit apo kolegët, ose me të tjerët në bashkësinë e saj.
23. Poashtu është me rëndësi të mirret parasysh se, në shumicën e kërkesave që ndërlidhen me përkatësinë gjinore, frika nga persekutimi mund të jetë si shak i një apo më tepër bazave të Konventës. Për shembull, kërkesa për statusin refugjat i bazuar në tejkalimin e normave shoqërore apo fetare mund të analizohet në kuptim të religjionit, mendimit politik, apo përkatësisë së ndonjë grupi të caktuar shoqëror. Nga paraqitësi i kërkesës nuk kërkohet që në mënyrë precize të identifikojë arësyen për shkak të së cilës ai/ajo ka bazë të fortë/dëshmi të frikës nga persekutimi.

Raca

24. Për nevojat e definicionit të refugjatit, raca definohet ashtu që përfshinë të gjitha grupet etnike për të cilat flitet si 'raca' në të folmen e përditëshme.¹⁶ Persekutimi për shkak të racës mund të shprehet në mënyra të ndryshme ndaj meshkujve dhe femrave. Për shembull, persekutuesi mund të orientohet të shkatërrojë identitetin dhe/apo prosperitetin e ndonjë grupi racor përmes vrasjes, gjymtimit, apo burgosjes së meshkujve, derisa femrat mund të shihen si mjet për shpërndarjen e identitetit etnik apo racor, andaj persekutimi bëhet në forma tjera, si për shembull, përmes dhunës seksuale apo kontrollit të reproduktionit.

Feja/Besimi

25. Në vendet e caktuara, feja ndanë role dhe kode të caktuara të sjelljes së femrave, përkatësisht meshkujve. Aty ku femra nuk e përmbushë rolin me të cilin është ngarkuar apo refuzon t'iu nënshtrohet kodeve dhe si pasojë dënohet, ajo mund të ketë bazë të fortë për frikë nga persekutimi për shkak të fesë. Refuzimi për t'iu nënshtruar kodeve të përcaktuara mund të kuptohet dhe përjetohet si dëshmi së femra ushqen qëndrime dhe mendime të papranueshme fetare, pa marrë parasysh se çka me të vërtetë ajo mendon, apo beson. Femra poashtu mund të ballafaqohet me keqtrajtime për shkak të besimeve apo veprimeve të posaçme fetare të saj, apo për ato që i mëveshen, përfshirë këtu edhe refuzimin e saj që t'iu përmbahet këtyre besimeve, apo që të sillt sipas rregullave të përcaktuara fetare.
26. Në kërkesat e bazuara në përkatësinë gjinore, ekziston një përkim i pjesshëm në mes të besimit fetar dhe mendimit politik, posaçërisht të mendimit politik të imputuar. Meqenëse parimet fetare kërkohen nga femrat në mënyrë të posaçme të sjelljes, sjellja e kundërt mund të kuptohet dhe përjetohet si dëshmi e ndonjë mendimi të papranueshëm politik. Për shembull, në disa shoqëri roli i përcaktuar për femrat mund të shpjegohet si kërkesë e shtetit apo fesë zyrtare. Refuzimi i femrës për t'iu nënshtruar atij roli, autoritetet apo akterët tjerë të persekutimit mund ta përjetojnë si lëshim në ushtrimin apo pranimin e besimeve fetare të caktuara. Në të njëjtën kohë, mospajtimi me kërkesën mund të interpretohet si

¹⁵ Të shikohet Përmbledhja e konkluzave – Persekutimi në bazë të përkatësisë gjinore, nr. 6.

¹⁶ Të shikohet Doracaku i UNHCR-së, paragrafi 68.

mbajtje e ndonjë mendimi të papranueshëm politik, i cili dëmton strukturën bazë, nga e cila rrjedhë forca politike e caktuar. Kjo sidomos vlenë për shoqëritë ku ka pak dallim në mes të institucioneve, ligjeve dhe doktrinave shtetërore me ato fetare.

Kombësia/Nacionaliteti

27. Kombësinë nuk duhet kuptuar vetëm si 'shtetësi'. Ky term poashtu i referohet përkatësisë së ndonjë grupi etnik apo gjuhësor dhe mundet, aty-këtu, të përputhet me termin 'racë'.¹⁷ Edhe pse persekutimi në bazë të kombësisë (sikurse edhe në rastin e racës) nuk është specifik vetëm për femrat apo për meshkujt, në shumicën e rasteve natyra e persekutimit merr formën e ndërlidhjes me përkatësinë gjinore, shpesh formën e dhunës seksuale ndaj grave dhe vajzave.

Përkatësia e ndonjë grupi të posaçëm shoqëror¹⁸

28. Kërkesat që lidhen me përkatësinë gjinore shpesh analizohen përbrenda parametrave të kësaj baze, duke dhënë interpretim të drejt të këtij termi të rëndësisë së lartë. Në disa raste, megjithatë, theksi i vënë në bazë të grupit shoqëror mund të tregojë se bazat tjera, sikurse janë feja dhe mendimi politik, janë lënë pasdore. Prandaj, interpretimi kushtuar kësaj baze nuk mund t'i bëjë të tepërta katër bazat tjera të Konventës.
29. Një grup i caktuar shoqëror, pra, është një grup njerëzish që kanë të përbashkët një sërë karakteristikash, përveç asaj se janë në rrezik të persekutimit, apo që shoqëria i konsideron si grup. Karakteristika e tillë, zakonisht, është një nga ato të lindurat, e pandryshuar, apo e cila ka rëndësi për identitetin, ndërgjegjen apo të drejtat njerëzore të individit.
30. Nga kjo rrjedhë se seksi gjenital bindshëm mund t'i përket kufinjëve të kategorisë së grupit shoqëror, ku femrat janë shembull i qartë i një nënbashkësie shoqërore të definuar me karakteristika të lindura dhe të pandryshueshme, të cilat shpesh trajtohen ndryshe nga meshkujt.¹⁹ Karakteristikat e tyre i definojnë ato edhe si grup në shoqëri, dhe të nënshtuara trajtimit dhe standardeve të ndryshme në disa vende.²⁰ Poashtu, ky definicion i përshtatet edhe homoseksualëve, transseksistëve, apo transvestitëve.
31. Madhësia e grupit ndonjëherë shfrytëzohet si bazë për refuzimin që 'femrat' përgjithësisht të pranohen si grup i posaçëm shoqëror. Ky argument nuk ka bazë në faktet apo arësyet, sepse bazat tjera nuk janë të lidhura me këtë çështje të madhësisë. Poashtu nuk do të duhej të kishte kërkesa që grupi i caktuar shoqëror të jetë koheziv dhe që anëtarët e vet t'i përkasin vullnetarisht,²¹ apo që secili anëtar i grupit të jetë në rrezik nga persekutimi.²² Fuqimisht është pranuar se duhet të jetë e mundëshme të identifikohet grupi i pavarur nga persekutimi, edhe pse diskriminimi apo persekutimi mund të jenë shkaqe relevante gjatë përcaktimit të dukurisë së grupit në një kontekst konkret.²³

¹⁷ Të shikohet: Doracaku i UNHCR-së, paragrafi 74.

¹⁸ Për informata shtesë të shikohen Direktivat e UNHCR-së për mbrojtjen ndërkombëtare: 'përkatësia ndonjë grupi të caktuar shoqëror' në kontekstin e nenit 1A(2) të Konventës 1951, dhe/apo Protokoli 1967 mbi statusin e refugjatëve (HCR/GIP/02/02, 7 maj 2002).

¹⁹ Të shikohet Përmbledhja e konkluzave – Persekutimi në bazë të përkatësisë gjinore, nr. 5.

²⁰ Poashtu të shikohet: Konkluzat e Këshillit ekzekutiv, nr. 39, Femrat refugjate dhe mbrojtja ndërkombëtare, 1985: 'Shtetet ... kanë lirinë të miratojnë interpretimin sipas të cilit femrat – kërkuese të azilit, të cilat ballafaqohen me sjellje mizore apo jonjerëzore për shkak se kanë shkelur zakonet shoqërore të shoqërisë ku jetojnë, mund të mirren si 'grup shoqëror i posaçëm' sipas domethënies se nenit 1A(2) të Konventës së Kombeve të Bashkuara të 1951".

²¹ Të shikohet: Përmbledhje e Konkluzave – Përkatësia e ndonjë grupi shoqëror, konsultimet Globale për mbrojtjen ndërkombëtare, tryeza e rrumbullakët e Ekspertëve në San Remo, 6-8 shtator 2001, nr. 4 (Përmbledhje e Konkluzave – Përkatësia ndonjë grupi shoqëror).

²² Të shikohet Përmbledhje e Konkluzave – Përkatësia e ndonjë grupi shoqëror, ibid., nr. 7.

²³ Të shikohet Përmbledhje e Konkluzave – Përkatësia e ndonjë grupi shoqëror, ibid., nr. 6.

Mendimi politik

32. Sipas kësaj baze, paraqitësi i kërkesës duhet të dëshmojë se – qoftë fjala për mashkull apo femër – ka bazë të fortë për frikë nga persekutimi për shkak të mendimeve politike të caktuara (zakonisht janë të ndryshme nga ato që kanë qeveria ose pjesët e shoqërisë), apo për shkak se atij/saj ia kanë mvëshur qëndrimin e mendimit të tillë politik. Mendimi politik duhet të vështrohet në kuptim të gjerë, për të përfshirë çfarëdo mendimi për çfarëdo çështje, për të cilën makineria e shtetit, qeverisë, e shoqërisë apo e politikës mund të angazhohej. Këtu mund të përfshihet edhe mendimi në lidhje me rolet gjinore. Poashtu mund të përfshihet edhe sjellja jokonvencionale, e cila e bën persekutorin që personit t'ia mvëshë ndonjë mendim politik. Në këtë kuptim, nuk ekziston asgjë që vetvetiu do të ishte një aktivitet i trashëguar politik apo jopolitik, por konteksti i rastit të dhënë, duhet ta përcaktojë natyrën e tij. Mirëpo, kërkesa për statusin refugjat, e bazuar në mendimin politik me të vërtetë presupozon se paraqitësi i kërkesës mbanë, apo supozohet se mbanë mendime, të cilat nuk tolerohen nga qeveria apo shoqëria, të cilat në mënyrë kritike i qasen politikës, traditës apo metodave të tyre. Kërkesa poashtu presupozon se mendimet e tilla janë vërejtë apo do të mund të vëreheshin nga autoritetet apo pjesët relevante të shoqërisë, apo nga ana e tyre i mëveshen paraqitësit të kërkesës. Nuk është gjithmonë e nevojshme që personi të ketë shprehur ndonjë mendim të tillë, apo të ketë përjetuar çfarëdo qoftë forme të diskriminimit apo persekutimit. Në raste të tilla, testi për frikë të dëshmuar do të bazohet në vlerësimin e pasojave me të cilat paraqitësi i kërkesës, që ka dispozita të caktuara, do të ballafaqohej në qoftë se ai apo ajo do të kthehej.
33. Imazhi i refugjatit politik, si dikush që ikë nga persekutimi për shkak të angazhimit të vet në aktivitete politike, nuk përputhet gjithmonë me realitetin e përvojave të femrave në disa shoqëri. Për femrat ka më pak mundësi, sesa për homologët e tyre meshkuj, të angazhohen në politikë të profilit të lart, dhe ato më shpesh janë të angazhuara në aktivitete politike të 'nivelit më të ulët' në të cilat pasqyrohen rolet gjinore dominante. Për shembull, femra mund të inkuadrohet në shërimin e kryengritësve të sëmurë dhe të plagosur, në rekrutimin e simpatizerëve, apo në përgatitjen dhe shpërndarjen e trakteve. Femrave, poashtu, shpesh iu mvishen mendimet politike të familjes së tyre apo të afërmëve meshkuj, dhe i nënshtrohen persekutimit për shkak të veprimtarisë politike të të afërmëve të tyre meshkuj. Kjo mund të analizohet në kontekstin e mendimit politik të mëveshur, por poashtu mund të analizohet edhe si persekutim për shkak të përkatësisë së femrës ndonjë grupi të caktuar shoqëror, që është 'familja' e saj. Këta shkaktarë gjithsesi duhet marrë parasysh në kërkesat që ndërlidhen me përkatësinë gjinore.
34. Për kërkesat që ndërlidhen me përkatësinë gjinore, poashtu është me rëndësi të kuptohet dhe pranohet se femra ndoshta nuk dëshiron të angazhohet në veprime të caktuara, sikurse është përgatitja dhe shëbimi i ushqimit ushtarëve të qeverisë ('ushtrisë së shtetit'), çka mund të konsiderohet nga persekutori si posedim i mendimit të kundërt politik.

III. ÇESHTJET PROCEDURALE²⁴

35. Personat të cilët i inicojnë kërkesat për statusin refugjat, e që ndërlidhen me përkatësinë gjinore, dhe posaçërisht personat që kanë përjetuar torturë apo traumë, e kërkojnë rrethin që do t'i përkrahë dhe ku do të mund të ndihen të sigurtë për besueshmërinë/sekretin e kërkesës së tyre. Për shkak të turpit që ndiejnë për atë që iu ka ndodhur, apo për shkak të traumës, disa paraqitës të kërkesave mund të jenë jo edhe aq të gatshëm ta identifikojnë vëllimin e vërtetë të persekutimit që kanë përjetuar apo nga i cili frikësohen. Personat e tillë edhe mëtej mund të kenë frikë nga personat në pushtet, apo mund të frigohen nga refuzimi dhe/apo ndëshkimi i familjes dhe/ose i bashkësisë së vet.²⁵

36. Përkundër kësaj prapavije, me qëllim të sigurimit se, kërkesat e bazuara në përkatësinë gjinore, posaçërisht ato të inicuara nga femrat, kanë shqyrtim të drejtë gjatë procesit të përcaktimit të statusit refugjat, duhet marrë parasysh masat në vijim:

- i. Me femrat që kërkojnë azil duhet bërë biseda të ndara, pa praninë e anëtarëve meshkuj të familjes, që ato të ndihen të sigurta se kanë mundësi të paraqesin rastin e tyre. Atyre duhet shpjeguar se ndoshta kanë kërkesë valide në bazë të së drejtës së tyre personale.
- ii. Është e rëndësishme thelbësore që femrave t'iu ofrohen informata për procesin e përcaktimit të statusit, të qasjes në te, si dhe këshilla ligjore, në mënyrën dhe në gjuhën që ato e kuptojnë.
- iii. Paraqitësit e kërkesës duhet të dijnë se kanë të drejtë të zgjedhin intervistuesit dhe përkthyesit e seksit gjeneral të njejtë sikurse i tyre,²⁶ dhe në rast se paraqitësi i kërkesës është femër, kjo duhet mundësuar automatikisht. Intervistuesit dhe përkthyesit duhet të kenë parasysh dhe të jenë të hapur ndaj çfarëdo ndjeshmërie kulturore apo fetare, apo të faktorëve personalë, sikurse janë mosha dhe niveli i arsimimit.
- iv. Një ambient i hapur dhe i sigurtë, shpesh herë ka rëndësi thelbësore për vendosjen e besueshmërisë në mes të intervistuesit dhe paraqitësit të kërkesës, dhe duhet t'i ndihmojë dhe kontribuojë zbardhjes së plotë, e ndonjëherë edhe shumë të ndjeshme dhe personale, të informatave. Dhoma ku zhvillohet biseda duhet të jetë e rregulluar në atë mënyrë që të inkurajojë bisedën, të sigurojë besueshmërinë dhe zvogëlojë çdo mundësi që të ndihet me ndikim dhe influencë jobalancuese.

²⁴ Kjo Pjesë shfrytëzon udhëzime të vlefshme, të cilat i kanë ofruar Shtete të ndryshme dhe akterë tjerë, duke përfshirë edhe këto udhëzime: çka duhet të dijnë nëpunësit për çështje të azilit, të cilët i shqyrtojnë kërkesat për azil, të paraqitura nga femrat (Shërbimi për imigrim dhe dhënien e shtetësisë, SHBA, 26 maj 1995); Paraqitësit e kërkesës për viza humanitare dhe të refugjatëve: Direktivat për vendimarrësit për çështjet e përkatësisë gjinore (Ministria për imigrim dhe çështje humanitare, Australi, korrik 1996); Udhëzimi 4 në lidhje me femrat-kërkuese të statusit refugjat, të cilat janë në frikë nga persekutimi në bazë të përkatësisë gjinore: Versioni i freskuar (Këshilli për imigrim dhe refugjatë, Kanadë, 13 nëntor 1996); Pozicioni për azil-kërkim dhe femrat refugjate (Këshilli Evropian për refugjatë dhe egzil, dhjetor 1997); Direktivat për marrjen e vendimeve të kërkesave për azil në Mbretërinë e Bashkuar, që ndërlidhen me përkatësinë gjinore (Grupi Ligjor për femrat refugjate, korrik 1998); Direktivat që ndërlidhen me përkatësinë gjinore për dhënien e azilit (Konzorciumi kombëtar për çështje të refugjatëve, Republika Jugafrikane, 1999); Direktivat që ndërlidhen me përkatësinë gjinore gjatë vendim-marrjes për azil (Autoriteti apelues për imigracion, Mbretëria e Bashkuar, nëntor 2000); Persekutimi i bazuar në përkatësinë gjinore: Direktivat për shqyrtim dhe vlerësim të nevojave të femrave për mbrojtje (Këshilli për migracion, sektori për praktikë ligjore, Suedi, 28 mars 2001).

²⁵ Poashtu të shikohet: Dhuna seksuale ndaj refugjatëve: Udhëzimet për parandalim dhe reagim (UNHCR, Gjenevë, 1995) dhe: Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini në situata të refugjatëve (Raporti i Konferencës ndër-agjensionesh mbi mësimet e nxjerrura, 27-29 mars 2001, Gjenevë).

²⁶ Poashtu të shikohet Raporti i Këshillit Ekzekutiv nr. 64, Femrat refugjate dhe mbrojtja ndërkombëtare, 1990, (a) (iii): Siguroni, kudo që është e mundur, femra të kualifikuara intervistuese për procedim në përcaktimin e statusit refugjat dhe mundësoni qasje të përshtatshme për femrat kërkuese të azilit, madje edhe nëse ato janë në përcjellje të anëtarëve meshkuj të familjes.

- v. Intervistuesi së pari duhet ta prezentojë veten dhe përkthyesin para paraqitësit të kërkesës, t'ia shpjegojë qartë rolinë vet, dhe qëllimin e sakt të asaj bisede. Paraqitësi i kërkesës duhet të bindet se kërkesa e tij/saj do të trajtohet në besueshmërinë dhe fshehtësinë më të rreptë, dhe se informatat e dhëna, të paraqitësit të kërkesës, nuk do t'i jepen anëtarëve të familjes së tij/saj. Poashtu është me rëndësi që personi që udhëheqë bisedën të shpjegojë për veten se nuk është këshilltar dhe ekspert për tejkalimin e traumave të përjetuara.
- vi. Intervistuesi duhet të mbetet neutral, i ndjeshëm dhe objektiv gjatë zhvillimit të bisedës, dhe duhet t'i shmangët 'të të folurit të trupit' apo gjestikulimit, të cilët mund të kuptohen si frikësim apo, shikuar sipas kulturës së paraqitësit të kërkesës, të pandjeshme dhe të pavend. Intervistuesi duhet t'i lejojë paraqitësit të kërkesës të prezentojë kërkesën e tij/saj, sipas mundësisë, me sa më pak ndërprerje dhe ndërhyrje.
- vii. Në të gjitha bisedat për azil duhet përfshirë pyetje 'te hapura' dhe konkrete, të cilat mund të ndihmojnë në zbulimin e çështjeve gjinore relevante për kërkesën e statusit refugjat. Femrat të cilat kanë qenë të angazhuara indirekt në aktivitete politike apo të cilave u është mëveshur mendimi politik, për shembull, shpesh ato nuk ofrojnë informata relevante gjatë këtyre bisedave për shkak të natyrës së bisedës të orientuar-kah natyra mashkullore. Femrat të cilat e kanë paraqitur kërkesën, poashtu, mund të dështojnë në lidhjen e pyetjeve që kanë të bëjnë me 'torturën' dhe me llojet e ndëshkimeve që ato i kanë frikë (sikurse janë dhunimi, shpërdorimi seksual, gjymtimi i organve gjinitale të femrave, humbja e krenarisë', martesat e detyruara, etj.).
- viii. Posaçërisht, në rastet e dhunës seksuale apo formave tjera të traumës, mund të shtrohet nevoja për biseda tjera shpesh, me qëllim të vendosjes së besueshmërisë dhe për të mbledhur të gjitha informatat. Në këtë kuptim, intervistuesit duhet të jenë të ndjeshëm ndaj traumës dhe emocioneve të paraqitësit të kërkesës dhe duhet ta ndalin bisedën kur paraqitësi të fillojë të shfaqë shenja të shqetësimit emocional.
- ix. Atje ku vërehet se rasti i caktuar mund të krijojë bazë për kërkesë, që ndërlidhet me përkatësinë gjinore, është i nevojshëm procedimi i përshtatshëm, i cili poashtu mundëson vendosjen e raporteve të besueshmërisë dhe besimit, të cilat duhet të zhvillohen te paraqitësi i kërkesës, dhe njëkohësisht i mundëson intervistuesit të parashtrijë pyetje me vend dhe të merret me cilindo problem që mund të lindë gjatë bisedës.
- x. Duhet mbledhur informatat mbi vendin e origjinës, të cilat janë relevante për kërkesat e femrave, për shembull të dhënat për pozitën e femrave në ligj, për të drejtat politike të femrave, të drejtat ekonomike dhe shoqërore të femrave, zakonet kulturore dhe shoqërore të vendosura në vendin në fjalë dhe për pasojat në rast të shkeljes së tyre, përhapjes së praktikave të tilla të dëmshme tradicionale, shkallën dhe format e dhunës së paraqitur ndaj femrave, për mbrojtjen që femrat e kanë në dispozicion, për çfarëdo lloji të denimeve të përcaktuara për persekutorët e dhunës dhe për rreziqet me të cilat femra do të mund të ballafaqohet pas kthimit të saj në vendin e origjinës, sepse e ka inicuar kërkesën për statusin refugjat.
- xi. Lloji dhe niveli i emocioneve të shfaqura gjatë rrëfimit të femrës për atë çfarë ka përjetuar, nuk duhet të ndikojnë në kredibilitetin e saj. Intervistuesit dhe vendimarrësit duhet të kuptojnë se dallimet kulturore dhe traumat luajnë rol të rëndësishëm dhe kompleks në përcaktimin e sjelljes. Në disa raste të veçanta, është me vend të kërkojnë dëshmi objektive psikologjike apo mjeksore. Nuk është e nevojshme të vendosen detajet precize të vet aktit të dhunimit apo të përdhunimit seksual, por është e nevojshme të përcaktohen shkaqet që kanë çuar deri te ky akt, veprimet që kanë pasuar, rrethanat e përgjithëshme dhe detajet (sikurse janë shfrytëzimi i armëve, çfarëdo lloj fjalësh apo shprehjesh që kanë përdorur persekutuesit, lloji i përdhunimit,

kur dhe si ka ndodhur akti, detajet për persekutorët – a kanë qenë ushtarë, civilë, etj.), dhe mund të jetë e nevojshme të dihet edhe motivi i persekutuesit. Në disa raste, dhe nën disa rrethana, duhet marrë parasysh se femra ndoshta edhe nuk është e vetëdijshme për arsyet e keqtrajtimit.

- xii. Aty ku është e nevojshme, duhet vendosur dhe mundësuar qasjen në mekanizmat për përcjellje dhe këshillime psiko-sociale dhe shërbime tjera të nevojshme. Praktikrat e dëshmuara më mirë, rekomandojnë që këshilltarët e stërvitur psiko-socialë të jenë në dispozicion dhe ta ndihmojnë paraqitësin e kërkesës para dhe pas bisedës.

Cështjet e dokumentimit dhe dëshmisë

- 37. Nuk është e obligueshme asnjë dëshmi e dokumentuar, që një qeveri t pranojë kërkesën për refugjat, edhe pse të gjitha informatat që kanë të bëjnë me praktikrat në vendin e origjinës, mund të mbështesin një rast konkret. Është me rëndësi të mirret parasysh se, kur bëhet fjalë për kërkesat e ndërlydhura me përkatësinë gjinore, tipet e zakonshme të dëshmive, që shqyrtohen gjatë përcaktimit të kërkesave tjera për refugjatë, mund të mos jenë në dispozicion edhe aq lehtë, për shkak të mosparaqitjes së mjaftueshme të rasteve dhe ndjekjes së dobët ligjore. Format alternative të informimit, poashtu, mund të ndihmojnë, si për shembull dëshmitë e femrave tjera në situata të ngjashme në formë të raporteve të shkruara apo deklarave gojore, dëshmitë që rrjedhin nga organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare, apo ndonjë hulumtim tjetër i pavarur.

IV. METODAT E IMPLEMENTIMIT

- 38. Varësisht nga tradita ligjore konkrete, ekzistojnë dy qasje të përgjithëshme, të cilat Shtetet i ndërmarrin për të siguruar aplikimin e ligjit për refugjatët, i ndieshëm ndaj përkatësisë gjinore, dhe posaçërisht definicioni refugjat, i cili e pranon atë përcaktim. Disa shtete i kanë përfshirë udhëzimet për interpretimin ligjor dhe/ose garancat procedurale në vetw legjislacionin, derisa shtetet tjera preferojnë që në kuptim të njejtë të zhvillojnë politikë të veprimit dhe direktiva ligjore për vendimarrësit. UNHCR i nxitë Shtetet, të cilat ende nuk kanë ndërmarrë hapa për sigurimin e aplikimit të ligjit dhe procedurës për statusin refugjat dhe veprime, të cilët janë të ndieshëm në përkatësinë gjinore, dhe se në çdo moment dhe në çdo mënyrë të mund të ofrojë ndihmë për këtë çështje.

KAPITULLI 8 PERSEKUTIMI NË BAZË TE PËRKATËSISË GJINORE

Qasja ndaj dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini, gjatë procesit të përcaktimit të statusit refugjat

Ky Kapitull jep udhëzime për atë se si ankesat dhe kërkesat e refugjatëve, lidhur me përkatësinë gjinore, duhet gjykuar gjatë përcaktimit të statusit refugjat. Ato mbështeten në Direktivat e UNHCR-së mbi persekutimin në bazë të përkatësisë gjinore, botuar në vitin 2002, duke ofruar këshilla praktike se si Konventa për refugjatë, e vitit 1951, kujdeset për të gjithë personat që ikin nga ndjekja, pa asnjë kusht të parashtruar paraprakisht lidhur me rolin e tyre të definuar në shoqëri, bazuar në përkatësinë gjinore.

UNHCR dhe të gjitha vendet kyçe duhet të përkujdesen që qeveritë e vendeve, këshilltarët ligjorë dhe nëpunësit e ngarkuar për mbrojtje, të cilët janë të përfshirë në procesin e përcaktimit të statusit refugjat, sipas Konventës të vitit 1951, që ndërlidhet me Statusin Refugjat, apo sipas Urdhëresës së vitit 1950, me të cilin themelohet Zyra e Komesariatit të Lart për Refugjatë e Kombeve të Bashkuara, duhet të jenë të njoftuara me Direktivat që kanë të bëjnë me përndjekjen, në bazë të përkatësisë gjinore të dhëna në këtë Kapitull.

Fuqimisht dënon përndjekjen përmes dhunës seksuale, e cila jo vetëm që paraqet shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut si dhe, kur bëhet në kontekst të konfliktit të armatosur, dëmtim të rëndë të së drejtës humanitare, e poashtu është edhe sulm i rëndë ndaj dinjitetit njerëzor.

Përkrash pranimin e statusit refugjat të personave, kërkesat e të cilëve për statusin e refugjatit janë të bazuara në frikën e dëshmuar nga persekutimi përmes dhunës seksuale, për shkak të dallimeve racore, fetare, kombëtare, përkatësisë së ndonjë grupi të caktuar shoqëror, apo mendimit politik.

Këshillon që, gjatë procedurave për përcaktimin e statusit refugjat, personat që kërkojnë azil, e që ndoshta kanë përjetuar dhunë seksuale, të trajtohen me kujdes dhe ndjeshmëri të posaçme.

Fragmente nga Konkluzat e ExCom-it nr. 73 (XLIV) (1993)

Dhuna seksuale dhe ajo e bazuar në gjini mund të ndikojnë në procesin e përcaktimit të statusit refugjat, si te parashtruesit e kërkesës që është viktimë/e mbijetuar, poashtu edhe te personi apo parashtruesi i kërkesës që posedon statusin refugjat, por që është keqbërës. Këto udhëzime përqëndrohen në interpretimin e definimit të termit refugjat nga perspektiva e përcaktimit gjinor, me sygjerime për disa veprime në praktikë, që duhet përkushtuar kujdesin e duhur femrave që kanë ankesa në procedurat gjyqësore për përcaktimin e statusit refugjat. Poashtu ofrojnë informacione relevante, të cilat sigurojnë se intervistuesi apo personi që vendos, posedon njohuri të duhura, në bazë të të cilave do t'i kuptojë dhe do t'i njohi kërkesat për azil, që ndërlidhen me përcaktimin gjinor.

Kur dhunimet, apo format e tjera të dhunës seksuale, bëhen nga shkak i racës, fesë, kombësisë, mendimit politik, apo përkatësisë së ndonjë grupi të caktuar shoqëror, mund të konsiderohen ndjekje, sipas definicionit të termit refugjat të përshkruar në Konventën e vitit 1951, e cila ndërlidhet me statusin refugjat dhe sipas Statutit të Zyrës së UNHCR-së. Ndjeshmëri e posaçme kërkohet në rastet kur personi që kërkon azil ndoshta ka përjetuar dhunë seksuale apo dhunë të bazuar në gjini. Nëpunësit për mbrojtje, intervistuesit apo vendimarrësit duhet të jenë të vetëdijshëm për faktin se asnjë dëshmi e dokumentuar, vetvetiu nuk kërkon për të treguar se personi i caktuar ndoshta ka përjetuar ndjekje të bazuar në përkatësinë gjinore. Intervistuesit apo vendimarrësit duhet të jenë plotësisht pa paragjykime në qasjen e

tyre, kur dihet se ka mungesë të përgjithëshme të të dhënave statistikore dhe paraqitje jo të mjaftueshme të shkeljeve të tilla të të drejtave të njeriut në shumicën e shoqërive.

Shërbime juridike duhet të ofrojnë vetëm personat e kualifikuar. Ata do të sigurojnë informata, këshilla dhe përfaqësim ligjor. Për hirë të vazhdimsisë dhe efikasitetit, personeli i njejt duhet të merret me të njejtin rast deri te mbyllja e tij. Por, pa marrë parasysh këtë, i gjithë personeli i UNHCR-së, posaçërisht ata të cilët intervistojnë viktimat/të mbijetuarat, duhet t'i njohin direktivat e UNHCR-së, ligjet ndërkombëtare që ndërlidhen me këtë lëmi, dhe ligjet e vendit nikoqir. Agjencionet humanitare që punojnë me popullatën e përndjekur dhe të zhvendosur, duhet poshtu të dijnë se cilët janë instrumentet që lidhen me ligjin e rrefugjatëve dhe aplikimin e tij pjesëmarrës, për t'iu siguruar femrave dhe meshkujve qasje të barabartë dhe që ta gëzojnë njësoj mbrojtjen ndërkombëtare.

Përndjekja për shkak të përcaktimit gjinor: Udhëzimet plotësuese për veprimet dhe kriteret për përcaktimin e statusit refugjat të vitit 2000

UNHCR i boton këto Direktiva, në përputhje me mandatin e vet, ashtu si është e paraparë në *Statutin e Zyrës së Komisarit të Lart për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara*, në pajtim me nenin 35 të *Konventës për statusin e refugjatëve të vitit 1951* dhe nenin II të *Protokolit të saj të vitit 1967*. Këto Direktiva janë plotësim i *Doracakut për veprim dhe përcaktimin e statusit refugjat të UNHCR-së sipas Konventës së 1951. dhe Protokolit të 1967. që bëjnë fjalë për statusin e refugjatëve (Ribotim, Gjenevë, janar 1992)*. Ato mëtutje zëvendësojnë Dokumentin e qëndrimit të UNHCR-së ndaj përndjekjes së bazuar në përcaktimin gjinor (Gjenevë, janar 2000), dhe rrjedhin nga hapi i Dytë i konsultimeve Globale për procesin e mbrojtjes ndërkombëtare, të cilat janë marrë me shqyrtimin e tij në mbledhjen e vet të ekspertëve në San Remo, në shator të vitit 2001.

Këto Direktiva kanë për qëllim të ndihmojnë, gjatë interpretimit ligjor, qeveritë, juristët, vendim-arrësit dhe gjyqet, si dhe personelin e UNHCR-së, të cilët e zbatojnë përcaktimin e statusit refugjat në terren.

PERNDJEKJA NË BAZË TË PÛRKATËSISË GJINORE NË KONTEKSTIN E NENIT 1A(2) TË KONVENTËS SË VITIT 1951, PÛRKATËSISHT PROTOKOLIT TË SAJ, TË VITIT 1967, QË BËN FJALË PÛR STATUSIN E REFUGJATËVE

I. Hyrje

39. "Persekutimi në bazë të përkatësisë gjinore" është term, i cili në vetëvete nuk ka kuptim juridik. Ai më parë shfrytëzohet për përfshirjen e një numër ankesash të ndryshme, në të cilat përkatësia gjinore është arsye relevante për shqyrtim gjatë përcaktimit të statusit refugjat. Këto Udhëzime posaçërisht përqëndrohen në interpretimin e definicionit të refugjatit që përfshihet në nenin 1A(2) të Konventës për statusin e refugjatëve të 1951 (në tekstin e mëtejshëm: "Konventa 1951") nga perspektiva e përkatësisë gjinore, e pashtu ofrojnë edhe disa veprime praktike se si femrave aplikuese për statusin refugjat, t'i kushtohet kujdes i mirëfillt në procesin gjatë përcaktimit të statusit refugjat dhe se si tërësia e ankesave e bazuar në përkatësinë gjinore të njihet dhe të pranohet.
40. Është parim i përcaktuar se definicionin refugjat, në përgjithësi duhet interpretuar me vetëdije për dimensionet e mundëshme gjinore, me qëllim që të përcaktohet sa më saktësisht statusi refugjat. Qasja e tillë ka pëlqimin e Kuvendit të Përgjithshëm, si dhe të Këshillit Ekzekutiv të Programit të UNHCR-së.²⁷

²⁷ Në Konkluzat e veta të tetorit 1999, Nr. 87(n), Këshilli ekzekutiv "thekson me vlerësim angazhimet e posaçme të vendeve për të përfshirë perspektivat gjinore në politikat, rregullativat dhe praktikatat e tyre për azil; nxitë vendet, UNHCR-në dhe akterët e tjerë prezent në këtë lëmi, të promovojnë pranimin dhe përfshirjen e gjerë në kriteret e tyre mbrojtëse nocionin se persekutimi mund të jetë i bazuar në përkatësinë gjinore apo të ushtrohet përmes dhunës seksuale; mëtutje nxitë UNHCR-në dhe akterët

41. Në përpjekje për të kuptuar natyrën e persekutimit të bazuar në gjini, është e rëndësishë thelbësore definimi dhe dallimi i termave "përkatësia gjinore" dhe "seksi gjenetiv". Përkatësia gjinore i referohet marrëdhënies në mes të meshkujve dhe femrave në bazë të identiteteve, të ndërtuara dhe definuara në baza shoqërore ose kulturore, statusi, roli dhe detyrat që i ndahen njerës apo gjinisë tjetër, ndërsa seksi gjenetiv është përcaktim biologjik. Gjinia nuk është statike dhe e lindur, por me kohën merr ndërtim shoqëror dhe kulturor. Ankesat për përkatësinë gjinore mund të rrjedhin edhe nga femrat edhe nga meshkujt, edhe pse, gjatë persekutimeve të ndryshme, më shpesh dhe zakonisht i paraqesin femrat. Në disa raste seksi gjenetiv i paraqitësit mund të jetë i rëndësishë thelbësore në mënyra të ndryshme, në lidhje me të cilat vendimarrësi duhet t'i kushtojë kujdes dhe vëmendje të posaçme. Në rastet tjera, megjithatë, paraqitja për statusin refugjat, të cilën e bën femra gjatë kërkesës për azil, nuk do të ketë kurrëfarë rëndësie siksi/pjella e saj biologjike. Paraqitjet e bazuara në gjini në mënytë tipike përfshijnë, edhe pse asesi nuk janë të kufizuara me kaq rastet e dhunës seksuale, dhunës në familje, planifikimit të detyruar të familjes, gjymtimit të organeve gjinitale të femrave, dënimeve, shkeljes së zakoneve shoqërore dhe diskriminimit të homoseksualëve.
42. Fakti se është miratuar interpretimi i Konventës 1951, e cila kujdeset për çështjet gjinore, nuk do të thotë se femrat automatikisht e gëzojnë të drejtën në statusin refugjat. Paraqitësi i kërkesës për statusin refugjat duhet qartë të dëshmojë se ekziston frikë e dëshmuar nga persekutimi për shkak të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë së ndonjë grupi të posaçëm shoqëror, apo mendimit politik.

tjerë pjesëmarrës të zhvillojnë, promovojnë dhe aplikojnë udhëzimet, kodet e miresjëlles dhe programet për stërvitje të çështjes gjinore të refugjatëve, me qëllim që të përkrahet vendosja në plan të parë të perspektivës gjinore dhe të ngritet niveli i përgjegjësisë për aplikimin e politikës lidhur qasjen e çështjeve gjinore". Poashtu duhet shikuar: Konkluzat e Këshillit Ekzekutiv: Nr. 39, Femrat refugjate dhe mbrojtja ndërkombëtare, 1985; Nr. 73, Mbrojtja e refugjatëve dhe dhuna seksuale, 1993; Nr. 77(g), Konkluzat e Përgjithëshme mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare, 1995; Nr. 79(o), Konkluzat e Përgjithëshme mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare, 1996; dhe Nr. 81(t), Nr. 77, Konkluzat e Përgjithëshme mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare, 1997.

II. ANALIZA E PËRMBAJTJES SË MATERIES

A. SFONDI/HISTORIKU

43. Historikisht, definicioni refugjat interpretohet përmes një përvoje të meshkujve, çka do të thotë se shumë ankesa të paraqitura nga femrat dhe homoseksualët kalojnë pa u vërejtë dhe mbeten të panjohura. Në decenien e fundit, megjithatë, analiza dhe kuptimi i seksit gjenetik dhe gjinisë në kontekstin e refugjatëve përbëjnë një përparim, përgjithësisht, të rëndësishëm në të drejtën e praktikës së mëparëshme, në praktikën e Shtetit përgjithësisht, dhe në punimet shkencore dhe profesionale. Përparimi i tillë ndodh paralelisht me përparimin dhe me ndihmën e zhvillimi të së drejtës ndërkombëtare dhe standardet që ndërliken me të drejtat e njeriut²⁸, si dhe në fushat e ndërlidhura të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë edhe të arriturat përmes jurisprudencës së gjyqeve penale ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën, dhe statutit të Romës të Gjykatës penale ndërkombëtare. Në këtë kuptim, për shembull, duhet marrë parasysh praktikën e dëmshme në shkeljen e ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ku nuk mund të arsyetohet në bazë të themeleve historike, tradicionale, fetare apo kulturore.
44. Edhe pse përkatësia gjinore nuk përfshihet posaçërisht në definicionin refugjat, është pranuar gjerësisht se ajo mund të ndikojë, apo edhe të diktojë, llojin e persekutimit apo dhunës së përjetuar dhe arsyet e trajtimit të tillë. Prandaj, definicioni refugjat, kur interpretohet saktë, përfshinë ankesat dhe kërkesat lidhur me përkatësinë gjinore. Si i tillë, nuk ka nevojë për të shtuar ndonjë bazë shtesë definicionit tani më të dhënë nga Konventa 1951.²⁹
45. Në përpjekje që gjatë procesit të përcaktimit të statusit refugjat të aplikohen kriteret e këtij definicioni të refugjatit, është me rëndësi që vlerësimi të tillë t'i qasemi në mënyrë holistike dhe të merren parasysh të gjitha rrethanat relative të rastit në fjalë. Me rëndësi të thelbësore është të kemi një pasqyrë të plotë të personit që kërkon azil, si dhe pasqyrën e prapavijës dhe përvojave të ngjashme, e poashtu të bëhet analiza mbi njohuritë për rrethanat historike, gjeografike dhe kulturore të vendit të origjinës. Nuk ndihmojnë shumë gjeneralizimet për femrat apo meshkujt, dhe duke bërë gjeneralizimet, dallimet vendimtare, të cilat ndoshta janë vendimtare për rastin në fjalë, mund të mos vërehen.
46. Elementet e definicionit që mëtej shqyrtohen, kërkojnë interpretime të ndjeshme ndaj përkatësive gjinore. Kriteret tjera (p.sh. të qenit jasht vendit të prejardhjes) mbesin, sigurisht, poashtu relevante për vlerësim holistik të secilës kërkesë. Përgjatë tërë këtij dokumenti, përdorimi i termit femër përfshinë poashtu edhe fëmijët-vajza.

²⁸ Në mesin e teksteve të dobishme bëjnë pjesë: Deklarata univverzale për të drejtat e njeriut 1948; Marrëveshja ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike, 1966; Marrëveshja ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, 1966; Konventa për të drejtat politike të grave, 1953; Konventa kundër torturës dhe trajtimeve apo dënimeve tjera mizore, jonjerëzore dhe nënçmuese, 1984; Konventa për të drejtat e femijës, 1989; dhe posaçërisht: Konventa për eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimit ndaj femrave, 1979, dhe Deklarata për eliminimin e dhunës ndaj femrave 1993. Në mesin e instrumenteve relevante regjionale bëjnë pjesë: Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut 1950; Konventa Amerikane për të drejtat e njeriut 1969, dhe Karta Afrikane për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e popujve 1981.

²⁹ Të shikohet: Përmbledhja e konkluzave – Persekutimi në bazë të përkatësisë gjinore, konsultimet Globale për mbrojtjen ndërkombëtare, Tryeza e rumbullakët e Ekspertëve në San Remo, 6-8 shtator 2001, nr. 1 dhe nr. 3.

B. FRIKA E BAZUAR THELLË NGA PERSEKUTIMI

47. Kuptimi i termit "frikë e bazuar nga persekutimi" do të varet nga rrethanat konkrete të secilit rast veç e veç. Është e vërtetë se si meshkujt ashtu edhe femrat, që e aparqesin kërkesën, mund t'i nënshtrohen llojit të njëjtë të dëmtimeve, por ata, poashtu, mund të ballafaqohen me forma të persekutimit që janë karakteristike për seksin gjenetik të tyre. Legjislacioni ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe ligji penal ndërkombëtar, i identifikojnë qartë veprimet e caktuara si shkelje të këtyre ligjeve, sikurse është dhuna seksuale, dhe përkrahin karakterizimin e tyre si keqpërdorime serioze të cilat, në përgjithësi, konsiderohen si persekutim.³⁰ Në këtë kuptim, e drejta ndërkombëtare mund t'i ndihmojë vendimarrësit gjatë përcaktimit të natyrës së persekutimit të ndonjë veprimi specifik. Nuk ka kurrëfarë dyshimi se dhunimi dhe format e tjera të persekutimit, bazuar në përkatësinë gjinore, sikurse është dhuna e motivuar nga paja, gjymtimi i organeve gjinitale të femrave, dhuna në familje dhe trafikimi,³¹ veprime këto të cilat shkaktojnë dhimbje dhe vuajtje të mëdha – shpirtërore dhe fizike – të cilat aplikohen si forma të persekutimit, pa marrë parasysh atë se a është keqbërës shteti apo është fjala për akterë individualë.
48. Vlerësimi i ndonjë **ligji si persekutues në përmbajtje të vet** është treguar si material për përcaktimin e disa ankesave/kërkesave, të bazuara në përkatësinë gjinore. Kjo posaçërisht vlenë kur mirret parasysh fakti se ligjet relevante mund të rrjedhin nga normat dhe praktikat tradicionale apo kulturore, të cilat nuk janë gjithmonë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Mirëpo, si në të gjitha rastet e tjera, paraqitësi i kërkesës megjithatë duhet të tregojë se ai/ajo ndien thellë frikë të bazuar nga persekutimi, si pasojë e ligjit të tillë. Kjo nuk do të ishte si kërkesë, për shembull, atje ku ndonjë ligj persekutues vazhdon të ekzistojë, por që nuk aplikohet më.
49. Edhe atëherë kur një vend ndoshta e **ka ndaluar ndonjë praktikë persekutuese** (për shembull gjymtimi i organeve gjinitale të femrave), ai vend megjithatë mund të vazhdojë "të falë" (të mos dënojë) apo tolerojë atë praktikë, apo ndoshta nuk është në gjendje që në mënyrë efikase të ndalë taktikën në fjalë. Në raste të tilla, praktika në fjalë do të kishte domethënien e persekutimit. Fakti se është nxjerrë ligji, me të cilin ndalohet apo shpallet e dënueshme një praktikë persekutuese, si e tillë nuk do të mjaftojë të përcaktojë se kërkesa e një individi për status të refugjatit nuk është e vlefshme.
50. Atje ku ka **dënim ligjor** për mospranim apo shkelje të ndonjë politike, apo ligji është joproporcionalisht i ashpër dhe poashtu ka dimension të përcaktimit gjinor, përsëri bëhet fjalë për persekutim.³² Edhe nëse ligji është përgjithësisht i zbatueshëm, rrethanat e dënimit apo trajtimit nuk mund të jenë aq të ashpra, sa të jenë në disproporcion me qëllimin e ligjit. Prandaj, dënimi i ashpër për femrat, të cilat me shkeljen e ndonjë ligji, i thyejnë zakonet shoqërore të asaj shoqërie, mund të konsiderohet persekutim.
51. Edhe atje ku **ligji apo politika kanë qëllime të arsyeshme**, metodat e zbatimit që çojnë në pasoja të natyrës kryesisht të dëmshme për personat në fjalë, si rrjedhojë do të ishin persekutim. Për shembull, është gjerësisht e pranueshme se planifikimi i familjes krijon përgjigje të përshtatshme ndaj presioneve të popullatës. Megjithatë, zbatimi i një politike të tillë, përmes shfrytëzimit të abortit dhe sterilizimit të dhunshëm, do të cënonte ligjin fundamental të së drejtave të njeriut. Praktika e tillë, përkundër faktit se ndoshta zbatohet në kontekst të ligjit legjitim, njihet si keqpërdorim serioz dhe konsiderohet persekutim.

³⁰ Të shikohet doracaku i UNHCR-së, paragrafi 51

³¹ Të shikohet mëtej në paragrafin 18

³² Personat që ikin nga ndjekja apo dënimet gjyqësore për kundërvajtje ndaj ligjit zakonor, kryesisht nuk janë refugjatë, megjithatë ky dallim mund të fshihet, posaçërisht në rrethanat e dënimit shumë të rrept për shkelje të ndonjë ligji legjitim. Të shikohet: Doracaku i UNHCR-së, paragrafi 56 dhe 57.

Diskriminimi që shndërrohet në persekutim

52. Ndonëse ekziston pajtueshmëri e përgjithëshme se diskriminimi i 'thjesht', në rrjedha normale, ndoshta edhe nuk rezulton si persekutim në vehte dhe në përgjithësi, një formular i diskriminimit apo ndonjë trajtimi më pak i favorshëm mundet, marrë në përgjithësi, të rezultojë si persekutim dhe ta meritojë dhe arsyejojë mbrojtjen ndërkombëtare. Diskriminimi, për shembull, do të rezultonte në persekutim, nëse masat e diskriminimit do të çonin te pasojat e natyrës thellësisht të dëmshme për personin në fjalë – për shembull kur bëhet fjalë për ndalesa serioze të së drejtës së dikujt për të fituar për jetesë, të drejtën për të ushtruar fenë dhe besimin, apo qasja në entet edukativo-arsimore ekzistuese.³³
53. Për ankesa/kërkesa lidhur me përkatësinë gjinore, është e rëndësishme edhe analiza e formës së diskriminimit nga ana e shtetit, kur ai dështon në mbrojtjen e individit nga lloje të caktuara të dëmit dhe dhunës. Nëse shteti me politikën apo praktikën e vet nuk i harmonizon dhe nuk i pranon të drejtat e caktuara apo mbrojtjen nga keqpërdorimet serioze, diskriminimi apo në garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes, mund të konsiderohet persekutim. Në këtë kontekst, për shembull, do të mund të analizohen rastet konkrete të dhunës në familje apo keqpërdorimet dhe keqtrajtimet për shkak se dikush ndryshon orientimet seksuale.

Persekutimi për shkak të orientimeve seksuale të individit

54. Kërkesat për statusin refugjat për shkak të orientimeve seksuale të individit përmbajnë elemente të përkatësisë gjinore. Seksualiteti dhe praktika seksuale e paraqitësit të kërkesës, mund të jetë relevante për kërkesën e statusit refugjat kur ai person mashkull apo femër është mjet i persekutimit (përfshirë edhe diskriminimin) për shkak të seksualitetit apo praktikës seksuale të tij/saj. Në shumicën e rasteve të tilla bëhet fjalë për individin, i cili refuzon t'iu nënshtrohet roleve apo pritjeve të definuara nga shoqëria apo kultura për mënyrën e sjelljes, që ndërlidhet me seksin gjenetik të tij/saj. Kërkesat/ankesat më të zakonshme, në këtë kuptim, nënkuptojnë homoseksualët, transseksualët dhe travestitët, të cilët ballafaqohen me armiqësi publike të ashpër, dhunë, keqtrajtim, apo përgjithësisht diskriminim të rëndë.
55. Kur homoseksualiteti është joligjor në një shoqëri të caktuar, imponimi i dënimeve të rënda penale për shkak të sjelljeve homoseksuale mund të konsiderohet persekutim, poashtu sikurse është rasti me femrat në disa shoqëri, të cilat refuzojnë të mbajnë vëllon. Poashtu, edhe në vendet ku homoseksualiteti nuk është i karakterizuar si vepër penale, paraqitësi i ankesës mund të krijojë kërkesë valide nëse shteti në heshtje pranon apo toleron praktikën diskriminuese apo dhunën përmes dëmit të shkaktuar atij/asaj, apo kur shteti nuk është në gjendje që në mënyrë efikase paraqitësin e ankesës ta mbrojë nga kjo dhunë apo dëm.

Trafikimi me qëllim të prostitucionit të detyruar apo shfrytëzimit seksual, si formë e persekutimit³⁴

³³ Shiko: Doracak i UNHCR-së, paragrafi 54.

³⁴ Për nevojat e këtyre Direktivave, 'trafikimi' definohet sipas nenit 3 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shuarjen dhe dënimin e tregtisë me njerëz, posaçërisht me femra dhe fëmijë, me çka plotësohet Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, 2000. Neni 3(1) thotë se tregtia me njerëz do të thotë 'rekrutimi, transporti, bartja, mshefja apo pranimi i personave, duke përdorur kërcënimin apo dhunën apo forma tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, tradhëtisë, keqpërdorimit të forcës ose pozitës së dobësisë apo dhënja apo pranimi i pagesave apo fitimeve për të arritur pajtimin e ndonjë personi që ka ndikim ndaj ndonjë personi tjetër, me qëllim të eksploatimit. Eksploatimi

56. Disa femra apo adoleshentë të trafikuar, mund të kenë kërkesa valide për ndarjen e statusit refugjat sipas Konventës 1951. Rekrutimi i detyruar apo mashtrimi i femrave apo të miturëve me qëllim të prostitucionit të detyruar apo eksploatimit seksual, është një nga format e dhunës apo keqpërdorimit të bazuar në përkatësinë gjinore, e cila mund të përfundojë edhe me vdekje. Veprimi i tillë mund të konsiderohet formë e torturës dhe trajtim mizor, jonjerëzor apo nënçmues. Poashtu mund të imponojë përkufizime serioze të lirisë së lëvizjes për femrat, të shkaktuara me rrëmbim, burgim, dhe/apo konfiskim të pasaportës ose dokumenteve tjera personale. Përveç kësaj, femrat dhe të miturit e trafikuar, mund të ballafaqohen me reperkusione të rënda pas ikjes së tyre dhe/apo pas kthimit, sikurse janë reprezalja apo shpagimi nga ana e grupeve apo individëve që merren me trafikimin e njerëzve, mundësia reale që përsëri të jenë të trafikuar, injorimet e rënda nga ana e familjes apo shoqërisë, apo diskriminimi i rëndë. Në raste individuale, fakti se personi ka qenë i/e trafikuar për qëllime të prostitucionit të detyruar apo eksploatimit seksual, si pasojë mund të paraqesë bazë për kërkesë të statusit refugjat atëherë kur shteti nuk është në gjendje apo nuk është i gatshëm t'i ofrojë mbrojtje ndaj kësaj të keqe të tillë apo kërcënimeve me dëmtim.³⁵

Kryesit e veprës së persekutimit

57. Përbrenda definicionit të refugjatit është një hapësirë për të njohur dhe përcaktuar akterët shtetrorë dhe joshetrorë të persekutimit. Persekutimi, të shumtën bëhet nga autoritetet e një shteti, por rastet e rënda të diskriminimit apo aktet e tjera ofenduese që i bën shoqëria, apo individët, poashtu mund të konsiderohen persekutim, nëse aktet e tilla tolerohen me vetëdije nga ana e shtetit ose nëse shteti refuzon, apo nuk është në gjendje të ofrojë mbrojtje efikase.³⁶

C. LIDHJA E SHKAKTUAR ("për arsye/shkak të")

58. Frika e madhe e shkaktuar nga persekutimi, duhet të jetë në lidhje me një apo më shumë baza themelore të Konventës. Me fjalë tjera, ajo duhet të jetë 'për arsye/shkak të' racës, fesë, kombësisë, përkatësisë ndonjë grupi shoqëror, apo mendimit politik. Baza që është në Konventë duhet të jetë faktor relevant kontribues, edhe pse nuk është e nevojshme që ai të jetë shkaku i vetëm, apo dominant. Në shumë sisteme të juridiksionit, kjo lidhje e shkaktuar (kjo për arsye/shkak të') duhet të përcaktohet shumë qartë (për shembull në disa vende ku respektohet ligji zakonor) derisa në vendet tjera përcaktimi i lidhjes së shkaktuar nuk trajtohet si pyetje e posaçme për analizë, por është e përfshirë në analizën holistike të definicionit të refugjatit. Në shumicën e kërkesave, që kanë të bëjnë me përcaktimin gjinor, çështje e vështirë për vendim-arrësin ndoshta nuk është vendimi sipas bazave të aplikueshme, aq sa është i vështirë vendimi sipas lidhjes shkajkore: përkatësisht fakti se frika e dëshmuar nga persekutimi ka qenë shkak për atë bazë. Dhënia apo atribuimi i bazës konvencionale paraqitësit të kërkesës nga ana e shtetit apo ndonjë akteri tjetër të persekutimit, mjafton të krijohet kjo lidhje e kërkuar shkajkore.

59. Në rastet kur ekziston rreziku se një person do të persekutohet nga ndonjë akter jo-shteti (për shembull nga burri, partneri, apo ndonjë akteri tjetër që nuk është shteti) nga shkaqet që lidhen me ndonjë nga bazat e Konventës, përcaktohet lidhja shkajkore edhe nëse mungesa e mbrojtjes nga shteti është e lidhur ose jo me Konventën. Në të kundërtën, kur rreziku nga persekutimi nga ana e ndonjë akteri jo-shteti nuk është në lidhje me ndonjë bazë të Konventës, mirëpo paaftësia apo jogadishmëria

së paku do të përfshijë shfrytëzimin e prostituimit të personit tjetër apo formave tjera të shfrytëzimit seksual, punën dhe shërbimin e detyruar, skllavërinë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë, shërbim i detyruar apo heqje të organeve."

³⁵ "Tregtia/trafikimi" me njerëz për qëllime tjera, poashtu mund të rezultojë në persekutim në ndonjë rast tjetër konkret, varësisht nga rrethanat.

³⁶ Të shikohet: Doracaku i UNHCR-së, paragrafi 65.

e shtetit për të ofruar mbrojtje ekziston si e tillë në bazat e Konventës, poashtu mund të përcaktohet lidhja shkajkore.³⁷

D. BAZAT E KONVENTËS

60. Duke u kujdesur që secilës bazë të Konventës t'i jepet interpretimi i ndjeshmërisë gjinore, ka rëndësi gjatë përcaktimit nëse ndonjë person i plotëson kriteret për definimin refugjat. Në shumicën e rasteve, paraqitësit e kërkesave mund të ballafaqohen me persekutim për shkak të ndonjë baze të Konventës që iu është përcaktuar apo mveshur. Në shumë shoqëri, mendimi politik i femrës, raca e saj, kombësia, feja apo lidhjet shoqërore, shpesh shikohen si diçka që radhitet dhe ndërlidhet me elementet përkatëse që vlejné për të afërmit apo kolegët, ose me të tjerët në bashkësinë e saj.
61. Poashtu është me rëndësi të mirret parasysh se, në shumicën e kërkesave që ndërlidhen me përkatësinë gjinore, frika nga persekutimi mund të jetë si shak i një apo më tepër bazave të Konventës. Për shembull, kërkesa për statusin refugjat i bazuar në tejkalimin e normave shoqërore apo fetare mund të analizohet në kuptim të religjionit, mendimit politik, apo përkatësisë së ndonjë grupi të caktuar shoqëror. Nga paraqitësi i kërkesës nuk kërkohet që në mënyrë precize të identifikojë arësyen për shkak të së cilës ai/ajo ka bazë të fortë/dëshmi të frikës nga persekutimi.

Raca

62. Për nevojat e definicionit të refugjatit, raca definohet ashtu që përfshinë të gjitha grupet etnike për të cilat flitet si 'raca' në të folmen e përditëshme.³⁸ Persekutimi për shkak të racës mund të shprehet në mënyra të ndryshme ndaj meshkujve dhe femrave. Për shembull, persekutuesi mund të orientohet të shkatërrojë identitetin dhe/apo prosperitetin e ndonjë grupi racor përmes vrasjes, gjymtimit, apo burgosjes së meshkujve, derisa femrat mund të shihen si mjet për shpërndarjen e identitetit etnik apo racor, andaj persekutimi bëhet në forma tjera, si për shembull, përmes dhunës seksuale apo kontrollit të reproduktionit.

Feja/Besimi

63. Në vendet e caktuara, feja ndanë role dhe kode të caktuara të sjelljes së femrave, përkatësisht meshkujve. Aty ku femra nuk e përmbushë rolin me të cilin është ngarkuar apo refuzon t'iu nënshtrohet kodeve dhe si pasojë dënohet, ajo mund të ketë bazë të fortë për frikë nga persekutimi për shkak të fesë. Refuzimi për t'iu nënshtruar kodeve të përcaktuara mund të kuptohet dhe përjetohet si dëshmi së femra ushqen qëndrime dhe mendime të papranueshme fetare, pa marrë parasysh se çka me të vërtetë ajo mendon, apo beson. Femra poashtu mund të ballafaqohet me keqtrajtime për shkak të besimeve apo veprimeve të posaçme fetare të saj, apo për ato që i mëveshen, përfshirë këtu edhe refuzimin e saj që t'iu përmbahet këtyre besimeve, apo që të sillt sipas rregullave të përcaktuara fetare.
64. Në kërkesat e bazuara në përkatësinë gjinore, ekziston një përkim i pjesshëm në mes të besimit fetar dhe mendimit politik, posaçërisht të mendimit politik të imputuar. Meqenëse parimet fetare kërkohen nga femrat në mënyrë të posaçme të sjelljes, sjellja e kundërt mund të kuptohet dhe përjetohet si dëshmi e ndonjë mendimi të papranueshëm politik. Për shembull, në disa shoqëri roli i përcaktuar për femrat mund të shpjegohet si kërkesë e shtetit apo fesë zyrtare. Refuzimi i femrës për t'iu nënshtruar atij roli, autoritetet apo akterët tjerë të persekutimit mund ta përjetojnë si lëshim në ushtrimin apo pranimin e besimeve fetare të caktuara. Në të njëjtën kohë, mospajtimi me kërkesën mund të interpretohet si

³⁷ Të shikohet Përmbledhja e konkluzave – Persekutimi në bazë të përkatësisë gjinore, nr. 6.

³⁸ Të shikohet Doracaku i UNHCR-së, paragrafi 68.

mbajtje e ndonjë mendimi të papranueshëm politik, i cili dëmton strukturën bazë, nga e cila rrjedhë forca politike e caktuar. Kjo sidomos vlenë për shoqëritë ku ka pak dallim në mes të institucioneve, ligjeve dhe doktrinave shtetërore me ato fetare.

Kombësia/Nacionaliteti

65. Kombësinë nuk duhet kuptuar vetëm si 'shtetësi'. Ky term poashtu i referohet përkatësisë së ndonjë grupi etnik apo gjuhësor dhe mundet, aty-këtu, të përputhet me termin 'racë'.³⁹ Edhe pse persekutimi në bazë të kombësisë (sikurse edhe në rastin e racës) nuk është specifik vetëm për femrat apo për meshkujt, në shumicën e rasteve natyra e persekutimit merr formën e ndërlidhjes me përkatësinë gjinore, shpesh formën e dhunës seksuale ndaj grave dhe vajzave.

Përkatësia e ndonjë grupi të posaçëm shoqëror⁴⁰

66. Kërkesat që lidhen me përkatësinë gjinore shpesh analizohen përbrenda parametrave të kësaj baze, duke dhënë interpretim të drejt të këtij termi të rëndësisë së lartë. Në disa raste, megjithatë, theksi i vënë në bazë të grupit shoqëror mund të tregojë se bazat tjera, sikurse janë feja dhe mendimi politik, janë lënë pasdore. Prandaj, interpretimi kushtuar kësaj baze nuk mund t'i bëjë të tepërta katër bazat tjera të Konventës.
67. Një grup i caktuar shoqëror, pra, është një grup njerëzish që kanë të përbashkët një sërë karakteristikash, përveç asaj se janë në rrezik të persekutimit, apo që shoqëria i konsideron si grup. Karakteristika e tillë, zakonisht, është një nga ato të lindurat, e pandryshuar, apo e cila ka rëndësi për identitetin, ndërgjegjen apo të drejtat njerëzore të individit.
68. Nga kjo rrjedhë se seksi gjenital bindshëm mund t'i përket kufinjëve të kategorisë së grupit shoqëror, ku femrat janë shembull i qartë i një nënbashkësie shoqërore të definuar me karakteristika të lindura dhe të pandryshueshme, të cilat shpesh trajtohen ndryshe nga meshkujt.⁴¹ Karakteristikat e tyre i definojnë ato edhe si grup në shoqëri, dhe të nënshtuara trajtimit dhe standardeve të ndryshme në disa vende.⁴² Poashtu, ky definicion i përshtatet edhe homoseksualëve, transseksistëve, apo transvestitëve.
69. Madhësia e grupit ndonjëherë shfrytëzohet si bazë për refuzimin që 'femrat' përgjithësisht të pranohen si grup i posaçëm shoqëror. Ky argument nuk ka bazë në faktet apo arësyet, sepse bazat tjera nuk janë të lidhura me këtë çështje të madhësisë. Poashtu nuk do të duhej të kishte kërkesa që grupi i caktuar shoqëror të jetë koheziv dhe që anëtarët e vet t'i përkasin vullnetarisht,⁴³ apo që secili anëtar i grupit të jetë në rrezik nga persekutimi.⁴⁴ Fuqimisht është pranuar se duhet të jetë e mundëshme të identifikohet grupi i pavarur nga persekutimi, edhe pse diskriminimi apo persekutimi mund të jenë shkaqe relevante gjatë përcaktimit të dukurisë së grupit në një kontekst konkret.⁴⁵

³⁹ Të shikohet: Doracaku i UNHCR-së, paragrafi 74.

⁴⁰ Për informata shtesë të shikohen Direktivat e UNHCR-së për mbrojtjen ndërkombëtare: 'përkatësia ndonjë grupi të caktuar shoqëror' në kontekstin e nenit 1A(2) të Konventës 1951, dhe/apo Protokoli 1967 mbi statusin e refugjatëve (HCR/GIP/02/02, 7 maj 2002).

⁴¹ Të shikohet Përmbledhja e konkluzave – Persekutimi në bazë të përkatësisë gjinore, nr. 5.

⁴² Poashtu të shikohet: Konkluzat e Këshillit ekzekutiv, nr. 39, Femrat refugjate dhe mbrojtja ndërkombëtare, 1985: 'Shtetet ... kanë lirinë të miratojnë interpretimin sipas të cilit femrat – kërkuese të azilit, të cilat ballafaqohen me sjellje mizore apo jonjerëzore për shkak se kanë shkelur zakonet shoqërore të shoqërisë ku jetojnë, mund të mirren si 'grup shoqëror i posaçëm' sipas domethënies së nenit 1A(2) të Konventës së Kombeve të Bashkuara të 1951".

⁴³ Të shikohet: Përmbledhje e Konkluzave – Përkatësia e ndonjë grupi shoqëror, konsultimet Globale për mbrojtjen ndërkombëtare, tryeza e rumbullakët e Ekspertëve në San Remo, 6-8 shtator 2001, nr. 4 (Përmbledhje e Konkluzave – Përkatësia ndonjë grupi shoqëror).

⁴⁴ Të shikohet Përmbledhje e Konkluzave – Përkatësia e ndonjë grupi shoqëror, ibid., nr. 7.

⁴⁵ Të shikohet Përmbledhje e Konkluzave – Përkatësia e ndonjë grupi shoqëror, ibid., nr. 6.

Mendimi politik

70. Sipas kësaj baze, paraqitësi i kërkesës duhet të dëshmojë se – qoftë fjala për mashkull apo femër – ka bazë të fortë për frikë nga persekutimi për shkak të mendimeve politike të caktuara (zakonisht janë të ndryshme nga ato që kanë qeveria ose pjesët e shoqërisë), apo për shkak se atij/saj ia kanë mvëshur qëndrimin e mendimit të tillë politik. Mendimi politik duhet të vështrohet në kuptim të gjerë, për të përfshirë çfarëdo mendimi për çfarëdo çështje, për të cilën makineria e shtetit, qeverisë, e shoqërisë apo e politikës mund të angazhohej. Këtu mund të përfshihet edhe mendimi në lidhje me rolet gjinore. Poashtu mund të përfshihet edhe sjellja jokonvencionale, e cila e bën persekutorin që personit t'ia mvëshë ndonjë mendim politik. Në këtë kuptim, nuk ekziston asgjë që vetvetiu do të ishte një aktivitet i trashëguar politik apo jopolitik, por konteksti i rastit të dhënë, duhet ta përcaktojë natyrën e tij. Mirëpo, kërkesa për statusin refugjat, e bazuar në mendimin politik me të vërtetë presupozon se paraqitësi i kërkesës mbanë, apo supozohet se mbanë mendime, të cilat nuk tolerohen nga qeveria apo shoqëria, të cilat në mënyrë kritike i qasen politikës, traditës apo metodave të tyre. Kërkesa poashtu presupozon se mendimet e tilla janë vërejtë apo do të mund të vëreheshin nga autoritetet apo pjesët relevante të shoqërisë, apo nga ana e tyre i mëveshen paraqitësit të kërkesës. Nuk është gjithmonë e nevojshme që personi të ketë shprehur ndonjë mendim të tillë, apo të ketë përjetuar çfarëdo qoftë forme të diskriminimit apo persekutimit. Në raste të tilla, testi për frikë të dëshmuar do të bazohet në vlerësimin e pasojave me të cilat paraqitësi i kërkesës, që ka dispozita të caktuara, do të ballafaqohet në qoftë se ai apo ajo do të kthehej.
71. Imazhi i refugjatit politik, si dikush që ikë nga persekutimi për shkak të angazhimit të vet në aktivitete politike, nuk përputhet gjithmonë me realitetin e përvojave të femrave në disa shoqëri. Për femrat ka më pak mundësi, sesa për homologët e tyre meshkuj, të angazhohen në politikë të profilit të lart, dhe ato më shpesh janë të angazhuara në aktivitete politike të 'nivelit më të ulët' në të cilat pasqyrohen rolet gjinore dominante. Për shembull, femra mund të inkuadrohet në shërimin e kryengritësve të sëmurë dhe të plagosur, në rekrutimin e simpatizerëve, apo në përgatitjen dhe shpërndarjen e trakteve. Femrave, poashtu, shpesh iu mvishen mendimet politike të familjes së tyre apo të afërmëve meshkuj, dhe i nënshtrohen persekutimit për shkak të veprimtarisë politike të të afërmëve të tyre meshkuj. Kjo mund të analizohet në kontekstin e mendimit politik të mëveshur, por poashtu mund të analizohet edhe si persekutim për shkak të përkatësisë së femrës ndonjë grupi të caktuar shoqëror, që është 'familja' e saj. Këta shkaktarë gjithsesi duhet marrë parasysh në kërkesat që ndërliken me përkatësinë gjinore.
72. Për kërkesat që ndërliken me përkatësinë gjinore, poashtu është me rëndësi të kuptohet dhe pranohet se femra ndoshta nuk dëshiron të angazhohet në veprime të caktuara, sikurse është përgatitja dhe shëbimi i ushqimit ushtarëve të qeverisë ('ushtrisë së shtetit'), çka mund të konsiderohet nga persekutori si posedim i mendimit të kundërt politik.

III. ÇESHTJET PROCEDURALE⁴⁶

73. Personat të cilët i inicojnë kërkesat për statusin refugjat, e që ndërlidhen më përkatësinë gjinore, dhe posaçërisht personat që kanë përjetuar torturë apo traumë, e kërkojnë rrethin që do t'i përkrahë dhe ku do të mund të ndihen të sigurtë për besueshmërinë/sekretin e kërkesës së tyre. Për shkak të turpit që ndiejnë për atë që iu ka ndodhur, apo për shkak të traumës, disa paraqitës të kërkesave mund të jenë jo edhe aq të gatshëm ta identifikojnë vëllimin e vërtetë të persekutimit që kanë përjetuar apo nga i cili frikësohen. Personat e tillë edhe mëtej mund të kenë frikë nga personat në pushtet, apo mund të frigohen nga refuzimi dhe/apo ndëshkimi i familjes dhe/ose i bashkësisë së vet.⁴⁷

74. Përkundër kësaj prapavije, me qëllim të sigurimit se, kërkesat e bazuara në përkatësinë gjinore, posaçërisht ato të inicuara nga femrat, kanë shqyrtim të drejtë gjatë procesit të përcaktimit të statusit refugjat, duhet marrë parasysh masat në vijim:

- i. Me femrat që kërkojnë azil duhet bërë biseda të ndara, pa praninë e anëtarëve meshkuj të familjes, që ato të ndihen të sigurta se kanë mundësi t paraqesin rastin e tyre. Atyre duhet shpjeguar se ndoshta kanë kërkesë valide në bazë të së drejtës së tyre personale.
- ii. Është e rëndësishme thelbësore që femrave t'iu ofrohen informata për procesin e përcaktimit të statusit, të qasjes në te, si dhe këshilla ligjore, në mënyrën dhe në gjuhën që ato e kuptojnë.
- iii. Paraqitësit e kërkesës duhet të dijnë se kanë të drejtë të zgjedhin intervistuesit dhe përkthyesit e seksit gjeneral të njejtë sikurse i tyre,⁴⁸ dhe në rast se paraqitësi i kërkesës është femër, kjo duhet mundësuar automatikisht. Intervistuesit dhe përkthyesit duhet të kenë parasysh dhe të jenë të hapur ndaj çfarëdo ndjeshmërie kulturore apo fetare, apo të faktorëve personalë, sikurse janë mosha dhe niveli i arsimimit.
- iv. Një ambient i hapur dhe i sigurtë, shpesh herë ka rëndësi thelbësore për vendosjen e besueshmërisë në mes të intervistuesit dhe paraqitësit të kërkesës, dhe duhet t'i ndihmojë dhe kontribuojë zbardhjes së plotë, e ndonjëherë edhe shumë të ndjeshme dhe personale, të informatave. Dhoma ku zhvillohet biseda duhet të jetë e rregulluar në atë mënyrë që të inkurajojë bisedën, të sigurojë besueshmërinë dhe zvogëlojë çdo mundësi që të ndihet me ndikim dhe influencë jobalancuese.

⁴⁶ Kjo Pjesë shfrytëzon udhëzime të vlefshme, të cilat i kanë ofruar Shtete të ndryshme dhe akterë tjerë, duke përfshirë edhe këto udhëzime: çka duhet të dijnë nëpunësit për çështje të azilit, të cilët i shqyrtojnë kërkesat për azil, të paraqitura nga femrat (Shërbimi për imigrim dhe dhënie të shtetësisë, SHBA, 26 maj 1995); Paraqitësit e kërkesës për viza humanitare dhe të refugjatëve: Direktivat për vendimarrësit për çështjet e përkatësisë gjinore (Ministria për imigrim dhe çështje humanitare, Australi, korrik 1996); Udhëzimi 4 në lidhje me femrat-kërkuese të statusit refugjat, të cilat janë në frikë nga persekutimi në bazë të përkatësisë gjinore: Versioni i freskuar (Këshilli për imigrim dhe refugjatë, Kanadë, 13 nëntor 1996); Pozicioni për azil-kërkim dhe femrat refugjate (Këshilli Evropian për refugjatë dhe egzil, dhjetor 1997); Direktivat për marrjen e vendimeve të kërkesave për azil në Mbretërinë e Bashkuar, që ndërlidhen me përkatësinë gjinore (Grupi Ligjor për femrat refugjate, korrik 1998); Direktivat që ndërlidhen me përkatësinë gjinore për dhënie të azilit (Konzorciumi kombëtar për çështje të refugjatëve, Republika Jugafrikane, 1999); Direktivat që ndërlidhen me përkatësinë gjinore gjatë vendim-marrjes për azil (Autoriteti apelues për imigracion, Mbretëria e Bashkuar, nëntor 2000); Persekutimi i bazuar në përkatësinë gjinore: Direktivat për shqyrtim dhe vlerësim të nevojave të femrave për mbrojtje (Këshilli për migracion, sektori për praktikë ligjore, Suedi, 28 mars 2001).

⁴⁷ Poashtu të shikohet: Dhuna seksuale ndaj refugjatëve: Udhëzimet për parandalim dhe reagim (UNHCR, Gjenevë, 1995) dhe: Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në gjini në situata të refugjatëve (Raporti i Konferencës ndër-agjensionesh mbi mësimet e nxjerrura, 27-29 mars 2001, Gjenevë).

⁴⁸ Poashtu të shikohet Raporti i Këshillit Ekzekutiv nr. 64, Femrat refugjate dhe mbrojtja ndërkombëtare, 1990, (a) (iii): Siguroni, kudo që është e mundur, femra të kualifikuara intervistuese për procedim në përcaktimin e statusit refugjat dhe mundësoni qasje të përshtatshme për femrat kërkuese të azilit, madje edhe nëse ato janë në përcjellje të anëtarëve meshkuj të familjes.

- v. Intervistuesi së pari duhet ta prezentojë veten dhe përkthyesin para paraqitësit të kërkesës, t'ia shpjegojë qartë roline vet, dhe qëllimin e sakt të asaj bisede. Paraqitësi i kërkesës duhet të bindet se kërkesa e tij/saj do të trajtohet në besueshmërinë dhe fshehtësinë më të rreptë, dhe se informatat e dhëna, të paraqitësit të kërkesës, nuk do t'i jepen anëtarëve të familjes së tij/saj. Poashtu është me rëndësi që personi që udhëheqë bisedën të shpjegojë për veten se nuk është këshilltar dhe ekspert për tejkalimin e traumave të përjetuara.
- vi. Intervistuesi duhet të mbetet neutral, i ndjeshëm dhe objektiv gjatë zhvillimit të bisedës, dhe duhet t'i shmanget 'të të folurit të trupit' apo gjestikulimit, të cilët mund të kuptohen si frikësim apo, shikuar sipas kulturës së paraqitësit të kërkesës, të pandjeshme dhe të pavend. Intervistuesi duhet t'i lejojë paraqitësit të kërkesës të prezentojë kërkesën e tij/saj, sipas mundësisë, me sa më pak ndërprerje dhe ndërhyrje.
- vii. Në të gjitha bisedat për azil duhet përfshirë pyetje 'te hapura' dhe konkrete, të cilat mund të ndihmojnë në zbulimin e çështjeve gjinore relevante për kërkesën e statusit refugjat. Femrat të cilat kanë qenë të angazhuara indirekt në aktivitete politike apo të cilave u është mëveshur mendimi politik, për shembull, shpesh ato nuk ofrojnë informata relevante gjatë këtyre bisedave për shkak të natyrës së bisedës të orientuar-kah natyra mashkullore. Femrat të cilat e kanë paraqitur kërkesën, poashtu, mund të dështojnë në lidhjen e pyetjeve që kanë të bëjnë me 'torturën' dhe me llojet e ndëshkimeve që ato i kanë frikë (sikurse janë dhunimi, shpërdorimi seksual, gjymtimi i organve gjenitale të femrave, humbja e krenarisë', martesat e detyruara, etj.).
- viii. Posaçërisht, në rastet e dhunës seksuale apo formave tjera të traumës, mund të shtrohet nevoja për biseda tjera shitesë, me qëllim të vendosjes së besueshmërisë dhe për të mbledhur të gjitha informatat. Në këtë kuptim, intervistuesit duhet të jenë të ndieshëm ndaj traumës dhe emocioneve të paraqitësit të kërkesës dhe duhet ta ndalin bisedën kur paraqitësi të fillojë të shfaqë shenja të shqetësimit emocional.
- ix. Atje ku vërehet se rasti i caktuar mund të krijojë bazë për kërkesë, që ndërlidhet me përkatësinë gjinore, është i nevojshëm procedimi i përshtatshëm, i cili poashtu mundëson vendosjen e raporteve të besueshmërisë dhe besimit, të cilat duhet të zhvillohen te paraqitësi i kërkesës, dhe njëkohësisht i mundëson intervistuesit të parashtrijë pyetje me vend dhe të merret me cilindo problem që mund të lindë gjatë bisedës.
- x. Duhet mbledhur informatat mbi vendin e origjinës, të cilat janë relevante për kërkesat e femrave, për shembull të dhënat për pozitën e femrave në ligj, për të drejtat politike të femrave, të drejtat ekonomike dhe shoqërore të femrave, zakonet kulturore dhe shoqërore të vendosura në vendin në fjalë dhe për pasojat në rast të shkeljes së tyre, përhapjes së praktikave të tilla të dëmshme tradicionale, shkallën dhe format e dhunës së paraqitur ndaj femrave, për mbrojtjen që femrat e kanë në dispozicion, për çfarëdo lloji të denimeve të përcaktuara për persekutorët e dhunës dhe për rreziqet me të cilat femra do të mund të ballafaqohet pas kthimit të saj në vendin e origjinës, sepse e ka inicuar kërkesën për statusin refugjat.
- xi. Lloji dhe niveli i emocioneve të shfaqura gjatë rrëfimit të femrës për atë çfarë ka përjetuar, nuk duhet të ndikojnë në kredibilitetin e saj. Intervistuesit dhe vendimarrësit duhet të kuptojnë se dallimet kulturore dhe traumat luajnë rol të rëndësishëm dhe kompleks në përcaktimin e sjelljes. Në disa raste të veçanta, është me vend të kërkojnë dëshmi objektive psikologjike apo mjeksore. Nuk është e nevojshme të vendosen detajet precize të vet aktit të dhunimit apo të përdhunimit seksual, por është e nevojshme të përcaktohen shkaqet që kanë çuar deri te ky akt, veprimet që kanë pasuar, rrethanat e përgjithëshme dhe detajet (sikurse janë shfrytëzimi i armëve, çfarëdo lloj fjalësh apo shprehjesh që kanë përdorur persekutuesit, lloji i përdhunimit,

kur dhe si ka ndodhur akti, detajet për persekutorët – a kanë qenë ushtarë, civilë, etj.), dhe mund të jetë e nevojshme të dihet edhe motivi i persekutuesit. Në disa raste, dhe nën disa rrethana, duhet marrë parasysh se femra ndoshta edhe nuk është e vetëdijshme për arsyet e keqtrajtimit.

- xii. Aty ku është e nevojshme, duhet vendosur dhe mundësuar qasjen në mekanizmat për përcjellje dhe këshillime psiko-sociale dhe shërbime tjera të nevojshme. Praktikrat e dëshmuara më mirë, rekomandojnë që këshilltarët e stërvitur psiko-socialë të jenë në dispozicion dhe ta ndihmojnë paraqitësin e kërkesës para dhe pas bisedës.

Cështjet e dokumentimit dhe dëshmisë

- 75. Nuk është e obligueshme asnjë dëshmi e dokumentuar, që një qeveri t pranojë kërkesën për refugjat, edhe pse të gjitha informatat që kanë të bëjnë me praktikrat në vendin e origjinës, mund të mbështesin një rast konkret. Është me rëndësi të mirret parasysh se, kur bëhet fjalë për kërkesat e ndërlydhura me përkatësinë gjinore, tipet e zakonshme të dëshmive, që shqyrtohen gjatë përcaktimit të kërkesave tjera për refugjatë, mund të mos jenë në dispozicion edhe aq lehtë, për shkak të mosparaqitjes së mjaftueshme të rasteve dhe ndjekjes së dobët ligjore. Format alternative të informimit, poashtu, mund të ndihmojnë, si për shembull dëshmitë e femrave tjera në situata të ngjashme në formë të raporteve të shkruara apo deklaratave gojore, dëshmitë që rrjedhin nga organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare, apo ndonjë hulumtim tjetër i pavarur.

IV. METODAT E IMPLEMENTIMIT

- 76. Varësisht nga tradita ligjore konkrete, ekzistojnë dy qasje të përgjithëshme, të cilat Shtetet i ndërmarrin për të siguruar aplikimin e ligjit për refugjatët, i ndieshëm ndaj përkatësisë gjinore, dhe posaçërisht definicioni refugjat, i cili e pranon atë përcaktim. Disa shtete i kanë përfshirë udhëzimet për interpretimin ligjor dhe/ose garancat procedurale në vetw legjislacionin, derisa shtetet tjera preferojnë që në kuptim të njejtë të zhvillojnë politikë të veprimit dhe direktiva ligjore për vendimarrësit. UNHCR i nxitë Shtetet, të cilat ende nuk kanë ndërmarrë hapa për sigurimin e aplikimit të ligjit dhe procedurës për statusin refugjat dhe veprime, të cilët janë të ndieshëm në përkatësinë gjinore, dhe se në çdo moment dhe në çdo mënyrë të mund të ofrojë ndihmë për këtë çështje.

SHTOJCA 1

KODI I MIRËSJELLJES I UNHCR-së

Hyrje

Kapaciteti i UNHCR-së për të siguruar mbrojtjen dhe për të ndihmuar refugjatët dhe personat e tjerë nën përgjegjësinë e vet, varet nga aftësitë e personelit të vet që të mbështesin dhe të promovojnë standardet më të larta të sjelljes etike dhe profesionale. Ne, dhe i tërë personeli që e përbën UNHCR-në, personalisht dhe si kolektiv jemi përgjegjës për mbajtjen e këtyre standardeve. Udhëheqësit kanë përgjegjësi të posaçme për t'i ruajtur këto standarde, për të dhënë shembull të mirë, dhe për të krijuar për personelin një ambient përkrahës dhe fuqizues të punës.

Pranohet fakti se puna e UNHCR-së shpesh e vë personelin e vet në pozitë të influencës, në raport me ata për të cilët ekziston. Personeli ka përgjegjësinë që këtë pozitë të mos e keqpërdorë.

Ky Kod i sjelljes është i menduar t'i shërbejë personelit si udhëzues i ilustruar për marrjen e vendimeve etike në jetën profesionale, dhe ndonjëherë edhe në jetën e tyre private. Fjala është për kodin moral, i cili nuk e ka fuqinë e ligjit. Ai është i përpiluar për të ndihmuar personelin, që më mirë të kuptojë obligimet për sjelljen e tyre të përcaktuara me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe me Urdhëresat dhe rregulloret e Personelit, që janë dokumente, të cilat ende e luajnë rolin e instrumenteve ligjore të cilët përcaktojnë sjelljen e pranueshme në UNHCR. Akti i nënshkrimit të Kodit nuk i heq personelit të UNHCR-së asnjë të drejtë të fituar dhe të garantuar.

Kodi i sjelljes pranon faktin se ligjet dhe zakonet lokale mund të dallojnë nga vendi në vend, por është i bazuar në standardet juridike ndërkombëtare. Për shembull, fëmijët definohen si persona më të rinj se 18 vjet. Udhëzimet për interpretim të drejtë dhe të përshtatshëm mund të gjenden në Shënimet për Kodin e sjelljes.

Kodi vlen për të gjithë personelin e UNHCR-së, nga të cilët kërkohet që ta nënshkruajnë. Nga personat e angazhuar me kontratë si konsultantë në UNHCR, apo ata të cilët janë si praktikantë, pas pranimit të Kodit, edhe nga ata do të kërkohet të konfirmojnë se i mbështesin standardet e tij po aq sa është e mundur dhe e zbatueshme, në suazat e statusit të tyre. Poashtu, edhe nga organizatat qeveritare dhe ato joqeveritare dhe ndërmarrjet, të cilat përmes të punësuarve të tyre, punojnë për UNHCR-në, do të kërkohet që t'i njoftojnë të punësuarit, në një mënyrë të përshtatshme, me parimet që përmbanë Kodi.

Të gjithë të punësuarit e UNHCR-së janë përgjegjës për përkrahjen, përfaqësimin dhe promovimin e përhapjes së Kodit të mirësjelljes. Ata poashtu kanë rol në zbatimin, mbikqyrjen dhe imponimin e standardeve të tij. Nga ata, gjithashtu, fuqimisht kërkohet t'i nxisin partnerët që të aderojnë në këto standarde dhe t'i bashkangjiten personelit të UNHCR-së në mbështetjen e tyre.

VLERAT THEMELORE DHE PARIMET ORIENTUESE

Personeli i UNHCR-së u zotohen këtyre vlerave dhe parimeve fundamentale:

- Si personel që punon në kuadër të Kombeve të Bashkuara, do të kujdesemi që sjellja jonë të jetë në përputhje me vlerat që pasyron Karta e Kombeve të Bashkuara: respektimin e të drejtave fundamentale të njeriut, drejtësinë shoqërore dinjitetin njerëzor, dhe respektimin e të drejtave të barabarta për meshkujt dhe femrat. Do të ndihmojmë UNHCR-në, që në mënyrë aktive të promovojë respektimin dhe zbatimin e parimeve ndërkombëtare për të drejtat e refugjatëve, ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe të drejtën humanitare ndërkombëtare. Do të na udhëheqin dhe udhëzojnë vlerat themelore të sistemit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë këtu profesionalizmin, ndershmërinë dhe respektimin e diversitetit, dhe gjithmonë do ta ruajmë perspektivën ndërkombëtare.
- Si personel i UNHCR-së, angazhim parësor e kemi mbrojtjen e refugjatëve dhe personave tjerë për të cilët ekzistojmë, dhe t'i ndihmojmë ata në pajtueshmëri me mandatin e Zyrës. Jemi të zotuar në përkrahjen më të plotë të mundëshme të pjesëmarrjes së refugjatëve dhe personave tjerë nën përgjegjësinë tonë - si individë, familje apo bashkësi – në vendimet që prekin jetën e tyre.
- Do të respektojmë dinjitetin dhe vlerat e secilit individ, do të promovojmë dhe zbatojmë mirëkuptimin, respektin, keqardhjen dhe tolerancën, dhe në vepër do të dëshmojmë maturi dhe do ta mbajmë besueshmërinë, ashtu si dhe për aq sa është kërkuar. Do të synojmë të ndërtojmë marrëdhënie konstruktive dhe respektuese të punës me partënerët tanë në punë humanitare, pandërpre do të kërkojmë mënyra të reja në përmirësimin dhe përparimin e punës tonë, dhe do të ushqejmë klimën e cila nxitë mësimin, përkrahë ndyshimet pozitive dhe zbaton mësimet e nxjerra nga përvoja jonë.
- Do të tregojmë njësoj respekt për secilin person, pa dallim race, përkatësie gjinore, fetare, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes kombëtare apo etnike, gjuhës, statusit martesor, orientimit seksual, moshës, statusit ekonomik-shoqëror, invaliditetit, bindjeve politike, apo çfarëdo lloji tjetër dallues. Fuqimisht do të përpiqemi të mënjanojmë të gjitha pengesat e barazisë.
- Do të respektojmë kulturën, zakonet dhe traditën e të gjithë popujve, dhe fuqimisht do të angazhohemi t'i shmangemi sjelljes që nuk është e pranueshme në një kontekst kulturor konkret. Mirëpo, kur një traditë apo zakon i posaçëm konsiderohet nga organi relevant i Kombeve të Bashkuara, si veprim në kundërshtim me ndonjrin nga standardet apo instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, do të udhëheqemi sipas standardit apo instrumentit të aplikueshëm për të drejtat e njeriut.

ZOTIMI NDAJ KODIT TE SJELLJES së UNHCR-së

Si punonjës i UNHCR-së, zotohem se:

1. *Ndaj të gjithë refugjatëve dhe personave tjerë nën përgjegjësinë tonë, do të veproj drejt, dhe me respekt e dinjitet.*

Gjithmonë do të përpiqem të kuptoj përvojat e vështira, me të cilat refugjatët dhe personat tjerë nën përgjegjësinë e UNHCR-së, janë ballafaquar dhe nëpër të cilat kanë kaluar, si dhe pozitën e palakmueshme dhe të papërshtatshme, në të cilën ata – posaçërisht për shkak të moshës, gjinisë apo paaftësisë – mund të gjenden, për dallim nga ata që mbajnë fuqinë dhe kanë ndikim ndaj aspekteve të ndryshme të jetës së tyre.

Gjithmonë do të përpiqem për kujdesin dhe mbrojtjen e të drejtave të femijës, dhe do të veproj në atë mënyrë, e cila garanton se intereset më të mira për te janë të rëndësishme parësore.

Nëse puna ime nënkupton punën e drejtpërdrejt me refugjatët apo personat tjerë për të cilët jemi përgjegjës, unë do të takohem rregullisht me ta, për të kuptuar plotësisht se çka kanë përjetuar dhe për çka kanë nevojë, dhe për të sqaruar rolin e UNHCR-së dhe fushën e veprimit të Komësariatit.

Do të jem gjithmonë e informuar për politikën e UNHCR-së, qëllimet e përcaktuara dhe aktivitetet, dhe për çështjet me interes për refugjatët, dhe do të bëj çdo gjë për të përkrahur punën e Zyrës në dhënien e ndihmës dhe mbrojtjes.

2. ***Do të mbështes integritetin e UNHCR-së, duke u kujdesur që sjellja ime personale dhe profesionale të jetë, dhe si të tillë edhe të tjerët do ta shohin, e standardeve më të larta.***

Do të demonstroj integritet, sinqeritet, përkushtim dhe çiltërsi në veprimet e mia. Do të jem i/e durueshëm/me, me plot mirëkuptim dhe mirësjellje ndaj të gjithëve personave për/me të cilët punoj, përfshirë edhe refugjatët dhe personat e tjerë nën përgjegjësinë tonë, përfaqësuesit e partnerëve operativë dhe veprues, qeveritë dhe donatorët.

Do t'i respektoj ligjet lokale, do t'i përmbushi të gjitha obligimet private, juridike dhe financiare, dhe nuk do të kërkoj të nxjerri përfitim personal nga çfarëdo përparësi apo imunitet, që më janë akorduar në interes të Kombeve të Bashkuara. Do të përpiqem fuqimisht për të siguruar se qëndrimi i anëtarëve të familjes sime të mos reflektohet jofavorshëm në integritetin e UNHCR-së.

3. ***Do të kryej obligimet e mia zyrtare dhe zbatoj detyrat e mia personale në atë mënyrë që i shmangjet konfliktit të interesave dhe, në këtë mënyrë, do ta ruaj dhe përforcoj besimin e publikut në UNHCR.***

Veprimet e mia nuk do të kenë asnjë lidhje dhe asnjë interes për përfitim personal dhe do t'iu shmangem dhe kundërshtoj çdo trysni politike të paligjshme gjatë vendimarrjes. Nuk do të kërkoj dhe nuk do të pranoj urdhëra për veprimet e mia nga asnjë qeveri, përfshirë këtu edhe qeverinë e vendit tim, dhe nga asnjë autoritet tjetër jasht Kombeve të Bashkuara.

Në pajtueshmëri me Normat dhe Rregulloren e Personelit, nuk do të pranoj asnjë nder, stoli, dhuratë për favorizim, kompensim, nga asnjë qeveri; nuk do të pranoj asgjë nga të lartpërmendurat nga asnjë burim jasht Kombeve të Bashkuara, pa miratim apo autorizim paraprak. Nuk do të lëshohem në asnjë veprimtari apo punësim të jashtëm, pa miratim paraprak. Nuk do të pranoj pagesa apo subvencione shtesë nga asnjë qeveri dhe asnjë burim tjetër, dhe nuk do të marr pjesë në veprimtari të caktuara politike, sikurse janë kandidimi apo pranimi i pozitës zyrtare.

Do t'i shmangem ndihmës së personave privat apo ndërmarrjeve, në punën e tyre për UNHCR-në, që do të çonte në një trajtim preferencial të vërteta apo i perceptuar si i tillë. Kurrë nuk do të marrë pjesë në veprimtari dhe punë që ndërliken me furnizimin e mallit apo shërbimeve ose në aktivitete, që ndërliken me resurset humane ku do të kishte konflikt interesash.

4. Do të kontribuoj në ndërtimin e një ambienti të harmonishëm të punës, i themeluar në frymë të punës ekipore, mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë.

Do të tregoj respekt për të gjithë kolegët, pa dallim nga statusi apo pozita e tyre, dhe të gjithë kolegëve do t'iu lejoj dhe mundësoj që haptas t'i shprehin qëndrimet e veta dhe me diturinë dhe përvojën e tyre t'i kontribuojnë angazhimit dhe përpjekjeve të ekipit. Do të komunikoj haptas dhe do t'i përcjelli informatat relevante (duke u kujdesur për kërkesat e besueshmërisë) dhe do t'i ndaj ato me kolegët, dhe fuqimisht do të mundohem që t'iu përgjigjem dyshimeve.

Do të respektoj privatësinë e kolegëve të mi, dhe do t'i shmangem informimit të gabueshëm. Fuqimisht do të përpiqem në zbehjen e dallimeve dhe gjetjen e zgjidhjeve për problemet e shfaqura. Do t'i kontribuoj ndërtimit të dialogut konstruktiv, i udhëhequr nga respekti i ndërsjellë dhe përmes qasjes së çiltër dhe pozitive, në mes të udhëheqjes dhe përfaqësuesve të punëtorëve.

Si udhëheqës/përgjegjës do të jem i çiltër ndaj qëndrimeve dhe vështrimeve të të gjithë anëtarëve të ekipit. Do të reagoj dhe jap vërejtje për punën e kryer dhe rezultatet e arritura të secilit anëtar të ekipit, përmes udhëzimeve, motivimit dhe pranimit të plotë të meritave të anëtarëve të ekipit.

5. Do të promovoj sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e të gjithë personelit të UNHCR-së, si kusht i domosdoshëm për punë efikase dhe me rezultate të qëndrueshme.

Tërë kohën do t'i kem ndër mend dhe do të veproj në pajtim të vazhdueshëm me udhëzimet e parapara për mbrojtjen e shëndetit, mirëqenies dhe sigurisë sime. Gjatë vendimeve operative, gjithmonë do të marr parasysh sigurinë e personelit. Nëse parqitet ndonjë dyshim apo rezervë në lidhje me ndonjë udhëzim apo urdhër, për të cilin mendoj se paraqet kërcënim për sigurinë time apo sigurinë e të tjerëve, menjëherë do ta njoftoj përgjegjësin tim.

Si udhëheqës/përgjegjës, do të angazhohem fuqimisht për sigurinë e shëndetit dhe mirëqenien e anëtarëve të personelit dhe familjeve të tyre, që ata të mos i nënshtrohen rrezikut të panevojshëm. Do të angazhohem për një baraspeshë të shëndoshë në mes të punës dhe jetës së personelit, dhe do t'i respektoj të gjitha të drejtat që ata i gëzojnë.

6. Do t'i ruaj dhe shfrytëzoj me përgjegjësi informatat dhe burimet, tek të cilat kam qasje në bazë të punësimit tim në UNHCR.

Do të ushtroj kudes të duhur ndaj të gjitha çështjeve të punës zyrtare, dhe nuk do të zbuloj asnjë informatë të besueshme, që ndërlidhet me refugjatët, kolegët apo çështjet e tjera që kanë të bëjnë me punën, sipas normave dhe rregulloreve të personelit dhe udhëzimeve aktuale.

Do të mbroj, udhëzoj dhe do të shfrytëzoj burimet humane, financiare dhe materiale të UNHCR-së në mënyrë efikase dhe frytdhënëse, duke mbajtur mend se këto burime i janë dhënë në dispozicion UNHCR-së për të mirën e refugjatëve dhe personave tjerë nën përgjegjësinë e Komesariatit.

7. Do të parandaloj, kundërshtoj dhe luftoj çdo lloj të eksploatimit dhe shpërdorimit të refugjatëve dhe personave tjerë nën përgjegjësinë tonë.

Angazhohem se nuk do të keqpërdori fuqinë dhe ndikimin që kam në bazë të pozitës sime ndaj jetës dhe mirëqenies së refugjatëve dhe personave tjerë nën përgjegjësinë tonë.

Kurrë nuk do të pranoj asnjë shpërblim apo fitim nga refugjatët apo personat e tjerë nën përgjegjësinë tonë, si dëmshpërblim për mbrojtje apo ndihmë. Kurrë nuk do të lëshohem në asnjë lidhje apo marrëdhënie për eksploatim – seksual, emocional, finaciar, apo të ndërlidhur me punësim – të refugjatëve apo personave tjerë nën përgjegjësinë tonë.

Nëse do të ndodhem në një lidhje me ndonjë përfitues të ndihmës dhe/apo mbrojtjes sonë, për të cilën mëndoj se nuk ka të bëjë me eksploatimin dhe se është në bazë të vullnetit të dyanëshëm, këtë lidhje do ta paraqes te përgjegjësi im me qëllim të udhëzimeve të përshatshme dhe në dijeni se kjo lidhje do të mbahet dhe trajtohet me diskrecionin e duhur. Pajtohem dhe jam në dijeni se unë dhe përgjegjësit e mi kemi në dispozicion mekanizmat normale të konsultimit dhe mbështetjes për këto çështje.

Do të veproj me përgjegjësi kur i punësoj apo angazhoj refugjatët apo personat tjerë nën përgjegjësinë tonë, për kryerjen e punëve apo shërbimeve private. Do ta njoftoj me shkrim, përgjegjësin tim për natyrën dhe kushtet e një veprimi të tillë.

8. ***Do të përmbahem nga çfarëdo kyçje në veprime kriminale apo jomorale, në veprime që janë në kundërshtim me të drejtat e njeriut, apo veprime të cilat komprometojnë shëmbëlltërinë dhe interesin e UNHCR-së.***

Nuk do të përkrah dhe nuk do të kyçem në asnjë lloj veprimi jolegal, eksploatues apo keqpërdorues, përfshirë këtu edhe, për shembull, shfrytëzimin e fëmijëve si fuqi punëtore dhe trafikimin me njerëz apo robër.

Ashtu siç UNHCR iu është përkushtuar standardeve më të larta për mbrojtjen e fëmijëve dhe për kujdesin ndaj fëmijëve, jam i/e vetdijshëm/e se nga unë pritet të mos kyçem në aktivitete seksuale me asnjë person nën moshën 18 vjeçare. (Më tutje udhëzimet jaë paraqitur në Shënimet që i bashkangjiten këtij Kodi të mirësjelljes).

9. ***Do të përmbahem nga çfardo lloj i shqetësimit apo ngacmimit, diskriminimit, keqtrajtimit fizik apo verbal, frikësimit apo favorizimit në vendin e punës.***

Nuk do të lëshohem në asnjë lloj të ngacmimit në vendin e punës, dhe nuk do të toleroj veprime të tilla, përfshirë edhe ngacmimin seksual apo keqpërdorimin e forcës.

Si udhëheqës/përgjegjës, nuk do të kërkoj favore, shërbime, hua apo dhurata nga personeli, dhe nuk do të pajtohem, pa e kërkuar paraprakisht, të pranoj asgjë që ka vlerë më të lart se simbolike.

Pajtohem me faktin se ekziston një konflikt i qenësishëm i interesit si dhe që ekziston keqpërdorimi potencial për shfrytëzim të forcës, në rast se kam marrëdhënie seksuale me personelin nën përgjegjësinë time. Nëse gjendem në një marrëdhënie të tillë, do ta zgjidhë këtë konflikt të interesave pa hamendje dhe pa vonesë.

SHTOJCA 1.1

PARIMET THEMELORE TË KODIT TË MIRËSJELLJES

Eksplotimi dhe shpërdorimi seksual në situatat e krizave humanitare

Fragmente nga Plani Veprues i grupit punues IASC për mbrojtjen nga eksplotimi dhe shpërdorimi seksual në situatat e krizave humanitare

A. Parimet themelore të Kodit të mirësjelljes

Agjensionet humanitare e kanë për detyrë të kujdesen për përfituesit, duke iu siguruar tretman që ata të trajtohen me dinjitet dhe respekt, dhe t'u përmbahen standardeve minimale të sjelljes. Për të penguar eksplotimin dhe shpërdorimin seksual, është e nevojshme që të përfshihen parimet në vijim, në kodin e mirësjelljes së agjensioneve⁴⁹.

- Eksplotimi dhe shpërdorimi seksual nga ana e punonjësve humanitarë është shkelje e rëndë, dhe si e tillë është bazë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
- Aktiviteti seksual me fëmijët (personat më të rinj se 18 vjeç) është i ndaluar, pa marrë parasysh nëse ajo moshë konsiderohet si madhore në atë bashkësi lokale. Nuk pranohet si justifikim fakti se ka qenë bindja e gabuar për moshën e fëmijës.
- Është i ndaluar këmbimi i parave, punësimit, mallit dhe shërbimeve për seks, përfshirë këtu edhe shërbimet seksuale apo format tjera të sjelljes nënçmuese, degraduese apo eksploatuese. Kjo nënkupton edhe ndihmën, në të cilën përfituesit edhe ashtu kanë të drejtë.
- Marrëdhëniet seksuale të punëtorëve humanitarë me përfituesit janë shumë dekurajuese, sepse bazohen në raporte forcash qenësisht të pabarabarta. Marrëdhëniet e tilla nënvlerësojnë kredibilitetin dhe integritetin e punës humanitare.
- Kur një punëtor humanitar ndihet i/e brengosur, apo ka dyshim për eksplotim apo shpërdorim seksual nga ana e ndonjë kolegu, qoftë nga i njejtë agjencion ose jo, ai/ajo duhet ta paraqesi këtë dyshim përmes mekanizmave përkatëse të agjencionit, të caktuar për paraqitje.
- Punëtorët humanitarë kanë për detyrë të krijojnë dhe mbajnë ambient, i cili e parandalon eksplotimin dhe shpërdorimin seksual, dhe i cili promovon zbatimin e Kodit të tyre të mirësjelljes. Udhëheqësit, në të gjitha nivelet, kanë detyra specifike për të përkrahur dhe zhvilluar sisteme, të cilat mbajnë ambient të tillë.

⁴⁹ Duhet marrë parasysh faktorë të ndryshëm në zbatimin e disa nga këto parime tek punëtorët humanitarë të rekrutuar nga bashkësia e përfituesve. Derisa eksplotimi dhe shpërdorimi seksual, si dhe keqpërdorimi i ndihmës humanitare do të jenë gjithmonë të ndaluara, mund të aplikohet parimi i diskrecionit në zbatimin e parimeve që ndërlidhen me lidhjet seksuale për këtë kategori të punëtorëve humanitarë.

SHTOJCA 2
FORMULARI PËR PARAQITJEN E RASTEVE TË DHUNËS

Faqja 1 prej 4

Udhëzimet	Formularin e plotëson personi i emruar dhe profesional Originali i formularit ruhet në agjencionin e emruar (jashtë kampit). Kopja i dërgohet personit zyrtar të UNHCR-së, i ngarkuar për mbrojtje, në pliko të mbyllur dhe sa më parë që është e mundur (Nëse personi mbijetuar dëshiron t'ia paraqesi rastin policisë, oficeri i mbrojtjes duhet ta pranoi kopjen brenda 24 orëve). Nëse është e nevojshme, t'i bashkangjiten faqet shtesë, ku do të vazhdohet me përshkrimin e ngjarjes
VËREJTJE	<i>Ky formular NUK ËSHTË udhëzim për shënimin e bisedës informative. Personeli duhet të jetë i ushtruar në shkathtësinë e intervistimit të viktimave/personave të mbijetuar. Ekzistojnë formularë të veçantë për shënimin e të dhënave, lidhur me këshillat dhe vizitat mjekësore/shërimin.</i>

LLOJI I INCIDENTIT		Llojet e incidenteve sekundare
Numri afarist i rasteve	Kampi/Adresa (për rastet në mjediset e qytetit dhe të kthyerit)	Data dhe koha e intervistimit
Numrat afariste të rasteve të mëparshëm, që janë nëlidhshmëri me klientin (nëse ekzistojnë)		

TË DHËNAT PËR VIKTIMËN/PERSONIN E MBIJETUAR			
Emri:	Mosha:	Viti i lindjes:	Gjinia:
Adresa:	Prejardhja fisnore/etnike:	Martesa:	Profesioni:
Numri i fëmijve:	Mosha e fëmijve:	Kryefamilari (viktima OSE emri dhe në çfarë raporti është me viktimën):	
Shenja e UNHCR-së "lëndimi" (nëse është relevante):		Numri dokumentit për ndarjen e ushqimit, ose numri i legjitimacionit:	
Nëse i mbijetuari është fëmij: Emri i kujdestarit:			Në çfarë relacioni është me viktimën:

INCIDENTI		
Lokacioni	Data:	Koha:
Përshkrimi i incidentit (rrethanat, çka ka ndodhur saktësisht, çka ka ndodhur pas incidentit):		

Faqja 2 prej 4

TË DHËNAT PËR KRYESIN E VEPRËS			
Emri:	Numri i kryesëve të veprave:	Gjinia:	
Adresa:	Nacionaliteti:	Mosha:	Prejardhja fisnore/etnike:
Në çfarë relacioni është me viktimën/personin e mbijetuar:	Martesa:	Profesioni:	
Nëse kryesi veprës është i panjohur për viktimën përshkruani atë/ate, duke i shënuar tiparet fizike:			
Vendbanimi momental i kryesit të veprës, nëse dihet: A trajtohet edhe mëtej si kërcnues, kryesi veprës?			
Nëse kryesi veprës është fëmij, emri i kujdestarit:		Në çfarë raporti është me viktimën:	

DËSHMITARËT QË KANË PARË ME SY
Të përshkruhet prezenca e dëshmitarëve (përfshirë edhe fëmijët):
Emrat dhe adresat:

MASAT E NDËRMARRURA – çfardo masa të ndërmarrura, që nga data e plotësimit të këtij formulari		
Paraqitur (personi):	Data e paraqitjes	Masat e ndërmarrura
POLICIA Emri		
SHËRBIMI I SIGURIMIT Emri		
UNHCR Emri		
UDHËHEQËSIT LOKAL Emri		
SHËRBIMI SHËNDETËSOR Shiko faqen 3 të këtij formulari për emrin/informacionet.		
TË TJERA Emri		

MASAT E DUHURA PLOTËSUESE DHE MASAT E PLANIFIKUARA – duke filluar nga data e plotësimit të këtij formulari		
Vlerësimi i nevojave lidhur me sigurinë fizike dhe plani i drejtpërdrejt për aksion:		
A ka marrë viktimë ndonjë lloj të këshillave-nëse po, çfarë lloji?	Po	Jo
A dëshiron viktimë/personi mbijetuar ta paraqes rastin në polici?	Po	Jo
A kërkon që gjyqi tradicional/ gjyqi që pleqnon të ndërmarr masa përkatëse?	Po	Jo
Çfarë lloji të përcjelljes së mëtejme do zbatojë bashkësia/punëtorët që merren me dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar në përkatësinë gjinore?		
Cilat masa shtesë janë të nevojshme nga ana e UNHCR-së dhe/ose tjerat?		
Formularin e plotësoi (Emri të shënohet me germa shtypi	Nënshkrimi:	

Faqja 3 prej 4

RAPORT MBI VIZITËN MJEKËSORE

Faqja 1 dhe 2 (të plotësuara) +Faqja 3 (me plotësim të dy rreshtave të parë)duhet dorëzuar me dorë entit shëndetësor, në prezencë të viktimës/të mbijetuarës. Faqen 3 e plotëson personeli i entit shëndetësor. OSE, nëse viktimë/personi i mbijetuar nuk e ka kryer vizitën mjekësore, në kohën kur është paraqitur rasti, të shpjegohet poshtë për çfarë arsye.

